

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP
FAKULTETI I SHKENCAVE ISLAME – SHKUP

ROLI I ISLAMIT NË MBROJTJEN E IDENTITETIT SHQIPTAR NË MAQEDONI

(konferencë e mbajtur më 13 qershor 2019)

27



Shkup, 2019

Boton:
INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP
FAKULTETI I SHKENCAVE ISLAME – SHKUP

Vëllimi 27 – 2019
Biblioteka: **SCUPI**

Për botuesin:
Dr. Skender Asani
Dr. Shaban Sulejmani

Këshilli redaktues:
Dr. Qerim Lita
Dr. Shenasi Memeti
Dr. Zeqirija Ibrahim
Dr. Ismet Osmani
Dr. Abdulxhemil Nesimi
Dr. Murtezan Idrizi

Copyright©ITSHKSH, 2019
Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për botuesin.

ISBN: 978–608–4653–98–1

www.itsh.edu.mk

Ky botim financohet nga :



Republika e Maqedonisë së Veriut

Ministria e Arsimit dhe Shkencës

INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP
FAKULTETI I SHKENCAVE ISLAME – SHKUP

ROLI I ISLAMIT
NË MBROJTJEN E
IDENTITETIT SHQIPTAR
NË MAQEDONI

(konferencë e mbajtur më 13 qershor 2019)

27

SCUPI

Shkup, 2019

TRYEZA E LËNDËS:

HYRJE	7
Skender ASANI – FJALË PËRSHËNDETËSE	9
H. Sulejman ef. REXHEPI – FJALË PËRSHËNDETËSE	13
Shaban SULEJMANI – FJALË PËRSHËNDETËSE	15
Milazim KRASNIQI : ROLI INTEGRUES DHE ILUMINUES I ISLAMIT NDËR SHQIPTARË, SI ALTERNATIVË E ASIMILIMIT NGA SLLAVËT DHE HELENËT	17
Shaban SULEJMANI : MBI LIBRAT FETARË ISLAMË NË GJUHËN SHQIPE	24
Qerim LITA : SHPËRNGULJA E SHQIPTARËVE MYSLIMANË NË TURQI DHE ROLI I ULEMAVE NË PENGIMIN E SAJ	30
Naim HALIMI : PRIJËSIT FETARË KUMANOVARË NË MBROJTJE TË IDENTITETIT KOMBËTAR – AZEM HOXHA....	50
Naser RAMADANI & Avni AVDIU : KONTRIBUTI I MEDIEVE TË KUMANOVËS NË NGRITJEN E VETËDIJES FETARE NË MAQEDONI DHE JASHTË SAJ	60
Sadik MEHMETI : SHKOLLA NORMALE – DÂRULMUALLIMÎN E SHKUPIT (1882–1912) DHE ROLI I SAJ NË ARSIMIMIN KOMBËTAR SHQIPTAR	73
Abdulkhemil NESIMI : KONTRIBUTI I ABDYLHAQIM DOGANIT PËR ZHVILLIMIN E GJUHËS SHQIPE DHE PËR ARSIMIN KOMBËTAR.....	85
Nuridin AHMETI : ROLI I KRERËVE FETARË MYSLIMAN TË MAQEDONISË NË UNIFIKIMIN E ALFABETIT TË GJUHËS SHQIPE MË 1908.....	97
Shinazi MEMEDI : ORGANIZIMI INSTITUCIONAL I BASHKËSISË FETARE ISLAME TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË.....	113

Isamedin AZIZI: KONFLIKTE RRYMASH NË JETËN FETARE E POLITIKE TË SHQIPTARËVE TË MAQEDONISË.....	141
Zeqirija IBRAHIMI: SHITESAT IDENTITARE TË SHQIPTARËVE MYSLIMANË NË MAQEDONI	153
Qenan ISMAILI: ROLI I XHAMISË NË MBROJTJEN E IDENTITETIT KOMBËTAR SHQIPTAR NË MAQEDONI	166
Murtezan IDRIZI: VEPRIMTARIA KOMBËTARE DHE FETARE E XHEMAL EFENDISË NË BURIMET ARKIVORE	174
Muzemil OSMANI: NJË PERSONALITET I TRADITËS DHE I FESË NË SHËRBIM TË KOMBIT DHE TË MIRËQENIES SHOQËRORE	196

HYRJE

Pasi që kishte realizuar një sërë aktiviteteve shkencore e kulturore, edhe me komunitete të ndryshe fetare, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve ndjente për detyrim shkencor që të vendosë ura bashkëpunimi dhe të realizojë projekte të përbashkëta edhe me komunitetin më të madh fetar shqiptar në Maqedoni, pra me Bashkësinë Fetare Islame, respektivisht me Fakultetin e Shkencave Islame si njësi e saj.

Dhe, falë angazhimit të dyanshëm, u arrit të nënshkruhet një protokoll i përbashkët për bashkëpunim, ndërsa – si rezultat i këtij memorandum, më 13 qershor 2019 u organizua edhe konferenca shkencore me titull “Roli i Islamit në mbrojtjen e identitetit shqiptar në Maqedoni”. Duke qenë një organizim i përbashkët, palët ranë dakord që pjesëmarrësit në këtë konferencë të propozohen nga të dyja institucionet dhe kështu u bë që në konferencën në fjalë u lexuan gjithsej 16 kumtesa, nga të cilat për botim na kanë arritur 14. Në konferencë, përveç studiuesve të vendit, morën pjesë edhe studiues të njohur të kësaj teme nga Kosova.

Në konferencë ishte i pranishëm edhe kreu Bashkësisë Fetare Islame në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Reis ul-Ulema H. Sulejman ef. Rexhepi, i cili i përshëndeti punimet e konferencës, ndërsa fjalë përshëndetëse patën edhe drejtori i Institutit, dr. Skender Asani, dhe dekani i FSHI-së, Dr. Shaban Sulejmani.

Kumtesat që u lexuan ishin jo vetëm risi shkencore, por edhe një kontribut i rëndësishëm për shkencën dhe një sihariq për trashëgiminë e pasur islame shqiptare, që pret të hulumtohet. Këto

tekste, pasi që janë redaktuar dhe përgatitur teknikisht, tash po i prezantohen opinionit shkencor, duke u shndërruar kështu në pronë intelektuale e këtyre dy institucioneve dhe mundësi referimi dhe diskutimi për të gjithë studiuesit dhe hulumtuesit e kësaj teme.

Gusht 2019

Këshilli organizues

FJALË PËRSHËNDETËSE

I nderuari Reis ul–Ulema i Bashkësisë Fetare Islame në Republikën e Maqedonisë, H. Sulejman ef. Rexhepi,

I nderuari dekan i Fakultetit të Shkencave Islame, prof. dr. Shaban Sulejmani

Të nderuar myftinj, teologë, profesorë e kolegë të Prishtinës dhe të vendit, si dhe ju mysafirë të dashur.

Kam kënaqësinë që sot po ju flas në cilësinë e të zotit të shtëpisë në hapjen e kësaj konference, duke ju dëshiruar para së gjithash mirëseardhje në Institutin tonë dhe duke uruar që kjo konferencë të jetë e mbarë dhe e frytshme. Këtu më duhet të theksoj se Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, si një vatër që kujdeset për krejt trashëgiminë shpirtërore e kulturore të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, përveç shumë aktiviteteve të ndryshme që ka realizuar me institucione shkencore e arsimore, por edhe me komunitete të ndryshme fetare, duke u kujdesur edhe për grupet më të vogla shoqërore, gjithnjë ka synuar që të organizojë diçka edhe komunitetin më të madh të përkatësisë religjioze të shqiptarëve në Maqedoninë e Veriut, pra me elementin mysliman. Për këtë arsye, përveç marrëdhënieve të mira e miqësore që i kemi kultivuar me institucionin e Bashkësisë Fetare Islame, ne tashmë kemi vendosur bashkëpunim formal edhe me Fakultetin e Shkencave Islame, si institucioni më i lartë arsimor e shkencor i këtij komuniteti dhe në sajë të këtij protokolli, ne sot jemi në këtë konferencë. Me këtë rast dëshiroj të shpreh kënaqësinë time nga

bashkëpunimi i deritanishëm dhe të uroj që kjo frymë të vazhdojë edhe në të ardhmen.

Sa i takon pjesës së konferencës, do të më lejoni të them dy—tri fjalë në këtë fjalë rasti. Siç tashmë e dimë mirë ne historianët, pas largimit të Perandorisë Osmane, në vjeshtën e vitit 1912 në këto hapësira u vendos pushteti serb, që fillimisht u quajt Mbretëria Serbo—Kroate—Sllovene e pastaj Mbretëria e Jugosllavisë. Në fakt, Beteja e Kumanovës, në shtator të 1912—tës, ishte fillimi i planit për krijimin e Serbisë së Madhe, që nuk ka reshtur as sot e kësaj dite bile. Dhe, meqë shqiptarët ishin dhe janë ata që fizikisht gjenden në rrugë si pengesë për realizimin e këtij plani, ata u bënë edhe caku i goditjeve serbe dhe ata pësuan me shpërngulje të dhunshme, asimilim, kolonizim, reformë agrare, por edhe barbari të tjera, si masakra e tmerre, që kanë vazhduar deri më 1999 në luftën e fundit në Kosovë. Kur jemi këtu, duhet ta themi pa ngurrim, sepse e kemi edhe detyrim shkencor dhe kombëtar, se derisa gjatë kësaj fushate elementi shqiptar i krishterë gati se nuk mbijetoi dhe u asimilua thuajse plotësisht, shqiptarët myslimanë gjetën shpëtim nga ky asimilim pikërisht në përkatësinë e tyre fetare islame. Islami, në një mënyrë, u bë mburoja e identitetit etnik shqiptar. Kështu, përkundër krejt planeve ekspansioniste dhe asimiluese, që i shkrinë gati se krejt shqiptarët ortodoksë, ndërsa e rrudhën shumë elementin shqiptar katolik, shqiptarët myslimanë të këtyre hapësirave mbijetuan dhe ata sot vazhdojnë t'i ruajnë vatrat e tyre stërgjyshore dhe kujdesën e vijimësisë etnike shqiptare.

Për hir të së vërtetës, edhe presioni komunist nuk ishte aspak më i vogël, që filloi me heqjen e ferexhesë, kufizimin e fesë, rrënimin e xhamive, e deri në prishjen e mureve në fund të viteve të '80—ta, që po ashtu ishin masa presioni, të cilat megjithatë nuk ia dolën ta

shuajnë identitetin e shqiptarëve në këtë hapësirë. E kur jemi në këtë periudhë, do të duhet të themi se ishin pikërisht një plejadë hoxhallarësh dhe veprimtarësh, që mundësuan ruajtjen e indit kombëtar, shpesh edhe duke e konservuar dhe ndoshta edhe duke e izoluar, për ta ruajtur ashtu bërthamën etnike të pastër për rrethana të tjera. Medresetë, mejtepet dhe xhamitë u bënë vatra që e kultivuan këtë identitet dhe mundësuan që, duke e ruajtur dallimin me të tjerët, shqiptarët të dalin në shekullin e ri me identitet të konsoliduar dhe me pjekuri politike e kulturore.

Shikuar në këtë kontekst, pas gjithë kësaj perspektive historike, Islami për shqiptarët tashmë nuk është diçka e huaj, fragment i ngjitur në identitetin tonë, porse Islami paraqet element të pandashëm të këtij identiteti. Madje, të jemi krejt të sigurtë, ne historianët dhe studiuesit shqiptarë të kësaj hapësirë i detyrohemi shumë këtij përcaktimi dhe neve na mbetet barra që në të ardhmen ta afirmojmë këtë të vërtetë.

Këtu më duhet ta theksoj edhe një tezë shpesh të gabuar që e lidh identitetin islam të shqiptarëve me shtetin turk. Madje, kjo ka qenë edhe arsyeja që pushteti serb dhe ai komunist, më vonë, të organizojnë shpërnguljen e dhunshme të shqiptarëve myslimanë, kjo me pretekstin se po i kthejnë shqiptarët në vendin e tyre amë. Prandaj ishin edhe detyrimet për regjistrim me përcaktim tjetër etnik e kështu me radhë. Por, e vërteta është se derisa në Turqinë republikane identiteti islam u shty në margjinë, te shqiptarët myslimanë në këto hapësirë ai u bë strumbullar që e ruajti identitetin kombëtar. Pra, nuk ishte arsye feja për shpërngulje, por ishte arsye politika ekspansioniste dhe kolonizuese ajo që e stimulonte shpërnguljen.

Sidoqoftë, që nga luftërat ballkanike, themelimi i Xhemijetit, beteja për Burmalin Xhaminë si identitet i Qytetit, deri te medreseja “Medah” dhe ajo e “Isa Beut”, janë një varg veprimtarësh, personalitetesh dhe veprash që presin nga ne t’i studiojmë dhe t’i ndriçojmë, sepse – thënë troç – pa to nuk mund të imagjinohet historia jonë kombëtare në Maqedoni.

Para se të përfundoj, do të më lejoni të them se ne si Institut ia kemi vënë vetes për detyrë që në të ardhmen ta shkruajmë edhe historinë e plotë të shqiptarëve në Maqedoni dhe këto konferenca do të jenë sigurisht material i rëndësishëm për ta bërë një vepër të tillë. Qasja jonë nuk do të jetë përjashtuese, subjektive dhe ideologjike. Ne jemi të interesuar ta zbardhim të vërtetën dhe përtej të vërtetës nuk duam t’ia dimë për asgjë.

Për këtë arsye që këtu ju ftoj që Institutin e Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve ta ndjeni si shtëpinë tuaj, ku gjithnjë do ta gjeni dorën e bashkëpunimit dhe komunikimit pa asnjë ngurrim dhe hezitim. Ky institut është meritë e popullit shqiptar në Maqedoni dhe ne jemi të vendosur që t’i shërbejmë këtij populli dhe të vërtetës për të.

Duke mos dashur ta zgjas, dëshiroj t’ju falënderoj të gjithëve që sot jeni këtu dhe t’ju premtoj se ky është vetëm fillimi. Neve na presin edhe shumë punë.

Suksese konferencës dhe ju faleminderit!

Dr. Skender Asani,

*Drejtor i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore
e Kulturore të Shqiptarëve*

Shkup, 13.06.2019

FJALË PËRSHËNDETËSE

Fort të nderuara zonja dhe zotërinj,
miq dhe dashamirë të mendimit shkencor,
të respektuar z. Skender Asani, drejtor i Institutit të Trashëgimisë
Kulturore të Shqiptarëve dhe z. Shaban Sulejmani, dekan i
Fakultetit të Shkencave Islame,
pjesëmarrës dhe mysafirë të konferencës që i kushtohet rolit të
Islamit në mbrojtjen e identitetit shqiptar në Maqedoni
paqja dhe mëshira e Zotit qofshin mbi ju!

Kam nderin dhe privilegjin ta përshëndes këtë konferencë që do
trajtojë një temë kaq të rëndësishme, siç është kjo që është zgjedhur
për trajtim dhe që mëton të ndriçojë sadopak shkencërisht një
segment të kulturës e të traditës sonë, e cila, mjerisht, jo rrallëherë
është keqinterpretuar në të kaluarën.

Në fakt, unë jam i ngazëllyer nga mundësia që po na ofrohet neve
dhe mbarë opinionit të dëgjojmë vlerësimet e shkencëtarëve e
intelektualëve shqiptarë të proveniencës islame dhe asaj profane
lidhur me rolin, pa dyshim të rëndësishëm, që ka pasur Islami në
mbrojtjen dhe kultivimin e ndjesisë dhe identitetit shqiptar këtu në
Maqedoni.

Në situata dhe raste të ndryshme, për aq sa kam ditur, edhe vetë
kam bërë përpjekje të flas e të shkruaj mbi këtë çështje, por këtë
konferencë e konsideroj si një mundësi të veçantë për të dëgjuar e
për të mësuar diçka të re. Pra, diçka që do ta begatojë dhe forcojë

vetëdijen dhe ndërgjegjen tonë lidhur me relacionin e shqiptarëve të Maqedonisë me Islamin, në përgjithësi, dhe me impaktin që ai, historikisht, e ka pasur në mbrojtjen dhe zhvillimin e identitetit të popullit shqiptar.

E ky popull, shpirti i njeriut shqiptar të Maqedonisë, ndër shekuj në këto anë është ndihmuar nga përkatësia e vet islame, që të tejkalojë sfidat e shumta dhe t'u mbijetojë furtunave që e kanë kërcënuar ta gllabërojnë identitetin dhe lashtësinë shqiptare.

Duke qenë fe që i njeh dhe respekton dallimet mes popujve dhe kulturave, Islami ka qenë digë që e ka mbrojtur identitetin shqiptar dhe ka lënë gjurmë të fuqishme në kujtesën tonë kolektive. Një meritë e këtillë madhore ndoshta dikur i është mohuar Islamit, por ja që sot mendimi i lirë dhe i shëndoshë shkencor gjithnjë e më shumë po i ndriçon dhe po i drejton paqartësitë dhe deformitetet e të kaluarës.

Ju uroj punë të mbarë dhe suksese. Paçit edhe shumë konferenca shkencore në të ardhmen. Unë ju përgëzoj për kontributet e juaja të sotme e të ardhme. Dijetarët kanë vend të veçantë te Allahu xh.sh.

Urime dhe suksese!

H. Sulejman ef. Rexhepi,

*Reis ul-Ulema i Bashkësisë Fetare Islame
në Republikën e Maqedonisë së Veriut*

Shkup, 13.06.2019

FJALË PËRSHËNDETËSE

I nderuari Reis ul–Ulema i Bashkësisë Fetare Islame, H. Sulejman ef. Rexhepi,

I nderuari drejtor i Institutit të Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve, Dr. Skender Asani,

Të nderuara zonja dhe zotërinj,

Kjo konferencë sot, ku marrin pjesë studiues të shquar të fushave të ndryshme, do të promovojë dhe shpalos fakte historike, dokumente për të kaluarën e lavdishme të popullit shqiptar, por do të jetë edhe një shtytje që ta njohim të ardhmen. Megjithatë, një të ardhme, që fillon nga e kaluara jonë e lavdishme. Kushti është ta duam të kaluarën ashtu siç është, pa mbetur në qerthullin e pyetjeve të brezave të shkuar. Të dashur miq, kam bindjen se në këtë konferencë, që pastaj të gjitha kumtesat do të botohen në një përmbledhje, në hollësi do të spikatet ideali i gjithë baballarëve të kombit tonë.

Këto kumtesa do të jenë një thesar depozitimi të kujtesës së shqiptarët, kudo që ishin, derdhën gjakun jo vetëm për të mos e gëlltitur harresa, por për një ideal të vetëm për një Shqipëri të mosvarme, siç thuhet në Aktin e Pavarësisë. Sepse shqiptarët, kudo që janë, qoftë jashtë trungut të tokës arbnore, në diasporë e gjetkë, me xhelozë e ruajtën kujtesën për atdheun – Shqipërinë, për gjuhën e pastër shqipe dhe se Manastiri është vendlindja e alfabetit të gjuhës së tyre.

Sot, edhe një fëmijë me një kureshtje të jashtëzakonshme, mëson shumë dhe gjithçka që mëson, që njeh, që e vëzhgon, e ngulit në kujtesën e tij se, motoja “*Për fë e atdhe*” na shpie nëpër histori, duke na njohur, mësuar e përdëftuar rolin e madh të rilindësve shqiptarë, të hoxhallarëve, myderrizëve e imamëve, që për prijës e kishin plakun Ismail Qemalin e Haxhi Vehbi Dibrën me shokë. Janë këto emra këto të pazëvendësueshëm, që e ngritën flamurin e pavarësisë në Vlorë më 1912, bashkë me bashkëmendimtarët e tyre, me ideatorët e shtetit të pavarur shqiptar dhe bënë që ardhmëria e shtetit të mos mbetet e panjohur.

Prandaj, të dashur miq, uroj që kjo përmbledhje punimesh, që do të dale nga kjo konference, të zë vend të merituar në bibliotekat tuaja dhe në bibliotekat kombëtare e universitare.

Uroj që ky mund i juaj të jetë motiv që shqiptarët kudo që janë, të jenë pjesë e “*dritës që lind andej ku perëndon*”, siç do të shkruante Naim Frashëri për Europën. Uroj të mos na mbetet peng amaneti i baballarëve të kombit për ta integruar vendin tonë në familjen e madhe europiane, sepse këtë gjë ua kemi borxh pasardhësve tanë.

Dr. Shaban Sulejmani

Dekan i Fakultetit të Shkencave Islame – Shkup

Shkup, 13.06.2019

MILAZIM KRASNIQI

Universiteti i Prishtinës – Prishtinë

ROLI INTEGRUES DHE ILUMINUES I ISLAMIT NDËR SHQIPTARË, SI ALTERNATIVË E ASIMILIMIT NGA SLLAVËT DHE HELENËT

Islami ndër shqiptarë, përfshirë edhe viset ku jetojnë në Maqedoninë e sotme, ka kontinuitet, që është zhvilluar pa ndërprerje që nga shekulli XV e deri në ditët tona, duke ushtruar një ndikim esencial në mbijetesën dhe në formësimin e identitetit fetar, kulturor dhe kombëtar. Mund të bëhen gjithfarë hamendësimesh se cila do të ishte rruga jetësore dhe fati historik i shqiptarëve po të mбетeshin jashtë rrezes së mesazhit Hyjnor Islam, në darat e hekurta të ordodoksisë bizantine e sllave, të cilat, aq sa është parë në shekujt para ardhjes së osmanëve, synonin asimilimin dhe zhdukjen e plotë kulturore dhe etnike të shqiptarëve. Po qe se merret si pikënisje e vlerësimit të perspektivës së shqiptarëve në sfondin bizantin e sllav, gjendja në të cilën ishin ata kur erdhi në trojet e tyre mesazhi islam, është krejt e qartë se ajo gjendje do të çonte më tutje në zvogëlimin numerik dhe asimilimin e vazhdueshëm gjuhësor e kulturor të shqiptarëve. Mungesa e plotë e dëshmive të shkrimeve shqipe, madje mungesa e gjurmëve kulturore të shekujve VII–XIV, ku bie edhe sllavizimi i toponimeve, madje edhe i patronimeve të shqiptarëve, zbulojnë qartë atë katandisje, e cila e thellonte edhe më tutje asimilimin që kishte përhapur romanizimi. Dëshmitë për shkallët e lartë të romanizimit janë të shumta. Peter Bartli njofton: “*Në momentin e pushtimit turk (përfundimisht më 1455) shqiptarët*

përbënin 4–5 % të popullsisë së gjithmbarshme të Kosovës. Këta shqiptarë, siç dëftojnë regjistrat turk, atëbotë i ishin nënshtruar procesit të sllavizimit. Ata mbanin emra sllavë e vetëm emri atëror dëshmonte nganjëherë prejardhjen shqiptare (Bogdani, biri i Arbanasit, Bozhidari i biri i Gjonit, e kështu me radhë. Pushtimi turk i dha fund këtij procesi të sllavizimit.”(Bartl: 6)

Nëse gjetja e Bartlit është e saktë, atëherë i bie që ardhja e osmanëve, shqiptarët në këto vise, që sot emërtohen si pjesë e Maqedonisë së Veriut, por që më herët ishin pjesë e Dardanisë, i gjeti në grahmat e fundit në asimilimit në sllavë. Në fakt, konstatimi i Bartlit është i bazuar, ngase metodat dhe njetet e asimilimit sllavë ishin brutale. Kjo gjë kuptohet fare mirë nga termat në Zakonikun e car Dushanit. Në të ndalohej çdo lloj praktikimi fetar, përveç atij ortodoks serbe, prandaj ortodoksët epirotas, arbër, maqedonas ose sido që të vetëquheshin, ishin të detyruar t'i nënshtrohen diktatit të Kishës Serbe dhe të shtetit serb. Termat e Zakonikut të tij zbulojnë qartë përndjekjen e besimtarëve të doktrinës latine dhe të herezisë bogumile.

Ligji i Car Dushanit që në nenin e parë e afirmon synimin e “pastrimit” të fesë së krishtere (të ortodoksisë), nga herezia latine:

“1. Për krishterimin: pikë së pari për krishterimin. Në këtë mënyrë të pastrohet krishterimi.”

Në pajtim me idenë kryesore, të pastrimit të krishterimit, në disa nene, veçmas në nenet 6, 7, 8 dhe 10, urdhërohen masa kundër herezisë latine, përkatësisht për kthimin me dhunë të të gjithë njerëzve në ortodoksi:

6. Për herezinë latine: Dhe për herezinë latine, që i kanë kthyer të krishterët në bogumilë, të kthehen sërish në krishterim, nëse gjen-

det dikush që dëgjon dhe nuk kthehet në krishterim, të dënohet ashtu si shkruan në ligjin e etërve të shenjtë.

7. Për herezinë latine: Dhe të nxjerrë Kisha e Madhe protopopët në të gjitha qytetet dhe në të gjitha sheshet, që të kthejnë krishterët nga herezia latine, ata që janë kthyer në fenë latine, dhe t'u jepet urdhër i shenjtë dhe të kthehet secili në krishterim.

8. Për popin latin: Edhe popi latin, nëse gjendet, duke kthyer të krishterët në fenë latine, të dënohet sipas ligjit të etërve të shenjtë.

10 Për heretikun: Dhe nëse ndokush gjendet si heretik, duke jetuar në mesin e të krishterëve, të damkoset nëpër fytyrë dhe të dëbohet, ndërsa kush do ta fshehte, edhe ai të ndëshkohet. (Krasniqi: 48–49)

Zbatimi i këtij ligji brutal në trevat dardane/arbre/epirote, treva që sot emërtohen si shqiptare, pashmangshëm ka sforcuar asimilimin e tyre në serbë. Pas vdekjes së Dushanit dhe fillimit të shpërbërjes së shtetit serb, filloi një tendencë e konsolidimit të arbërve, por ajo ishte jetëshkurtër dhe e ndikuar nga pasojat që kishte lënë fragmentimi nën sundimin serb.

Pasoja e fragmentimit, që ishin imponuar nga sundimi serb, nga tendencat asimiluese, kuptohen edhe nga emërtimet që përdorëhin, *arbër, alban, epirotas, magedonas*. Emri shqiptar, si emër që integroi fise, rajone e etni, erdhi më vonë dhe pastaj mbuloi mbarë hapësirën shqiptare, erdhi falë ndryshimeve që ndodhën në terren, pas kalimit të një numri significant shqiptarësh në Islam.

Triumfi i emrit të ri, emrit shqiptar, në raport me emrat pararendës, *arbën, epirotë* ose edhe *magedonas*, i farkuar nga materiali gjuhësor i shqipes, ka mundur të ndodhte vetëm pas ndryshimeve të mëdha që kanë pasur ndikim të fortë mbi tërësinë e vlerave, pas rënies së tyre nën sundimin e plotë osman. Futja e të gjitha hapësirave arbë

nën sundimin osman, veçmas pas rënies së Shkodrës më 1479, me gjithë konsekuencat demografike, kulturore e fetare që pati ky proces, e eliminoi fragmentimin e këtyre hapësirave dhe emërtimet e ndryshme që përdorehin. Ndërkaq, procesi i kalimit në Islam i një pjese të konsiderueshme të popullsisë solli edhe një realitet të ri, i cili duhej të refleктоhej edhe në vetëpërceptimin, po edhe në emërtimin e këtij formacioni të ri, me synimin që e gjithë etnia të kishte një emërtim integruar. Mendojmë se emërtimi i ri vetëm për gjuhën si *shqip*, ka ndodhë për dy arsye. **E para**, ngase në pikëpamje etnike dhe etnografike nuk kishte ndodhur ndonjë ndryshim, që do të meritonte të kishte një emërtim të ri. Pra, banorët ishin po ata në pikëpamje etnike dhe etnografike dhe ende nuk kishin nevojë për një emërtim të ri. Por, tek ata kishte ndodhur një ndryshim në aspektin fetar: një numër i konsiderueshëm i banorëve, që quheshin arbër e epirotë, e kishin përqafuar Islamin si fenë e tyre të re, ndërsa ky ndryshim kishte pasur implikime gjuhësore, prandaj edhe fillimisht kishte kërkuar një emërtim të ri për gjuhën. Si? Për ndryshim nga feja katolike dhe ajo ortodokse, që kishin një kler të qendëruar dhe që në liturgji praktikonin vetëm gjuhën latine, përkatësisht greke (ose sllave në trevat e sunduara nga serbët), feja Islame, e cila ishte përhapur tashmë në një pjesë të popullsisë që emërtoheshin si arbëre (albane) dhe epirote, nuk praktikoheshin në gjuhën e sunduesit osman. Gjuha e fesë islame ishte gjuha arabe, e cila nuk kishte përhapje entuziaste as në vetë Perandorinë Osmane e aq më pak në territoret periferike, si tokat arbëre/epirote, që sundoheshin prej saj. Në këso rrethanash, shqiptarët e konvertuar në Islam, në mënyrë radikale u shkëputën nga latinishtja, përkatësisht nga greqishtja e sllavishtja, dhe filluan të komunikonin në jetën fetare e edhe publike në gjuhën shqipe, e cila doli si element i ri i identitetit të tyre fetar, që ishte veçuar nga identiteti katolik dhe ai ortodoks. Këta

muslimanë shqipfolës, që po diferencoheshin qartë fetarisht nga katolikët dhe nga ortodoksët, që praktikonin fenë në latinishte, përkatësisht greqishte ose sllavishte, u bënë njësia e afirmimit të gjuhës shqipe në një mjedis multigjuhësor. Ata po flisnin shqip, që të shprehnin identitetin e vet fetar të ndryshëm nga pjesëtarët e etnisë së njëjtë, por që tashmë fetarisht ishin të ndryshëm. Sikundër u tha më lart, ata që e përqaftuan Islamin, nuk kishin një gjuhë të ngulitur të fesë në atë periudhë, prandaj ata flisnin shqip, duke u dalluar në atë mënyrë nga të krishterët, që praktikonin në jetën fetare latinishten e greqishten (sllavishten). Ndryshime të tjera, përveç këtij ndryshimi fetar, nuk ka pasur në kohën kur ndryshoi emri i gjuhës nga *arbëre* në *shqipë* dhe emri i etnisë nga *arbër* e *epirotas* në *shqiptar*. Nëse kjo hipotezë e jona vërtetohet edhe me fakte të tjera, do të rezultonte që feja islame e stimuloi afirmimin dhe zgjerimin e gjuhës shqipe dhe integrimin kombëtar. Pra, do të rezultonte edhe se kombit shqiptar, që u formua në mesin e shekullit XIX, emri iu ngjiz nga ky proces diferencimi brenda etnik, pasi që ishte krijuar një ekuilibër i ri fetar brenda etnisë, që deri në atë kohë kishte mbajtur dy emra të ndryshëm për një etni të vetme.

Islami u ofroi shqiptarëve të Mesjetës së errët evropiane një vizion të ri për misionin e njeriut në këtë botë, para së gjithash duke ua fiksuar në ndërgjegjen e tyre të vërtetën për njëshmërinë e Krijuesit të Botëve. Të ndërgjegjësuar nga kjo aksiomë për njëshmërinë e Krijuesit, shqiptarët muslimanë u larguan nga konceptimi skizofrenik për Krijuesin. Ky largim nga konceptimi skizofrenik për Krijuesin u dha një kompaktësim në ndërgjegje, i bëri më të durueshëm e më të qëndrueshëm në fatet e tyre si sprovë e re e aftësisë së mbijetesës fizike dhe kombëtare pas daljes me përdhunë nga ombrella e

hilafetit islam. Edhe besimi i patundur në botën e amshueshme, në ahiret, si vazhdimësi e jetës në nivel dhe në përmbajtje më të lartë për besimtarët, që e gjejnë mëshirën e Krijuesit të Botërave, u ndihmoi që të dilnin nga vorbullat e nihilizmit të të ashtuquajturit faj fillestar, i cili ushtron ndikim të fuqishëm në ndërgjegjen e të krishterëve. Ndërkaq, namazi dhe agjërimi i Ramazanit u sollën atyre shqiptarëve që përqafulan Islamit një botëkuptim të ri për adhurimin ndaj Krijuesit të tyre, duke u edukuar me disiplinë, durim dhe sakrificë. Edhe praktika e zekatit u dha besimtarëve muslimanë një vizion të ri të solidaritetit me njëri-tjetrin, duke e hequr bamirësinë nga niveli i përkatësisë fisnore e duke e bërë atë detyrim për hir të All-llahut ndaj të gjithë nevojtarëve. Ky horizont i ri i bamirësisë dhe solidaritetit ka pasur ndikime pozitive në zgjerimin e njohjeve dhe të komunikimeve brendashqiptare, të cilat me shekuj kanë qenë të konservuara në korniza të ngushta fisnore. Kësisoj, njohja e shtyllave të Islamit dhe organizimi për shekuj të tërë i jetës në bazë të udhëzimeve kur'anore pati ndikim të fuqishëm në formësimin e individit shqiptar, në strukturën e familjes shqiptare dhe, pjesërisht, të shoqërisë shqiptare.

Shqiptarët që hynë në shekullin XIV nën Perandorinë Osmane si një popull i pushtuar dhe i defaktorizuar e në një proces të asimilimit, në fund të shekullit XIX dhe fillim të shekullit XX, kur dolën prej Perandorisë Osmane, ishin një komb i konsoliduar, që ishte i aftë të luftojë edhe me vetë Perandorinë Osmane.

Fakti që Shkupi ishte kryeqytet i Vilajetit të Kosovës dhe Manastiri një nga qendrat kulturore të Rilindjes Kombëtare është provë se hapësira e sotme, ku jetojnë shqiptarët në Maqedoni, ishte pjesë integrale e identitetit islam e shqiptar dhe gjenerator i lëvizjeve nacionale. Jahja Kemal në kujtimet e tij e kujton Shkupin si qytet

me shqiptarë krenarë e nazeli, të cilëve nazet ua respektonte edhe sulltan Abdylhamidi. Po ashtu ai pohon se shqiptarët, faktikisht, trajtoheshin nga turqit si evropianë.

Thënë shkurt, Islami i ndihmoi edhe kësaj hapësire që të shpëtonte nga helenizimi dhe nga sllavizimi dhe që të dilte në skenën e historisë së re si pjesë dinamike e Rilindjes Kombëtare dhe e kombit shqiptar dhe e fesë islame si fe dominuese ndër shqiptarë. Gjithsesi, me fenë islame si pjesë signifikante të identitetit të vet. Ashtu si është edhe sot, kur falë këtyre shqiptarëve muslimanë, Maqedonia e Veriut po ecën drejt anëtarësimit në NATO e në BE. Këta shqiptarë muslimanë i shpëtuan edhe sllavomaqedonasit nga presioni dhe bllokimi helenist dhe po i mbrojnë edhe nga kërcënimi pansllavist. Ndërkaq, në të njëjtën kohë vazhdojnë të jenë njëra nga shtyllat e forta të kombit tonë shqiptar.

SHABAN SULEJMANI

Fakulteti i Shkencave Islame – Shkup

MBI LIBRAT FETARË ISLAMË NË GJUHËN SHQIPE

Libri në përgjithësi luan një rol të rëndësishëm në përfitimin e njohurive në fusha të ndryshme¹. Ai bën që nxënësit, studentët dhe të tjerët, të ndërtojnë perceptimin ndaj diversitetit të njerëzve në botë dhe njëdisit në të cilin jetojnë dhe si të tillë ta pranojnë². Hulumtimet e bëra nga shumë studiues tregojnë se mënyra me të cilën janë përfaqësuar përmbajtjet në një tekst qoftë shkollor (e kam fjalën për shkollën fillore dhe të mesme) ose universitar ndikon tek nxënësit, studenti e të tjerë në formimin e qëndrimeve të caktuara, qofshin ato fetare ose të përgjithshme³.

¹ Të lexuarit e librave/teksteve të ndryshme, pos që zhvillon shkathësi si dhe ndikon në aftësimin e nxënësve për të shkruar dhe për të folur, e me këtë rast zhvillon një mori kompetencash, ndër to dhe të shkruarit për qëllime personale dhe jo vetëm por dhe për ato funksionale.

² Konfliktet ka qenë dhe, fatkeqësisht, druaj se edhe më janë një realitet që po shfaqen në shoqërinë tonë dhe si, të thuash, janë një pjesë “integrale e jetës dhe punës për të gjithë njerëzit”. Si të tilla, shfaqen si pjesë ndërpersonale e marrëdhënie midis individëve, midis të afërmeve të ngushtë, miqve etj.. Tendencat e përgjithshme e konfliktit gjykoj se paraqet kërcënim real për marrëdhënie të mira ndërpersonale. Për t’i evituar konfliktet, patjetër duhet të ndryshohet mënyra si mendojmë për të tjerët. Vetëm me punë të palodhshme dhe këmbëngulje, mund të evitohen konfliktet. Konflikti, në vete, ndonëse nuk është as pozitiv dhe as negativ, por është rrjedhojë e diversitetit që i karakterizon mendimet tona, qëndrimet, bindjet, perceptimet tona shoqërore etj.. Një punim të shkëlqyeshëm se si nga mendja e të rinjve të mos zë vend as dhe termi konflikt shih në: *Зборник за стручни трудови, Книгата и библиотеата – мостови кон ненасилсна комуникација кај младите*, Универзитетска библиотека „Св. Климент Охридски, -Битола, Манастир 2016.

³ Si librin e Snežana Mirazhičeva, Vlado Petrovski, *Методика на наставата по религиозно проповедание*, Universiteti “Goce Dellçev, Shtip 2010.

Nëse në librat shkollorë janë përfshirë më shumë shembuj pozitiv, të cilët kanë përcaktim të saktë për ndërtimin e shoqërie të bashkëjetesës dhe bashkëveprimit ku duhet respektuar tjetri, atëherë ekzistojnë parakushte reale që nxënësit të formojnë qëndrime, opinione dhe sjellje pozitive në raport me të tjerët. Në librat në gjuhën shqipe për fëmijët e moshës nga klasa e parë deri të pestën nuk gjen asnjë njësi mësimore me përmbajtje fetare për festat fetare Bajramin e Ramazanit ose atë të Kurban Bajramit, Ditëlindjen e Muhamedit a.s. Ndërkaq në tekstet në gjuhën turke, sa kam arritur t'i shoh, kremtimi i festës të Bajramit bëhet në kuadër të përshkrimit të traditave dhe zakoneve që praktikohen në familjen tipike turke, po jo edhe si pjesë e besimit, përkatësisht fesë islame.

Një dukuri e tillë e dëmton imazhin dhe hesht një realitet të paktë kontestueshëm, përkundër asaj që shtiremi se nuk jemi të tillë ose të atillë. Pjesa dërmuese e shqiptarëve në Maqedoni janë të besimit islam, por pa pretenduar të mohoj tjetrin, se në bindjen time është respektimi i tjetrit, sepse atë e kam edhe parim fetar islam. Prandaj, i takon çdo shteti që i do dhe e do të ardhmen e fëmijëve, t'i hapë rrugë mundësisë që çdo fëmijë të ushqehet edhe me kulturën e feve, për ta kthyer shkollën publike në një hapësirë njohëse jo vetëm për shkencat, por edhe për fenë. Një veprim i tillë nuk e cenon laicitetin e shkollës sonë, por ndihmon në forcimin e themeleve të kulturës laike, e cila është e dobët dhe e pafuqishme që të përballët me format e ekstremizmit të dhunshëm nëse nuk arrin dot t'i pajisë fëmijët e të gjitha besimeve me instrument njohës për faktin fetar si gjenerues civilizimesh dhe përparimi filozofik e social. Në këtë mënyrë, nxënësit do të nxiten nga mësuesit e lëndëve fetare të përvetësojnë elementët e të folurit, premisat e dialogut, hapat e parë të të argumentuarit, pa pasione, pa paragjykime...duke zhvi-

lluar sensin e përkatësisë, dobinë nga dallimet dhe jo në pësim të dallimeve fetare.

Me këtë rast, duhet theksuar edhe një çështje shumë të rëndësishme, atë të kurrikulave, në bazë të të cilave do të hartohen edhe tekstet mësimore. Varet nga ne studiuesit e fushave islame se a do të hartojmë ose jo plan-programet mësimore adekuate të disiplinave shkencore islame, duke filluar nga fusha e së drejtës islame, akaidi, tefsiri e hadithi, historia islame etj. Ne jemi dëshmitarë se edhe në medresetë tona përballemi me probleme të plan-programeve mësimore, për gjykimin tim, joadekuate dhe të papërpunuara në mënyrë profesionale dhe nga njohës të kualifikuar të çështjeve islame. Në këto tekste ndodh që nxënësit të kenë qasje të ngushtë dhe jofleksibile të kurrikulave të lëndëve fetare, në përgjithësi, dhe nuk kanë rastin të njohin trajtime dhe interpretime që përqendrohen në pozitiven, të bukurën, atë që është e përbashkët, njerëzoren dhe humanen si vlerë universale. Kështu, në lëndën e të drejtës islame, kurikulat duhet të fokusohen në emetimin e kulturës jurisprudençiale islame, si për shembull të drejtat që kishin minoritetet joislame në shtetin islam, imazhin e kalifit të drejtë Omer, i cili u angazhua me plotfuqinë e tij në mbrojtjen e të krishterëve koptë në Egjipt, ndërsa një veprim të tij human e dëshmon edhe thënia e tij: ***“Kur keni filluar t’i skllavëroni njerëzit, ndërkohë që nënat e tyre i kanë lindur të lirë? ...”***.

Trajtimi i problemeve nga këndvështrimi Islam nënkupton referimin në burimet parimore, Kur’anin dhe traditën profetike, të drejtën islame, përkatësisht nxjerrjen e argumenteve nga tekstet e këtyre dy burimeve për t’i mbështetur tezat, vlerësimet dhe përfundimet për shumë çështje të rëndësishme fetare islame. Më pastaj duhet trajtuar edhe çështje tjera të rëndësishme, siç janë ana-

logjia (kijasi), krahasimet e teksteve të ndryshme. Metodologjia e hartimit të teksteve është shumë primare në trajtimin e përmbajtjeve mësimore dhe mendimin shkencor islam. Në vazhden e të gjitha këtyre elementeve nuk duhet lënë anash edhe pozitën e familjes në Islam dhe rolin e saj në edukimin e fëmijëve.

Në të gjitha tekstet shkollore, por edhe të tjerat (universitare), gjuha luan një rol jetik në zhvillimin e fëmijëve. Shumë lloje të të mësuarit vendosen nëpërmjet ndërveprimit të gjuhës dhe përvojës. Gjuha e ndihmon fëmijën ta qartësojë dhe interpretojë përvojën, të fitojë koncepte të reja, si dhe të thellohet në përvetësimin e tyre. Në shikimin e kësaj marrëdhënieje midis gjuhës dhe të mësuarit, kurrikula e mishëron përdorimin e bisedës dhe diskutimit si një strategji qendrore të të mësuarit në çdo fushë kurrikulare⁴. Kjo e lehtëson zbulimin e ideve, emocioneve dhe reaksioneve nëpërmjet rritjes së rëndësisë së gjuhës dhe thellimit të të kuptuarit të botës nga fëmija, por edhe të rriturit.

Një gjuhë e kuptueshme ia lehtëson nxënësit përvetësimin e njohurive. Ne jemi të prirë të përkthejmë çdo gjë. Por, duhet pasur kujdes se jo çdo gjë nuk mund të përkthehet. Për vetë ne studentët, që i kemi kryer studimet në botën arabe, përkundër njohurive për gjuhën arabe që i kishim marrë në medrese, megjithatë, siç thotë **Edward W. SAID**: “*Arabishtja i ngjan një ideje abstrakte gati matematikore. Sistemi i përkryer i tre bashkëtingëlloreve themelore, format e përftuara foljore me kuptimet e tyre bazë, formimi i*

⁴Mungesa e kualitetit, e balancës në gjerësinë dhe thellësinë e trajtimit të temave, mospërputhja me nivelin kognitiv të nxënësve, ilustrime joadekuatë e jofunksionale për nxënësit mund të theksohen si problematika kryesore të teksteve shkollore në përgjithësi, po ashtu edhe atyre fetare në veçanti. Shih librin: *Cilësia e teksteve shkollore në Kosovë*, Prishtinë, Prill 2019, publikim i “Rrjeti i Kosovës për arsim dhe Punësim-KEEN”.

*përkryer i enrit foljor, i pjesoreve – çdo gjë është e qartë, e logjikshme, sistematike dhe abstrakte. Gjuha është njësoj si një formulë matematikore*⁵.

Përkthimi është një artizanat që nuk bëhet lehtë pa një kompetencë të mirëfilltë gjuhësore në të dyja gjuhët. Prandaj, ndodh që shumë tekste të përkthehen gabimisht, bile edhe përmbajtje thelbësore të përkthyer keq. Ligjërimi fetar, megjithëse, sikurse pranohet nga shumica e studiuesve⁶, është më i hershmi si ligjërimit letrar dhe kronologjikisht vetë burimi i shqipes së shkruar, mbetet njëherësh një prej stileve të ligjëritimit gjuhësor që ka trashëguar dhe vazhdon të trashëgojë probleme të pazgjidhura, që e ngadalësojnë zhvillimin e tij si një stil i pavarur funksional i shqipes dhe pasuri e gjuhës së gjallë.

Vështirësitë për të përkufizuar ligjërimin fetar, siç do të thoshte Sh. Sinani, nuk janë një dukuri përjashtimore e shqipes⁷. Të gjitha gjuhët, duke përfshirë edhe gjuhët e mëdha, i kanë kaluar me shumë ngadalësi ato ose vazhdojnë t'i përfetojnë edhe sot si probleme të zhvillimit gjuhësor. Sikurse dihet, ligjërimi fetar ndër shekuj e mijëvjeçarë është zhvilluar në ato gjuhë, që zakonisht quhen “imperiale”, si: latinishtja, greqishtja, arabishtja, sllavishtja e vjetër.

Nga të gjitha vështirësitë, më e hershmja dhe e përhershme është e karakterit psikologjik–gjuhësor. Ajo ka të bëjë me raportin midis shkrimeve të shenjta, që janë të lidhura me hyjnoren dhe kompetencës së kufizuar të arsyes njerëzore për interpretimin e kuptimeve të tyre. Kjo mendësi në thelb e ka tabunë.

⁵ <https://orientalizmi.wordpress.com/2011/07/16/te-jetosh-ne-gjuhen-arabe/>

⁶ Shih Shaban Sinani shih <http://www.gjuhashqipe.com/sq/Albanologji/Ligj%C3%ABrimi-fetar-dhe-gjuha-shqipe->

⁷ Ibid.

Psikologjia e tabusë ndaj gjuhës burimore të shkrimit të shenjtë e shoqëroi edhe përkthimin e parë të Kuranit famëlartë. Sprovat e para të përkthimit shqip të Kur'anit shihen në dekadat e para të shekullit të kaluar. Kjo meritë i takon Hafiz Ibrahim Dalliut. Por, njeriu që botoi fragmentet e para shqip të Kur'anit, afro pesë shekuj pas përkthimit frëngjisht, duke i vënë titullin "Këndim", ishte një i krishterë, Ilo Mitkë Qafëzezi. Pastaj vazhdojnë përkthyes të tjerë, të cilët janë meritore për sjelljen e Kuranit në gjuhën shqipe.

Shqipja e shkruar, historikisht, ka lindur në formën e librave të shërbesës fetare. Ajo u themelua me ligjërimin fetar⁸. Në fillimet e veta ky stil ligjërimi dëshmon jo vetëm plotninë e shqipes për t'u dhënë besimtarëve në gjuhën amtare porosinë hyjnore, por edhe një prirje për të sjellë në gjuhën shqipe të mundshmen, por jo edhe të pamundshme.

Çështje tjetër që duhet trajtuar është edhe ajo e terminologjisë, që mendoj se është bërë njaft, por jo dhe aq që nuk ka nevojë më të punohet, si në Shqipëri, Kosovë, por edhe këtu në Maqedoni.

Terminologjia fetare, si përgjegjësi e shkencës gjuhësore, është një çështje e hapur. Një prej zgjidhjeve të këshillueshme për të arritur në një shtjellim të frytshëm të problemit do të ishte shkencorizimi i shkrimeve të shenjta.

Bashkëpunimi midis gjuhëtarëve dhe teologëve për ta zhvilluar ligjërimin fetar në gjuhën amtare, për ta sjellë atë sa më pranë gjuhës së popullit, për të shmangur sinoniminë e mbingarkuar terminologjike, mund të ishte pikërisht në formën e një dialogu, ku teologët e mbikëqyrin përmbajtjen, besnikërinë me burimin, kurse filologët formën e qartë të komunikimit, si kusht parësor i edukimit fetar.

⁸Shaban Sinani, "Ligjërimi fetar dhe gjuha shqipe", Revista shkencore kulturore "Perla", vit. XI, 2016, nr. 3(42), fq. 69-81.

QERIM LITA

Fondacioni “Qendra e Civilizimit Islam” – Shkup

SHPËRNGULJA E SHQIPTARËVE MYSLIMANË NË TURQI DHE ROLI I ULEMAVE NË PENGIMIN E SAJ

Procesi i shpërnguljes së popullsisë shqiptare myslimane nga trevat veri-lindore, përkatësisht Maqedonisë Veriore së sotme, filloi me shpërthimin e Luftës së Parë Ballkanike, rënien e Perandorisë Osmane dhe pushtimin e tokave shqiptare nga aleanca ortodokse ballkanike, përkatësisht asaj serbo-malazezo-bullgaro-greke. Dokumentet e zbuluara kohëve të fundit hedhin dritë se brenda vitit 1912/13, ushtritë pushtuese të lartpërmendura, sidomos ajo serbe, dëbuan me dhunë mbi 120.000 shqiptarë të përkatësisë fetare islame, pjesa dërmuese e të cilëve u vendosën në Stamboll me rret-hinë⁹. Kjo masë e madhe shqiptare jetonte në kushte të mjerueshme, sepse tërë pasuria e tyre e tundshme dhe e patundshme u ishte konfiskuar nga ana e pushtuesve sllavo-ortodoksë. Ndonëse ata dikur kishin qenë qytetar dhe shtetas të Perandorisë Osmane, me krijimin e Republikës moderne të Turqisë (1923), pjesës dërmuese të tyre u mohojë shtetësia turke, me çka atyre iu vështirësuan edhe më shumë kushtet e jetesës. Në këto rrethana, shumë prej tyre dëshironin të ktheheshin në vendlindjet e tyre, ku i kishin lënë shtëpitë dhe pronat e tyre, mirëpo këtë nuk ua mundësonin autoritetet pushtuese të Beogradit, të cilat u rekomandonin të akredituarve të tyre pranë konsullatës së Stambollit, që gjatë dhënies së vizave

⁹ Архив Југославије, Фонд бр. 370, фасц. бр. 22, Јединице описа бр. 334-335 (мë tej AJ. 370. 22/334-335).

hyrëse, të kenë kujdes që “në mesin e tyre mund të ketë edhe të tillë të cilët dëshirojnë të futen në territorin tonë me qëllim që të ngelin te ne”. “Që ky spekulim i myslimanëve të anashkalohet – thuhej në dokument – Ministria për Punë të Jashtme ka nderin të lutet që myslimanët e shpërngulur, të cilët kërkojnë vizë hyrëse më shumë herë brenda vitit /2–3 herë/, të mos u jepet pëlqimi për hyrje, për arsye se vetëm në atë mënyrë mund të pengohet spekulimi i tyre dhe të pamundësohet shpresa e tyre për t’u kthyer...”¹⁰.

Që shpërngulja e popullsisë shqiptare myslimane për në Turqi ose edhe për në Shqipëri, të kryhej sa më parë që ishte e mundur, Mbretëria Serbo–Kroate–Sllovene (SKS–së), komunitetin mysliman e ndau në dy organizata fetare. E para ishte Bashkësia Fetare Islame e Bosnjës e Hercegovinës, e cila pati një autonomi të plotë që buronte nga Kushtetuta e miratuar që nga koha e Perandorisë së Austro–Hungarisë. Qendra e saj ishte Sarajevë, ndërsa me të udhëhiqte Reis–ul–Ulemaja. Organizata e dytë fetare ishte Myftinia Supreme, në kuadër të së cilës përfshihej komuniteti mysliman i Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Sanxhakut. Qendra e saj ishte Beogradi, ndërsa me të udhëhiqte kryemyftiu, i cili njihej si myftiu suprem¹¹. Për dallim nga BFI–ja e Bonjës e Hercegovinës, Myftinia Supreme ishte nën varësi të plotë të Qeverisë së SKS–së, përkatësisht të Ministrisë së Fesë. Veprimtaria e saj mbështetej mbi një rregullore të miratuar gjatë vitit 1919, e cila në vitin 1920 kaloi në Ligj¹². Sipas dispozitave të asaj rregulloreje, tërë pushteti ishte përqendruar te kryemyftiu dhe myftinj të e qarqeve e të rretheve, të cilët emëroheshin nga ana e ministrit të Fesë. Në krye të këtyre institucioneve u emëruan njerëz më të besuar të pushtetit, siç ishin

¹⁰ AJ. 411. 2/16

¹¹ Qerim Lita, Shenjat e Kohës, Konica Press, Shkup 2019, fq. 79–80.

¹² Po aty.

Hasan Rebac, Mehmet Zeki, Talat Selim etj. Se vërtetë tërë hierarkia udhëheqëse e saj ishte nën mbikëqyrje të plotë të pushtetit, dëshmon shkresa e Hasan Rebacit, dërguar më 23 mars 1920 kryemuftiut, Mehmet Zeki, përmbajtja e së cilës ishte me sa vijon:

*“Jam informuar se muftiu i Qarkut të Ohrit, z. Hajredin Ahmeti, dhe muftiu i rrethit të Dibrës, z. Hysni Aliu, koketojnë me shqiptarët dhe punojnë kundër shtetit tonë. Ata janë njerëz shumë të rrezikshëm, prandaj në interes të shtetit duhet sa më parë të ndërrohen nga ato pozita... Në informatën e njëjtë përmendet edhe një farë Hafiz Sherifi (Sherif Langu) si ndihmës muftiu gjithashtu si një figurë e rrezikshme për shtetin tonë.”*¹³

Në kuadër të fushatës së luftës kundër krerëve fetarë, me vetëdije të qartë nacionale, duhet përmendur edhe shkresën e 27 marsit të atij viti të Hasan Rebacit, përmes së cilës e urdhëronte kryemuftiun, Mehmet Zeki, që të ndërmarrë masa kundër disa hoxhallarëve në Kosovë e Maqedoni, për shkak se nga njoftimet që i kishin arritur nga ana e Ministrisë së Luftës, në ato krahina *“në mesin e muhamedanëve po vërehet një farë lëvizje me qëllim të autonomisë politike e fetare”*, dhe se në to *“po marrin pjesë edhe hoxhallarët, duke mbajtur fjalime të fshehta nëpër xhami...”*¹⁴.

Ndërkohë, forcat ushtarako-policore serbe e filluan një fushatë të gjerë e tejet brutale, gjoja për kapjen e të arratisurve, përkatësisht të anëtarëve të Lëvizjes Kaçake, të cilët përbënin krahun ushtarak të Komitetit për Mbrojtjen Kombëtare të Kosovës. Rrjedhimisht, në pjesën e parë të vitit 1923 një numër i madh i popullsisë shqiptare myslimane qe detyruar t’i braktisë vatrat e tyre. Legata jugosllave në Sofje, më 3 qershor, përmes depeshes e njoftonte MPJ-në për një

¹³ Po aty.

¹⁴ Po aty, fq. 81.

vërshim të ri të popullsisë shqiptare myslimane nga Kosova dhe Maqedonia e sotme Veriore për në Turqi: “...Në kohë të fundit myslimanët nga territori ynë po emigrojnë në Turqi. Një numër i caktuar i personave të tillë ngelin në territorin bullgar, për arsye se pushtetarët turq në pikën kufitare i pengojnë të hynë brenda. Ata, të shpërngulurit nga Serbia e Jugut (mendohet për Kosovën dhe Maqedoninë – Q.L.), tash nga Legata jonë në Sofje kërkojnë t’u lejojë kthimin në vendin tonë...”¹⁵.

Po ashtu edhe i deleguari jugosllav nga Stambolli i raportonte Beogradit për takimin e tij me këshilltarin e lartë të MPJ-së së Turqisë, Mexhit Beu, i cili siç bëhet me dije, ka shprehur brengosjen e Qeverisë së Republikës së Turqisë për gjendjen e rëndë të popullsisë myslimane në Jugosllavi: “...Qeveria e Ankarasë – thuhet në raport – ka konstatuar se në kohë të fundit ekziston një eksod i vërtetë i shpërnguljes së popullsisë myslimane nga vendi ynë. Një dukuri e tillë e brengos Qeverinë e Ankarasë, aq më tepër për shkak se edhe ashtu ajo gjendet në rrethana të jashtëzakonshme me popullsinë e arratisur myslimane, e cila, me Marrëveshjen e Lozanës, ka filluar të vijë prej Greqie....”¹⁶.

Autoritetet jugosllave, të frymëzuara nga Ligji për Kolonizim, të cilin parlamenti turk e solli më 14 korrik të vitit 1934, i cili, veç tjerash, parashihte shpërnguljen e të gjithë turqve të Ballkanit për në Turqi, e panë këtë si moment të volitshëm për shpërnguljen e tërësishme të popullsisë shqiptare e turke nga vatrat e tyre për në Turqi dhe në tokat e tyre të vendoseshin kolonë sllavë. Për këtë qëllim, parlamenti jugosllav, në mbledhjen e mbajtur më 21 gusht të vitit 1934 bëri ndryshimin dhe plotësimin e nenit 55 të Ligjit për

¹⁵ AJ. 370. 9/506.

¹⁶ AJ. 370. 9/522.

shtetësi jugosllave, të miratuar gjatë vitit 1928, përmbajtja e të cilit ishte si më poshtë: “...*Josllavët të cilët në kuptimin e paragrafit të dytë të nenit 55, janë bërë shtetas të Mbretërisë, pushojnë të jenë të tillë nëse pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji e deri me 1 nëntor të vitit 1938 para organeve kompetente të pushtetit të shkallës së parë ose në cilëndo përfaqësi tonën diplomatike ose konsullore në botën e jashtme, deklarojnë se tërhiqen nga shtetësia. Deklaratat të cilat i janë dorëzuar pushtetit të përmendur, si edhe përfaqësive diploma- tike e konsullore nga ana e personave në fjalë pas 1 nëntorit të vitit 1938, e deri në hyrje në fuqi të këtij Ligji, do të konsiderohen si të dërguara me kohë...*”¹⁷.

Po në këtë periudhë kohore Dhoma e Reformës Agrare në Shkup filloi një fushatë të gjerë të konfiskimit të tokës pjellore nëpër vendbanimet shqiptare. Aksioni parashihnte që “fshatarëve shqiptarë t’u lejohej vetëm 0,4 hektarë tokë për një anëtar të familjes”. Qëllimi kësaj politike antishqiptare, siç njoftohemi nga burimet e shumta të proveniencës policore e ushtarake jugosllave, ishte “dëshpërimi i banorëve shqiptarë”, sidomos i fshatrave që shtriheshin buzë Malit Sharr e deri në hapësirën Kumanovë–Prishtinë, ku kompaktësia shqiptare ishte tepër e madhe. Autoritetet e Beogradit shpresonin që, përmes këtyre masave të ashpra agrare, do t’i detyronin shqiptarët t’i braktisin vatrat e tyre e të shpërnguleshin për në Turqi¹⁸.

Ndërkohë, qeveria e Stojadinoviqit, në shtator të vitit 1935 e themeloi Komitetin Ndërmnistror¹⁹, i cili në tetor të atij viti e hartoi “Projektin” për, siç thuhej, “shpërnguljen e elementeve josllave nga

¹⁷ AJ. 411. 2/33-34.

¹⁸ Qerim Lita, *Shaban Efendia atdhetar i devotshëm*, Kumanovë 2010, fq. 74.

¹⁹ AJ. 370-9/638-641.

Serbia Jugore”. Në të veç tjerash thuhej se çështja e shpërnguljes “duhet rregulluar sa më parë përmes konventës speciale” midis Jugosllavisë dhe Turqisë, si dhe midis Jugosllavisë dhe Shqipërisë, ashtu sikurse “kjo çështje është zgjidhur midis Turqisë dhe Rumanisë”. *“Në rast se me Shqipërinë – thuhej në vazhdim – nuk do të mund të arrihet marrëveshje për shpërnguljen e shqiptarëve në Shqipëri ose nëse shqiptarët nuk dëshirojnë të shpërngulen në Turqi, menjëherë duhet shkuar në dispozitat ligjore ekzistuese për shpërnguljen e këtij elementi nga zonat kufitare në brendi të vendit dhe popullzimin e zonave të njëjta me popullsi të kombësisë jugosllave....”* Projekti, për të gjithë ata persona, të cilët *“shprehnin dëshirën për shpërngulje”*, përkatësisht, jepnin deklaratë se tërhiqeshin nga shtetësia jugosllave, parashikonte lehtësime të shumta²⁰.

Për rrjedhojë, Ministria e Punëve të Jashtme Jugosllave, më 11 dhjetor 1935, urdhëronte legatën e saj në Ankara që sa më shpejt që është e mundur të iniciojë arritjen e një konvente me Qeverinë e Republikës së Turqisë, për *“shpërnguljen e popullsisë myslimane nga viset jugore për në Turqi”*. Kjo çështje, thuhej në urdhëresë, *“është e një rëndësie të shkallës së parë për vendin tonë”*, prandaj kësaj *“t’i kushtoni vëmendje sa më të madhe”* dhe të bëni çmos që *“me Qeverinë turke të arrihet sa më parë marrëveshja e propozuar...”*²¹. Burimet diplomatike jugosllave nxjerrin në pah se, përkundër përpjekjeve të shumta nga Beogradi zyrtar për ta bindur Ankaranë të nënshkruajë sa më parë një konventë të tillë edhe me Jugosllavinë, kjo çështje për qeverinë turke nuk ishte me prioritet, për arsye se, sipas tyre numri i popullsisë turke në këtë shtet (jugosllav) arrinte shifrën prej rreth 50.000 banorëve, që për dallim nga

²⁰ AJ. 370-9/642-643.

²¹ AJ. 370-9-662.

shtetet tjera ballkanike, si p.sh. në Bullgari, numri i të cilëve ishte 400.000, Greqi, 300.000 dhe Rumani 450.000, aty përbënte një pakicë e parëndësishme²². Këto të dhëna, edhe pse ishin reale, binin ndesh me planet dhe projektet serbomëdha, të cilat parashikonin të shpërngulnin rreth 750.000 myslimanë (550.000 i konsideronin për shqiptarë dhe 200.000 turq) nga tokat shqiptare, të cilat gjatë vitit 1913 iu aneksuan Serbisë:

“Për ne është shumë me rëndësi – i shkruante më 18 tetor 1935 Stojadinoviçi përfaqësuesit diplomatik jugosllav në Ankara – që Ligji turk për kolonizim parasheh emigrimin në Turqi jo vetëm të turqve, por edhe të popullsisë së kulturës turke,... për arsye se në këtë mënyrë për ne ekziston mundësia që, krahas turqve, të cilët do t’i shpërngulim nga vendi ynë për në Turqi, të fusim edhe një numër më të madh të shqiptarëve”²³.

Pas përpjekjeve thuajse trevjeçare, autoritetet jugosllave, duke e shfrytëzuar Konferencën e Marrëveshjes Ballkanike, punimet e së cilës u mbajtën gjatë muajit shkurt 1938 në Stamboll, arritën ta bindin qeverinë turke për fillimin e negociatave rreth konventës. Kryeministri jugosllav, M. Stojadinoviç, më 29 mars 1938, përmes një telegrami të shifruar, e porosiste të deleguarin e tij në Ankara, Axhemoviç, të veprojë te autoritetet turke rreth përsheptimit të fillimit të negociatave për shpërnguljen e popullsisë shqiptare myslimane për në Turqi:

“Në mbledhjen e Ankarasë që vendosur që në muajin e ardhshëm në Stamboll të organizohet konferenca për çështjen e shpërnguljes së turqve. Më 7 prill në Stamboll takohet Këshilli ekonomik të Marrëveshjes Ballkanike. Prandaj vlerësoj se do të ishte e

²² AJ. 370. 9/ 632.

²³ AJ. 370. 9/630-631.

përshatshme që me atë rast të takohen edhe përfaqësuesit për çështjen e shpërnguljes. Në atë mënyrë nga të dy anët do të ruhej sekreti rreth negociatave për këtë çështje. Në këtë këndvështrim në Beograd i është folur Numanit, i cili parimisht u dakordua. Ju lutem këtë çështje hulumtojeni në vendin kompetent dhe nëse janë dakord, le të dërgojnë ftesë të nevojshme”²⁴.

Ndërkohë, autoritetet turke propozuan që negociatat të fillonin më 7 qershor 1938 në Stamboll, me të cilin propozim u dakordua edhe pala jugosllave²⁵. Në fakt, negociatat filluan më 9 qershor dhe zgjatën deri më 11 korrik. Delegacionin turk e përfaqësonte Hasan Saka, deputet i popullit dhe ish ministër, ndërsa delegacioni jugosllav përbëhej nga Millan Ristiq, shef i Dhomës Politike pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme, dhe Vojsllav Magovçeviq, inspektor pranë Ministrisë së Bujqësisë. Në negociata ishte paraparë të merrte pjesë edhe një delegat rumun dhe një mbikëqyrës grek²⁶. Shefi i delegacionit jugosllav, M. Ristiq, më 14 qershor 1938, i shkruante M. Stojadinoviçit për rrjedhat e negociatave, sipas të cilit, turqit ishin dakorduar për dy çështje thelbësore: *“1) në afat prej gjashtë viteve të pranojnë 200.000 vetë nga Serbia Jugore (Kosova dhe trevat shqiptare në Maqedoni e Mal të Zi – Q. L.). Fëmijët nën moshën 10-vjeçare nuk hynë në këtë kuotë, e as që jepet dëmtshpërblim për ta. 2) që në këtë kuotë të hynë edhe shqiptarët”²⁷.*

Negociatat, siç u tha më lart, zgjatën deri më 11 korrik, kur të dy palët negociuese e parafuan tekstin përfundimtar të Konventës. Në mbledhje u vendos që të përgatitet një komunikatë që do t'i përci-

²⁴ AJ. 370. 9/773.

²⁵ AJ. 370. 9/776.

²⁶ AJ. 370. 9/893-924.

²⁷ AJ. 411. 2/54.

llej shtypit të të dyja vendeve nën kujdesin e Agjencisë së Anadolisë, përmbajtja e së cilës ishte si më poshtë:

“Komisioni për shpërngulje i formuar për të studiuar e për të shqyrtuar çështjet që kanë të bëjnë me shpërnguljen e turqve të Jugosllavisë, u mbledh më 9 qershor 1938 në Stamboll nën udhëheqjen e Sh. së T. Hasan Saka, deputet dhe Kryetar i Seksionit turk të Këshillit Ekonomik për Mirëkuptim Ballkanik, dhe i ka përfunduar punët e tij më 11 korrik 1938, duke sjellë një rezultat pozitiv dhe të kënaqshëm për palët e interesuara të të dyja vendeve mike dhe aleatë. Ky komision përbëhej prej z-ve Hasan Saka, Xhevdet Atasagan, Drejtor i Përgjithshëm për vendosjen e popullatës, në Ministrinë e Higjienës dhe të Asistencës Sociale, Millan A. Risti, shef i Seksionit Ballkanik në Ministrinë e Punëve të Jashtme të Jugosllavisë dhe Vojsllav V. Magovçeviq, Inspektor në Ministrinë e Bujqësisë. Delegatët e kanë sigluar tekstin e Konventës që e qeveris dhe e rregullon shpërnguljen e turqve të Jugosllavisë. që pastaj të njëjtën t’ua prezantojnë qeverive të tyre përkatëse. Kjo konventë do të firmoset sapo qeveritë përkatëse ta kenë miratuar dhe do të hyjë në fuqi kur të ratifikohet”²⁸.

Konventa parashihte që brenda gjashtë viteve, duke filluar nga viti 1939 e deri në vitin 1944, nga Kosova, trevat shqiptare në Maqedoninë e sotme Veriore dhe Mali i Zi të shpërnguleshin gjithsej 40.000 familje shqiptare myslimane. Kjo çështje sqarohej në nenin IV të Konventës, ku thuhej shprehimisht:

“Riatdhesimi i këtyre 40.000 (një) familjeve do të bëhet në afat brenda gjashtë viteve, me këto përpjesëtueshmëri:

²⁸ AJ. 370. 9/893-924.

Në vitin 1939 : 4.000 (mijë) familje

Në vitin 1940 : 6.000 (mijë) //

Në vitin 1941 : 7.000 (mijë) //

Në vitin 1942 : 7.000 (mijë) //

Në vitin 1943 : 8.000 (mijë) //

Në vitin 1944 : 8.000 (mijë) //

Nëse kjo kuotë – pjesë vjetore nuk do të mund të realizohej për shkak të ndonjë pamundësie rasti, të dyja palët kontraktuese do të merren vesh përmes legatave përkatëse për numrin e të shpërngulurve që do të zbrazen a largohen në një anë e do të pranohen në anën tjetër, tre muaj para se të fillojë periudha e shpërnguljes. Ndërkaq, kuptohet se këto ndryshime rasti të numrit vjetor të të shpërngulurve nuk mund të zgjasin më tepër se një vit prej afatit të caktuar për shpërngulje prej gjashtë muajsh.

Periudhat vjetore të shpërnguljes do të zgjasin që nga fillimi i muajit maj deri më pesëmbëdhjetë tetor, përveç kur të jetë fjala për kon-tingjentin e të shpërngulurve për vitin e parë e i cili do të fillon të zbrazet e largohet vetëm në fillim të korrikut të vitit 1939²⁹.

Për çdo familje të shpërngulur Jugosllavia ishte e detyruar t'i paguajë Turqisë nga 500 lira turke, ndërsa tërë prona e patundshme e të shpërngulurve kalonte në pronësi të shtetit jugosllav. Që Konventa të bëhej e plotfuqishme, nevojitej legalizimi dhe ratifikimi i saj, që palët negociuese për, siç thuhej, “shkaqe politike” nuk rekomandonin procedurë të rregullt për legalizim. Sipas tyre, më mirë do të ishte “Konventa të jetësohej përmes rregullores, ndërsa më pas të legalizohej përmes ligjit të ardhshëm financiar”³⁰.

²⁹ Po aty.

³⁰ Po aty.

Neni II i Konventës i përcaktonte rajonet të cilat i ishin nënshtruar shpërnguljes, që ishin si më poshtë:

“1) Rrethet e Banovinës së Vardarit, si:

Nga Mali Sharr (Prizreni), nga Gora (Dragashi), nga Podgurra (Suhareka), nga Nerodimja (Ferizaji), nga Pollogu i Poshtëm (Tetova), nga Pollogu i Epërmë (Gostivari), nga Galica (Radastushi), nga Dibra (Dibra), nga Struga (Struga), nga Graçanica (Prishtina), nga Kaçaniku (Kaçaniku), nga Gjilani (Gjilani), nga Presheva (Presheva), nga Prespa (Rresnja), nga Ohri (Ohri), nga Kërçova (Kërçova), nga Krusheva (Krusheva), nga Poreçi (Brodi i Jugut), nga Prilepi (Prilepi), nga Manastiri (Manastiri), nga Kavadari (Kavadari), nga Marihova (Manastiri), nga Negotini mbi Vardar (Negotini mbi Vardar), nga Shkupi (Shkupi), nga Kumanova (Kumanova), nga Velesi (Velesi), nga Ovçe Pole (Sveti Nikola), nga Shtipi (Shtipi), nga Koçani (Koçani), nga Radovishi (Radovishi), nga Strumica (Strumica), nga Dojrani (Vallandova), nga Gjevgjelia (Gjevgjelia), nga Kriva Pallanka (Kriva Pallanka), nga Kratova (Kratova), nga Carevo Sello (Carevo Sella), nga Malesheva (Berova);

2) Rrethet e Banovinës së Zetës, veçmas:

Nga Peja (Peja), nga Istogu (Istogu), nga Mitrovica e Kosovës (Mitrovica), nga Gjakova (Gjakova), nga Podrinja (Rahoveci);

3) Rrethet e Banovinës së Moravës, si :

Nga Llabi (Podujeva), nga Vuçitërna (Vuçitërna), nga Drenica (Skënderaji).

Qeveria Jugosllave do të vendos vetë se në cilat rajone do të nisë së pari shpërngulja.”³¹.

³¹ Po aty.

Për sa u tha më sipër, shihet qartë se me përjashtim të disa rajoneve në pjesën lindore të Maqedonisë së sotme, ku siç dihet banorët myslimanë i takonin kombësisë turke (turk-juruk), të gjitha rajonet e tjera ishin të populluara me popullsi shqiptare myslimane. Burimet e proveniencës policore e ushtarake jugosllave bëjnë të ditur se Beogradi zyrtar nuk ishte i kënaqur me Konventën e parafuar, duke kërkuar që asaj t'i shtohet edhe shkëmbini i popullsisë, përkatësisht dëbimi edhe i 100.000 shqiptarëve tjerë për në Turqi dhe vendosja e elementit ortodoksë nga Turqia në Jugosllavi. Mirëpo, këto shifra nuk i kënaqnin apetitet e pushtetarëve serbo-mëdhenj, sepse, sipas tyre, dëbimi i 400.000 shqiptarëve nuk i plotësonte “interesat e tyre shtetërore e nacionale serbe”, e që ishte “dëbimi deri në shqiptarin e fundit” nga tokat e tyre etnike dhe kolonizimi me elemente serbe e malazeze, për arsye se numri i përgjithshëm i shqiptarëve nën pushtimin e tyre arrinte shifrën prej rreth 732.000 banorësh. Nisur nga kjo, ata planifikonin nënshkrimin e një konvente të ngjashme sikurse me Republikën e Turqisë edhe me Qeverinë Mbretërore të Shqipërisë, për shkëmbim të popullsisë, përkatësisht dëbimin e 100.000 shqiptarëve myslimanë në Shqipëri dhe sjelljen e 100.000 shqiptarëve të krishterë (ortodoksë), që ata i konsideronin për “serb”. Për realizimin e këtyre planeve antishqiptare, qeveria jugosllave parashikonte themelimin e Inspektoratit Suprem, me qendër në Shkup dhe me dy qendra rajonale, në Prishtinë e Pejë. Themelimi i këtij inspektorati u iniciua nga Ministria e Punëve të Brendshme, e cila në elaboratin me titull “Problemet dhe metodat e shpërnguljes së shqiptarëve dhe turqve nga Serbia Jugore për në Turqi”, hartuar më 23 tetor 1938, ndër të tjera, potenconte:

“...Që të mund të zbatohet me trazira sa më të vogla kjo punë e rëndë e delikate për interesin shtetëror e kombëtar, nevojitet sa më parë, që

në muajin janar, të themelohet Inspektorati Suprem për shpërnguljen e shqiptarëve e turqve për në Azi, me qendër në Shkup, i cili do të ketë dy qendra të veta rajonale, në Prishtinë dhe Pejë...”³².

Pikërisht këto projekte antishqiptare e nxitën parinë e atëhershme shqiptare, të cilës i printe Ferhat bej Draga, që të ndërmarrin masa urgjente për pengimin e zbatimit të tyre në praktikë. Ministria e Punëve të Jashtme të Mbretërisë Jugosllave, më 5 gusht të vitit 1938, përmes një shkrese, e njoftonte legatën e vet në Ankara se para pak kohësh, një delegacion shqiptar i udhëhequr nga Ferhat bej Draga dhe Maliq Pehlivani kanë udhëtuar për në Stamboll.

“Nga të dhënat e marra si duket të gjithë ata kanë udhëtuar për në Turqi për të vepruar te qeveria turke me qëllim që mos të nënshkruhet Konventa rreth shpërnguljes së myslimanëve nga viset tona jugore ose së paku në të të mos përfshihen shqiptarët të cilët jetojnë në mbretërinë tonë. Si duket ata, deputetëve të parlamentit turk u kanë dorëzuar një memorandum, me të cilin i kanë paraqitur pikëpamjet e veta për atë çështje...”³³.

Fushëveprimi i parisë shqiptare, krahas atij diplomatik, u përqendrue edhe në aktivitetin e brendshëm, i cili zhvillohej përmes mbledhjeve dhe tubimeve të ndryshme të organizuara anembanë trevave shqiptare nën pushtimin jugosllav. Tema boshte e këtyre takimeve, siç bënin të ditur raportet ushtarake e policore jugosllave, ishte ndërprerja e shpërnguljes së popullsisë shqiptare nga vatrën e tyre. Është me rëndësi të theksohet fakti se përkrah Ferhat Dragës u rreshtuan një numër i madh i intelektualëve shqiptarë të kohës, shumica e tyre ulema të njohur shqiptarë, si: hafiz Sherif Langu, Bedri ef. Hamidi, Ataullah ef. Kurtishi, Mulla Idriz Gjilani, Shaban

³² ДАМ. 1. 613. 1. 68/1243-1244.

³³ Q.Lita, Shenjat e Kohës, vepra e cituar, po aty, fq. 139-140.

Efendiu, Sherif Voca, Remzi ef. Abdullau, Azem hoxhë Latifi, mulla Hajdar Jashari, Fetah Efendiu, Ibrahim Lutfiu, Kadri Salii, Shuaip Kamberi, Shaip Mustafa e shumë të tjerë. Burimet policore komuniste maqedonase vënë në dukje për një fushatë të gjerë kundër shpërnguljes, që asaj kohe që zhvilluar nga Shaban Efendiu, Azem Hoxha, Abdulla ef. Ebibi, Mulla Hajdari, Lutfi ef. Ahmeti e ulema të tjerë shqiptarë nga Fushëgropa e Kumanovës dhe Lugina e Preshevës:

“...Shaban Osmani (Efendiu) dhe Azem Hoxha..., që të përfitonin simpati tek kombi shqiptar, kishin lëshuar parulla të ndryshme kundër shpërnguljes. Kur fshatarët tanë filluan të shpërngulen për Turqi, Shabani i ndaloi dhe ju fliste me parulla të ndryshme, se do të vijë dita kur këtu do të qeverisë Shqipëria etnike. Kështu ai fliste para masave dhe nëpër kafene...Shabani si intelektual ndërsa Azemi si hoxhë kishin ndikim dhe autoritet të lartë, posaçërisht te elementet kulake...”³⁴.

Fushatë të tillë asaj kohe u zhvillua në mbarë hapësirën shqiptare nën pushtimin jugosllav, ku krerët shqiptarë kërkonin nga bashkëkombësit e tyre mos i lëshonin vatrat e veta, duke u thënë se pusheteti “mund t’ua konfiskonte tokën, por shtëpitë nuk mund t’ua merrete”, se një politikë e tillë nuk do të zgjaste shumë dhe se “do të vijë dita që Shqipëria do t’i çlirojë të gjitha viset e robëruara shqiptare që nga Shkupi e deri në Prishtinë...”³⁵.

Komandanti i Armatës III, Millan S. Jekmeniq nga Shkupi, e vinte në dijeni Shtabin e Përgjithshëm të Armatës në Beograd se Ferhat Draga kishte filluar një aksion në mbarë hapësirën shqiptare. Sipas

³⁴ ДАРМ. 1. 885. Д. 432000948, Изјава...3. XII. 1948 год., Куманово; Q. Lita, Shaban Efendia, vepra e cituar, po aty, fq. 264-267.

³⁵ Q. Lita, Shaban Efendia, po aty, fq. 74.

vlërësimin të tij, nën ndikimin e aksionit të Ferhat bej Dragës dhe zhvillimeve politike ndërkombëtare, “propaganda shqiptare në Jug” asnjëherë nuk kishte qenë më e gjallë³⁶. Një vlerësim të tillë e patën edhe organet policore jugosllave, të cilat e vinin në dukje faktin se “shqiptarët janë tepër të dëgjueshëm ndaj kërkesave të parisë së tyre”, që, siç do të shprehen, “tani më rreth tre vite të tëra nuk shesin asnjë pëllëmbë tokë”³⁷.

Në janar të vitit 1939 M. Jekmeniqi i shkruante Komandës së Shtatmadhorisë në Beograd, për një propagandë të fuqishme që po zhvillohej në Dibër të Madhe kundër shpërnguljes.

*“Shqiptarët nga Dibra të cilët kanë farefis në Shqipëri kanë marrë nga ata letra nëpërmjet të cilave i këshillojnë që bagëtinë dhe pronat në asnjë mënyrë të mos i shesin dhe të mos shpërngulen për Turqi ose Shqipëri, sepse patjetër duhet të ngelin në qytet që të gjithë, ashtu që për ta parë faktori ndërkombëtar se ato vise janë të banuara kryesisht me shqiptarë, ndërsa në Shqipëri për këtë çështje punohet me një intensitet të lartë dhe se ekziston shpresa e arsyeshme se për këtë do të ketë sukses”*³⁸.

Ndërkohë, një burim i xhandarmërisë jugosllave njoftonte se gjatë muajit dhjetor të vitit 1939, kryetari i Mexhllisit të Ulemasë së Shkupit, hafiz Sherif Langu, kishte qëndruar në Manastir, me ç’rast “në mesin e popullsisë shqiptare ka agjituat që mos shpërngulen për Turqi”³⁹. Ngjashëm sikurse Sh. Langu vepronin edhe anëtarët tjerë

³⁶ Po aty, dok. nr. 51, fq. 191-196.

³⁷ ДАРМ. Ф. ВИИ. М.346, Прилике у Јужној Србији 1938 год.

³⁸ Arkivi Shtetëror i Republikës së Maqedonisë – Agjencia Shtetërore e arkivave të Kosovës, Politika e Mbretërisë jugosllave ndaj shqiptarëve dhe Shqipërisë 1929-1941, Përmbledhje dokumentesh, përzgjedhjen, parathënien dhe redaktimin, Qerim Lita, dok. nr. 64, Shkup-Prishtinë 2012, fq. 213.

³⁹ Po aty, dok.nr. 121, fq. 283; Q. Lita, Shaban Efendiu, vepra e cituar, po aty, fq. 83.

të Mexhlsit të Ulemasë. Në elaboratin e hartuar në vitin 1954 nga Komisioni për organizimin dhe udhëheqjen e procesit të shpërnguljes së popullsisë myslimane (shqiptare e turke) pranë KQ të PKM-së, ndër të tjerash, kështu përshkruhet veprimtaria e Ataullaf ef. Kurtishit kundër shpërnguljes së popullsisë shqiptare për në Turqi midis dy luftërave botërore:

“...Reformat e Qemal Atatürkut në Turqi, posaçërisht rreth çështjes së fesë dhe mbulesës,...shkaktuan një huti dhe frikë bukur të madhe te masat myslimane në Maqedoni. Në këtë rol të madh patën një pjesë e hoxhallarëve, të cilët, për shkak të atyre reformave, ishin të detyruar ta braktisin Turqinë dhe të vendosen te ne. Më i njohuri në mesin e tyre ishte Ataullah Hoxha, i cili në Turqi ishte i dënuar me vdekje, por arriti të ikte dhe të vinte në Shkup, ku e hapi medresenë e tij të lartë. Ataullah Hoxha,...bëhet një udhëheqës fetar shumë i njohur dhe me ndikim në pakicën turke (shqiptare – Q.L.). Aktiviteti politik i tij në atë kohë ishte përqendruar kundër shpërnguljes, duke e quajtur Turqinë si vend të pafë, shtet ku nuk ekziston morali dhe ku nuk respektohen liritë fetare. Shembulli i Ataullah Hoxhës nuk është i vetëm, por pati edhe të tjerë, që në mënyrë aktive punonin kundër shpërnguljes për Turqi, të cilët në vitet e fundit të Jugosllavisë së vjetër, e ngadalësuan këtë proces...”⁴⁰.

Një aktivitet të dendur kundër shpërnguljes, asaj kohe, pati edhe Bedri ef. Hamidi, i cili në vitin 1939 zhvilloi një vizitë disamujore në të gjitha qendrat më të rëndësishme të Mexhlsit të Ulemasë së Shkupit, si: Prishtinë, Prizren, Gjilan, Ferizaj, Pejë, Mitrovicë, Gjakovë, Preshevë, Kumanovë, Tetovë, Gostivar, Dibër, Kërçovë,

⁴⁰ Problemi Shqiptar në RP(S) të Maqedonisë 1944-1974, përmbledhje dokumentesh vëllimi II, përzgjedhjen, redaktimin, përkthimin, parathënien dhe hyrjen Qerim Lita, Logos-A, Shkup-Prishtinë-Tiranë 2018, dok. nr. 116, fq. 169-181.

Strugë, Ohër, Manastir, Ulqin, Novi Pazar etj., me ç'rast mbajti ligjëratat me karakter fetar e politik në xhamitë kryesore të këtyre qendrave. Për tërë atë aktivitet të tij, përmes një raporti prej më shumë se 200 faqesh, ai njoftonte Mexhlisin e Ulemasë së Shkupit për gjendjen e mjerueshme të popullsisë myslimane:

“...Si pasojë e Luftës së Parë Botërore, e cila pati një ndikim të madh në zhvillimin e jetës së përgjithshme të këtyre myslimanëve, është shpërngulja e familjeve të tëra për në Republikën e Turqisë. Hovi i kësaj shpërngulje u shtua sidomos pas përfundimit të luftës. Shkak i kësaj shpërngulje ishte vendimi i prerë për zbatimin e reformave agrare, reformë kjo që familjet myslimane i la në rrugë të shkreta. Padyshim, lufta solli pasojat të rënda dhe myslimanët nuk arritën të gjenden në situatën e krijuar fill pas luftës. Shpëtimin e kërkonin në shpërngulje, e cila po përpinte familje të tëra myslimane dhe, kësaj, vendbanimet myslimane po e humbisnin karakterin dhe frymën islame... Kjo shpërngulje nuk po ndikonte vetëm në zvogëlimin e numrit të myslimanëve, por shkaktonte dhe një psikozë edhe tek ata pak myslimanë që nuk kishin braktisur vendlindjet e tyre, të cilëve po ua mbyste impulsin për jetë e për punë. Në shumë vise..., me shpërnguljen e familjeve të tëra u humb shumica e myslimanëve dhe me këtë edhe pesha e tyre në drejtimin e këtyre vendbanimeve. Falë Zotit, kohëve të fundit ky trend është zvogëluar, por pasojat po ndjehen akoma në të gjitha sferat e jetës tek myslimanët e ngelur, sidomos në sferën ekonomike.

Të theksojmë këtu se, reforma agrare, e cila ishte shkaku kryesor i varfërimit të të gjithë shtresave të myslimanëve dhe që i nxiti në shpërngulje, la pasojat edhe më të mëdha. Përveç që ishte një zgjidhje jofatlume, u zbatua në mënyrë shumë të egër, duke e proletarizuar një numër shumë të madh të myslimanëve, kurse familjet

e tëra myslimane i solli në varfëri të skajshme. Kjo ndodhi për shkak se tokat nuk iu morën vetëm pronarëve të mëdhenj, por edhe atyre të vegjël, të cilët tokën e kishin të vetmen pasuri, kurse punën bujqësore të vetmen mënyrë jetese. Me këtë plan joracional ekonomik shkatërruan shumë familje myslimane, sollën pasoja edhe në sferat e tjera të jetës, sepse pa një bazë materiale nuk ka kurrfarë perspektive. Prandaj, edhe nëse ka pasur ndonjë përpjekje vullnet apo dëshirë tek myslimanët për ngritje kulturore e arsimore, munonin mjetet materiale dhe kjo bëhet pengesa kryesore e zhvillimit të tyre. Vendet e braktisura myslimane nisën të popullohen nga të tjerët, proces ky që u emërua kolonizimi me vullnetarë...”⁴¹.

Veprimtaria atdhetare e Ferhat bej Dragës dhe bashkëveprimtarëve të tij, më së miri përshkruhet në analizën me titull “Propaganda shqiptare”, hartuar më 12 mars të vitit 1939 nga kryeshefi i njësisë administrativ në Shkup, Nik Dimitrijeviq. Në të, ndër të tjera, thuhej se pas vrasjes së Hasan Prishtinës, irredentizmit shqiptar i prin Ferhat bej Draga, veprimtaria e të cilit “zbatohet përmes rrugës konspirative”. Shenja të dukshme të veprimit të Dragës dhe miqve të tij ishin “përpjekjet që shqiptarët të tubohen në radhët e ngushta, të zgjedhin njerëzit e tyre, të cilët do t’i përfaqësojnë në Kuvendin Kombëtar, si dhe njerëzit e tyre në krye të administratave komunale”⁴². Ndër bashkëpunëtorët më të ngushtë të tij ishin mësuesit e mësim-besimit fetar, hoxhallarët dhe zyrtarët e vakëfeve. Me qëllim “që kompaktësia të jetë sa më e madhe – thuhej më tej në analizë – ka ardhur edhe deri te pajtimi i gjaqeve e kontesteve të tjera nga ana e parisë shqiptare”⁴³.

⁴¹ ДАРМ. 1. 613. 2.1/1-205, Извештај о раду Улема меџлиса у Скопљу за време од 1 јула 1938 до 1 јануара 1940 године.

⁴² Q. Lita, Shenjat e Kohës, vepra e cituar, fq. 127-159.

⁴³ Po aty.

Aktiviteti politik i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare i përfshinte dy pika më të rëndësishme:

1. Shpërndarja në popull e literaturës shqiptare, e cila depërtonte ilegalisht përmes kufirit; dhe
2. Ndërprerja e tërësishme e shpërnguljes së shqiptarëve, qoftë për Turqi, qoftë për Shqipëri.

Sipas Dimitrijviciqit, ky aktivitet i parisë shqiptare, mësuesve fetarë, si dhe përfaqësive diplomatike shqiptare në Shkup, Manastir e Beograd, pati ndikim vendimtar që *“lëvizja për shpërnguljen, e cila qe përfshirë te popullsia e jonë shqiptare deri në vitin 1936, sot të ngulëtatet”*, përkundër faktit se deri në atë periudhë kohore fshatra të tëra ishin të gatshme t’i braktisin vatrat e tyre dhe t’i lënë pasuritë e tyre pa kurrfarë dëmshpërblimi *“vetëm se shteti t’i lirojë nga tatimi i tokës, t’u japë pasaporta pa pare dhe t’ua paguajë rrugën deri në kufirin tonë”*. Nuk patën sukses *“as masat e rrepta agrare, as konfiskimi i armatimit”*. Prandaj, rruga e vetme që kjo çështje të filloj nga pika fillestare është *“shpërngulja përmes rrugës së caktuar diplomatike sipas Konventës së nënshkruar me Turqinë, edhe pse shqiptarët flasin publikisht se në asnjë mënyrë nuk do t’i lëshojnë vatrat e tyre...”*⁴⁴, theksonte veç tjerash Nik Dimitrijeviq.

Duke e përfunduar këtë punim studimor, kushtuar shpërnguljes së popullsisë shqiptare myslimane në Turqi dhe rolin e ulemave në pengimin e saj, mund të thuhet se procesi i shpërnguljes së shqiptarëve për në Turqi deri në vitin 1941 është zhvilluar në disa faza kohore. Shpërngulje më të mëdha pati në harkun kohor 1912–1924, pastaj më 1928–1936 dhe faza e fundit ishte më 1938–1941. Kjo e fundit lidhej drejtpërdrejt me Konventën e parafuar më 11 korrik në Stamboll nga palët negociuese turko-jugosllave, e cila –

⁴⁴ Po aty.

siç u tha më lart – parashihte që brenda gjashtë viteve të shpërngu-
leshin 40.000 familje myslimane (shqiptare e turke) për në Turqi.
Por, deri te kjo nuk u arrit falë veprimtarisë së palodhur të parisë së
atëhershme shqiptare, të udhëhequr nga Ferhat bej Draga, hafiz
Sherif Langu, mulla Idriz Gjilani, Ataullah ef. Kurtishi, Bedri ef.
Hamidi, Shaban Efendia, Azem Hoxha, Mulla Hajdari, Abdullah ef.
Ebibi, Lutfi ef. Ahmeti, Shherif Voca, Fetah Efendiu, Kadri Saliu,
Shuaip Kamberi, Ibrahim Lutfiu, Shaip Mustafa e shumë personali-
tete të tjera atdhetare e fetare shqiptare. Aktiviteti i tyre, nga njëra
anë, si dhe presioni politik nga diplomacia e atëhershme shqiptare
në Ankara dhe Stamboll, ishin arsyt kryesore që udhëheqja e atë-
hershme politike e Turqisë të mos e nënshkruajë Konventën, me
çka dështuan të gjitha planet antishqiptare të hartuara nga qarqet
serbomadhe. Lajmin për mosgatishmërinë e nënshkrimit të Kon-
ventës nga ana e Turqisë e solli i deleguari jugosllav në Ankara,
Axhemoviq, i cili me 4 maj 1939 i telegrafonte Ministrisë së Punë-
ve të Jashtme në Beograd me sa vijon:

“Shefi i sektorit ballkanik sot më komunikoi me sa vijon:

*Qeveria e Turqisë është e gatshme ta nënshkruajë Konventën, mirë-
po në situatën e tanishme është e detyruar ta ndërpres çdo aktivitet i
cili nuk është në përputhje me mbrojtjen kombëtare. Andaj, pasi nuk
ka mundësi ta zbatojë konventën, e ka patjetër ta shtyjë nënshkrimin.
Mundet të bisedohet vetëm nëse Jugosllavia është e gatshme ta rrisë
kontributin e saj për financimin e shpërnguljes.*

*Nga e mësipërmja konkludoj se Qeveria e Turqisë dëshiron që
neve të na kushtëzojë, duke vlerësuar se për këtë ka ardhur mo-
menti i duhur. Shtoj se Turqia nuk i ka ndërprerë punët e shumta
të cilat fare nuk kanë lidhje me mbrojtjen kombëtare”⁴⁵.*

⁴⁵ AJ. 370. 9/892.

NAIM HALIMI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore
të Shqiptarëve – Shkup*

PRIJËSIT FETARË KUMANOVARË NË MBROJTJE TË IDENTITETIT KOMBËTAR – AZEM HOXHA

Në kohën e sistemit monist në vendin tonë shumë është folur e është shkruar kundër fesë dhe prijësve tanë fetarë, sidomos hoxhallarëve atdhetarë. Shumë prej tyre janë akuzuar si të padëshiruar, si njerëz që ishin kundër regjimit, përparimit, vëllazërim–bashkimit, shkollimit, madje edhe kundër fesë islame, duke i quajtur si besimtar të rrejshëm, fanatikë fetarë, si njerëz që e shpjegonin gabim Kuranin dhe fenë islame, në përgjithësi, andaj si të tillë duhej dënuar. Kjo lloj propagande kishte për qëllim që t'i nënçmojë e t'i poshtërojë dhe, më pas, t'i dënojë njerëzit e devotshëm, besimtarët atdhetarë shqiptarë, e mbi të gjitha hoxhallarë të mirë. Për fat të keq, në këtë kohë, një numër i madh i tyre u akuzuan, u pushuan nga puna, u dënuan dhe u dëbuan. Për mendimin tonë, një fushatë e tillë zgjati shumë kohë, madje deri vonë, por jo në atë shkallë, si më parë. Ata që e patën këtë fat, ku treguan gjithçka që ditën dhe e dhanë atë që patën, madje edhe jetën dhe familjen e tyre e sakrifikuan, nuk humbën. Ata nuk i humbi Zoti e as populli, madje nuk i harroi as historia, ngase lanë fjalë, vepra, besa dhe pasardhës të mirë. Të tillë pati edhe në Kumanovë. Kalimthi po i përmendi disa prej tyre, si: Bylbyl Efendiu, Nuhi Efendiu, Shaban Efendiu, Mulla Sadiku, Mulla Dulla, Mulla Hajdari, Mulla Azemi, Mulla Jakupi e shumë e shumë të tjerë.

Në mesin e këtyre që përmendëm qe edhe Azem Hoxha, i njohur edhe si Azem Latifi-Shtraza ose Mulla Azemi, për të cilin do bëjmë fjalë pak më shumë në këtë kumesë. Azem Hoxha lindi më 1890 në fshatin Shtrazë të Malësisë së Kumanovës në familjen atdhetare të Latifit, vatër kjo e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Si gjyshi Latifi, ashtu edhe i ati, Aliu, morën pjesë në shumë ngjarje të kohës, jo vetëm në Karadak, por edhe më gjerë, duke dhënë kontribut të çmuar në luftën për liri, të udhëhequr nga Idriz Seferi. Të bindur se atdheut i duhet jo vetëm trimëria, por edhe dituria, ata i kushtuan rëndësi edhe shkollimit.⁴⁶ Prandaj e shkolluan edhe Azemin. Ai mësimet e para i mori në familje, ku mësoi histori të pashkruar e të shkruar, dituri, burrëri, trimëri e atdhedashuri. Duke parë aftësitë, interetin dhe intelektin e malësorit të ai, familja e dërgoi Azemin në shkollim të mëtejshëm në Kumanovë, në shkollën fillore (Iptidajje) dhe progjimnazin (Ruzhdije), të cilat i mbaroi para kohe dhe me sukses të shkëlqyeshëm. Me udhëzim të hoxhës dijetar e atdhetar, Nuhi efendiut,⁴⁷ (mik shtëpie i familjes së Azemit) dhe axhës Selim (Çaushi, ku banonte Azemi)⁴⁸, djaloshi i ri u regjistrua në Shkup, në Normalen e njohur të asaj kohe (Daryl Mualimi), të cilën e mbaroi po ashtu me sukses dhe e mori titullin Hoxhë – Mësues i fesë islame.⁴⁹

⁴⁶ Deklaratë e Haxhi Xhavit Latifit (i biri Azem Hoxhës), (60) më 14.06.1982, Kumanovë. Deklaratë e Izet Latifit (65), më 25.03.1979, Kumanovë. Shih edhe Naim Halimi, Azem Hoxha – fetar dhe atdhetar i shquar kumanovar, “Lavaruna”, qershor 1997, f. 17. Deklaratë e Shukri Latifit (70) Kumanovë, 16.09.1978. Deklaratë e Ali Latifitit (67), Kumanovë, më 10.06.1980.

⁴⁷ Nuhi efendi (1863) ishte bir i Isuf agës. Pasi mori mësimet e para fetare në gjuhën turke e arabe, e kreu medresenë e vjetër të Kumanovës dhe punoi si mësimdhënës dhe udhëheqës i medresesë e nga e cila dolën shumë dijetarë fetarë dhe atdhetarë, të cilët i shërbyen popullit në kohët më të vështira.

⁴⁸ Selim Latifi-Çaushi ishte udhëheqës i lartë ushtarak dhe atdhetar i shquar kumanovar (shtrazjan). U vra në Betejën e Kumanovës në f. Çetircë dhe u varros në varret e qytetit (sot spitali i qytet).

⁴⁹ Dëshmi është diploma e tij e gjetur në bibliotekën personale në Kumanovë.

Por, Hoxha i ri nuk u ndal me kaq. I etur për dituri dhe i përkrahur nga arsintare, dijetarë dhe atdhetarë të kohës, studimet i vazhdoi në Stamboll, në medresenë e vjetër (nga koha osmane) “İsa Beu”, ku mori titullin myderriz, profesor i teologji–filozofisë. Shokët e tij thonë se ai lexonte me pasion çdo gjë që i binte në dorë. Mësoi mirë dhe, pos shqipes, e njohte edhe serbishten, turqishten, arabishten e bullgarishten, ndërsa komunikonte edhe rusisht, frëngjisht dhe gjermanisht. Ai fitoi njohuri edhe nga shkencat ekzakte, nga matematika, inxhinieria dhe astronomia. Por, në veçanti i interesonte çështja shqiptare, shqiptaria nga e cila kishte dalë dhe së cilës donte t’i dalë krah, që i kishte borxh dhe donte të punojë për të sa dinte e si të mundej, duke mos kursyer asgjë, madje sa jetën nëse e kërkonte nevojja. Interesimi për këtë çështje sa vinte e rritej, sidomos kur ra në kontakt, jo vetëm me veprat e rilindësve tanë, por edhe me veprimtarë të shquar kombëtarë në lagjen Taksim ku banonte.

I frymëzuar nga ata, ndonëse i ri, ai mori pjesë në themelimin e Organizatës Politike “Xhemijeti” (Bashkimi) në Shkup më 1919.⁵⁰ Kjo organizatë, edhe pse nuk qe pastër shqiptare, siç e dimë, kishte për qëllim mbrojtjen e çështjes shqiptare dhe të myslimanëve në tërësi. Nëpërmjet tij dhe anëtarëve si ky, aty u bartën vendimet dhe detyrat e Bashkimit (Xhemietit) jo vetëm në anën e Kumanovës e Karadakut, po edhe më tej në Anamoravë e Kosovë, ku u shpërnda edhe informatori i saj, gazeta “Hak”, e cila – thënë realisht – edhe pse botohej serbisht e turqisht – dha kontribut të çmuar edhe për çështjen shqiptare e fetare.

Azem Hoxha, pos në vendlindje, aktivitetin patriotik e vazhdoi edhe në Stamboll. Meqë banonte në lagjen Taksim, siç thamë, të

⁵⁰Ditari 50-fletësh në dorëshkrim i shkruar shqip e i gjetur në bibliotekën e tij në vitin 1982. Shih edhe Naim Halimi, *Xhemijeti në ditarin e Azem Hoxhës*.

banuar kryesisht me shqiptar, atij iu dha mundësia edhe më tepër ta tregojë veten në çështjen kombëtare. Mësoi shumë prej udhëheqësve të Lëvizjes Kombëtare, madje prej tyre mori edhe detyra me rëndësi që t'i realizojë kudo që të shkojë. Duke hulumtuar veprimtarinë e tij, shohim se edhe në gazetatat e kohës ai kritikoi shumë dukuri negative që e rëndonin pozitën e shqiptarëve e që u vinin nga qarqe të ndryshme, madje e kritikoi ashpër pjesëmarrjen e madhe të shqiptarëve në Luftën e Çanakalasë (1915), si të atyre të Anadollit që u rekrutuan me dhunë nga strukturat udhëheqëse të Sulltanit (Stambollit), jodashamirëse të shqiptarëve, ashtu edhe të atyre të Ballkanit, që vullnetarisht shkuan, luftuan e u vranë për pak interesa, duke e lënë vendlindjen e tyre në luftë e në flakën e zjarrit.

Ai shkroi në disa gazeta e në disa gjuhë shumë artikuj për popullin e tij liridashës, madje hartoi edhe disa shkresa, ankesa, kërkesa dhe memorandumë. Kjo, siç shihet nga shkrimet, qe koha e revolucionit të Kemal Atatürkut (me origjinë shqiptare), i cili në Turqi bëri një seri reformash për ndërtimin e shtetit modern turk, ku morën pjesë edhe shqiptarët (por, siç thotë edhe këtu Azem Hoxha, shqiptarët s'fituan gjë nga çështja kombëtare ose fituan fare pak).

Hoxhë Azemi, pas mbarimit të studimeve, punoi një kohë si profesor dhe edukator në medresenë e lartpërmendur, e njohur për sukseset e saj, nga e cila mësuam e punuan edhe shumë shqiptarë, të cilët më pas u njohën si dijetarë të shquar dhe atdhetarë, jo vetëm në viset tona.

Hoxha, për nga bindjet politike dhe shtetndërtimi, qe demokrat, përkrahës i Nolit dhe i Avni Rustemit. Disa herë, për t'i realizuar detyrat e marra nga veprimtarët (nga Stambolli), shkoi në Shqipëri

dhe u kthye me sukses prapë në Turqi.⁵¹ Gjatë kësaj kohe edhe më tepër e përforcoi bindjen se “kombi dhe feja (ose feja dhe kombi) janë dy shtylla kryesore që e formojnë njeriun (personalitetin e tij), kombin dhe shtetin. I pajisur mirë me këto cilësi e virtyte të larta, Azem Hoxha vendosi të kthehet në atdhe, në Kumanovë (1926), si myderriz, me diplomë, ku filloi të punojë si imam, hoxhë dhe myfti. Për të rregulluar një konflikt në xhami, punoi derisa e rregulloi edhe në Rahovicë (sot në Luginë të Preshevës), ku edhe hapi shkollën nga e cila dolën shumë dijetarë që punuan në të mirë të popullit, jo vetëm në atë anë.⁵²

Ndonëse në kushte tejet të rënda të hegjemonisë serbe, kur shqiptarët s’kishin kurrfarë të drejte, Hoxhë Azemi u bë njeri i dashur, i besuar dhe i respektuar, me aftësi të shquara intelektuale, me fjalor të ëmbël e të sinqertë, me oratori, i palodhshëm, organizator i papërtueshëm, familjar shembullor, atdhetar dhe fetar i devotshëm, shpjegues dhe ligjërues i denjë i fesë islame, i Kuranit hyjnor, shqiptar shembullor, trim sypatrembur dhe atdhetar.

Përmes gjuhës së bukur shqipe, që e donte më shumë, ai arriti t’i përhapë porositë e Zotit dhe të Dërguarit të Tij, Muhamedit, të marrë nga Kuranit famëlartë, jo vetëm në Kumanovë e rrethinë, po kudo që shkoi. Janë të panumërta ligjëratat e tij, mendimet, thëniet, mësimet, këshillimet e fetfatë, që edhe sot përmenden dhe përdoren në popull.⁵³ Ai shumë herë thoshte, për ta kuptuar populli më mirë, se “feja e kombi janë si mishi e thoni, të pandarë”, duke aluduar që edhe populli edhe ai të jetë i bashkuar pa dallim gjinie, pasurie, shtrese shoqërore, diturie e nahije. Natyrisht duke qenë hoxhë dhe

⁵¹ Deklaratë e Izet Latifit (67), Kumanovë, 23.07.1986.

⁵² Deklaratë e Mulla Jupës (60), Kumanovë, 20 .04.1984.

⁵³ Deklaratë e Sefë Malokut(58), Kumanovë, 15.04.19787.

prijës fetar, preokupim kryesor e kishte edukimin dhe arsimimin e popullit në fenë islame sipas Kuranit të Shenjtë dhe udhëzimeve të profetit Muhamed, por kur ishte në pyetje çështja kombëtare shqiptare, asnjëherë nuk e anashkalonte atë, duke e lidhë gjithnjë çështjen kombëtare me atë fetare, madje në disa raste kombëtares i jepte përparësi, sidomos kur ishte në pyetje shtetndërtimi.

Atdheun, fenë dhe kombin e Shqipërinë e donte në veçanti, madje i krahasonte me shumë shembuj e edhe me njeriun, krijesën më të vlefshme të Perëndisë, njeriun pa të meta, i cili vetëm ai nuk mund të ishte njeri. Pa atdhe thoshte ai “s’ka din, iman as fe”. “Më e vështirë për ne, është të mbahet, kombi, feja dhe atdheu, Shqipëria etnike e demokratike deri aty ku na i ka dhanë Zoti”, thoshte ai, duke dhënë qindra shembuj të mundshëm se si ruhen ato.

Atdhetarizmi i tij shfaqej kudo. Meqë në veçanti e donte shqiptarinë, vazhdimisht këshillonte “ne jemi shqiptarë dhe si të tillë duhet të jetojmë dhe të vdesim”. Ai kishte admirim për gjithçka që ishte shqiptare, për gjuhën, doket, besën, veshjen, ushqimin, mënyrën e jetës, moralin, simbolet e, sidomos, për flamurin. Në ligjëratat e tij gjithnjë gjente vend gjendja e popullit të tij të dashur shqiptar, nga i cili kishte dalë e për të cilin më së shumti interesohej e punonte, duke mos e lënë anash as gjendjen e vështirë të popullit mysliman.

Ai i kishte zbuluar shumë mirë shkaqet e jetës së rëndë të shqiptarëve, si në kohën Perandorisë Osmane, të Turqisë, të Serbisë, por edhe të Jugosllavisë. Qe ihtar dhe anëtar i flakët i organizatës “Be-sa” e themeluar në Beograd (1935) nga studentët përparimtarë shqiptarë.⁵⁴

⁵⁴ Deklaratë e Zeqavete Nuhiut (56), Kumanovë, 17.07.1989.

Si i tillë Hoxha, qe kundërshtar i ashpër i hegjemonizmit serbo-madh, i reformës agrare e kolonizimit, si dhe kundër shpërnguljes së shqiptarëve dhe myslimanëve për Turqi. Ashpër iu kundërvu marrjes së tokave të shqiptarëve, pasurisë së myftinisë e vakëfit të xhamive dhe varrezave të Kumanovës (gjoja për ndërtimin e një spitali nga tregtari beogradas Nikolla Spasiq më 1938), për çka u pushua nga puna dhe qyteti dhe u detyrua të kthehet në fshatin e lindjes, ku punoi dhe veproi disa vjet, deri në LDB.

Lufta krijoi rrethana të reja, por Hoxha nuk qe pa angazhime. Ai e vazhdoi punën në Lëvizjen Kombëtare, duke iu bashkuar luftëtarëve të lirisë, të udhëhequr nga tribuni popullor Sylë Hotla. Qe këshilltar e bashkëluftëtar i tij. Si në vendluftime, edhe në shumë vendtakime, madje edhe në rastet më të rënda, fjala dhe mendimi i tij qe pothuajse vendimtar, sepse jepte mesazhe paqeje, drejtësie, besimi, vendosmërie, singëriteti, guximi dhe trimërie.⁵⁵

Ai ishte kundër diktaturës komuniste. Duke ditur se është ideologji e huaj, sllave-ruse, ai nuk priste gjë prej saj. Në fjalimet e tij thoshte se “komunizmi sjell drejtësi me fjalë, jo me vepra. Ka synim t’i mashtrojë e t’i bashkojë popujt, e mandej t’i nënshtrojë dhe asimilojë, sidomos ata josllavë e jomysliman, në rend të parë shqiptarët, kompakt dhe autokton në vendet e tyre”.

Azem Hoxha –shte pro –perëndimor. Lindjen e diellit, çlirimin, si rilindësit, e shihte nga Perëndimi. E donte shkollimin. Ishte das-hamir i shkollës dhe shkollimit, sidomos në gjuhën amtare,shqipe. Në viti 1942, më herët e më pas, bëri një përpjekje bashkë me arsimdashësit atdhetar kumanovarë të hapë shkollë shqipe në Kuma-

⁵⁵ Deklaratë e Sefer Halimit,(60), Kumanovë,16.05.1989.

novë⁵⁶. Madje kërkoi me ngulm nga fuqitë e mëdha të kohës, edhe ato shqiptare, që treva shqiptare e Kumanovës heroike me Karada-kun legjendar dhe viset e tjera të banuara me shqiptarë, t'i bashkohen Shqipërisë Demokratike – deri aty ku flitej shqip të ishte Shqipëri etnike. Ndonëse kjo nuk u realizua për shkaqe të njohura, Hoxha nuk u dëshpërua dhe nuk iu nda punës fetare e kombëtare, me shpresë se ajo do të realizohej një ditë.

Ai ishte adhures i dijes. Dituria, sipas tij, “ishte drita e syrit” dhe vazhdonte më tej “i pa shkolluari është si i verbëti”, duke aluduar që populli të shkollohet sa më shumë, sidomos rinia të jetë përfutjesja më e madhe e njohurive pozitive në të gjitha fushat e shkencave dhe jetës në tërësi. Madje, shkollimin e preferonte edhe në gjuhë të huaja, nëse kishte nevojë, duke cituar shpeshherë profetin Muhamed që kishte thënë: “Kërkojeni diturinë, qoftë edhe në Kinë!”.

Për shkak ideve përparimtare dhe kundërshtimit të sistemit, disa herë qe burgosur edhe në vitin 1948, por ai kurrë nuk u thye dhe nuk u nënshtrua. Gjatë arrestimeve, iu sekuestruan shumë libra, revista, gazeta dhe dorëshkrime. U fajësua me akuzën kundër popullit e shtetit – agjitacion e propagandë. U torturua pa marrë parasysh moshën që kishte. Në burgje qëndroi burrërisht, pa e zbuluar e rënduar asnjë bashkëpunëtor dhe qëndroi ashtu siç i kishte hije një hoxhe me shtat malësori, i pashëm, dijetar, patriot e krenar.⁵⁷

⁵⁶Qerim Lita, Shaban Efendia atdhetar i devotshëm, Kumanovë, 2010. Izet Latifi, po aty. Sefë Maloku, po aty. Agim Rushiti, *Me pishtarët e arsimit shqip në komunën e Kumanovës e Likovës* (1945-1960), Kumanovë, 2000, f.55. Deklaratë e Bajram Nuhiut (60), Kumanovë, 17.07. 1997. Deklaratë e Mustafa Ajdinit (65), Kumanovë, më 20.04.2002. Deklaratë e Hamid dhe Kadrije Thaçit (78,70), Shkup, më 10.06.1988.

⁵⁷ Deklaratë e Haxhi Reshatit (77), Kumanovë,1990. Deklaratë e Arif Seferit (56) Kumanovë,16.06.1986. Deklaratë e Jetulla Likovës (60), Kumanovë, më 16.06.1986.

Edhe sot flitet për një rast (që veçuam prej shumë rasteve) kur shefi i policisë bullgare (fetfebelli) e kërcënoi duke i thënë “ti kërkon plumb në lule të ballit për punën që po bën”. Hoxhës, pa iu trembur syri fare, ia ktheu: “po, ndoshta kërkuj, po s’ka kush me ma dhënë, e nëse ka, atëherë le ta provojë ta shohë kush është ai”. Nëse ndodh kjo – vazhdoi hoxha – do të ishte shumë mirë, sepse për punën që kamë bërë për popullin tim populli do të më shpallë hero, ndërsa feja shehid, por po frikohem se kam punuar pak e nuk e kamë atë fat të vdes të shpallem martir. Pas kësaj polemike, kryeshefi e uli kokën dhe i tërbuar doli nga zyra duke e sharë, ndërsa hoxha e vazhdoi punën syptrembur si më parë.

Në vitin Hoxha 1945 ishte udhëheqës i “Shoqatës Ilmije”. Si hoxhë e myfti, edhe pas LDB-së, ai pati shumë probleme me pushtetin. Iu kundërvu projektit të ri antishqiptar të regjimit komunist të shpërnguljes së shqiptarëve në Turqi. Me guximin më të madh e ftonë popullin që të mos e braktisë atdheun e të parëve. U kundërviej atyre që shpërnguleshin duke ju thënë se “s’janë shqiptarë mysliman ata që shpërngulen. Ata s’ja duan të mirën as vetes, as popullit e as atdheut. Vendi ku shkojnë se dinë çka i pret, s’është xhenet etj. Parajsë është vendlindja. Ata, që shpërngulen mos i ndihmoni. Pengoni, mos i lejon. Mos i përcillni” etj. etj.

Azem Hoxha ishte edhe hoxhë inovator. Mendohej njohurit e fituara t’i zbatojë në praktik, aq sa ia lejonin kushtet e kohës dhe vendit. Në punëtorinë e tij (që e kishte afër xhamisë) ideoi dhe punoi shumë orëndi, vegla, llogari, sistem të llogaritjes së kohës, kalendar mbi pozitën e yjeve në sistemin diellor për çdo ditë, javë, muaj vite e shekuj. Ai qe edhe orëndeçës, konstruktor i armëve, sidomos i revoleve e pushkës me një e më shumë fishekë etj.

Hoxha ka lexuar shumë, ka pasur bibliotekë të pasur. Aftësitë e tija shkencore (mendore) në atë kohë nuk mund t'i kuptonin shumë njerëz, prandaj kishte edhe raste kur përgeshej nga injorantët, duke thënë se “hoxha nuk ishte në veti” kur ai thoshte se “do të vijë koha kur njeriu do të shkoj në Hënë” ose se “armët do të përsosen aq shumë, saqë një shtet sa do i vogël të jetë, mund ta shkatërrojë botën nëse nuk kontrollohen ato, ashtu që njerëzit do ta kenë vështirë të jetojnë në tokë nëse nuk gjejnë mirëkuptim” etj.

Pas gjithë kësaj veprimtarie, Azem Hoxha, në moshë të shtyrë e pas një sëmundje të shkurtër e të rëndë, u nda nga kjo botë më 14 maj 1964 në Kumanovë dhe u varros në varret e qytetit me nderime të larta fetare dhe kombëtare, duke lënë pas vetes shumë fjalë, vepra dhe pasardhës të mirë. Ai mbeti një personalitet i shquar, i paharruar, i nderuar, hoxhë, dijetar, atdhetar i shquar shqiptar, jo vetëm shtrazjan e kumanovar.

NASER RAMADANI

Fakulteti i Shkencave Islame – Shkup

AVNI AVDIU

Universiteti “Nënë Tereza” – Shkup

KONTRIBUTI I MEDIEVE TË KUMANOVËS NË NGRITJEN E VETËDIJES FETARE NË MAQEDONI DHE JASHTË SAJ

Klima fetare para dhe pas pluralizmi medial

Para viteve të '90-ta vetëdija fetare e popullatës në Maqedoni ka qenë e ulët. Feja më tepër kuptohej si traditë e trashëguar sesa si sistem jete. Pjesa dërmuese e popullatës më tepër e kishin marrë fenë me të dëgjuar, edhe atë shpesh nga burime jokompetente. Edhe fryma fetare, e cila pak ishte e hetueshme, e reflektonte këtë mentalitet. Praktikantë të detyrimeve fetare ishin vetëm të mos-huarit dhe fare pak mund të shihej ndonjë i ri në xhami. Fryma fetare jehonë më të madhe kishte vetëm gjatë muajit të bekuar të Ramazanit, në veçanti gjatë dy kremtave të bajrameve, e pak më pak edhe gjatë sezonit të haxhit: vajtje–ardhjes së haxhilerëve. Madje, mund të thuhet se haxhi nuk kishte edhe aq ndonjë ndikim në popullatë, por veç sa zgjonte interesime individuale të atyre që shprehnin dëshirë për të shkuar në haxh, e deri–diku edhe të të afërmeve të tyre.

E vetmja gazetë ishte “Hëna e Re”, e cila botohej çdo muaj. Shitja dhe shpërndarja e saj bëhej ekskluzivisht nëpër xhami dhe dorë më dorë. Së këtejmi, edhe interesimi i të rinjve për të ishte i paqasshëm e i papërfillshëm, ndërsa të moshuarit nuk kishin kulturë leximi.

Pra, duke pasur parasysh këto rrethana, gazeta nuk ishte me botim voluminoz, e madje edhe aq sa editohej nuk shitej tërësisht. Nga botimet vlen të veçohen edhe periodikët e takvimeve, që më tepër ishin informatorë të kalendarit islam dhe kohës së lutjeve dhe kishin pak faqe që trajtonin ndonjë temë besimi.

Kësisoj, mund të thuhet se gjatë kësaj periudhe jeta fetare kalonte nëpër terrin informativ të regjimit komunist dhe kështu mbeti gjer në kohën e mëvetësimit të Maqedonisë.

Pas shkëputjes së Republikës së Maqedonisë nga RSFJ, demokrazimit të vendit dhe instalimit të pluralizmit politik, lindi edhe një pluralizëm aq fort i dëshiruar e që lidhej me lirinë e shprehjes – pluralizmi mediatik. U hoq monopoli centralist mbi medien, u lejua hapja e medieprivate dhe njëherazi u lejua fjala e lirë. Kjo atmosferë e re politike ishte e mirëseardhur në të gjitha sferat ku shqiptarët ishin të diskriminuar, në veçanti në atë kombëtare, kulturore e fetare. Gjithandëj u hapën radio e televizione private edhe nga shqiptarët, kurse – përmes tyre – u mundësua edhe përçimi i mesazhit islam. Një kontribut të konsiderueshëm në këtë drejtim kanë dhënë edhe mediet e Kumanovës.

RTV Hana

Themelues i RTV “Hana” ishte mërgimtari Mevlan Latifi, drejtor Selver Ajdini, ndërsa kryeredaktor Bejzad Ismaili. Programi eksperimental filloi në nëntor të vitit 1992 nga banesa e pronarit të TV-së, që gjendej në rrugën 11 Oktomvri I-46. Nga viti 1993 TV Hana u vendos në lokalitetin Garnizon I-48. Për gjashtë muaj rresht ka qenë program eksperimental, për të filluar pastaj me program të rregullt prej 12-orësh në TV dhe 6-orësh në radio. Në vitin 1999 TV Hana me vetëfinancim e ndërtoi objektin në rrugën

11 Nëntori 1/1–16 me standarde profesionale dhe që i përmbushte nevojat për punë, madje edhe i kalonte caqet e televizionit lokal. Valët e Hanës e mbulonin rajonin e Kumanovës, Preshevës me rrethinë, Bujanocit me rrethinë (22 repetitorë ishin të instaluar në shumicën e fshatrave të rrethit të Bujanocit). Televizioni funksiononte në bazë të një leje që e kishte lëshuar Ministria për Informim. Ministria e njëjtë në vitin 1995 lëshoi një urdhër për ndalim të emetimit të programit të të gjitha televizioneve private në Maqedoni për një periudhë të pacaktuar. Me presione nga faktori i jashtëm dhe i partisë shqiptare në pushtet (Partisë për Prosperitet Demokratik), televizioni përsëri nisi me punë pas 45 ditësh. Me hyrjen në fuqi të ligjit për medien nga viti 1997, TV “Hana” punoi profesionalisht si në aspektin teknik, kadrovik dhe hapësinor. Emisionet e para të saj ishin kryesisht argëtuese, gjersa pjesa dërmuese mbulohej me muzikë. Tek në orët e mbrëmjes kishte emisione tematike, në të cilat jepej edhe hapësira kontaktuese e inkuadrimit të dëgjuesve. Në programet e natës, që i mbante Agim Beluli, trajtoheshin herë–herë edhe tema me karakter religjioz, ku dominonte interesimi i dëgjuesve për të debatuar lidhur me tema ekzorciste, në veçanti për magjinë dhe ndikimin e saj. Nga emisionet e tilla mund të hetohej besimi naiv i pjesës dërmuese të qytetarëve, mosnjohja e tyre me gjërat elementare të fesë dhe besimi në besëtytni të ndryshme.

Ashtu sikurse përmbajtjet programore të radios, edhe ato televizive fillimisht kishin karakter rekreativo–argëtues. Më pas stafi medial u përcaktua ta shesë radion, për t’u fokusuar në televizion. Tek atëherë filluan të jepeshin disa emisione me karakter informativ dhe edukativo–arsimor, në kuadër të të cilave nganjëherë gjenin hapësirë edhe temat fetare.

Më 1994 TV “Hana”, për herë të parë, bëri transmetimin e drejtpërdrejtë të faljes së Bajramit. Emisionet fetare bëheshin në bashkëpunim me Myftininë e Kumanovës. Gjatë muajit të Ramazanit emetoheshin ligjëratat të rregullta ditore para kohës së iftarit. Po ashtu jepeshin edhe recitime Kurani, dokumentare fetare, ilahi dhe ezani i akshamit. Ligjëratat i mbanin hoxhallarë të ndryshëm nga Komuna e Kumanovës, të cilët caktoheshin nga ana e Muftinisë së Kumanovës. Temat në fjalë, në përgjithësi, kishin karakter edukativ dhe arsimor dhe kishin për qëllim ngritjen e vetëdijes fetare në mesin e muslimanëve. Aty shpeshherë trajtoheshin edhe tema debatuuese, ku krahas një teologu kishte edhe të ftuar të tjerë, si njëkë, psikologë, sociologë, pedagogë etj. TV “Hana” u mbyll më 17 janar të këtij viti [2019].

Radio “AsHana”

RTV “Hana” teknikën e saj të radios ia shiti gazetarit Fejzi Ajdari. Radioja u hap me emër të ri (AsHana) dhe filloi me punë në prill të vitit 1995 në rrugën Nikolla Vapcarov nr. 1. Edhe kjo radio, krahas emisioneve të ndryshme, kishte edhe emisione fetare, të cilat i udhëhiqte gazetari Bashkim Murtezi. Radioja, përveç ligjëratave fetare, transmetonte edhe këndim Kurani, ilahi, thirrjen e ezanit dhe emisione kontaktuese me karakter fetar. Radioja u mbyll në tetor të vitit 1997.

Radio Albana

Një ndër mediet që u ka kushtuar hapësirë të konsiderueshme emisioneve fetare është edhe radio “Albana”. Themeluesi i saj ishte Bajrush Veliu, ndërsa radioja ka qenë fare afër xhamisë së qytetit Sinan Tatar Pasha. Ndër punëtorët më të zellshëm të emisioneve

fetare kanë qenë Fejzulla Arifi dhe Bajram Ramadani. Herë njëri e herë tjetri, që nga viti 1994 e deri më 1998, ata kanë përgatitur emisione të ndryshme me karakter fetar, duke përfshirë edhe emisionet kontaktuese me dëgjuesit.

Prej vitit 2001 e gjer më tani radio “Albana” sërish vazhdon me emisionet fetare, në veçanti me ligjëratat të hoxhallarëve. Radio “Albana” transmeton edhe ezanet ditore nga xhamia që ka afër. Sipas këtyre dy aktivistëve (Fejzulla Arifit dhe Bajram Ramadanit), para se të inkuadroheshin në radio Albana, janë bërë edhe përpjekje të mëhershme për t’i përçuar ligjëratat fetare. Sipas tyre, emetimi i parë në eter i përmbytjeve fetare është bërë qysh më 1991 me një transmetues shumë të vogël me rreze veprimi që përfshinte vetëm fshatin Sllupçan, e që ishte vendosur brenda xhamisë me qëllim që ligjëratat e hoxhës Jakup Asipit t’i dëgjonin edhe ata që ndodheshin në shtëpi. Nga viti 1992 e deri më 1994 nga po ky fshat është emetuar program fetar nga një transmetues i punuar nga një gjerman i konvertuar në Islam që vinte nga Bremeni i Gjermanisë. Ky transmetues kishte rreze më të gjerë përfshirjeje në tërë fshatrat e komunës së Likovës.

Prej janarit e deri në nëntor të vitit 1998 këta veprimtarë (Fejzulla Arifi dhe Bajram Ramadani) kanë vepruar me një radio lokale, që ia kishin vënë emrin radio Horizonti, e që ishte e vendosur në fshatin Mateç. Kjo radio kishte rreze akoma më të gjerë përfshirjeje, kështu që dëgjueshmëria arrinte në Kumanovë, Preshevë, Gjilan, Ferizaj etj.

Veprimtaria fetare-islame në radio “Albana” ishte projekt në kuadër të bibliotekës “*Halid Efendi*” në Sllupçan. Gjatë Ramazanit emisionet fetare realizoheshin edhe pas mesnate deri në kohën e syfyrit. Emisioni dyorësh quhej “*Ta njohim të vërtetën*” dhe reali-

zohej çdo natë me rubrika të ndryshme: emisione kontaktuese, kuriozitete, pjesë teatrale, anketa të dëgjuesve, intervista etj. Duke e parë interesimin e madh të dëgjuesve, pas disa ditësh emisioni u zhvendos në orën 20.00, me çka u krijua hapësirë më e madhe transmetimi.

Radio Jehona

Ndërmarrja tregtare radiodifuzive “*Radio Jehona*” fillesat e para i kishte nga viti 1995 me emrin “*Radio Arbana*”, si radiostacioni i parë shqiptar në komunën e Likovës, ndërsa në vitin 1997 u bë themelimi edhe i televizionit të parë e të vetëm në komunën e Likovës – “TV Arbana”, pajisjet teknike të së cilit u blenë nga TV “Zëri i Kumanovës”. Pronar i TV Arbanës ishte Raif Shabani, pronar i ndërmarrjes për përpunimin e drurit *Mahagonija*. Kjo medie ka pasur program të plotë, me skemë programore mjaft të pasur me lajme, emisione edukative, kulturore, argëtuese, me mysafirë në studio etj. Ajo ka dhënë kontribut të madh në ngritjen e vetëdijes fetare në mesin e muslimanëve të këtij rajoni. Kishte emisione të rregullta javore, të cilat i udhëhiqte hoxhë Nebi Memedi. Në këto emisione ftoheshin hoxhallarë të ndryshëm, por i rregullt ishte dr. Naser Ramadani nga fshati Mateç.

Ky televizion ka dhënë kontribut të madh në kohën e krizës me refugjatët nga Kosova (1998–2000), duke ndihmuar në bashkimin familjar nga Kosova dhe duke dhënë informacione për të gjitha ndodhitë e atëhershme gjatë luftës në Kosovë.

Me fillimin e konfliktit të armatosur në komunën e Likovës në vitin 2001, objekti në të cilin ishte radioja dhe televizioni, e që njihej si shtëpia e kulturës në qendër të fshatit Mateç, u bombardua nga forcat e armatosura maqedonase, me ç’rast u dogj tërësisht gjithçka

që ndodhej në të. Pas përfundimit të konfliktit, asgjë nuk u kompensua nga instancat shtetërore. Pas konfliktit luftarak, me mjetet vetanake financiare të pronarit ajo u riparua, duke funksionuar në kushte tejet të vështira deri në vitin 2003. Pas këtij viti, radio “Arabana”, përveç që u licencua dhe mori frekuenca të reja, e ndërroi edhe emrin në radio “Jehona”, me të cilin emër funksionon sot e kësaj dite. Pronar dhe drejtor i radio *Jehonës* është Besim Shabani. Radio “Jehona” ndodhet përballë tregut të gjelbër në Kumanovë, afër Shkollës së Mesme “*Sami Frashëri*”. Valët e radios përfshijnë Kumanovën, komunën e Likovës dhe rajonin e Preshevës dhe Bujanocit. Edhe radio “*Jehona*” në programin e saj ka ndarë hapësirë për emisionet fetare. Çdo të premte transmeton ligjërata të shkurtëra nga hoxhallarë të ndryshëm, emeton këndim Kurani, ilahi dhe përmbajtje të tjera fetare. Sikurse pohon hoxha Abdullah Shaqiri, ai personalisht është angazhuar që prej vitit 2010 të mbajë një sërë emisionesh, posaçërisht të shtunave para dite prej orës 11.30 e gjer në orën 13.00. Në emisionet e tij, ai disa herë ka pasur mysafirë eminentë, me të cilët kanë shtjelluar tema nga më të ndryshmet. Emisionet kanë qenë më intensive gjatë muajit të Ramazanit, ku krahas mysafirëve dhe kontaktit me dëgjues me pyetje e përgjigje, janë përgatitur edhe kuize, ku dëgjuesit janë shpërblyer për përgjigjet e sakta. Hoxha, me zërin e tij të bukur, shpesh ka kënduar Kuran e ilahi drejtpërdrejt në studio dhe po ashtu ka pasur të ftuar edhe këndues të tjerë të ilahive. Radio “Jehona” bashkëpunon gjithashtu edhe me struktura të tjera fetare, si me Forumin Rinor Islam, shoqatën “Vllaznia” dhe me Organizatën Humanitare “El Hilal”. Kontribut të madh në përgatitjen dhe udhëheqjen e emisioneve fetare ka dhënë edhe Agim Avdiu, njëherësh përkthyes i dhjetëra librave fetarë, vëllimeve të haditheve dhe moderator i disa manifestimeve fetare brenda dhe jashtë shtetit.

RTV “Zëri i Kumanovës”

Një ndër mediat që ka lënë gjurmë më të thella ka qenë RTV “Zëri i Kumanovës”. Radioja u hap më 26 nëntor 1993, ndërsa një vit më vonë edhe televizioni. Vendndodhja e medias ishte në rrugën Uzhička, nr. 3. Para hapjes së “Zërit të Kumanovës” bashkëthemeluesit, gazetari Nexhat Aqifi dhe këngëtari Ismet Bexheti, kishin ftuar krerët fetarë, reis ulemanë Sulejman Rexhepin, myftiun, Isa Ismaili, dhe hoxhallarë të tjerë për ta bërë hapjen zyrtare me mevlud dhe dua. Me të filluar punën, kjo medie menjëherë u shqua jo vetëm për nga organizimi më i sofistikuar kadrovik e programor, por edhe me bashkëpunimin që vendosi me shumë mekanizma relevante të jetës shoqërore. Një bashkëpunim të tillë kishte edhe me Myftininë e Kumanovës, me të cilën ka organizuar disa emisione fetare nën mbikëqyrjen e redaktorit të emisioneve hoxhës Enver Zeqiri. Përndryshe, përmbajtjet fetare nuk janë shtrirë vetëm në emisionet fetare. Ka pasur emisione, si bie fjala “Për të gjithë nga pak”, ku janë ndërfutur edhe tematikat fetare. Nuk ka qëlluar ndonjë datë me rëndësi fetare pa u mbajtur emision enkas për atë ngjarje. Në radio është lexuar arabisht krejt Kurani, pastaj ajet pas ajeti është përkthyer në gjuhën shqipe me koment. Janë lexuar përmbledhje hadithesh po ashtu me koment dhe janë lexuar dhjetëra libra të tërë, duke u ndarë tematikat sipas kapitujve e duke sjellë çdo ditë tematika të ndryshme. Një terren i përshtatshëm i leximit të librave ka qenë emisioni i mëngjesit “Parraditja me Zërin”, ku dëgjueshmëria ka qenë e nivelit më të lartë. Në këtë emision, të përgatitur e udhëhequr nga kryeredaktori Avni Avdiu, çdo ditë nga çerekore është lexuar pjesë nga librat me përmbajtje islame. Intermeco gjatë pauzimit të leximit kanë qenë ilahitë e përzgjedhura në gjuhën arabe, shqipe, turke e rrallë edhe

në atë boshnjake. Në pjesën më të madhe të emisioneve të zhvilluara dëgjuesit kanë pasur mundësi të inkuadrohen, të pyesin hoxhallarët mysafirë dhe të japin edhe mendimet e tyre. Edhe televizioni ka dedikuar një hapësirë të madhe për emisionet fetare, përfshirë mysafirët e ftuar, dokumentarë, Kuran, ilahi etj. Gjatë Ramazanit të vitit 1997 kishte emisione të rregullta ditore me përmbajtje fetare islame. Mysafir i rregullt ishte dr. Naser Ramadani, i caktuar nga Myftinia e Kumanovës, ndërsa emisionet i udhëhiqte kryeredaktori Avni Avdiu. Temat në fjalë ndërlidheshin me çështjet islame, si besim, adhurime, etikë, moral, komente të Kuranit e komente të haditheve, të cilat në përgjithësi kishin për qëllim ngritjen e vetëdijes së popullatës.

Kjo medie është shquar edhe për faktin se ndërkomunikimi me dëgjuesin dhe shikuesin ka qenë më intensiv. Ndërkaq fakti se valët radiotelevizive përfshinin një pjesë të konsiderueshme të Republikës së Kosovës (Ferizaj, Viti, Gjilan, Kaçanik etj.) dhe të Kosovës Lindore (Preshevë, Medvegje e Bujanoc) e bënte këtë medie edhe më me peshë. Reklammat, shpalljet dhe lajmërimet nga Kosova dhe inkuadrimi i shpeshtë i dëgjuesve nga këto anë, si dhe i mërgimtarëve nga diaspora shqiptare, i dhanë një popullaritet edhe më të madh. Ashtu sikurse filloi me mision, edhe përfundoi. “Zëri i Kumanovës” u mbyll në qytetin e Kumanovës më 1998, për të vazhduar si radio “Kosova e Lirë”. Pronari, Ismet Bexheti, me të filluar lufta në Kosovë, kishte vendosur që teknikën e radios ta bartë në malet e Berishës për ta vënë në shërbim të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ashtu që të kontribuojë në aspektin informativ gjatë zhvillimit të luftimeve me forcat serbe. Përndryshe “Zëri i Kumanovës”, me të filluar lufta në Kosovë, ka qenë në gatishmërinë më të lartë informative, duke emituar çdo orë lajme dhe vazhdimisht

këngë patriotike, aq sa është lavdëruar nga shumë medie të njohura brenda dhe jashtë Maqedonisë, përfshirë edhe *Zërin e Amerikës*.

Televizioni “Festa”

Televizioni “Festa” u hap më 21 mars 1996 në rrugën Kiro An-tevski nr. 15, ndërsa themelues është po ashtu gazetari Nexhat Aqifi. Sipas tij, edhe kjo medie është hapur me ceremoni fetare, me duanë që ia ka bërë hoxha i ndjerë Jakup Asipi. Krahas emisioneve informative e argëtuese, ky televizion ka pasur edhe emisione të shumta fetare. Që nga fillimi i punës së këtij televizioni, aty janë mbajtur emisione të ndryshme fetare, me theks të veçantë gjatë muajit të Ramazanit. Aty janë ftuar hoxhallarë eminentë, të cilët i kanë prezantuar temat e tyre. Emisionet fetare janë mbajtur ose me udhëheqës në emision ose vetë ligjëruesi e ka prezantuar temën e tij.

Disa herë televizioni ka transmetuar drejtpërdrejt ligjëratat e xhumasë të hoxhës Iljasa Mahmudi afër xhamisë së afërt në Lagjen e Trimave në Kumanovë. Po ashtu ka pasur trasmetime direkte edhe të faljes së bajrameve. Transmetime të drejtpërdrejta ka pasur edhe nga xhamia e haxhi Shefketit – Duli, prej nga herë pas herë edhe janë incizuar ligjëratat, të cilat më pas janë transmetuar të xhumave mbrema. Më së shumti ligjërata ka pasur nga hoxhallarët Shaban Neziri dhe Imer Mustafa. Televizioni ka mbajtur shumë emisione në bashkëpunim me Myftininë e Kumanovës, Forumin Rinor Islam, por edhe me individë të ndryshëm veç e veç. Me një fjalë, kushdo nga hoxhallarët që ka shfaqur interesim për të treguar ndonjë ders mirë të përgatitur, TV “Festa” gjithnjë i ka pasur dyert e hapura. Me vetinciativën e pronarit dhe kryeredaktorit Nexhat

Aqifi, aty janë përgatitur dhjetëra dokumentarë për xhami të ndryshme nëpër diasporë.

Gjithashtu nën patronazhin e Myftinisë së Kumanovës, që nga viti 2014 vazhdon edhe sot e kësaj dite të emetohet emisioni i rregullt javor “Nën hijen e Kuranit”. Këtë emision e udhëheq ligjëruesi në Fakultetin e Shkencave Islame, profesori i asocuar dr. Naser Ramadani. Në këtë emision, krahas dr. Naser Ramadanit, kanë marrë pjesë dhe vazhdojnë edhe më tutje hoxhallarë të ndryshëm, si: Eljasa Mahmudi, Abdulfeta Shahini, Ragmi Destani, Ibrahim Sulejmani, Shaban Neziri, Lutfi Nexhipi, Azir Avdiu, Berat Ramadani etj. Emisioni në fjalë ndërthen tema të ndryshme të fushës fetare dhe shkencore. Në të përfshihen kryesisht komentime të ajeteve kuranore dhe haditheve pejgamberike, por përfshihen edhe tema të datave historike dhe herë–herë edhe tema me karakter kombëtar. Në kuadër të këtij emisioni përfshihen edhe tema debatuese, e në veçanti gjatë muajit të Ramazanit, ku ftohen hoxhallarë eminentë dhe mjekë, psikologë e sociologë, për të debatuar rreth rolit dhe ndikimit të Ramazanit në ngritjen e vetëdijes dhe mobilizimit shpirtëror dhe material të muslimanëve, si dhe ngritjes së nivelit të humanizimit gjatë këtij muaji të bekuar. Emisioni në fjalë është ndër emisionet më të rregullta dhe me ndikim më të madh, si për nga përmbajtja e temave që shtjellohen, ashtu edhe nga jetëgjatësia, ngase ka filluar para ca viteve dhe vazhdon edhe sot e kësaj dite. Shumica e këtyre temave sot mund të gjenden në internet (youtube). Ky emision ka për qëllim ngritjen e vetëdijes fetare në mesin e muslimanëve, duke filluar nga çështja e besimit, që nënkupton kthimin në besim të vërtetë të bazuar në Kuran dhe Sunet dhe largimi nga besëtytnitë e ndryshme. Pas besimit, emisioni në fjalë ka për qëllim nxitjen e besimtarëve për kryerjen e detyrimeve fetare,

siç janë falja e namazit, dhënia e zekatit, agjërimi i Ramazanit dhe kryerja e haxhit. Përveç kësaj, emisioni në fjalë është shumë i përqendruar edhe në ngritjen e vetëdijes morale. Aty trajtohen tema me karakter edukativ, me qëllim që Islami të reflektohet edhe në përditshmërinë e muslimanëve, duke përfshirë jetën në familje, rrugë, punë, shkollë, xhami dhe gjetiu. Thënë thjesht e troç, objektiv kryesor i këtij emisioni është përgatitja e qytetarit të vyeshtëm, të arsimuar, të edukuar, punëtor dhe me karakter të ushqyer me mësimet islame e kombëtare.

Në bazë të pyetjeve nga shikuesit, por edhe në bazë të klikimeve në internet, sikurse theksoi pronari Nexhat Aqifi, “shikueshmëria e emisioneve fetare ka qenë shumëfish më e madhe se e të gjitha emisioneve të tjera, përfshirë ato politike, argëtuese, spektakle dhe transmetimeve sportive”. Ky është një indikator për interesimin e madh të dëgjuesve e shikuesve dhe, në përgjithësi, të gjithë qytetarëve për të dëgjuar e shikuar emisione me përmbajtje fetare. Njashtu kjo tregon etjen e tyre për të ditur më shumë për fenë, për ta kuptuar e për ta jetuar atë sa më mirë. Po ashtu vlen të theksohet edhe kontributi i madh i TV “*Festës*” gjatë luftës së Kosovës, sensibilizimit të popullatës për gjendjen e krijuar me refugjatët dhe furnizimin e tyre emergjent në Bllacë. Një rol të madh në këtë drejtim luajti edhe hoxha i nderuar Enver Zeqiri, i cili iu drejtua qytetarëve shqiptarë me një apel e mesazh me përmbajtje e karakter fetar e patriotik për të kontribuar në ndihmë vëllezërve nga Kosova, të dëbuar më 1998–1999 gjatë luftës nga regjimi serb. Kontribut në planin informativ e humanitar TV “*Festa*” ka dhënë edhe gjatë luftës së 2001 në Maqedoni dhe konfliktit të armatosur në Lagjen e Trimave në Kumanovë më 9–10 maj 2015, me ç’rast pamjet e TV

“Festa” janë marrë nga mediet më prestigjoze rajonale e ndërkombëtare.

Përmbyllje

Kontributi i medieeve të Kumanovës në përçimin e ligjëratave islame ka qenë jashtëzakonisht i madh. Pa mëdyshje kjo është reflektuar edhe në ngritjen e vetëdijes fetare te popullata, në veçanti të rinia. Dhe, madje, jo vetëm në Kumanovë me rrethinë. Depërtimi i valëve të tyre edhe në pothuajse gjysmën e territorit të Kosovës e në Preshevë e Bujanoc, ndikoi në ngritjen e vetëdijes fetare edhe në këto pjesë. Një pjesë bukur e madhe e pyetjeve adresoheshin pikërisht nga këto troje shqiptare, e në veçanti kur emisionet ishin kontaktuese, pra me karakter fetar. Është fakt se është punuar shumë, në veçanti në përgatitjen e emisioneve fetare. Me zell, elan, vullnet, energji, kreativitet, e mbi të gjitha me pasionin fisebililah është punuar pa kurrfarë interesi tjetër, përpos arritjes e të qenit razi me kënaqësinë e Allahut të Lartmadhëruar.

Deri më tani kjo temë nuk është trajtuar fare, ndërsa ky punim modest shpresoj të shërbejë si motiv për një punë edhe më të thelluar në këtë drejtim.

SADIK MEHMETI

Instituti Albanologjik – Prishtinë

SHKOLLA NORMALE – DÂRULMUALLIMÎN E SHKUPIT (1882–1912) DHE ROLI I SAJ NË ARSIMIMIN KOMBËTAR SHQIPTAR

Hyrje

Dekreti perandorak i Gjylhanesë (1839) paralajmëroi një etapë të re reformash në Perandorinë Osmane dhe fillimin e një ere, që më të drejtë do ta merrte emrin e periudhës së Tanzimatit. Këto reforma në administratën qendrore, administratën lokale, në sistemin juridik, të financave, në sistemin arsimor etj., do të zbatoheshin në mënyrë progresive dhe do ta jepnin efektin e tyre vetëm pas Luftës së Krimesë (1853–1856), në mënyrë të veçantë në krahinat periferike ballkanike⁵⁸. Për sa i përket arsimit, këto reforma do të shënonin rezultate mjaft pozitive, ndonëse jo sa ishte pritur dhe sa që shpresuar⁵⁹.

Kështu, me qëllim të përgatitjes dhe plotësimit të nevojave të qeverisë me shërbyes të aftë për t'u punësuar në postet administrative, në atë kohë, rëndësi iu kushtua, përveç tjerash, edhe zhvillimit dhe modernizimit të institucioneve arsimore. Hapja e shkollave laike shënonte një hap të madh në sistemin arsimor osman dhe – së bashku me shpalljen e të drejtave të barabarta të myslimanëve me

⁵⁸ Nathalie Clayer, *Në fillimet e nacionalizmit shqiptar (lindja e një kombi me shumicë myslimane në Evropë)*, botime “Përpjekja”, përktheu: Artan Puto, Tiranë, 2012, f. 143.

⁵⁹ Dr. Hasan Kaleshi-Dr. Hans Jürgen, *Vilajeti i Prizrenit*, në revistën: “Përparimi”, nr. 3, Prishtinë 1967, f. 295.

jomyslimanët në kuadër të Perandorisë – mund të konsiderohen si masa liberalizimi në Perandorinë Osmane⁶⁰.

Kështu, pas reformimit të shkollave fillore klasike (*mekâtib-i sibjân*), në shkolla fillore moderne (*mekâtib-i ibtidaije*), hapjes së shkollave të mesme të ulëta (*mekâtib-i rüşdiye*) dhe hapjes së gjimnazëve (*idâdiye*)⁶¹, u hapën edhe shkollat normale (*dâru'lmuallimîn*)⁶², të cilat kishin për synim përgatitjen e mësuesve për shkollat fillore dhe për shkollat e mesme të ulëta.

Për këtë arsye, më 16 mars 1848 në Stamboll u hap një shkollë normale – *dâru'lmuallimîn*, që ishte institucioni i parë arsimor në Perandorinë Osmane që përgatiste mësuesit dhe i pari jashtë sistemit të medreseve⁶³.

Drejtori i parë i asaj shkolle dhe personi që përgatiti rregulloren e shkollave normale ishte burrështetasi dhe intelektuali i njohur, *Ahmed Xhevdet Pasha* (1822–1895), i cili, duke qenë vetë i diplomuar në medrese, afroi krah për krah *dâru'lmuallimîn* me medresenë, të renë me të vjetrën⁶⁴.

⁶⁰ Noel Malcolm, *Kosova-një histori e shkurtër*, Prishtinë-Tiranë, “Koha”, 2001, f. 187.

⁶¹ Ekmeleddin Ihsanoğlu, *Institucionet studimore-shkencore dhe arsimore osmane*, në: *Historia e shtetit, shoqërisë dhe qytetërimit osman*, vëll. II, AIITC, Tiranë, 2009, f. 450.

⁶² *Dâru'lmuallimîn* (tur. “*Dâru'lmuallimîn*”, ar. “*Dâru 'l-mu'al-limîn*”, nga kompozita e gj. arabe “*dâr*” - “*shtëpi*” dhe “*mu'al-limîn*” - “*mësues*”, d.m.th. “*shtëpi e mësuesve*”, pra shkollë normale.

⁶³ Ekmeleddin Ihsanoğlu, *Institucionet studimore-shkencore dhe arsimore osmane...*, po aty, f. 453.

⁶⁴ Yahya Akyüz, *Türkiye’de Öğretmen Yetiştirilmenin 160. Yılında Darülmüallimîn’in Yıllarına Toplu ve Yeni Bir Bakış*, *dergiler.ankara.edu.tr/dergiler/19/1335/15452.pdf*; Ekmeleddin Ihsanoğlu, *Institucionet...*, vep. cit., f. 454.

Hapjen e shkollës për përgatitjen e mësuesve për mejtepe e kushtëzoi dhe e përshpejtoi edhe fakti se arsimimi fetar, që merrnin nxënësit në mejtepe, nuk ishte i njaftueshëm, sidomos për nxënësit që nuk vazhdonin mësimin në shkollat rushdije, e që po u kushtoheshin zanateve dhe profesioneve të tjera. Nevojat e kohës kërkonin të bëheshin ndryshime në programet e mejtepeve dhe në to, krahas mësimave për fenë dhe për detyrimet e myslimanit, të futeshin edhe lëndë që ishin të nevojshme për jetën⁶⁵. E ajo mund të bëhej vetëm me përgatitjen e mësuesve të aftë dhe të përgatitur, që do të mbanin mësimet në mejtepet e reformuara.

Ashtu si në rastin e institucioneve të tjera arsimore, hapja e shkollave normale pati një rritje gjatë kohës së qeverisjes së sulltan Abdylhametit II (qeverisi ndërmjet viteve 1876–1909) dhe nuk kishte një shkollë vetëm për Stambollin, por shumë prej tyre u hapën në qendra të shumta të sanxhaqeve të tjera. E para *dârulmuallimîn*, që u hap në sanxhaqe ishte ajo e Prishtinës, që nisi punën në vitin 1880⁶⁶.

Numri i shkollave fillore klasike dhe, më pastaj, hapja e shkollave fillore të reformuara (iptidâije) në Vilajetin e Kosovës kërkonte edhe mësues të përgatitur dhe të kualifikuar. Kështu Qeverisa Osmane, sikurse u tha më sipër, në vitin 1880 hapi një *dârulmuallimîn* në Prishtinë, ndërsa dy vjet më vonë e hapi edhe në Shkup (1882). Pastaj dy dekada më vonë (1900/1) një shkollë e tillë u hap edhe në Prizren.

⁶⁵ Dr. Hajrudin Ćurić, *Muslimansko školstvo u Bosni i Hercegovini do 1918*. Godine, Sarajevo, 1983, f. 158.

⁶⁶ *Başbakanlık Osmanlı Arşivi*, 79. 75. MF. MKT; Necati Demir, *Education in Kosovo...*, vep. cit., f. 11.

Ç'është e vërteta, shkolla të tilla për përgatitjen e mësuesve u hapën edhe në qytete të tjera shqiptare, si në *Manastir, Shkodër, Janinë, Dibër* etj., e që patën një veprimtari të bujshme, dhe mësimet në to i vijuan një numër i madh i nxënësve shqiptarë.

Nuk është vërtetuar që në trojet shqiptare të ishte hapur ndonjë shkollë normale për përgatitjen e mësuesve (*dârulmuallimât*). Gjithashtu shkollat normale në Prishtinë dhe në Prizren nuk kanë pasur drejtimin për përgatitjen e mësuesve për shkollat rushdije. Një drejtim të tillë në Vilajetin e Kosovës pati vetëm *Dârulmuallimîn* e Shkupit, e cila sikurse simotrat e saj në Prishtinë dhe Prizren, luajti një rol të rëndësishëm në arsimimin dhe edukimin e shqiptarëve dhe në përgatitjen e mësuesve kryesisht nga Kosova dhe pjesërisht nga Maqedonia.⁶⁷



Objekti i Shkollës Normale në Shkup (foto, 1928)

⁶⁷ Dr. Jašar Redžepagić, “Školstvo i prosveta na Kosovu od kraja XVIII stoleća do 1918 godine, Priština, 1974, f. 38.

Programi në Dârulmuallimîn të Shkupit

Në kohën kur në Shkup u hap Shkolla Normale/Dârulmuallimîn, ky qytet i takonte Vilajetit të Kosovës, kurse pas vitit 1888 u bë kryeqendër e këtij vilajeti (më përpara ishte Prishtina).

Dârulmuallimîn e Shkupit, sikurse u tha, u themelua në vitin 1882 dhe filloi të arsimonte e të përgatiste mësimdhënës për nevojat e shkollave iptidajje dhe rushdije⁶⁸. Kjo shkollë kishte një program të avancuar dhe gjithëpërfshirës. Në të mësoheshin lëndët fetare dhe ato botërore. Aty mësoheshin edhe filozofia e logjika, sigurisht krahas lëndëve të tjera, si: historia, metodologjia e mësimdhënies, gjeografia, njohuri natyre, matematika, turqishtja, arabishtja, frëngjishtja, persishtja, gjimnastika, punëdore, vizatim, këngë dhe gjeometria⁶⁹.

Këtë më së miri e dëshmojnë shehâdetnâmetë/diplomat që u ishin lëshuar studentëve që e kishin mbaruar këtë shkollë, e që nuk janë të pakta. Për këtë vështrim tonin kemi marrë në shqyrtim tri shehâdetnâme të tre studentëve nga Kosova, që e kishin kryer Shkollën Normale të Shkupit dhe të cilët më vonë do të bëheshin personalitete të shquara të dijes, arsimit e edukimit kombëtarë, jo vetëm në Kosovë por edhe më gjerë: *Selim ef. Drejtës* nga Vusht-rria (1883–1951), *Sherif ef. Dautit* nga Vranoci i Pejës (1885–1932)⁷⁰ dhe *Ibrahim Kolçit* nga Gjakova (1888–1960)⁷¹. Diplomat


⁶⁸ *Başbakanlık Osmanlı Arşivi*, 79. 75. MF. MKT; Necati Demir, *Education in Kosovo...*, vep. cit., f. 11.

⁶⁹ Dr. Jašar Redžepagić, *Školstvo i prosveta na Kosovu...*, vep. cit., f. 38.

⁷⁰ Arkivi i Kosovës Prishtinë, *Fondi i Muharrem Krasniqit*, kutia nr. 1, dokumenti: diploma e Sherif ef. Dautit; Arkivi i Kosovës, *Fondi i Ibrahim Kolçit*, dok. diploma e Dârulmuallimîn të Shkupit.

e tyre na japin të dhëna të rëndësishme për lëndët, pedagogët dhe suksesin e këtyre studentëve gjatë kohës sa ishin në Dâru muallimîn të Shkupit. Nga këto diploma, të cilat u takojnë viteve 1904, 1906, 1910, mësojmë se në atë shkollë janë mësuar një numër i konsiderueshëm i lëndëve dhe se aty ka pasur një program të përgjithshëm që me kohë ka pësuar edhe ndryshime e janë shtuar lëndë të reja, si: Kurani fisnik me Texhvid, Shkenca fetare, Gjuhë perse, Gjuhë arabe, Matematikë, Gjeografi, Histori, Gjuhë turke/osmane, Ortografi, Metodologji e mësimdhënies, Bukurshkrim, Ruajtje e shëndetit, Gjeometri, Njohuri natyre, Punëdore, Vizatim dhe Muzikë.

Vërehet fakti se në këtë shkollë, në gjithë veprimtarinë e saj prej dy dekadash, vetëm dy lëndë janë fetare: Kurani fisnik me texhvid dhe Shkencat fetare si lëndë e veçantë, kurse të tjerat kanë qenë me karakter laik, që e kanë bërë këtë shkollë moderne dhe me karakter të përgjithshëm.



Diploma e Sherif Dautit, viti 1906

⁷¹ Arkivi i Kosovës, Fondi: Ibrahim Kolçi, kutia. Nr. 1; Abdullah Vokrri, *Mësues në Kosovë e në Shqipëri (personalitete të shquara të arsimit tonë kombëtar)*, Prishtinë, 2008, f. 125-136.

Çerdhe e përhapjes së shkrimit dhe gjuhës shqipe

Mirëpo, pavarësisht Rregullores për Arsimin e Përgjithshëm osman të viti 1869, ku theksohej se në shkollat shtetërore osmane mësimi mund të zhvillohej edhe në gjuhën vendëse, një e drejtë kjo që u ishte dhënë të tjerëve, shteti osman megjithatë vazhdoi ta mohonte të drejtën e shqiptarëve për të hapur shkolla. Kjo e drejtë shqiptarëve nuk do t'u njihet zyrtarisht pothuajse deri në fund të sundimit osman në këto vise. Në kushte të tilla dhe në pamundësi që të kishin shkollat e tyre kombëtare, mësimi i shqipes nga mësues patriotë e me nxënës të besuar u përhap fshehurazi, tinëz dhe në mënyrë individuale.

Kështu, duke qenë në atë kohë Shkupi kryeqendër e Vilajetit, patriotët shqiptarë bënë përpjekje të mëdha për futjen e gjuhës shqipe në shkollat turke jo vetëm në këtë qytet, por gjithandej vilajetit dhe jo vetëm si lëndë, por edhe si gjuhë mësimi. Gjimmazi i lartë (Idâdija) dhe Dârulmuallimîni të Shkupit luajtën rolin e vatrave të përhapjes së shkrimit dhe gjuhës shqipe. Një luftë e tillë u zhvillua edhe brenda vetë Dârulmuallimînit midis pedagogëve që ishin konservatorë e proqeveritarë dhe kundër gjuhës shqipe (siç ishte drejtori i kësaj shkolle Ejup Sabri Xhemili⁷²) dhe pedagogëve atdhetarë, si *Salih Gjuka*⁷³, *Bedri Pejani* i mirënjohur etj.⁷⁴

⁷² *Sabri Xhemili* me origjinë nga Prishtina e kishte mbaruar fakultetin në Stamboll. Kishte qenë pedagog dhe drejtor në shkollën normale Dârulmuallimîn në Shkup, drejtor dhe mualim i gjuhës turke në Idadinë e Shkupit, poet dhe autor i disa shkrimeve në gazetën “Yeni mekteb”, nga fusha e pedagogjisë, që botohej në vitet 1910-1912 në Shkup, si dhe përkthyes i doracakëve nga gjuha frënge etj. Ka shkruar bukur shumë mbi problemet e shkollave fillore dhe mbi mënyrat e mësimi të suksesshëm. Ka botuar një varg studimesh nga pedagogjia në vitet 1910-1912. Ishte kundër aplikimit të gjuhës shqipe në shkollë. Jašar Redžepagić, *Školstvo i prosveta na Kosovu...*, po aty, f. 38-39.

⁷³ *Salih Gjuka Dukagjini* (1876-1925) Veprimtar i lëvizjes patriotike shqiptare, publicist, pedagog, “Mësues i popullit”. Lindi në Pejë. Pasi e mbaroi shkollën fillore (iptidainë) në Pejë, shkoi në Shkup për të mësuar në idâdije. Pas mbarimit të idâdijes, shkoi në Selanik, për të studiuar në shkollën e lartë juridike. U specializua për njëfarë

Këta pedagogë atdhetarë dhe, nën ndikimin e, tyre edhe studentët e Shkollës së Lartë Pedagogjike të Shkupit dhe shkollave të tjera në këtë qytet, kanë zhvilluar polemika të shumta për futjen e gjuhës shqipe si lëndë në këto shkolla. Studentët dhe pedagogët e tyre atdhetarë kërkonin që të mësonin në gjuhën shqipe dhe për këtë qëllim ata do t'i shkruanin telegrame edhe në Ministrisë së Arsimit në Stamboll, duke e theksuar nevojën e mësimin të kësaj gjuhe si lëndë e veçantë mësimore. Në fund të telegrameve nënshkrueshin, në të shumtën, studentët nga Kosova.⁷⁵ Kur një gjë e tillë ishte lejuar nga Stambolli, drejtori i shkollës, Sabri Xhemili, nuk donte të realizonte një vendim të tillë, duke e arsyetuar këtë me mungesën e lokaleve dhe me vështirësi të tjera.⁷⁶ Por, më në fund fitoi krahu i pedagogëve atdhetarë dhe në vitin 1910 për mësimdhënës të gjuhës shqipe u emërua Sali Gjuka–Dukagjini, i cili nuk do të qëndrojë shumë gjatë dhe do të zëvendësohet nga një mësimdhënës tjetër nga Maqedonia, që shumë pak e njihnte gjuhën shqipe.⁷⁷ Megjithëkëtë, kërkesat e

kohe edhe në Stamboll dhe në Paris. Më 1908 kthehet në Pejë, ku pas një viti hap një shkollë fillore me mësim në gjuhën shqipe. Meqë puna e tij u sabotua nga disa shqiptarë fanatikë proqeveritarë osmanë, të vjetër dhe nga qarqet serbe, u largua nga Peja dhe shkoi në Shkup, ku iu bashkua klubit “Bashkimi”, të cilin e drejtonin Nexhib Draga, Hasan Prishtina, Bajram Curri, Bedri Pejani, Jashar Erbara etj. Më 1909 u vendos drejtor i qarkut të Neveskës, në Vilajetin e Manastirit. Ishte një ndër organizatorët kryesorë të Kongresit II të Manastirit (1 prill 1910). Punoi edhe si mësues i gjuhës shqipe në Darul-muallimin në Shkup, ku pati ndikim të drejtpërdrejtë mbi rininë shkollore, ku shumica vinin nga qytetet e Kosovës, që pastaj do të bëheshin mësues të ardhshëm. Nga presioni i xhonturqe u largua nga Shkupi dhe shkoi në Manastir, e më pastaj edhe në Selanik, ku punoi si nëpunës i gjykatores. Mori pjesë pothuajse në të gjitha kongreset arsimore. Ishte drejtues dhe mësimdhënës në shumë shkolla në Kosovë dhe Shqipëri. Është i njohur edhe si publicist. Botoi shumë artikuj në më se 60 organe të ndryshme. Është poet dhe autor i gramatikës së gjuhës shqipe me alfabet arabo-osman “*Shkrolaria e shqypes*”, të cilën e botoi në Manastir më 1910. Shih: Salih Gjuka–Dukagjini, *Shkrolaria e Shqypes, pjesa e parë: teorike dhe praktike*, u botua nën kujdesin e Muhamet Pirakut, Prishtinë, 1991.

⁷⁴ Më gjerësisht, shih: Salih Gjuka–Dukagjini, *Shkrolaria e Shqypes...*, po aty.

⁷⁵ Dr. Jašar Redžepagić, *Školstvo i prosveta na Kosovu...*, po aty, f. 39-40.


⁷⁶ Po aty, f. 39-40.

⁷⁷ Po aty.

studentëve dhe të pedagogëve për futjen e gjuhës shqipe si lëndë nuk pushuan, por rezistenca ishte e madhe. Prandaj edhe këto kërkesa nuk dhanë shumë rezultate. Gjuha shqipe nuk arriti të futej zyrtarisht si lëndë e veçantë, por ajo vazhdonte të përdorej si gjuhë mësimi dhe jozyrtarisht.

Dârulmuallimîn e Shkupit e botonte edhe revistën pedagogjike *“Yeni mektep”* (“Shkolla e re”), që doli midis viteve 1910–1912. Këtë revistë e udhëhiqnin Sabri Xhemili (i sipërpërmendur) dhe Mehmet Shekibi, mësimdhënës në këtë shkollë, por në të kanë botuar shkrime autoriale dhe përkthime sidomos nga fusha e pedagogjisë edhe shumë autorët të tjerë–mësimdhënës në shkollat idadîje dhe në normalet e kohës. Kjo revistë, përveç shkrimeve nga fusha e pedagogjisë, ka edhe shumë këshilla për mësimdhënësit dhe për nxënësit, si dhe informata interesante. Revista është përcjellë me mjaft interesim nga pedagogët dhe studentët e Shkollës së Lartë Pedagogjike të Shkupit dhe jo vetëm. Deri më sot kjo revistë, ndonëse paraqet një material interesant pedagogjik dhe informativ, nuk ka qenë pjesë e ndonjë analize a studimi shkencor. Duhet theksuar se Shkolla e Lartë Pedagogjike e Shkupit ka zhvilluar polemika teorike lidhur me problemet e ndryshme pedagogjike me Shkollën e Lartë Pedagogjike të Stambollit⁷⁸. Darulmuallimin e Shkupit e kishte edhe vulën e vet, si dhe konviktin për vendosjen e studentëve. Aty zhvillohej edhe mësimi i pasdites, që kontrollohej nga profesorët, të cilët organizonin edhe orë të detyrueshme për mësim.

⁷⁸ Po aty.



Revista mujore “Yeni mektep”, organ i Shkollës Normale në Shkup

Nga kjo shkollë patën marrë diploma shumë djelmosha të këtyre viseve e të krahinave të tjera vartëse të këtyre qendrave. Këta qenë mësuesit e parë vendës, të cilët pas largimit të Perandorisë Osmane dhanë ndihmesën e tyre të pazëvendësueshme në atë kohë kur kishte mungesë të theksuar kuadrosh arsimore. Në këto shkolla u përgatitën mësues të shquar shqiptarë, të cilët më vonë punuan në Kosovë dhe në Shqipëri. Midis tyre kishte edhe të atillë që u ndërruan me titullin “*Mësues i popullit*”, si *Ahmet Gashi*⁷⁹, *Niman Ferizi*⁸⁰, *Sadi Pejani*, *Sadi Morina* etj.

⁷⁹ *Ahmet Gashi (1888-1977)* i takon plejadës së fundit të Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Ai ishte dhe mbeti shpirt i pashuar i shkollës dhe i arsimit tonë kombëtar. Ishte pjesëmarrës në Kuvendin e Vlorës, ku efirmosi aktin e shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. U lind në Prishtinë. Shkollën fillore dhe rushdijen i kreu në Prishtinë me sukses të shkëlqyeshëm. Idëdijen e mbaroi në Shkup dhe më pastaj edhe Dëruallimimin po në Shkup. Studimet i vazhdoi në Shkollën e Lartë të Stambollit.

Aty u arsimuan edhe *Isuf Puka, Avni Zajini, Jonuz Blakçori, Minush Shala, Ferid Imami, Ferid Bajrami*⁸¹, *baba Qazim Bakalli*⁸², *Ibrahim Fehmiu* etj.⁸³

Në Normalen e Shkupit, përveç pedagogëve që u përmendën më sipër, kanë mbajtur mësim në gjuhën shqipe edhe: *Sali Gjuka–Dukagjini, Niman Ferizi, Ahmet Gashi, Bedri Pejani* etj.⁸⁴

Pas përfundimit të studimeve në Stamboll, më 1909 kthehet në vendlindje, në Prishtinë, dhe emërohet profesor në shkollën idadije të Prishtinës, për lëndët Histori dhe Gjeografi. Hapi i parë që bëri në këtë institucion edukativo arsimor ishte futja e gjuhës shqipe si gjuhë e dytë. Hapi i dytë që organizimi i kurseve për shkrim-leximin e gjuhës shqipe. Ishte bashkëpunëtor dhe përkrahës i patriotit të shquar Nazmi Gafurrit. Më gjerësisht: Abdullah Vokri, *Mësues në Kosovë...*, po aty, f. 27-40. Gani Demir Ratkoceri, *Prof. Ahmet Gashi, Rilindësi i fundit*, Tiranë, 2005, f. 12-14.

⁸⁰ *Niman Ferizi (1883-1936)*. Lindi në Gjakovë. Aty kreu shkollën fillore, kurse studimet e mesme në idadijen e Shkupit. Kreu edhe Dârlmuallimîn po në Shkup. Figurë e shquar e arsimit tonë kombëtar. Mori pjesë aktive në jetën shoqërore, politike, arsimore dhe kulturore të kohës. Në fushën e arsimit kombëtar dha një ndihmesë të vyer, duke hapur shkollat e para shqipe në fshatrat e ish-prefekturës së Kosovës (Tropojë, Krumë, Kukës), si në Bujan, Kolgecaj, Bicaj, Kalimash e Krumë. Ishte bashkëluftëtar i Bajram Currit dhe sekretar personal i tij. Shih: *Fjalori enciklopedik shqiptar*, vëll. I, Tiranë 2008, f. 659-660; Abdullah Vokri, *Mësues në Kosovë e në Shqipëri...*, po aty, f. 150-166.

⁸¹ *Ferid Bajrami (1880-1965)*. Personalitet i shquar në fushën e arsimit dhe mjaft meritor për arsimin shqip në vilajetin e Kosovës. Kishte kryer idadijen e pastaj edhe Dârlmuallimîn në Shkup. Gjatë viteve 1900-1905 ka shërbyer si mësues në Shkup dhe Veles, kurse pas vitit 1905 ka punuar si inspektor i arsimit në Shkup. Shih: Dr. Nexhat Abazi, *Zhvillimi i arsimit, i shkollave dhe i mendimit pedagogjik shqiptar në Maqedoni (1830-1912)*, Tetovë, 1997, f. 162.

⁸² *Baba Qazim Bakalli (1895-1981)* lindi në Gjakovë. Pas kryerjes së shkollës fillore në vendlindje, më 1909 u regjistrua në Dârlmuallimîn e Shkupit, të cilën e mbaroi më 1912. Pastaj i vijoi mësimet edhe në Normalen e Beratit. Punoi si mësues në shumë vende, si në Gjakovë, Shijak, Qaf Zogajt, Krumë etj.. Shërbeu edhe si sheh në teqenë e Bektashinjve në Tetovë. Është marrë edhe me shkrime. Ka lënë disa poezi, ilahi dhe vështrime historike e fetare. Më gjerësisht: Dr. Abdullah Vokri, *Mësues në Kosovë e në Shqipëri...*, po aty, f. 43-48

⁸³ As. prof. Dr. Murat Gecaj, *Ndihmesa e mësuesve veteranë kosovarë për edukimin e nxënësve në konvikte*, në: "Revista Pedagogjike", nr. 1, Tiranë, 1999; f. 123-133. Hajrullah Koliqi, *Historia e arsimit...*, vep. cit., f. 143.

⁸⁴ Hajrullah Koliqi, *Historia e arsimit dhe e mendimit pedagogjik shqiptar*, Prishtinë, 2002, f. 143.

Përfundim

Shkolla Normale (*Dârulmuallimîn*) e Shkupit u hap në vitin 1882. Hapja e kësaj shkolle dhe e simotrave të saj në Prishtinë, Prizren, Shkodër, Manastir etj. ishte një kërkesë e kohës për përgatitjen e mësuesve të kualifikuar për shkollat e reformuara fillore (iptidaije) dhe për ato të pareformuara (sibjane).

Shkollat *Dârulmuallimîn*, në trojet shqiptare, i shërbyen shumë mirë qëllimit të tyre, patën domethënien e tyre dhe, në sajë të atyre shkollave, pa mëdyshje, jeta arsimore arriti një shkallë njaft të lartë. Këtë e dëshmojnë lëndët që mësoheshin në ato shkolla, mësuesit që kanë dhënë mësimë dhe kuadrot që kanë dalë nga aty.

Gjatë veprimtarisë së saj *Dârulmuallimîn* e Shkupit ka nxjerrë disa dhjetëra kandidatë, shumë prej të cilëve kanë shërbyer si mësues nëpër mejtepe, qoftë deri në 1912, qoftë edhe në mes dy luftërave botërore, madje deri në vitet e '50-ta të shekullit të kaluar. Shumë prej tyre qenë emëruar edhe mësues në shkollat fillore kombëtare, disa kanë vazhduar studime profilesh të ndryshme dhe disa kanë punuar në administratë. *Dârulmuallimîn* e Shkupit, sikurse edhe të gjitha shkollat e tjera moderne osmane, pushoi me veprimtarinë e saj në vitin 1912, kur Perandoria Osmane u tërhoq nga këto vise.

Dhe, në fund fare, mund të konstatohet me plot gojën se *Dârulmuallimîn* e Shkupit dhe simotrat e saj në trojet shqiptare, në sajë të rolit dhe kontributit që dhanë me veprimtarinë e tyre për më shumë se tri dekada, duhet të gjejnë vend në historinë e arsimit dhe mendimit pedagogjik shqiptar.

PROF. DR. ABDULXHEMIL NESIMI

Fakulteti i Shkencave Islame – Shkup

KONTRIBUTI I ABDYLHAQIM DOGANIT PËR ZHVILLIMIN E GJUHËS SHQIPE DHE PËR ARSIMIN KOMBËTAR

Hyrije

Një kontribut të rëndësishëm për zhvillimin e gjuhës shqipe dhe arsimin kombëtar në kapërcyell të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX pa dyshim që ka luajtur edhe kleri mysliman shqiptar. Pavarësisht faktit se deri vonë, për arsye ideologjike ka pasur një tendence për t'i vënë në plan të kundërt komponentët “shkollë”, “gjuhë” dhe “identitet kombëtarë” me fjalën “kler”, “klerikë” ose, në rastin konkret, “hoxhallarë”,⁸⁵ e vërteta qëndron ndryshe. Një numër alfabetesh dhe abetaresh të gjuhës shqipe na rezultojnë të jenë hartuar pikërisht nga këta personalitete. Megjithatë ato nuk përbëjnë një numër të madh për nga sasia, përsëri në raport me peshën specifike dhe kohën kur u hartuan, dëshmojnë për shkallën e lartë të preokupimit dhe rëndësinë që klerikët myslimanë shqiptarë i jepnin zhvillimit dhe mësimi të gjuhës shqipe.

Që në fundin e viteve të ‘30-ta të shekullit të kaluar, në një artikull të revistës “Zani i Naltë”, pasi theksohej roli i klerit mysliman shqiptar në lëmenj të ndryshëm të çështjes kombëtare, kur vinte fjala për shkrimin e gjuhës shqipe, shkruhej se: “Ndofa mund të thotë dikush se këta kanë shkruar me alfabet arab! Ani, mjafton që

⁸⁵ *Historia e Shqipërisë*, vëll. II, Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë, 1984, f. 429-436.

kanë shkruar shqip; mjafton që këtij populli i kanë dhanë të kuptojë se edhe gjuha e tyre, shqipja, mund të shkruhet. Mbasandaj, çfaj kanë këta shkrimtar të moçëm që kanë shkruar në një kohë kur shqipja ska pasë alfabetin e saj, jo kanë asnjë faj këta shkrimtarë; ashtu sikurse kanë faj as ata që kanë shkruar me alfabetin grek e me ndonjë alfabet tjetër”.⁸⁶

Kontribut të rëndësishëm në këtë drejtim për zhvillimin e gjuhës shqipe dhe arsimin kombëtar në gjuhën shqipe në kapërcyell të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX ka dhënë edhe pedagogu ynë nga Gostivari, Abdylhaqim Hiqmet Dogani.

Fjalët çelës: *abetare, gjuhë, shqip, hoxhallarë, rilindës.*

1. Gostivari, vendlindja e Abdylhaqim Doganit

Gostivari është një qytet me pozitë të volitshme gjeografike, me mbi 500 m lartësi mbidetare, që shtrihen në mbi shtratin e lumit Vardar. Është i vendosur në perëndim të Maqedonisë dhe është i rrethuar nga dy male të larta, Sharri dhe Mali i Thatë. Aty jetojnë mbi 100 mijë shqiptarë në bashkëjetesë me turqit, maqedonasit, romët, bullgarët etj.

Rreth qytetit të Gostivarit dhe për Gostivarin janë thurë shumë legjenda me versione të ndryshme bazuar nga pushtuesit e periudhave të ndryshme. Sipas dokumentit të vetëm nga epoka antike, tek historiani Tit Livi (59 p.e.s – 17 p.e.s), thuhet se mbreti i fundit i Maqedonisë Pasai (179 – 163) me 10.000 ushtarë, pas pushtimit të Uskanës (Kërçovës), e pushton qytezën DrauDAK që më pas të pushtohet Oneji (Tetova). Nga këto të dhëna mund të kuptohet se qyteti i vjetër DrauDAK, i cili ka pasur rëndësi të madhe, është

⁸⁶Zani i Naltë, “Veteranët e Klerit Mysliman”, nr. 11, Nanduer 1937, f. 330.

gjendur ndërmjet Kërçovës dhe Tetovës, d.t.th. Gostivari i tanishëm.

Bazuar në shkrimet e Abdylhaqim Doganit, Gostivari e merr emrin nga vajza e ardhur nga Tivari që për vendbanim e ka zgjedhur këtë qytet. Në gjuhën lokale vajza është gocë edhe atë nga Tivari, prandaj del emri Gostivar, pra goca e Tivarit. Dogani hedh poshtë pikëpamjet joshkencore, sipas të cilave fjala Gostivar rrjedh nga fjala slave “*gosti*” dhe nga fjala turke “*var*”, e cila sipas kombinimit të tyre gosti-miq dhe var-ka nënkupton *vend ku ka mysafirë*.

Dogani shpjegonte se në afërsi të Gostivarit, në vendin e quajtur “Kara agaç”, ka pasur një manastir shqiptar, të cilin siç flasin gojëdhënat, e ka ndërtuar një gocë prej Tivari, nga mori emrin qyteti i ndërtuar më pas “Goc Tivar” dhe në bazë të evolucioneve fonetike qyteti e mori emrin Gostivar. Turqit osmanlinj përmenden si të ardhur në vitin 1382 afër Gostivarit në fshatin turçan (Bellovishtë) 4km në jugë lindje të Gostivarit. Atëkohë si vend më i përmendur njihet fshati Zdunjë, ndërsa më vonë Gostivari.⁸⁷

Vetë pozicioni e ka bërë qytetin shumë herë transit, jo vetëm për shqiptarët që kalonin në vise të tjera arbërore, por edhe mëtej, deri thellë në Perandorinë Osmane e para saj. Në gjysmën e parë të shek XVI Gostivari përmendet si qendër banimi qytetar e zhvilluar me degë zejtarie e sociale, një vend ekonomik, që gradualisht, duke e shfrytëzuar pozitën e favorshme gjeografike dhe kushtet natyrore të mira, hapet ndaj zhvillimit në fushën ekonomike-tregtare, sidomos në komunikimin me zonën e Tetovës, Shkupit, Ohrit, Korçës, Elbasanit.

⁸⁷Dogani, Abdylhaqim, “Gostivari”, në “Flaka e Vëllazërimit” Shkup: 25.8.1951

Duhet theksuar se në Gostivar ka funksionuar një shkollë në nivel të medresesë që nga fundi i shek. XVII, ndërsa në fshatin Vrapçishtë funksiononte një medrese e ulët që nga viti 1827. Vetë Abdylhaqim Dogani i është përkushtuar, mes tjerash, edhe hulumtimeve për vendlindjen e tij të dashur, Gostivarin, duke kryer studime me vlerë, të cilat janë burime për studiuesit e fushave të ndryshme të traditës shqiptare.

Shumë personalitete të larta në Perandorinë Osmane e kishin origjinën nga Gostivari. I tillë ka qenë edhe Karamahmuti Pasha, një ndër vezirët e mëdhenj, i cili e mori këtë detyrë në Bagdad dhe e stabilizoi ekonominë e tregut. Një pjesë të pasurisë së tij, Karamahmuti e vuri në dispozicion të ndërtimit të objekteve kulturore, të xhamive etj. I biri i tij, Ebu Beqir Beu, në vitin e 1676 ndërtoi “Xhamin e Sahatit”, ku ushqeheshin edhe të vobektët. Qyteti dhe rrethina pësonin ndryshime varësisht nga situatat nëpër të cilat kalonte vendi e më gjerë Perandoria Osmane, nën të cilën ishin viset shqiptare.⁸⁸

Në qytete dhe në disa fshatra, në fundin e shek. XIX, ishin hapur shkolla fillore “sibjan mejtepe”, siç quheshin atëherë. Në vitin 1859 në qytet ishte ndërtuar një xhami nga familja Bejlikçi Zade, nga trangu i së cilës ishin më në zë Ismail Aga, Sali Aga, Mustafa Efendi, për një opinion shoqëror në nderim të tyre, sidomos të Mustafa Efendiut, që njihej edhe si më i arsimuar. Njëri nga bijtë e kësaj familjeje, Sadik Beu, arriti të bëjë karrierë në administratën perandorake, duke arritur deri në detyrën e ministrit të Ndërtimit.

Gostivari ishte në lidhje e nën ndikimin e shumë qendrave arsimore e kulturore shqiptare brenda e jashtë vendit, duke e mposhtur fanatiz-

⁸⁸Kaso, Sheraf, *Monumentet Islame ne Muftininë e Gostivarit*, Gostivar, 2002.

min. Kështu, në përpjekje për t'i zbatuar porositë e rilindësve, veçanërisht të Sami Frashrit, lidhur me emancipimin e gruas, si rrugë kryesore për emancipimin e kombit, u hap edhe një shkollë femrash.

Duhet theksuar se disa bij të Gostivarit, si Abdylhaqim Dogani, Josif Bageri, por edhe Hasan dhe Mehmet Derralla, kishin kontakte direkte me rilindës të shquar, përfshirë edhe vëllezërit Frashëri, duke u ndikuar prej tyre duke e harmonizuar punën sipas orientimeve të Rilindjes sonë Kombëtare.

2. Lindja e tij

Abdylaqim Doganiu u lind në vitin 1880 në një familje me tradita të hershme fetare dhe patriotike. Për shumë vite me radhë babai i tij, Idriz efendi, kishte shërbyer si myfti i Gostivarit. Idriz Dogani, përveç formimit qytetar e fetar, ishte edhe njeri i arsimuar. Ai kishte një bibliotekë të mirë në shtëpi. Ai ishte edukator me njohuri të thella fetare, të cilat ndikuan që në shtëpi të krijohet një mjedis i favorshëm për zhvillim arsimor, shkencor e kulturor. Pra, niveli intelektual i kësaj familje la gjurmë edhe te fëmijët.

Vetë edukata e familjes, sidomos edukata e punës, u bë një mjet efikas për rritjen dhe formimin e personalitetit të fëmijës e adolescentit Abdylhaqim Dogani. Në një mjedis të tillë familjar e shoqëror lindi dhe u edukua Abdylhaqim Dogani.

Studiuesi Hasan Kaleshi, orientalist dhe autor i disa veprave, e radhiste Abdylhaqim Doganin ndër personalitet shqiptare të shquara, që kontribuan edhe në dituritë islame. Ai, mes tjerash, shkruan: “Për sa i përket një numri të madh shkrimtarësh nga Maqedonia, ata i kam marrë vetëm nëse burimi përmendet si shqiptar ose kur është fjala për shek. XIX, nëse e di se në këtë apo atë mënyrë ka

qenë i angazhuar në lëvizjen shqiptare, si p.sh. Dervish Hima nga Ohri, Dr Ibrahim Temo nga Struga, Rexhep Voka nga Tetova, Ali Isuf Albani nga Kërçova etj.⁸⁹

Abdylhaqimi e kaloi “shkollën amnore” në mjedis shqiptarëve të shoqëruar me dashuri e respekt për gjuhën, doket dhe zakonet e popullit vëlla turk. Njohuritë e para i mori nga i ati, që pastaj ta dërgojnë në sibjan–mekteb.

Atëbotë në Gostivar dhe në fshatrat përreth kishte mjaftë shkolla të tilla, por hafizi që e zhvillonte mësimin në mejtepin ku mësonte Abdylhaqimi, ishte vetë i ati, i kompletuar në formimin teologjik e kulturor. Vërtet që nxënësit mësonin së bashku, pra jo të ndarë në klasa e pa ndonjë bazë didaktike e në gjuhën osmanë, por duke qenë hafizi shqiptar, ata komunikonin edhe në gjuhën e tyre shqipe, madje në vitet e para kryesisht shqip.

Ishte një specifik e Abdylhaqimit se “shkolla amnore” në shqip e vazhdoi në sibjan mejtep me të atin, pasi Idrizi i mësonte vetë fëmijët, pra mësues e kishte babain e vet. Kështu duke mësuar në shtëpi dhe në sibjan mejtep, ai përgatitet për të shkuar në mejtep të reformuar shtetëror, me karakter laik, ku vazhdoi 4 vjet. Atje mësoi lexim, shkrim, gramatikë, aritmetikë, histori të Perandorisë Osmane, gjeografi, edukatë morale dhe dituri natyrore. Këtu mësimi zhvillohej në bazë klase, viti shkollor realizohej me mësues laikë që përdornin mjete mësimore mbi parime të didaktikës bashkëkohore, ndërsa njohuritë e nxënësve i vlerësonin me nota etj. Mësuesi i çdo klase kishte mbaruar shkollën normale – “Dar-ul-mualimin”.⁹⁰

⁸⁹Kaleshi, Hasan, *Kontributi i shqiptarëve në dituritë Islame*, 1991, f.79-80.

⁹⁰“Personalitete të kulturës islame shqiptare,që kanë jetuar e kontribuar në fund të Shek. XIX - Gjysma e parë e shek. XX”, Materialet janë marrë nga botimi: “Instituti Shqiptar i Mendimit dhe Qytetërimit Islamik”, <http://muslimsonline.com>.

Shkollën fillore e kreu në Gostivar, r kurse të mesmen në Stamboll. Pas përfundimit të shkollimit të mesëm, u regjistrua në Fakultetin e Farmacisë në Stamboll, mirëpo, pas dy vjetësh, për shkaqe financiare, detyrohet të kthehet në vendlindje.

Edhe pse shkollimin e tij e kishte mbaruar në gjuhën turqishte, atëherë kur akoma në atë gjuhë përdorej alfabeti arab, ai nuk e la pas dore gjuhën e vet. Qysh kur ishte si nxënës dhe si student në Stamboll, në kushte shumë të vështira, e mësoi edhe gjuhën shqipe, këtë nga shokët e tij të shumtë që jetonin në Stamboll. Një ndër të njohurit e tij në Stambollit ka qenë edhe Sami Frashëri, veprat e të cilit i njihte fare mirë, si edhe vetë Samiun. Pas kthimit në vendlindje, e ndoqi rrugën e mësuesisë – emërohet mësues i parë në Gostivar.

Nga studimet që bëri në Stamboll, mori arsim laik. Megjithatë, gjatë gjithë kohës së punës së tij shërbeu si mësues, si në shkolla laike, ashtu edhe në ato fetare. Është ndër të rrallët që shkroi tekste me karakter fetar. Në vitin 1911 u punësua në Shkollën Normale (Darul-Mu`alimin) të Shkupit, ku shumicën e nxënësve e përbënin shqiptarët. Aty lënda e gjuhës shqipe iu ngarkua pikërisht Abulhaqim Doganit, kjo nga klubi shqiptar “Rinia Patriotike” (Shubani vatan). Për pak kohë ai u zgjodh edhe deputet në Parlamentin e Dytë Osman si përfaqësues i Gostivarit. Abdylhaqim Dogani që i vonuar dhe fillimisht nuk ishte për alfabetin e Manastirit, të miratuar nga përfaqësuesit e njëzet e gjashtë shoqërive e klubeve në nëntor të vitit 1908, por shpejt e kuptoi dhe reagoi drejt.

3. *Veprimtaria e Abdylhaqim Doganit*

Kontributi i Abdylhaqim Doganit kryesisht konsiston në fushën e tekstologjisë dhe ai mbetet i njohur si didakt. Ai mban autorësinë e të paktën 16 teksteve shkollore, të cilat janë të shkruara në gjuhën turke.

Pas çlirimit, në vitin 1945, e botoi edhe abetaren e parë shqipe, gjë që e ka kishte ëndërruar me kohë. Kjo abetare nga shpejtimi i botimeve nuk ishte pa të meta, por atë vit, për herë të parë në vendin tonë, nxënësit shqiptarë gjetën abetare në gjuhën shqipe, që u botua si libër në ish-Jugosllavi për vitin shkollor 1946–47.

Në vitin 1947 përmbushi kërkesën e Ministrisë së Kulturës e Shkencës në Maqedoni, duke e shkruar historinë e Gostivarit – të qytetit të vet, ku kish shërbyer 42 vjet si mësues dhe ku vdiq më 1955.

Kontributi i tij në arsim dhe në edukatën islame ishte i veçantë. Madje, Abdylhaqim Dogani ka shkruar proza të shumta për fëmijë, një pjesë e të cilave i ruajnë edhe sot vlerat e tyre arsimore dhe edukative. Ka botuar edhe artikuj studimorë, sidomos për historinë e Gostivarit e të viseve të tjera shqiptare.

Tekstet e tjera të tij janë shkruar në gjuhën turke, por kanë shërbyer për edukimin e nxënësve shqiptarë në shkollat që ndiqnin.⁹¹ Veprat e tij të njohura deri më sot, të paracaktuara për shkollat laike dhe fetare janë:

- “Saban Yildizi yahot Musavver Osmanli Elifbasi” (*Ylli i mëngjesit apo abetare e ilustruar e osmanishtes*).

⁹¹ “Personalitete të kulturës islame shqiptare që kanë jetuar e kontribuar në fund të Shek. XIX - Gjysma e parë e shek. XX”, “Instituti Shqiptar i Mendimit dhe Qytetimit Islamik”.

- “Yeni Elifba–Nesh harflariyla tabedlimis ueni imla ilifbasi” (*Abetarja e re – Abetarja portografike e botuar me shkronjat nes’li*).
- “Muslumanlik” (*Feja islame*).
- “Arnavutca elifba–Arap harflariyla” (*Abetare shqip me alfabet arab*).
- “Pedagogji kavaidine mutabik yeni sistem elifba” (*Sistemi i ri i abetares sipas parimeve pedagogjike*).
- “Kur’ani Kerim Derslaerine Baslangiç” (*Hyrje në mësimin e Kuranit të nderuar*).
- “Birinci Kisim Turkçe Dersleri Elifba” (*Pjesa e parë e mësimëve të turqishtes–Abetarja*).
- “Ikinci Kisim Turkçe Dersleri” (*Pjesa e dytë e mësimëve të turqishtes*).
- “Uçunçu Kisim Turkçe Dersleri” (*Pjesa e tretë e mësimëve të turqishtes*).
- “Doruncu Kisim Turkçe Dersleri” (*Pjesa e katërt e mësimëve të turqishtes*).
- “Birinci Kisim Din Dersleri” (*Pjesa e parë e mësimëve të fesë*).
- “Ikinci Kisim Din Dersleri” (*Pjesa e dytë e mësimëve të fesë*).
- “Uçuncu Kisim Din Dersleri” (*Pjesa e tretë e mësimëve të fesë*).
- “Dorduncu Kisim Din Dersleri” (*Pjesa e katërt e mësimëve të fesë*).
- “Birinci Kisim Dersleri” (*Pjesa e parë e mësimëve të historisë*).

- “Abetare”, në gjuhën shqipe shtypur nga Shtypshkronja “Kultura”, Shkup, 1946.

Nga veprat e mësipërme, të një rëndësie të veçantë janë veprat fetare, si: *“Feja Islame”*, *“Sistemi i ri i mësimin fetar sipas parimeve pedagogjike”*, si dhe *“Hytje në mësimin e Kur’anit Famëlartë”*.

Kontributi i tij në arsim dhe në edukatën islame ishte i veçantë. Abdulhaqim Dogani ka shkruar proza të shumta për fëmijë, një pjesë e të cilave ruajnë edhe sot vlerat e tyre arsimore dhe edukative, ndërsa ka botuar edhe artikuj studimorë, sidomos për historinë e Gostivarit e të viseve të tjera shqiptare.

Gostivari ishte objekt i rrezatimit të arsimit kombëtar sidomos pas Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, idetë e së cilës synonin një arsim e shkollë shqipe në një alfabet të njësuar, kjo si një rrugë për arritje në jetën e kombit. Por, në këtë kohë ishin të pranishme edhe shkollat serbe, të cilat u hapën në disa fshatra, siç ishin të pranishme edhe shkollat osmane, bullgare, greke. Në disa zona, ku flitej në shtëpi gjuha shqipe, si Reka e Epërme, këto përbënin edhe rreziqe për asimilimin, sidomos duke parë edhe disa përpjekje të shovinistëve në këtë fushë.

Si një qendër tranziti, por edhe si bijë të atyre viseve, atje u ndalën për veprimtari atdhetarë veprimtarë të shquar, si: Jashar Erebara, Rexhep Voka, Anastas Albanski, Josif Bageri, Sali Gjuka etj., disa prej të cilëve ishin edhe të njohur, madje edhe miq të Abdylhaqim Doganit. Po ashtu në Gostivar vinin gazeta e botime nga Shqipëria, nga Italia e përtej, duke u përgatitur një opinion shkencor objektiv.

Konkluzion

Nga hulumtimet e deritanishme është evidentuar se hoxhallarët dhe mendimtarët myslimanë shqiptarë në periudhën e Rilindjes Kombëtare pa dyshim kanë luajtur një rol të rëndësishëm për shkrimin, mësimin dhe përhapjen e gjuhës shqipe. Për këtë tregues i qartë është fakti se një alfabet origjinal me germa arabe dhe gjashtë abetare të gjuhës shqipe mbajnë autorësinë e këtyre kolosëve, pa potencuar librat, fjalorët e tekstet mësimore që patën ndikim të madh për zhvillimin e gjuhës shqipe.

Nga ky hulumtim arrijmë të konstatojmë se kontribut të rëndësishëm për zhvillimin e gjuhës shqipe dhe arsimin kombëtar në gjuhën shqipe në kapërcyell të shek. XIX dhe në fillim të shek. XX ka dhënë edhe pedagogu ynë nga Gostivari, Abdylhaqim Hiqmet Dogani.

Dogani jo vetëm që llogaritet si mësues më i vjetër, por ai hynë edhe në radhën e atyre personaliteteve shqiptare, që kanë bashkëpunuar edhe me shkrimtarë të huaj.

Shembull pune, virtyti, vetëmohimi, humanizmi dhe patriotizmi, Abdylhaqim Dogani mbetet dritë e pashuar për arsimin shqiptar në Maqedoni.

Një specifikë njerëzore, një edukatë e thellë pune, një bardhësi shpirtërore e njerëzve të Gostivarit, e bënë vendlindjen e Doganit, të ndjehej, siç ishte në të vërtetë, një vend i bekuar.

Historia e arsimit tonë është një histori luftash, përpjekjesh, histori e një populli të vogël në numër, por të madh në botën e tij shpirtërore, në vullnetin e tij për të qenë i lirë dhe i pavarur.

Ngjarjet janë ato që duhet të kujtohen nga gjeneratat, kurse mendimet dhe veprat të lartësohen. Populli ynë do t'i kujtojë dhe do të lartësojë veprimtarinë e tyre për sakrificën që bënë për edukimin dhe arsimimin e shoqërisë, ngase këtë e ka detyrim fetar dhe kombëtar.

Bibliografia

- [1]. Dogani, Abdulhaqim Hiqmet, *Abetare*, Shkup: Kultura, 1946.
- [2]. Dogani, Abdylhaqim, "*Gostivari*", në "Flaka e Vëllazrimit" Shkup: 25.8.1951
- [3]. *Historia e Shqipërisë*, vëll. II, Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, Instituti i Historisë.
- [4]. Kaleshi, Hasan, *Kontributi i shqiptarëve në dituritë Islame*, 1991.
- [5]. Kaso, Sheraf, *Monumentet Islame ne Muftinin e Gostivarit*, Gostivar, 2002.
- [6]. "*Personalitete të kulturës islame shqiptare që kanë jetuar e kontribuar në fund të Shek. XIX – Gjysma e parë e shek. XX*", Materialet janë marr nga botimi: "Instituti Shqiptarni Mendimit dhe Qytetërimit Islamik", <http://muslimsonline.com>.
- [7]. Zani i Naltë, "*Veteranët e Klerit Mysliman*", nr. 11, Nanëduer 1937.
- [8]. Zekaj, Ramiz, *Zhvillimi i kulturës islame te shqiptarët gjatë shekullit XX*, Tiranë: Insituti i Mendimit dhe Qytetërimit Islam, 1997, f.315.

NURIDIN AHMETI

Instituti Albanologjik – Prishtinë

ROLI I KRERËVE FETARË MYSLIMAN TË MAQEDONISË NË UNIFIKIMIN E ALFABETIT TË GJUHËS SHQIPE MË 1908

“Ishte, pra, një ngjarje e re për ne kjo mbledhje, ku pamë shqiptarë të ardhur nga veriu e nga jugu, nga lindja e perëndimi, ku pamë krah për krah gegë e toskë, të krishterë dhe myslimanë, hoxhë dhe priftërinj”.
(Mid’hat Frashëri)⁹²

Hyrje

Kështu do të shkruante në një editorial, që do ta botonte në gazetën “Lirija” më 1908, kryetari i Kongresit të Manastirit Mid’hat Frashëri. Derisa i pari i këtij Kongresi e vë në pah prezencën e krevë tanë fetarë në këtë ngjarje të rëndësishme për kombin shqiptarë, historiografia shqiptare, posaçërisht ajo e periudhës komuniste, rolin e tyre mund të thuhet se, në përgjithësi, e ka anashkaluar. Propaganda moniste, përmes botimeve zyrtare, shkoi deri në atë shkallë, duke nxjerrë artikuj si “Roli reaksionar i klerit ndaj problemeve të alfabetit (1879–1912)”⁹³ etj.

Në periudhën e monizmit u botuan botime e materiale të veçanta për Lëvizjen Kombëtare Shqiptare dhe kur ishte fjala për krerët tanë

⁹² Mid’hat Frashëri, *Vepra të zgjedhura I*, ISH “Lumo Skendo”, Tiranë, 2017, f. 253.

⁹³ Zihni Haskaj, “Roli reaksionar i klerit ndaj problemeve të alfabetit(1879-1912)”, *Alfabeti i gjuhës shqipe dhe Kongresi i Manastirit*, UT-IH-IGJL, Tiranë, 1972, f. 119-126.

fetarë, u seleksionuan dhe u botuan vetëm ato materiale ku flitej kundra kësaj shtrese.⁹⁴

Rrjedhimisht edhe “Historia e Popullit Shqiptar” e viteve të ‘60–ta dhe, më vonë, e ribotuar në Prishtinë në dy vëllime, kësaj shtrese nuk është se ia kushtoi vëmendjen e duhur.⁹⁵ Në përgjithësi, perceptimi për këtë shtresë në këtë ngjarje të rëndësishme u përshkrua nga diskursi negativ.

Pas viteve të ‘90–ta, për rolin e krerëve tanë fetarë në këtë ngjarje nga disa studiues u shkrua më intensitet të shtuar për veprimtarinë e tyre, por prapë në mënyrë selektive, duke vështuar në pjesë të krerëve fetarë të një komuniteti të caktuar dhe pjesa tjetër disi u anashkalua.

Rolin i krerëve fetarë mysliman në Kongresin e Manastirit më 1908 sipas Mit’hat Frashërit dhe Gjergj Qiriazit

E potencuam edhe më lart se Kryetari i Komisionit të Kongresit të Manastirit Mit’hat Frashëri nuk e fsheh entuziazimin e tij për pjesëmarrjen krerëve fetarë në këtë ngjarje. Për më tepër, ai edhe në ditarin e tij, të cilin e boton në gazetën “Lirija” më 1908, shkruan se në këtë ngjarje pritet të vijë edhe Haxhi Vildan efendi Dibra⁹⁶, i dërguar nga klubi i shqiptarëve të Stambollit dhe misioni i

⁹⁴ *Mendimi politik e shoqëror i Rilindjes Kombëtare Shqiptare (1908-1910)*, Vëll. II, SSHSH-IH, Tiranë, 1976, f. 7, 493-553.

⁹⁵ *Historia e popullit shqiptar II*, ETMMKSAK, Prishtinë, 1979, f. 282-283.

⁹⁶ **Vildan Faik Dibra (?-1925)** u lind në Rimnicë të Rekës së Dibrës. Shkollimin fillor dhe të mesëm i mbaroi në Dibër. Studimet i vazhdoi në Stamboll, ku i përfundoi me rezultate shumë të mira. Pas përfundimit të studimeve, shërbeu si profesor në medresenë e Yskudarit në Stamboll. Po aty për nxënësit refugjatë shqiptarë hapi edhe një shkollë shqipe me emrin “Kosova”. U bë pjesë e Lëvizjes Kombëtare të fillimit të shek. XX. U bë pjesë edhe e Klubit “Bashkimi” në Stamboll dhe e përfaqësoi këtë klub në Kongresin e Manastirit më 1908. Si i dërguar i Komitetit Stambollit në hapësirat shqiptare, ai mbajti një varg ligjëratash. Janë me interes ligjëratat rreth shkrimit të

tyre, sipas Mit'hat Frashërit, ishte “për të dhenë këshilla në Shqipëri”.⁹⁷ Pra, kuptohet se ky komision këshillëdhënës, i dërguar nga shqiptarët e Stambollit, siç edhe shihet në dokumente, kishte për detyrë të jepte këshilla në lidhje me çështjet e alfabetit.

Në ditën e tetë të punimeve të këtij Kongresi, sipas Mit'hat Frashërit, fjalën kryesore në këtë ditë e kishte Haxhi Vildan Dibra, duke bërë fjalë për rrethanat politike e shoqërore të kohës. Pas fjalës së Haxhi Vildanit, në këtë ditë kishin folur edhe të tjerë të pranishëm në këtë ngjarje, për ta marrë në fund fjalën prapë Haxhi Vildani, i cili gjithmonë sipas shënimeve të Mit'hat Frashërit, mes tjerash, kishte folur edhe për mospengesat e të mësuarit të fesë islame më alfabet joarab.⁹⁸

Si raporti më i besueshëm në lidhje me këtë ngjarje, të cilit raport i janë referuar dhe akoma vazhdojnë t'i referohen studiuesit e huaj dhe vendorë, që merren me të kaluarën e shqiptarëve, është ai i Gjergj Qiriazit i vitit 1909 në lidhje me këtë ngjarje. Ky raport u dërgua në ministrinë përkatëse austrohungarezë, disa javë pasi ishte mbajtur Kongresi. Krahësuar me të dhënat që i ofron Mit'hat Frashëru në ditarin e tij, raporti i Gjergj Qiriazit dukej më i plotë, me më shumë të dhëna. Bie fjala, edhe te Mit'hat Frashëri edhe te Gjergj Qiriazit përmendet si delegat nga Shkupi në këtë Kongres Hafiz Ibrahim Shkupi, por Gjergj Qiriazit në lidhje me personalite-

shqipes me alfabet latin, të cilën ky e mbronte. Shkroi në gjuhët e lindjes një mori shkrimesh e librash nga fusha teologjike, filozofike e drejtësisë. Vdiq në Stamboll më 1925. Ramiz Zekaj, *Zhvillimi i kulturës islame te shqiptarët gjatë shekullit XX*, ISHMQL, Tiranë, 2002, f. 278-280; *100 personalitete shqiptare të kulturës islame shekulli XIX-XX*, KMSH, Tiranë, 2012, f. 280; Ruzhdi Lata, “Kontributi i ulemave dibranë për çështjen kombëtare”, *Kontributi i prijësve myslimanë në formimin e vetëdijes dhe identitetit kombëtar*, (Konferencë shkencore 28-29 shtator 2012), BIK-KMSH-BFIRM, Tiranë, 2013, f. 45-48.

⁹⁷ Mit'hat Frashëri, *Veptra të zgjedhura I...*, f. 250.

⁹⁸ *Po aty*, f. 251.

tin e Hafiz Ibrahim Shkupit në këtë ngjarje e shënon edhe këtë veprim. Në ditën e tretë të zhvillimit të punimeve të Kongresit, në mesin e delegatëve të pranishëm, kishte folur edhe Gjergj Fishta, i cili e kishte potencuar rendësinë e të shkruarit të gjuhës shqipe me një alfabet, fjalim ky, që sipas Gj. Qiriazit, kishte lënë përshtypje te të pranishmit. Pas zbritjes së Gjergj Fishtës nga podiumi, për të pranishmit kishte lënë përshtypje veprimi i hafëz Ibrahim Shkupit, i cili pas mbarimit të fjalës së Gjergj Fishtës, i del para “u sul drej tij, e përqafoi dhe me lot në sy e puthi. Një skenë e tillë, në prani të 300–400 njerëzve, nga të cilat $\frac{3}{4}$ ishin myslimanë, la përshtypje të thellë tek të gjithë”⁹⁹ – shkruante, mes tjerash, Gjergj Qiriazit.

Në raportin e Gjergj Qiriazit përmendet edhe ardhja e Haxhi Vildan Efendi Dibrës në ditën e shtatë të mbajtjes së punimeve të këtij Kongresi, ndërsa për ditën e tetë e ve në dukje rolin e Haxhi Vildan Efendi Dibrës në përkrahjen e unifikimit të alfabetit dhe kontributin e tij në argumentimin se shkrimi latin nuk është i ndaluar për shqiptarët, siç kishin pretenduar disa, por feja mund të mësohet edhe nga shkrimet me shkronja latine.¹⁰⁰ Roli Haxhi Vildan Efendi Dibrës, sipas raportit, ishte konstruktiv dhe në frymën e rilindësve tanë.

Agjencia Tregtare Bullgare

Kjo agjenci ishte aktive dhe e pranishme sidomos në territorin e Maqedonisë Veriore të sotme. Në Perandorinë Osmane kjo agjenci e kishte edhe statusin diplomatik, në mungesë të formave të tjera të përfaqësimit. Siç duket, përveç aspekteve tregtare, për të cilat kujdesej kjo agjenci, për çka edhe e mbante emrin, ajo ishte mjaft ak-

⁹⁹ Memli Krasniqi-Armend Mehmeti, *Dokumente të Shoqërisë Biblike dhe Britanike dhe për të huajt (1816-1912)*, IAP, Prishtinë, 2016, f. 104.

¹⁰⁰ *Po aty*, f. 110-112.

tive edhe në dërgimin e raporteve Ministrisë së Punëve të Jashtme Bullgare. Këto raporte, shumë herë të shoqëruara edhe me foto, kanë informacione interesante për disa ngjarje të këtij vitit në hapësirat shqiptare. Njëra nga ngjarjet që prezantohet në një nga raportet e kësaj agjencie është edhe ai mbi rrjedhat e mbajtjes së Kongresit të Manastirit të vitit 1908.

Për dallim prej dy shënimeve të raporteve të lartcekura, atij të Mit'hat Frashërit dhe Gjergj Qiriazit, ku shënimet paraqitën në forme ditore, ky raport i kësaj agjencie ishte përgjithësues. Gjithashtu, kur jemi te Kongresi dhe roli i krerëve fetarë myslimanë në këtë Kongres, në raport shënohet se Kongresin e ka shpallur të hapur Myftiu i Manastirit, por që ishte me origjinë nga Tetova, Rexhep Efendiu, dhe fjalimi i tij ishte ndërprerë disa herë nga duartrokitjet e të pranishmëve. Pra, ky fjalim ishte një lloj besatimi që Myftiu i Manastirit e kërkoi nga të pranishmit që të gjitha vendimet e këtij kongresi duhet pranuar nga populli ynë, shqiptarët, thuhet në raport. Të pranishmit gjithmonë, sipas raportit, bënë betimin se do t'i pranonin të gjitha vendimet e Kongresit. Kuptohet, ky raport shpreh edhe kënaqësinë e raportuesit se ngjarjet që po ndodhin te shqiptarët janë në favorin e politikës bullgare. Për arsye se nuk e kemi hasur të publikuar këtë raport, e as nuk kemi hasur shumë të cituar nga studiuesit tanë, ne po e paraqesim në tërësinë e tij si më poshtë:

“Agjencia Tregtare Bullgare / Manastir 12 nëndor 1908. Nr. 830—Ministria e Punëve të Jashtme të Besimit. Sekrete — Arkivi sekret Nr. 4075.

Zoti Ministër, Filluan bisedimet fillestare ndërmjet dy fiseve kryesore, gegëve dhe toskëve, mbi të cilin ju kam vënë në dijeni në raportin tim të mëparshëm. Kjo u arrit nga puna plot energji e mi—

sionarëve të tyre, të cilët për një kohë shumë të shkurtër mundën ta popullarizonin idenë e thirrjes së kongresit, në të cilin do të shqyrtohen çështje të radhës së parë, si ruajtja e tërësisë tokësore të Shqipërisë dhe e rilindjes së popullit shqiptar. Kongresi u mbledh në datën 1 të këtij muaji në Manastir, që tani e kanë përcaktuar si qendrën politike kulturore të të gjithë veprimtarisë së shqiptarëve.

Çelja e këtij kongresi u bë nën kujdesin e Valiut dhe në prezencën e 42 delegatëve, një pjesë e të cilëve zotërojnë nga disa mandate përfaqësie. Në kongres ishin pjesëtarë këto shoqëri dhe klube shqiptare:

- a. Nga brenda Shqipërisë: Manastiri, Selaniku, Shkupi, Stam-bolli, Shkodra (të dy klubet “Agimi” dhe “Bashkimi”), Gjirokastra, Elbasani, Kolonja, Lekoviku i Vilajetit të Janinës, Vlora, Janina, Starova, Tirana, Berati, misioni katolik i Shkodrës, princi i Mirditës, i përfaqësuar prej Vrec Dodës, misioni protestant i qytetit të Korçës, i përfaqësuar nga Cilika, së bashku me gruan e tij, zonjën Cilike, të cilën e ka bërë për vete misionarja revolucionare bullgare Ston.
- b. Nga jashtë: Sofja, Plovdivi, Bukureshti, Konstanca, Bostoni, Italia dhe Egjipti.

Kongresin e deklaroi të hapur me një fjalim përshëndetës të përgatitur nga klubi vendas Rexhep Efendiu, gegë nga Tetova, që tani është myfti në këtë qytet.¹⁰¹ Në fjalimin e tij, që disa herë u ndërpre nga duartrokitjet, Rexhep Efendiu foli me fjalë të mëdha për përpjekjet që kanë bërë shqiptarët me shekuj për përparimin dhe lirinë e tyre. Pasi mbaroi ky fjalim, të gjithë shqiptarët bënë betimin se do ta kryenin me besnikëri detyrën për t’i zbatuar deri në fund

¹⁰¹ Për më tepër për jetën dhe veprimtarinë e Rexhep Vokës së Tetovës, shih: Nuridin Ahmeti, *Krërët fetare në Lëvizjen Kombëtare Shqiptare*, 1A, Prishtinë, 2017, f. 328-336.

vendimet e Kongresit. Me propozimin e delegatit të Selanikut, që ishte më i vjetri në moshë, u zgjodh një komision, i cili do tëa hartonte rezolutën e këtij kongresi. Komisioni përbëhej prej 10 vetash: Sotir Peci, drejtor i gazetës “Kombi” që botohej në Boston; Fishta, peshkop shqiptar nga Shkodra; Gurakuqi, katolik nga i njëjti qytet; Mosi Kaçori, misionar katolik po nga Shkodra; Buda, farmacist nga Elbasani; Bajo Fehim Topulli, ish emigrant, vëllai i kryengritësit të njohur shqiptar Çerçizit, i cili i pari nga shqiptarët filloi të përkrahë lëvizjen e turqve të rinj dhe që u prit me aq solemnitet së bashku me njerëzit e tij në Manastir nga ana e organeve të pushtetit e banorëve të qytetit mbas shpalljes së kushtetutës; Refik Bej Toptani nga Tirana; Mjeda, prift katolik nga Shkodra; Cilika, i misionit protestant të qytetit të Korçës; Shahin Kolonja, ish redaktor i gazetës “Drita” që botohej në Sofje dhe kohët e fundit është zgjedhur deputet i Korçës në parlamentin turk; Qiriazhi, shkrimtar, përkthyes i konsullatës austrohungareze të Manastirit.

Seancat e kongresit u zhvilluan dy herë në ditë me dyer të hapura dhe të mbyllura. Në seancat e fundit kanë marrë pjesë vetëm delegatët. Çështja kryesore, që u zhvillua në mbledhjet publike dhe që ishin shkaku kryesor i thirrjes së këtij kongresi, ishte aprovimi i një alfabeti të vetëm që do të luante një rol madh në zhvillimin kulturor e arsimor dhe sidomos në bashkimin e shqiptarëve. Deri tani, sikurse dihet, për shkrimin e shqipes janë përdorur shumë alfabetë, por tri kanë qenë ata që e përdornin kryesisht atë latin:

1. Alfabeti i “Agimit” me 36 gërma: a, b, c, c’, d, et, e, 9, f, g, g’, h, i, j, k, k’, l, t, m, n, n’, o, p, r, r’, s, s’, t, th, u, v, dz, y, z, z’.

Ky alfabet ka filluar që të përdoret para pesë vjetësh nga priftërinjtë katolikë, që kanë pasur përkrahjen edhe të Austro-

Hungarisë. Më këtë alfabet janë shkruar shumë pak disa libra kishtare dhe disa këngë të kishës.

2. Alfabeti i “Bashkimit”, i krijuar 10–12 vjet më parë dhe përbëhet nga 35 germa: a, b, c, th, ch, d, dh, é, e, p, g, gh, h, i, j, k, l, ll, m, n, o, p, c, r, rr, s, sh, t, th, u, v, z, zh, y, x, xh. Ky alfabet doli në një kohë të tillë kur grekët e ngritën çështjen e përdorimit të alfabetit grek për ta shkruar gjuhën shqipe. Prej tij janë hequr pesë germa të alfabetit grek që ekzistonte më parë dhe që përdorej në alfabetin e ashtuquajtur “Frashëri”, i cili deri tani është konsideruar si thjesht shqiptar. Me sa duket, me këtë alfabet janë botuar shumë botime shqipe. Me të në fillim u botua edhe gazeta “Kombi”.
3. Alfabeti “Frashëri”, i njohur edhe me emrin i Stambollit përmban 36 germa nga të cilat pesë të alfabetit grek: a, b, c, ç, j, d, ç, e, p, g, h, i, j, k, l, m, n, nj, o, p, q, r, R, s, f, t, v, u, g, y, z, z. Ky alfabet është krijuar para 35 vjetësh prej Sami Frashërit dhe ka qenë njaft i përhapur. Me të janë botuar të gjitha librat e broshurat e njohura deri tani. Me të është botuar edhe gazeta “Drita” në Sofje, si dhe të gjitha dorëshkrimet e gazetave të botuara nga shoqëritë jashtë e brënda vendit. Përveç këtyre alfabeteve, ekzistojnë edhe dy të tjera që kanë më tepër rëndësi historike, ai i “Kristoforidhit”, që është i përbërë thjesht me alfabetin grek dhe me të janë botuar një fjalor e një ungjill, ndërsa alfabeti tjetër është ai i Naum Veqilharxhit, i krijuar që para vjetësh. Ai ka qenë prej Vithkuqi të kazasë së Korçës. Me këto dy alfabete kongresi nuk u mor fare. Në mbledhjet rregullta të kongresit u diskutua për çështjet e alfabetit, ndërsa në mbledhjet e veçanta (sekrete), të cilat u zhvilluan në datat 3, 4 dhe 5 të muajit. Në vazhdim të gjithë delegatët, kryesisht, ata fetarë katolikë, duke

pare traditën e shqiptarit si mjet të rëndësishëm për zhvillimin fetar dhe politik, e kanë përkrahur alfabetin e “Bashkimit” si një alfabet të të gjithë shqiptarëve, që deri tani e ka marrë gati emrin e alfabetit kombëtar shqiptar. Pjesa më e madhe e delegatëve u shprehën për aprovimin e alfabetit “Frashërit” (të Stambollit), duke argumentuar me këto të dhëna:

- 1) Më të janë shkruar shumë pjesë, si pjesa më e madhe e literaturës e publicistikës shqiptare. Është alfabet i popullarizuar ndër të gjithë shqiptarët. Tani, që gjuhën shqipe e ka garantuar dhe kushtetuta, do të ishte e pavyend të hidhej poshtë alfabeti “Frashëri” dhe, së bashku me të, të hidhej poshtë gjithë literatura ku pasqyrohet e kaluara dhe historia e shqiptarëve. Në të kundërtën, ai do të mbetej vetëm objekt i studimit nga ana e studiuesve e gjuhëtarëve.
- 2) Nga ana fonetike alfabeti “Frashëri”, duke qenë i plotësuar edhe me pesë germa greke, u përgjigjet më mire rregullave fonetike të shqipes.

Mbas diskutimesh të gjata, në të cilat delegatët katolikë këmbëngulin me energji, duke sjellë si pasojë që të aprovohej nga kongresi përdorimi i të dy alfabeteve, ai i “Bashkimit” dhe “Frashëri” (i Stambollit), duke ju bërë atyre vetëm disa ndryshime të vogla, ashtu si dhe duket nga paraqitja e tij me këto germa: **a**–Ai i ngjashëm me alfabetin e “Bashkimit”: a, b, c, ç, d, dh, Ee, Eé, f, g, gj, h, i, k, l, ll, m, n, nj, o, p, q, r, rr, s, sh, t, th, u, v, x, y, z, zh, x, xh. **b**– Ai i afërt me atë “Frashëri” (të Stambollit): a, b, c, ç, d, æ, e, ë, f, g, j, h, i, j, k, l, lj, m, n, nj, o, p, q, r, rr, s, ð, t, ð, u, v, x, y, z, yj, xj. Të dy palët, përkrahësit e alfabetit “Frashëri” dhe atij të “Bashkimit” ranë dakord unanimisht që çështja e alfabetit të vendoset definitivisht në

kongresin e ardhshëm, i cili sipas vendimit të marrë do të zhvillohej në qytetin e Janinës mbas dy vjetësh. Pas përfundimit të diskutimit për alfabetin, kongresi u mor me çështjen e shkollës, por u mor vendim që menjëherë të çelen në masë shkolla shqipe me aq sa lejojnë mundësitë materiale. Po ai komision, i përberë prej 11 vetave, u ngarkua që të hartojë një thirrje për të gjithë shqiptarët në gjithë Perandorinë për të kontribuar materialisht në shpenzimet që duhen për mbajtjen e shkollave.

Qyteti i Manastirit u caktua përsëri të jetë qendra politike e kulturore e të gjitha klubeve shqiptare. Komiteti i zgjedhur kohëve të fundit, me gegë e toskë, do të jetë komiteti politik shqiptar, duke u paraqitur atyre edhe detyra e udhëzimet e kongresit për ngritjen kulturore dhe bashkimin e të gjitha fiseve të Shqipërisë. Në këtë drejtim u përcaktuan edhe një herë çështjet që do të jenë në programin e Kongresit. U diskutuan edhe çështje të tjera që kanë të bëjnë me situatën politike të Shqipërisë. Këto u diskutuan nëpër mbledhjet e fshehta të kongresit. Diskutimi i këtyre çështjeve, me karakter politik dhe marrja e vendimeve përkatëse, nënkuptohet që mbahen sekrete, por nga një bisedë konfidenciale, që zhvillova me anëtarët e komisionit të 11 vetave, pikërisht me Shahin Kolonjen e Qiriazin, munda të njihem me përmbajtjen e rendit të ditës të secancave sekrete të Kongresit, në të cilat janë diskutuar bazat mbi të cilat do të mbështetet lëvizja kombëtare shqiptare dhe gjithë aktiviteti i saj për shkëputjen për të krijuar një Shqipëri të pandarë në të gjithë shtrirjen e saj. Kjo do të jetë detyra numër një e të gjithë patriotëve shqiptarë. Ata këtej e tutje do të marrin iniciativën për bashkimin kulturor të të gjithë shqiptarëve dhe për ta arritur këtë do të shfrytëzohen të gjitha të drejtat që ua ka dhënë kushtetuta, duke u mbështetur gjithmonë mbi frymën kombëtare dhe traditën e

kombit. Për t'i shfrytëzuar më mirë të gjithë liritë që i garanton kushtetuta për kauzën kombëtare shqiptare, delegatët u angazhuan të punojnë me masat për të marrë iniciativa të reja. Ky komision është i përbërë nga Fazil Pasha, gjeneral brigade i shtabit të përgjithshëm të ushtrisë turke, lindur në Tiranë me origjinë shqiptare; Zija Pasha, gjeneral brigade, i biri i të mirënjohurit Xhemal Pasha, kajmekam i dikurshëm i Matit; Vildan Efendiu, personalitet fetar nga Dibra; dhe Shaqir Efendiu, ish doktor në Shkodër. Gjatë kësaj hashtu është edhe një shqiptar nga Ohri, të cilët arritën në Stamboll në mbrëmjen e datës 8 të këtij muaji. Po atë ditë Zija Pasha e mori emërimin e tij me shërbim në Bagdat dhe pas një dite ai u nis për në këtë qytet për ta marrë në dorëzim detyrën e re. Shokët e tij qëndruan në qytet, ku morën pjesë në punimet e kongresit. Fazili mbajti një fjalim, në të cilin vuri në dukje detyrën e çdo nënshtetasi të Perandorisë Osmane ndaj atdheut të vet, duke vënë në dukje se zhvillimi u veçantë i çdo kombi brenda vetes mund të arrihet me përpjekjet e përbashkëta të të gjithëve, ndërsa në mënyrë të veçantë konsolidimi i tij arrihet nga ky bashkëpunim, sepse nuk mundet të ekzistojë një lumturi e mirëqenie Perandorisë pa pasur një gjë të tillë për të gjithë qytetarët e saj. Me këtë fjalim ai u paralajmërua. Kjo krijoi një bazë mbi të cilën mbështeten të gjithë turqit, veçanërisht komitetet e turqve të rinj, për të gjitha çështjet që u diskutuan në Kongres.

Për ne bullgarët çështjet të cilat u diskutuan në kongresin shqiptar kanë rëndësi kryesisht politike. Në të vlerësohet edhe njëherë çështja nacionale, veçanërisht ajo e autonomisë politike të Shqipërisë, të cilat janë që të dyja çështje që ne i kemi paraqitur për Maqedoninë. Në fakt, ky kongres krijoi mundësi të reja për bashkëpunim ndërmjet bullgarëve dhe shqiptarëve. Kongresi u mbyll në datën 15 të këtij muaji me një banket, në të cilin morën pjesë të gjithë delegatët dhe

disa të ftuar nga komiteti i turqve të rinj. Pranoni, zoti ministër, besimin dhe respektin tim më të thellë për ju”.¹⁰²

Hoxhë Ismail Hakiut dhe Hoxhë Vildan Dibra

Dy personalitet nga radhët e krerëve fetarë myslimanë, që me veprimet e tyre luajtën rol me rëndësi në unifikimin e alfabetit të gjuhës shqipe në Kongresin e Manastirit, ishin edhe Hoxhë Ismail Hakiut¹⁰³ dhe Hoxhë Vildan Dibra. Derisa për Hoxhë Vildan Dibrën u përmend edhe në shkrimet e Mit’hat Frashërit, Gjergj Qiriazit dhe raportin bullgar, të cilët i trajtuan si më sipër, për Hoxhë Ismail Hakiun nuk u apostrofua shumë në këtë ngjarje, edhe pse kontributi i tij në këtë kongres ishte i theksueshëm, po aq sa edhe i Hoxhë Vildan Dibrës. Ishin dy personalitet të shquara me origjinë nga Maqedonia, anëtar të Komitetit të Stambollit, të cilët u dërguan nga Stambolli për ta përkrahur iniciativën e rilindësve në Kongresin e Manastirit më 1908.

Në raportet austro-hungareze, potencohet roli i Hoxhë Vildan Dibrës dhe Hoxhë Ismail Hakiut në vazhdimësi. Ata morën mision që t’i vizitonin të gjitha trevat shqiptarë, duke mbajtur ligjëratë se alfabeti i gjuhës shqipe me shkronja latinë nuk bie ndesh me normat kuranore dhe fokusi i tjetër i ligjëratës së tyre ishte ai i unifikimit të shqiptarëve pa dallime fetare.

¹⁰² Centralen Derzhaven Istoriceski Arhiv (më tej: *CDIA*) Dokumente bullgare (sipas përkthimeve që ndodhen në *AIHT*), H-25. Raport i Agjencisë Tregtare Bullgare nga Manastiri, nr. 830, dt. 12 nëntor 1908, dërguar Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të Besimeve Sofje, fl. 5-10.

¹⁰³ **Ismail Haki ef. Manastiri (1846-1912).** Dijetar i shquar, profesor universitar, publicist, autor i shumë veprave. U lind në Manastir, prandaj dhe u bë i njohur sipas vendlindjes. Botoi shumë shkrime në gazetën “Sirât-i müstakîm”, të cilën e drejtonte vetë ai, si dhe në gazetën “Sebîl’ur-reşâd” me kryeredaktor Mehmet Akif Pejani. Ishte autor i dhjetëra veprave nga fusha e shkencave islame. Vdiq më 22 nëntor 1912 dhe u varros në oborrin e xhamisë “Fatih” në Stamboll. Shih: Sülejman Baki, *Manastırlı İsmâil Hakkı ve Telhîsu’l-Kelâm Eseri*, Logos-A, Shkup, 2006.

Studiuesi Stavro Skendi vë në dukje se nga mesi i vitit 1908 ishte krijuar Lidhja Kombëtare për Mbarësinë e Shkollave Shqipe, e cila lidhje bisedonte edhe për çështjen e shkollave. Nga disa burime shihet se kjo lidhje ishte e interesuar që sa më shumë të përhapej në trevat shqiptare. Përhapja e kësaj organizate pothuajse u ishte besuar hoxhallarëve. Sipas një shënimi, Komiteti i Stambollit u kishte caktuar rregullore veprimi Hoxhë Vildan Dibrës, Hoxhë Ismail Hakiut dhe përkrahësve të tyre. Kjo rregullore përbehej prej dymbëdhjetë pikave, ndërsa pika një dhe dymbëdhjetë, siç vë në dukje shënimi i vitit 1908 i konsullatës austro-hungareze në Manastir ishin këto: *“Në të gjitha viset e Shqipërisë do të dërgohen hoxhallarë për të bërë propagandë nacionale shqiptare dhe hoxhallarët e dërguar ndër fshatra do të zgjedhin me kujdes personat e përshtatshëm duke u njohur mandateve të tyre enurat dhe pastaj dega e komitetit ka për të dërguar një person të përshtatshëm dhe do të krijoj një degë të re të komitetit”*.¹⁰⁴

Konsullata austro-hungareze në Manastir, për rolin e dy krerëve fetarë të kësaj ane, i dërgon këto dy shënime, të cilat ne i kemi marrë në shqyrtim në këtë punim. Shënimi i parë titullohet *“Misioni i Hoxhë Ismail Hakiut në Manastir, anëtar i Komitetit të Fshehtë të Stambollit. Synim për themelimin e komiteteve të fshehta”*. Shënimi dërgohet në muajin dhjetor të vitit 1908 nga Manastiri dhe, mes tjerash, shkruan: *“Hoxhë Ismail Haki Beu, shqiptar me prejardhje nga Manastiri, i njohur si kortizan i xhonturqve, ka arritur këtu para disa ditëve prej një udhëtimi që kishte bërë me tre shokë, që kishin misionin e njëjtë në Vilajetin e*

¹⁰⁴ Haus und Hof Staats Archiv, Wien, Politisches Archiv, Albanien (më tej: HHSt.A.P.A.A), në Arkivi i Institutit të Historisë - Tiranë, (më tej: AIHT), AIHT, Vj. 18-7-751. Raport i Posfait nga Manastiri dërguar në Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vjenë, më 7 dhjetor 1908.

Kosovës për një qëndrim të shkurtër këtu, si ai për të cilin ishte genë dërguar Haxhi Vildani nga Manastiri në Shkodër (relacioni, dt., 23 Nëntor 1908). Ai mbajti para mijera dëgjuesve në pjesë të madhe muhamedan në Xhaminë e madhe një fjalim të gjatë, i cili ka bërë një përshtypje të thellë....Siç kam marrë vesh në mënyrë tepër konfidenciale, Ismail Hakiu ishte një anëtar i shquar i Komitetit të fshehtë të shqiptarëve të Stambollit, qendra e të cilit sipas të gjitha gjasave duket se është në Stamboll dhe ai është ngarkuar po me atë detyrë sekrete si ajo e mikut të tij të Presidentit të Klubit të këtushëm “Bashkini” Rexhep Hoxhës,¹⁰⁵ – theksohet në këtë shënim.

Derisa në shënimin e parë behët fjalë për Hoxhë Ismail Hakiun nga Manastiri, në shënimin tjetër, të cilin ne e kemi marrë në shqyrtim, bëhet fjalë Hoxhë Vildan Dibrën. Ky shënim titullohet: *“Delegatët e Klubit të Stambollit, Hoxhë Vildan Efendiu, kolonel Ali Riza dhe avokat Abdyl bej Ypi. 31 dhejtor 1908.* Ky shënim, siç edhe mund të kuptohet nga titulli, i kushtohet në tërësi veprimtarisë së Hoxhë Vildan Dibrës. Në këtë shënim, mes tjerash, thuhet: *“Pjesëtarët e Kongresit të alfabetit në Manastir ishin në fillim të mendimit se Vildan Efendiu me shokë vinin për t’i bindur që të pranonin për alfabet shqiptar shkronjat turqisht, por nga fjalimet e mbajtura prej tyre në Manastir, u duk menjëherë se ishte e kundërta. Hoxha theksoj atje dhe në vendet e tjera se shqiptarët duhet të sqarohen mbi propagandën e përhapur nga disa fanatikë turq se Kurani e ndaluaka që shqipja të shkruhet ndryshe, veçse me shkronja arabe. Prandaj, një gjuhë mund ta shkruajmë si ta duam, si t’i përshtatemi më mirë asaj. Shkronjat rrjedhin prej dorës së njeriut dhe nuk*

¹⁰⁵ AIHT, Vj. 18-7-751. Raport i Posfajt nga Manastiri dërguar në Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vjenë, më 7 dhjetor 1908.

rrjedhin prej Zotit. Nuk mund të thuhet se arabishtja qenka e vetnija gjuhë që e ka pëlqyer Zoti, sepse ekzistojnë shumë libra fetare dhe në gjuhën turqishte. Prandaj, nuk ekziston as edhe një pengesë që shqipja të shkruhet me shkronja latine. Delegatet kishin pastaj për detyrë të zgjonin ndjenjat kombëtare, të formonin klube shqiptare, ta zgjonin dëshirën për leximin e shkrimeve shqipe etj., detyrë që ata e kryenin vetëm me nuanca të ndryshme dhe sipas gjendjes së lëvizjes kombëtare nëpër krahinat e veçanta. Ata folën edhe mbi pagën e nevojshme ndërmjet secilës fe¹⁰⁶ – theksohet, mes tjerash, në shënim.

Përfundim

Nga shënimet e prezantuar më sipër, mund të konstatojmë se krerët fetarë myslimanë të kësaj anë kanë dhënë kontribute të çmuara në Kongresin e Alfabetit, së bashku më krerët e tjerë të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Shënimet, bullgare, austro–hungarezë, por edhe shënimet e tjera të lartcekura, flasin për krerët fetarë myslimanë të kësaj ane dhe personalitetet e tyre i shkruajnë me epitete të larta si “anëtarë të shquar” etj. Këto shënime nxjerrin në pah kontributin e krerëve fetarë të kësaj ane jo vetëm në Kongresin e Manastirit, por edhe në veprimtari të tjera më frymë kombëtare.

Ndër me të apostrofuarit në trajtimet e lartcekura shihet se janë Hoxhë Ismail Hakiu dhe Hoxhë Vildan Dibra, por duhet potencuar se raporti bullgar është ndoshta nga të vetmit shënim që kemi potencuar si më sipër, që e vë në dukje edhe rolin e Myftiut të Manastirit, i cili – sipas raportit bullgar – ishte me origjinë nga Tetova dhe quhej Rexhep Efendi, fjalimi i të cilit kishte lënë përshtypje të

¹⁰⁶ *HHSt.A.P.A.A* në *AIHT*, Vj. 18- 2- 245. Raport i Kral dërguar në Ministrinë e Punëve të Jashtme në Vjenë, më 31 dhjetor 1908.

mira te të pranishmit, po aq sa kishte lënë përshtypje edhe gjesti i Hafiz Ibrahim Shkupit me rastin e përshëndetjes së Gjergj Fishtës në këtë kongres. Duhet theksuar se studiuesit Stavro Skendi¹⁰⁷ edhe Peter Bratl,¹⁰⁸ ky i fundit i referohet Stavro Skendit, potencojnë se krerët fetarë myslimanë e konsideronin përdorimin e alfabetit latin si diçka jashtë normave kuranore. Pa dyshim se ka pasur edhe nga ata të cilët kanë menduar kështu, por burimet e gjertanishme, disa prej të cilëve i kemi trajtuar më sipër, e kanë vërtetuar katërçipërisht se kishte edhe nga autoritetet e njohura të krerëve fetarë myslimanë, si Hafiz Ali Korça, Hafiz Ibrahim Dalliu, e personalitet fetare myslimane nga Maqedonia, disa prej të cilëve i cekëm më lartë, që e përkrahën nismën e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare për një alfabet të njësuar të gjuhës shqipe me shkronja latine.

Për sa u tha më sipër, ne mendojmë se fjalët e thëna nga Hoxhë Vildan Efendiu, të cilat potencohen edhe në raportet e konsullatës austro-hungareze se “*një gjuhë mund ta shkruajmë si ta duam si t’i përshtatemi më mirë asaj. Shkronjat rrjedhin prej dorës së njeriut dhe nuk rrjedhin prej Zotit. Nuk mund të thuhet se arabishtja qenka e vetnija gjuhë që e ka pëlqyer Zoti, sepse ekzistojnë shumë libra fetare dhe në gjuhën turqishte. Prandaj, nuk ekziston as edhe një pengim që shqipja të shkruhet me shkronja latine*”,¹⁰⁹ – janë më tepër se përkrahje për këtë nismë. Këto fjalë paraqesin njëkohësisht edhe fetvanë e krerëve tanë fetarë myslimanë të kohës për shkronjat me të cilat sot shkruhet gjuha e jonë shqipe.

¹⁰⁷ Stavro Skendi, *Zgimi kombëtar shqiptarë*, (Përkthyer nga Skënder Luarasi-Nestor Neprevishta), Phoenix& Shtëpia e Librit, Tiranë, 2000, f. 347.

¹⁰⁸ Peter Bratl, *Myslimanët shqiptarë në lëvizjen për pavarësinë kombëtare (1878-1912)*, (Përkthyer nga Nestor Neprevishta), ShB, Dituria, Tiranë, 2006, f. 203. (203).

¹⁰⁹ *HHSSt.A.P.A.A në AIHT*, Vj. 18- 2- 245.

SHINAZI MEMEDI

Fakulteti i Shkencave Islame – Shkup

ORGANIZIMI INSTITUCIONAL I BASHKËSISË FETARE ISLAME TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

1. Vështrim historikë të organizimit institucional të Bashkësisë Islame

Nëse bëjmë një analizë të shkurtër historike të aspektit organizativ të Bashkësisë Islame në viset ballkanike, atëherë duhet të rikthehemi dhe të bëjmë një analizë të shkurtër duke filluar nga sundimi i Perandorisë Osmane në këto anë, ku do të vërejmë se myslimanët e këtyre anëve nuk kishin bashkësi të veçanta fetare, por organizimi i jetës fetare edhe këtu ishte i njëjtë si në pjesët e tjera të Perandorisë Osmane.

Udhëheqësi suprem fetar i gjithë myslimanëve ishte halifi, i cili pushtetin fetar e ushtronte nëpërmjet Shejhul–islamit¹¹⁰. Ai për rajone të caktuara emëronte myfti,¹¹¹ të cilët kujdeseshin për jetën fetare për rajonet e veta. Ekzistonte ministria e veçantë që kujdesej për pronën e vakëfeve, duke mbikëqyrur aktivitetet e mytevelinjve¹¹² dhe personave të tjerë fetarë.

Me përfundimin e sundimit dhe shpartallimin e Perandorisë Osmane, shtetet e reja ballkanike, veçanërisht Serbia dhe Mali i Zi, e

¹¹⁰ Shejhul islami – Myftiu i Lartë, Kryetari i Bashkësisë Fetare Islame në Perandorinë Osmane.

¹¹¹ Myfti – njohës i diturive fetare, njohës i sheriatit islam, përfaqësues i dijetarëve islam të një rrethi,

¹¹² Muteveli – Drejtues i vakëfit, i cili drejtonte me mbledhjen dhe shpërndarjen e të ardhurave nga vakëfi të përcaktuara sipas vakëfnamesë,

shpallën fenë e krishterë si fe shtetërore, kurse e pranuan edhe Islamin, por jo si fe shtetërore të barabartë me fenë krishtere, madje ushtruan kontroll të rreptë mbi të. Në të vërtetë halifi edhe më tej vetëm formalisht konsiderohej udhëheqës suprem fetar dhe parashihej që Bashkësia Islame mund të realizojë lidhje bashkëpunimi me qendrat e tjera islame jashtë Serbisë,¹¹³ përbërëse e së cilës ishte edhe Republika e Maqedonisë së sotme për çështjet fetare.

Pas formimit të Mbretërisë SKS, për myslimanët do të fillojë një periudhë e vështirë, e cila për Bashkësinë Islame mund të ketë qenë periudha më e vështirë e organizimit të Bashkësisë Islame dhe myslimanëve. Kjo situatë u gjet në vitin 1918 në Mbretërinë e re të formuar të Serbëve Kroatëve dhe Sllovenëve dhe për një kohë nuk pësoi ndryshime të mëdha.

Struktura organizative në aspektin administrativ e Bashkësisë Islame në Mbretërinë SKS deri në vitin 1929 ishte e këtillë:

- Kryetari suprem, Reis ul-Ulemaja me seli në Sarajevë për myslimanët në Bosnje dhe Hercegovinë, Kroaci, Slloveni, Sllavoni dhe Dalmaci dhe

- Myftiut Suprem me seli në Beograd për myslimanët në Serbi, Mal të Zi, Kosovë, Sanxhak dhe Maqedoninë dhe disa myftinj të qarkut në disa vende.¹¹⁴

Bashkimi i Bashkësisë Islame në Mbretërinë Jugosllave u themelua pasi që Mbreti Aleksandër më 6 Janar të vitit 1929 me vendosmëri zhvendosi luhatjet e tendosura nënryet centralizmit politik dhe federalizmit dhe e fiksoi atë në seksionin e integruar jugosllav. Me ligjin e Bashkësisë Islame të 31 janarit të vitit 1930, u caktua mira-

¹¹³ Edah, Bećirbegović, *Organizacija Islamske zajednice u SFRJ*, Sarajevo, 1981, f. 32-33,

¹¹⁴ Edah, Bećirbegović, *Organizacija Islamske zajednice u SFRJ*, Sarajevo, 1981, fq. 33,

timi i Ligjit për Bashkësinë Islame në Mbretërinë Jugosllave. Ky ligj siguroi miratimin e Kushtetutës të Bashkësisë Islame në mbledhjen e përbashkët nën udhëheqjen e kryesisë së Reis-ul-ulemasë të të gjithë anëtarëve të dy Ulema-mexhlisave, të të gjithë myftinjve dhe të gjithë anëtarëve të dy gjyqeve të sheriatit. Miratimi i Kushtetutës do t'i besohet ministrit të Drejtësisë, i cili pas miratimit do t'i dorëzohet Mbretit për verifikim. Sipas kësaj procedure, është miratuar Kushtetuta e Bashkësisë Islame të Mbretërisë Jugosllave, e cila publikohet në gazetën zyrtare të 25 qershor të vitit 1930. Me këtë Kushtetutë u themelua Bashkësia Islame, me çka u pezullua organizimi i deriatëhershëm i Bashkësisë Islame dhe më 9 korrik 1930 u miratua Kushtetuta e Bashkësisë Islame për gjithë Mbretërinë e Jugosllavisë, sipas së cilës myslimanët e Mbretërisë së Jugosllavisë përbëjnë një Bashkësi Fetare me një kryesi të Bashkësisë Islame në krye me Reis ul-Ulemanë me seli në Beograd¹¹⁵.

Me përfundimin e diktuarës së 6 janarit të regjimit në Mbretërinë Jugosllave, u paralajmërua një situatë më e volitshme për Bashkësinë Islame. Kjo situatë do ndikoi që trupi kompetent i Bashkësisë Islame më 25 mars 1936 të miratojë kushtetutë të re të Bashkësisë Islame të Mbretërisë Jugosllave, e cila nga është nënshkruar Mbreti më 24 tetor, kurse në gazetën zyrtare është shpallur më 5 nëntor 1936¹¹⁶. Me këtë Kushtetutë do të ndryshohet edhe selia e Bashkësisë Islame dhe Reis ul-Ulema – nga Beogradi do të kthehet në Sarajevë.

Pas Luftës së Dytë Botërore, Bashkësia Islame në RPF të Jugosllavisë hyn në një fazë të gjatë të mbijetimit si faktor i dorës së dytë, panjet e së cilës deri diku tregohen në kushtetutën vijuese të Bashkësisë Islame, të miratuar nga Kuvendi Suprem i Bashkësisë

¹¹⁵ Muhamed, Salkić, *Ustavi islamičke zajednice, Sarajevo*, 1422/2001, fq. 8,

¹¹⁶ Muhamed, Salkić, *Ustavi islamičke zajednice, Sarajevo*, 1422/2001, fq. 118,

Islame me seli në Sarajevë më 27 gusht të vitit 1947. Organet drejtuese në këtë Kuvend ishin Kuvendi Suprem i Këshillit të Vakëfit dhe Kryesia Supreme e Bashkësisë Islame në krye me Reis ul-Ulemanë. Në katër republikat socialiste (Serbi, Mali i Zi, Maqedonia dhe Bosnja dhe Hercegovina) kishte Drejtori të Vakëfit dhe Ulema Mexhlise (Kryesi të Bashkësisë Islame).¹¹⁷ Deri në shpartallimin e RFS të Jugosllavisë, Bashkësia Islame në këto troje do të mbetet unike.

Në prag të luftës, Bashkësisë Islame iu dha mundësia të bëhet plotësisht e pavarur në përfshirjen e vendime të ngushta të problemeve shoqërore. Në këtë mënyrë, ajo fitoi rëndësi, por në të njëjtën kohë e rriti përgjegjësinë e saj, mbi të gjitha, në udhëzimin e anëtarëve të saj se si të veprojnë në situata të caktuara krize.

Bashkësia Islame dhe udhëheqësit e saj do të mundohen në mënyra të ndryshme ta mbrojnë unitetin e Bashkësisë Islame për një unitet të përbashkët të myslimanëve në të gjithë RSF të Jugosllavisë. Në mesin e udhëheqësve të asaj kohe me deklarata për një bashkësi unike u deklaruan: Senahid ef. Bistrić, Jakup ef. Selimoski dhe Mustafa Cerić, deklarata e të cilit ishte më e rezervuar dhe përmbante një koncept pak më të theksuar boshnjak¹¹⁸. Qëndrime të tilla do të mbizotëronin deri në fillim të vitit 1992, kur u bë e qartë se shpërbërja e RSF të Jugosllavisë është e patjetërsueshme.

Shpërbërja e RSF të Jugosllavisë dhe njohja ndërkombëtare e shteteve të reja të krijuara imponua krijimin e formave të reja organizative të përshtatura për kufijtë e rinj shtetërorë dhe administrativ. Themelimi i bashkësive të pavarura islame u zyrtarizua nga ndry-

¹¹⁷ Edin, Radušić, *Stav Islamske zajednice prema raspadu Jugosllavije*, Prilozi, 36, Sarajevo, 2007, fq. 197.

¹¹⁸ Shih më shumë: Edin, Radušić, *Stav Islamske zajednice prema raspadu Jugosllavije*, Prilozi, 36, Sarajevo, 2007, fq. 193-202.

himet në Kushtetutën e Bashkësisë Islame të RSF të Jugosllavisë, të cilat u zbatuan në mbledhjen e Rijasetit të atëhershëm, i cili do ta organizojë mbledhjen e tij më 5 shkurt të vitit 1993. Në at kohë Bosnja dhe Hercegovina, Maqedonia dhe Mali i Zi tashmë i kishin bashkësitë e tyre të pavarura islame, kurse Meshihati i Bashkësisë Islame të Serbisë, me seli në Prishtinë, do të riemërohet “Bashkësia Islame e Kosovës”. Takimi në Stamboll, në fund të muajit tetor të vitit 1994, nga përfaqësuesit e meshihateve të porsaformuara, të cilëve do t’u bashkëngjitet edhe përfaqësuesi i Bashkësisë Islame të Sanxhakut, përfaqëson përfundimin zyrtarë të Bashkësisë Islame në RSF të Jugosllavisë¹¹⁹.

Janë këto periudha për organizimin e Bashkësisë Islame dhe myslimanëve, të cilat do të kalojnë nëpër faza të ndryshme, ku myslimanët ishin të detyruar që gradualisht të ndryshojnë dhe të adaptohen në veprimet dhe funksionimin e këtyre periudhave. Në këtë periudhë popullata myslimane do t’i humbë privilegjet e forcave shpirtërore, të arritura gjatë sistemit shumëshekullor të Perandorisë Osmane. Përpjekjet e autoriteteve të shtetit të ri do të ushtrojnë një ndikim vendimtar në organizimin, përzgjedhjen dhe menaxhimin e administrimit të pronës së vakëfeve dhe kujdesit të rregullimit të popullatës myslimane në vend. Por, pa marrë parasysh rrethanat dhe situatën kaotike gjatë këtyre periudhave, organet e Bashkësisë Islame nuk do të qëndrojnë duarlidhur, por do të zhvillojnë një aktivitet të bujshëm pa kursyer asgjë në ngritjen dhe zhvillimin e arsimit dhe shkollave gjatë tërë etapave historike të organizimit të myslimanëve në këto anë dhe të idealeve të larta për ngritjen kulturo-arsimore dhe fetare të popullit mysliman.

¹¹⁹ <https://pescanik.net/muslimani-i-raspad-sfrj/>

2. Organizimi institucional i Bashkësisë Islame në Republikën e Maqedonisë

Organizimi dhe roli i Bashkësisë Islame në Republikën e Maqedonisë, si shtet i pavarur i organizuar, fillon me përfundimin e të ekzistuarit si shtet të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Fundi i viteve 1980-të dhe fillimi i viteve 1990-të u shënuan nga ngjarje të mëdha historike, të cilat lanë gjurmë në ndryshimet e sistemeve dhe pushteteve të ndryshme. Shembja e murit të Berlinit shënoi në mënyrë simbolike përfundimin dhe largimin e komunizmit nga skena politike, të cilën Jugosllavia, megjithëse nuk ishte dukshëm e ndryshme nga rendi shtetëror e politik nga vendet tjera komuniste, nuk mund ta shmange. Në një periudhë kur ish udhëheqësit komunistë u bënë nacionalistët më të mëdhenj, shpartallimi i RSF të Jugosllavisë në trojet e tij ishte i pashmangshëm¹²⁰.

Qëndrimi i Bashkësive Fetare në RSF të Jugosllavisë mbi ekzistencën ose mosekzistencën e tyre ishte shumë domethënëse. Kur bëhet fjalë për Bashkësinë Fetare të myslimanëve, të cilët jetonin në trojet e RSF të Jugosllavisë, veçanërisht në Republikën e Maqedonisë dhe të republikave tjera në kuadër të RFS të Jugosllavisë, deklaratat e udhëheqësve të lartë dhe të institucioneve zyrtare të Bashkësisë Islame për një bashkësi unike nuk do të realizohen.

Me pavarësimin e Republikës së Maqedonisë u pavarësuan të gjitha organet e atëhershme kolektive. Së këndejmi, kjo ndodhi edhe me Bashkësinë Islame në Republikën e Maqedonisë, akt ky që e detyroi ëndhëheqësin e atëhershme të Bashkësisë Islame në Republikën

¹²⁰ Edin, Radušić, *Stav Islamske zajednice prema raspadu Jugosllavije*, Prilozi, 36, Sarajevo, 2007, fq. 197.

e Maqedonisë ta përshpejtojë edhe ngritjen e këtij institucioni në pozitën kushtetutare¹²¹.

Në vitin 1991 filluan përpjekjet për rregullimin e organeve dhe funksionimin e Bashkësisë Islame në Republikën e Maqedonisë si institucion më i lartë i organizimit fetar të myslimanëve në këtë vend, edhe pse deri atëherë Bashkësia Islame për myslimanët ishte e organizuar, por ishte nën organizimin e përbashkët me Bashkësinë Islame të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë.

Me formimin e organeve të pa varura të Bashkësisë Islame në Republikën e Maqedonisë, në vitin 1994 organet e Bashkësisë Islame do ta miratojnë Kushtetutën e parë të Bashkësisë Islame në Republikën e Maqedonisë. Kështu ky organizim, në baza ligjore, do të riorganizohet gjatë viteve 2003 dhe 2008.

3. Roli i Bashkësisë Islame në Republikën e Maqedonisë

Bashkësia Islame është organizatë fetare e të gjithë myslimanëve të cilët jetojnë në hapësirën e Republikës së Maqedonisë së Veriut pa marrë parasysh përcaktimin e tyre etnik dhe shprehjen e tyre gjuhësore.

Është institucion kompetent dhe përgjegjës për zhvillimin e jetës fetare mbi baza të shëndosha islame;

Ajo e organizon mbarrëvajtjen e punëve fetare të besimtarëve dhe përcakton detyrat dhe obligimet e tyre.

¹²¹ Fjala e Reisul Ulemasë, H. Sulejman ef. Rexhepi, në tryezën shkencore “80 vjet të kushtetutshmërisë së BFI-së”, mbajtur më 5 Nëntor 2019, në FSHI-Shkup, Shkup, 2017, fq. 7.

Bashkësia Islame mbron dhe kultivon thesarin e çmueshëm të vlerave morale, sociale, ekonomike, kulturore, arsimore etj, të pjesëtarëve të saj.

Ajo i përfaqëson myslimanët e këtij nënqielli në vend dhe jashtë dhe i mbron interesat e tyre në të gjitha sferat e jetës.

Prej paraqitjes së Islamit në trojet Ballkanike, myslimanët që jetojnë në Republikën e Maqedonisë, pandërprerë kanë qenë një tërësi shpirtërore islame e pandarë, të cilët kanë trashëguar mësimet fetare nga Kur'ani Famëlartë dhe Sunneti i Muhammedit, paqja dhe mëshira e Zotit qoftë mbi te.

Organizimi i jetës fetare gjatë kohës së Perandorisë Osmane ka qenë i organizuar nën juridiksionin e Shejhul-Islamit në Stamboll, ndërkaq pas luftërave ballkanike, respektivisht pas Luftës së Parë Botërore, jeta fetare e myslimanëve ishte nën juridiksionin e Reisul Ulemasë me seli në Sarajevë. Përndryshe, Bashkësia Islame e Republikës së Maqedonisë ishte pjesë përbërëse e Bashkësisë Islame në Mbretërinë Jugosllave dhe më pas në Republikën Federative Socialiste të Jugosllavisë. Pas shpërbërjes së bashkësisë shtetërore të mëparshme dhe me mëvetësimin e Republikës së Maqedonisë, Bashkësia Islame vazhdon të veprojë si bashkësi fetare e pavarur në Republikën e Maqedonisë dhe këtë e dëshmoi me miratimin e Kushtetutës së Bashkësisë Islame në vitin 1994.

Bashkësia Islame është organizatë e vetme, e cila organizon jetën fetare të myslimanëve në vend dhe jashtë.

Bashkësia Islame është e pavarur në organizimin e jetës fetare, në edukimin dhe arsimimin fetar, në vakëfet, veprimtarinë administrativo-financiare, si dhe në veprimtaritë tjera që burojnë nga ligjet dhe rregullat e Kushtetutës, rregulloreve dhe akteve të tjera.

4. Organizimi institucional i Bashkësisë Islame në Republikën e Maqedonisë gjatë viteve 1992–2008

Me fillimin e destabilizimit politik në RSF të Jugosllavisë, do të fillojë edhe interesimi për riorganizimin institucional të Bashkësisë Islame dhe atë duke u mbështetur në aktet ligjore të miratuara nga organet legjitime–ligjdhënëse të Bashkësisë Islame, si:

- *Organizimi i Bashkësisë Islame gjatë viteve 1990–1992;*
- *Organizimi i Bashkësisë Islame gjatë viteve 1992–1994;*
- *Organizimi i Bashkësisë Islame gjatë viteve 1994–2003;*
- *Organizimi i Bashkësisë Islame gjatë viteve 2003–2008;*

a. Organizimi i Bashkësisë Islame gjatë viteve 1990–1992

Me miratimin e Kushtetutës së vitit 1990, të cilën do ta miratojë Kuvendi Suprem i Bashkësisë Islame të Republikës Federative Socialiste të Jugosllavisë më 12 Prill 1990¹²², Bashkësia Islame e Republikës së Maqedonisë do të jetë ende pjesë përbërëse e organizimit të Bashkësisë Islame të RFS të Jugosllavisë, në të cilën Kuvendi i Bashkësisë Islame të Republikës së Maqedonisë do të përfaqësohet me nëntë anëtarë në Kuvendin Suprem të Bashkësisë Islame të RFS të Jugosllavisë.

Në bazë të formës organizative, Kushtetuta e Bashkësisë Islame në kreun IV– ORGANIZIMI I BASHKËSISË ISLAME, nën nenin 18, Organet e Bashkësisë Islame janë:

- *Këshilli i Bashkësisë Islame;*
- *Muftinitë e Bashkësisë Islame;*
- *Kuvendet e Bashkësisë Islame;*

¹²² Muhamed, Salkić, Ustavi islamičke zajednice, Sarajevo, 1422/2001, fq. 289,

- *Meshihatet e Bashkësinë Islame;*
- *Kuvendi Suprem i Bashkësisë Islame;*
- *Rijaseti i Bashkësisë Islame dhe*
- *Reis-ul-Ulemaja*¹²³.

b. Organizimi i Bashkësisë Islame gjatë viteve 1992–1994

Në bazë të Nenit 31, paragrafi 1, pika 1, të Kushtetutës së Bashkësisë Islame të RSF të Jugosllavisë¹²⁴, Kuvendi i Bashkësisë Islame të Republikës së Maqedonisë, në kuadër të kompetencave të veta, në mbledhjen e mbajtur më 15 gusht 1992 në Shkup do ta miratojë Statutin e Bashkësisë Islame në Republikën e Maqedonisë.

Në bazë të këtij Statutit në kreun IV – ORGANIZATA DHE STRUKTURA E BASHKËSISË ISLAME, në nenin 22 do të parashihen këto organe të Bashkësisë Islame:

- *Këshillat e Bashkësisë Islame;*
- *Muftinitë;*
- *Meshihati i Bashkësisë Islame dhe*
- *Kuvendi i Bashkësisë Islame*¹²⁵.

c. Organizimi i Bashkësisë Islame gjatë viteve 1994–2003

Në këtë periudhë kohore më 18 dhjetor 1994 në lokalet e Meshihatit të Bashkësisë Islame në Shkup, Kuvendi i Bashkësisë Islame me tekbirë do ta miratojë Kushtetutën, e cila paraqet një akt historik për pjesëtarët e besimit islam në Republikën e Maqedonisë.

¹²³ Muhamed, Salkić, Ustavi islamike zajednice, Sarajevo, 1422/2001, fq. 289,

¹²⁴ Muhamed, Salkić, Ustavi islamike zajednice, Sarajevo, 1422/2001, fq. 299,

¹²⁵ Statuti i Bashkësisë Islame të Republikës së Maqedonisë, i miratuar më 15 Gusht 1992, Shkup, 1992, fq. 295.

Përmes kësaj Kushtetute parashihet një riorganizim plotësisht i ri i punës së këtij institucioni, nga i cili priten ndryshime rrënjësore dhe kualitative, të cilat në të ardhmen do të mundësojnë që feja islame të zë vendin e merituar në shoqërinë islame të këtushme.

Është me rëndësi të theksohet se aprovimi i kësaj Kushtetute shpreh edhe ndarjen praktike nga organizata e dikurshme që i lidhte bashkësitë islame të ish-Jugosllavisë¹²⁶.

Struktura organizative në aspektin administrativ të Bashkësisë Islame në Republikën e Maqedonisë nga miratimi i Kushtetutës së vitit 1994, në kreun V – ORGANIZIMI I BASHKËSISË ISLAME, në nenin 27 parasheh këto organe:

- *Muftinitë e Bashkësisë Islame;*
- *Mexhlisi përfaqësues juridiko–financiar;*
- *Mexhlisi Shura dhe*
- *Kryetari i Bashkësisë Islame;*

d. Organizimi i Bashkësisë Islame gjatë viteve 2003–2008

Me ndryshimet të cilat do të ndodhin në vitin 2000, e sidomos me ndryshimet të cilat do të bëhen në udhëheqësin e porsazgjedhur të Bashkësisë Islame, do të ngrihet edhe iniciativa për ndryshim të akteve dhe rregulloreve të këtij institucioni. Në rend të parë do të formohet komisioni për ndryshimin e Kushtetutës së Bashkësisë Islame të Republikës së Maqedonisë.

Në bazë të nenit 64 alineja 4 dhe 5 të Kushtetutës së Bashkësisë Islame në Republikën e Maqedonisë, Mexhisi Shura dhe Mexhlisi përfaqësues Juridiko–financiar të Bashkësisë Islame në Republikën

¹²⁶ Hëna e Re, *U miratua Kushtetuta e BI në RM*, viti IX, nr. 91-92, 1 Janar 1995, Shkup, fq. 5

e Maqedonisë, në mbledhjen e rregullt të përbashkët të mbajtur më 29 maj 2002, do të marrin këtë:

VENDIM për shpalljen e amendamenteve për ndryshimin e preambulës dhe nenit 14 të Kushtetutës së Bashkësisë Islame në Republikën e Maqedonisë¹²⁷.

Struktura organizative në aspektin administrativ të Bashkësisë Islame në Republikën e Maqedonisë nga miratimi i Kushtetutës së vitit 2003, në kreun V – ORGANIZIMI I BASHKËSISË ISLAME, neni 24 organet e Bashkësisë Islame do të jenë:

- *Këshilli i xhematit;*
- *Muftinia në vend dhe jashtë;*
- *Kuvendi i Muftinisë;*
- *Rijaseti i Bashkësisë Islame;*
- *Reisul-Ulema;*
- *Kuvendi i Bashkësisë Islame dhe*
- *Këshilli Kushtetues¹²⁸;*

e. Organizimi institucional dhe kompetencat e organeve të Bashkësisë Islame me Kushtetutën e vitit 2008

Në vitin 2007 do u jepen fund të gjitha ndodhjet dhe destabilizimi, i cili do të përfshijë gati të gjitha strukturat dhe organet e Bashkësisë Islame dhe me ndryshimet të cilat do të ndodhin në këtë vit, e sidomos me ndryshimet të cilat do të bëhen në udhëheqësin e porsazgjedhur të Bashkësisë Islame, do të ngrihet edhe iniciativa për ndryshimin e Kushtetutës së Bashkësisë Islame të Republikës së Maqedonisë. Kështu në mbledhjen e mbajtur më 24 korrik të vitit

¹²⁷ Arkivi i Bashkësisë Islame, akti nr. 02-325, me datë 17. 06. 2002.

¹²⁸ Kushtetuta e Bashkësisë Fetare Islame të Republikës së Maqedonisë, Shkup, 25 dhjetor 2003, fq. 9.

2008, në lokalet e Fakultetit të Shkencave Islame në Shkup, me një pikë të rendit të ditës “Ndryshimet e Kushtetutës 2003”, ajo do të miratohet nga të gjithë të pranishmit¹²⁹.

Struktura organizative në aspektin administrativ të Bashkësisë Islame në Republikën e Maqedonisë nga miratimi i Kushtetutës së vitit 2008, në kreun V – ORGANIZIMI I BASHKËSISË ISLAME, neni 24, organet e Bashkësisë Islame do të jenë:

- *Muftinia;*
- *Rijaseti i Bashkësisë Fetare Islame;*
- *Reis ul Ulema dhe*
- *Kuvendi i Bashkësisë Fetare Islame*¹³⁰.

Për shkak të përkufizimit të temës dhe të pamundësisë të paraqitjes së kompetencave të organeve të Bashkësisë Islame nga miratimi i të gjitha kushtetutave, asaj të vitit 1994, 2003 dhe 2008, në këtë punim jemi përcaktuar që të paraqesim vetë kompetencat e organeve të organizimit të Bashkësisë Islame sipas Kushtetutës së miratuar më 24 korrik të vitit 2008 dhe atë duke filluar nga:

KREU V

ORGANIZIMI I BFI-së

Neni 23

BFI ka organet dhe institucionet e veta.

¹²⁹ Arkivi i Bashkësisë Islame, akti nr. 03-610, me datë 29. 07. 2008.

¹³⁰ Kushtetuta e Bashkësisë Fetare Islame e Republikës së Maqedonisë, Shkup, 24 korrik 2008, fq. 9.

Neni 24

Organet e BFI-së janë:

- *Muftinia,*
- *Rijaseti i BFI-së,*
- *Reis ul Ulema dhe*
- *Kuvendi i BFI-së.*

Neni 25

Të gjitha organet kolektive të BFI-së punojnë në seanca nëse në to marrin pjesë shumica e antarësisë nga numri i përgjithshëm, kurse vendimet i sjellin me shumicë të votave të anëtarëve prezentë, por jo më pak se 1/3 e numrit të përgjithshëm të organit përkatës, nëse nuk përcaktohet ndryshe me këtë Kushtetutë dhe me aktet tjera normative.

Neni 26

Thirrja e përfaqësuesit të Rijasetit nëpër seancat e organeve, shoqatave dhe institucioneve të BFI-së është e obliguar.

Muftinia

Neni 27

Muftinia është organ themelor i Bashkësisë Islame. Organi i Muftinisë numëron prej pesë deri në pesëmbëdhjetë anëtarë, varësisht nga numri i organeve ndihmëse të saj, pra xhematëve në territorin përkatës. Numrin e anëtarëve të Muftinisë, për çdo muftini e cakton Rijaseti. Në organin e Muftinisë më së paku 1/3 e anëtarëve duhet të jetë nga xhemati. Organi i Muftinisë përbëhet nga Muftiu, Kryeimami dhe Sekretari sipas pozitës, 2/3 prej tyre propozohen nga Mexhlisi i xhematit, kurse 1/3 prej tyre caktohen nga Myftiu.

Të propozuarit në mënyrë proporcionale, duhet të mbulojnë terri-torin e Muftinisë. Mandati i anëtarëve të zgjedhur zgjatë katër vjet.

Neni 28

Xhemati është grup besintarësh ku organizohet jeta fetare: në bashkësi, në vend të caktuar, në territor të caktuar dhe realizon detyrat dhe të drejtat e veta konform kësaj Kushtetute dhe akteve të tjera normative. Xhemati përbëhet prej të gjithë besintarëve që kanë arritur moshën tetëmbëdhjetëvjeçare e që janë anëtarë të të njëjtit xhemat. Këshilli i xhematit është trup ndihmës i muftinisë. Mexhlisin e xhematit e përbëjnë: nëpunësit fetar të muftinive, mu-tevelinjte e xhamive dhe të punësuarit në operativën e Muftinisë. Mexhlisi i xhematit është kuorum i gjerë konsultativ i Muftinisë. Me mbledhjen e Mexhlisit të xhematëve udhëheq Muftiu.

Neni 29

Me Muftininë udhëheq Muftiu. Kryeimami emërohet nga Reis ul Ulemaja me propozim të Muftinisë. Muftiu dhe Kryeimami, duhet të jen me arsimim sipëror islam dhe me përvojë pune së paku pesë vjet në radhët e BFI-së. Në muftinitë ku nuk ka kuadër sipas kushteve të parapara, emërohet koordinator.

Neni 30

Muftinia kandidon kandidatë të mundshëm për mufti, Rijaseti i BFI-së bën emërtimin e muftive, kurse Reis ul Ulema verifikon emërtimin dhe u lëshon Murasele. Mosdhënia dhe tërheqja e Muraseles obligon Muftininë në afat prej tridhjetë ditë të propozon kandidatë të mundshëm për mufti. Muftiu përgjigjet vetëm para Reis ul Ulemasë. Muftiu është personaliteti më i lartë në territorin e Muftinisë dhe e përfaqëson atë në territorin e vet. Nënshkruan aktet e Muftinisë dhe i obligon shërbimet fetare për zbatim.

Neni 31

Muftinia:

- zbaton vendimet e Rijasetit dhe të organeve më të larta të BFI-së;
- kujdeset për mbarëvajtjen e punëve dhe të jetës fetare në terri-
torin e vet;
- siguron mjete për funksionimin e BFI-së;
- propozon Rijasetit buxhetin dhe llogarinë përfundimtare të
Muftinisë;
- paraqet raport dhe program vjetor për punën e vet para Rijasetit
të BFI-së;
- mbikëqyr drejtpërdrejtë punën e nëpunësve fetarë në territorin e
vet;
- propozon emërimin dhe shkarkimin e nëpunësve të Muftinisë;
- kujdeset për realizimin e detyrave ndaj organeve dhe institucio-
neve të BFI-së;
- i propozon Rijasetit të BFI-së formimin e xhematit të ri dhe
ndërtimin e xhamisë së re;
- informon Mexhlisin e Xhemateve për punën e vet;
- udhëheq me pasurinë e tundshme dhe të patundshme në terri-
torin e vet sipas rregullores gjegjëse;
- bashkëpunon me shërbimin e vakëfeve për ruajtjen, kultivimin
dhe ekonomizimin e të mirave të saj;
- propozon themelimin e institucioneve arsimore. Muftinitë kanë
shërbimet e veta profesionale. Muftinitë formojnë komisione të
veta të përkohshme dhe të përhershme.

Neni 32

Muftinia mban mbledhje të rregullta më së paku një herë në muaj.
Mbledhjen e Muftinisë e konvokon Muftiu, në raste të veçanta, atë

e konvokon, me kërkesë të Rijasetit të BFI-së dhe të një të tretës së anëtarëve të Muftinisë.

Neni 33

Detyrat dhe obligimet e tjera të Muftinisë, xhematit dhe Mexhllisit të xhemateve përcaktohen me rregullore të veçantë.

Rijaseti i BFI-së

Neni 34

Rijaseti i BFI-së është organ i cili vendos për çështje islamike. Rijaseti i BFI-së përbëhet prej Reis ul Ulemasë, Sekretarit të Përgjithshëm të BFI-së, muftinjve, drejtorëve dhe dekanëve të institucioneve arsimore, kryetarëve të shoqatave të Bashkësisë Fetare Islame dhe dy anëtarëve të caktuar nga ana e Reis ul Ulemasë me përvojë në organizimin e jetës fetare në radhët e BFI-së.

Neni 35

Fushëveprimi i Rijasetit të BFI-së në vend dhe jashtë:

- Organizimi i jetës fetare;
- Zhvillimi i njohurive edukativo-arsimore, kulturoro-shkencore dhe informative;
- Ndërtimi dhe mirëmbajtja e objekteve islame;
- Strukturën organizative dhe veprimtarinë e organeve të BFI-së;
- Bashkëpunimi me organizatat dhe institucionet islame në botë;
- Puna juridiko-administrative dhe financiaro-ekonomike.

Neni 36

Rijaseti i Bashkësisë Fetare Islame:

- Propozon, zgjedh dhe shkarkon Reis ul Ulemanë;

- cakton numrin e muftinive dhe bën emërimin e muftive;
- emëron Sekretarin e Përgjithshëm me propozim të Reis ul Ulemasë;
- zgjedh anëtarë të komisionit disiplinor dhe prokurorin publik të BFI-së;
- formon komisione dhe këshilla të përthshme dhe të përthshme;
- verifikon mandatet dhe shpall zgjedhjet e rregullta dhe të parathshme;
- kujdeset për jetën e përgjithshme fetare dhe veprimtarinë e BFI-së të mbështetur mbi parimet e Sheriatit dhe në përputhshmëri me sistemin juridik të BFI-së;
- organizon dhe autorizon kuadrin fetar në diasporë;
- mbikëqyr punën e organeve, enteve dhe institucioneve;
- miraton plan-programet e institucioneve edukativo- arsimore si dhe programet dhe tekstet e mësim-besimit;
- angazhohet për mbrojtjen e të drejtave fetare të myslimanëve;
- themelon ente dhe institucione;
- sjell vendim për themelimin e vakëfit;
- sjell vendim për ndërrimin e pasurisë së vakëfit, në bazë të propozimit të organit gjegjë, nëse është në pajtueshmëri me rregullat e Sheriatit
- vendos për ankesat e organeve më të ulta BFI-së;
- i propozon Kuvendit planin vjetor financiar dhe llogarinë përfundimtare për miratim;
- organizon grumbullimin e mjeteve nga zeqati, sadekatul-fitrit dhe të hyrave të tjera;
- është organizator kryesor dhe i vetëm në realizimin e kryerjes së Haxhit dhe Umrës;
- emëron, ndërron dhe shkarkon nëpunës të Rijasetit;

- lejon rregullat e tarikateve, mbikëqyrë punën e tyre dhe verifikon zgjedhjen dhe emërimin e shehlerëve;
- lejon botimin e literaturës Islame;
- në kushte të jashtëzakonshme kryen edhe detyra të organeve të tjera.

Rijaseti i BFI-së mban mbledhje së paku njëherë në muaj.

Mbledhjen e Rijasetit të BFI-së e konvokon dhe e udhëheq Reis ul Ulemaja, në raste të veçanta atë e konvokon me kërkesë të 1/3 të anëtarëve të Rijasetit.

Neni 37

Rijaseti ka shërbimet e veta profesionale.

Rijaseti formon komisione të përhershme dhe të përkohshme.

Reisul-Ulema,

Neni 38

Reis ul Ulema është organ dhe kryepar i BFI-së.

Neni 39

Reis ul Ulema përfaqëson unitetin fetarë të pjesëtarëve të Islamit.

Neni 40

Reis ul Ulema, sipas nevojës ka të drejtë të thërrasë mbledhje me të gjitha organet, institucionet, organizatat dhe shoqatat e BFI-së.

Neni 41

Për Reis ul Ulema mund të propozohen dhe të zgjedhen personat të cilët kanë të kryer fakultete islame, që kanë përvojë pune të suk-

sesshme dhjetëvjeçare në radhët e BFI-së dhe kanë moshë mbi dyzetvjeçare.

Neni 42

Zgjedhja e Reis ul Ulemasë behet konform Rregullores mbi zgjedhje të Reis ul Ulemasë.

Neni 43

Rijaseti i BFI-së zgjedh Këshill të posaçëm për dorëzimin e Menshurës.

Neni 44

Reisul-Ulema:

- përfaqëson Bashkësinë Fetare Islame në vend dhe jashtë;
- jep murasele (autorizim) për kryerjen e punëve fetare, pa të cilën tërheq kontest të legjitimitetit;
- emëron dekanët, drejtorët dhe mësimdhënësit të institucioneve arsimore të BFI-së dhe mësimdhënësit e lëndës së mësim-besimit në shkollat publike;
- organizon dhe mbikëqyr punën e shërbimeve profesionale të BFI-së;
- konvokon dhe udhëheq seancat e Rijasetit dhe kujdeset për zbatimin e vendimeve të tij;
- ndërmon dy mbledhjeve të Rijasetit, kryen punë të domosdoshme që janë në kompetencë të Rijasetit dhe për këtë informon Rijasetin në seancën e radhës;
- nënshkruan aktet e Rijasetit;
- nënshkruan aktet për punësim në BFI;

- viziton regjionet në të cilët jetojnë pjesëtarët e fesë islame; që të njihet drejtpërdrejtë me gjendjen dhe propozon masa për zhvillimin dhe avansimin e jetës fetare;
- lejon pushimet e muftive, dekanëve, drejtorëve të medreseve, drejtorëve dhe kryetarëve të institucioneve, shoqatave të cilat janë në mbikëqyrje të Rijasetit;
- ka të drejtë të pengojë ekzekutimin e vendimeve të organeve dhe të institucioneve të BFI-së nëse konstaton se të njëjtat janë kundërshtim me parimet islame dhe të njëjtat t'i kthejë në rishqyrtim, kurse vendimin përfundimtar e sjell Rijaseti i BFI-së.
- dekreton vendimet e marrura nga Rijaseti i BFI-së.

Kuvendi i BFI-së

Neni 45

Kuvendi i Bashkësisë Fetare Islame është organ më i lartë juridiko-finansiar.

Neni 46

Kuvendin e BFI-së e përbëjnë njëzet e shtatë anëtarë:

- nga Shkupi pesë;
- nga Tetova katër;
- nga Gostivari tre;
- nga Kumanova dy;
- nga Kërçova dy;
- nga Dibra dy;
- nga Struga dy;
- nga Shtipi dy;
- nga Manastiri një;
- nga Velesi një;

- nga Ohri një;
- nga Prilepi një dhe
- nga Resnja një.

Neni 47

Të deleguarit për anëtarë të Kuvendit të BFI-së nga ana e organit të Muftinisë bëhet përmes sistemit një plus një sipas rregullores së veçantë për Kuvendin.

Neni 48

Anëtarët e Kuvendit të BFI-së me 2/3 duhet të jen me arsimin sipëror nga profilet juridiko-administrativo-ekonomik.

Neni 49

Kuvendi i BFI-së:

Në mbledhje të përbashkët me Rijasetin e BFI-së miraton Kush-tetutën e BFI-së, ndryshimet dhe plotësimin e saj.

- miraton plan-programin vjetor dhe raportin e punës së Rijasetit të BFI-së;
- miraton planin financiar dhe llogarinë përfundimtare të Rijasetit të BFI-së;
- verifikon miratimin e planeve financiare dhe të llogarive përfundimtare të muftinive të BFI-së;
- miraton rregulloren për punë të Kuvendit të BFI-së si dhe akte të tjera normative të BFI-së;

Neni 50

Kuvendi i BFI-së punon në seanca. Seancat e Kuvendit të BFI-së mbahet më së paku një herë në vit. Në mbledhjen e parë konsti-

tuive Kuvendi zgjedh kryetarin dhe nënkryetarin e vet. Me seancat e Kuvendit të BFI-së udhëheq Kryetari i Kuvendit të BFI-së. Kryetari i Kuvendit është i detyruar të konvokojë seancë të Kuvendit të BFI-së me kërkesë të Reis ul Ulemasë, Rijasetit të BFI-së dhe me kërkesës të 1/3 së anëtarëve të Kuvendit të BFI-së.

Neni 51

Mandati i Kuvendit të BFI-së zgjat katër vjet¹³¹.

3. Roli dhe qëllimet e Bashkësisë Islame në realizimin e detyrave dhe obligimeve të saja

Bashkësia Islame permanent do të angazhohet në:

Që pjesëtarëve të saj t'ua ruaj dhe kultivojë moralin fetar dhe në mesin e tyre ta përhap atë, e pastaj t'i avancojë në aspektin kulturor.

Të ua ruaj pronën e Bashkësisë Islame, vakëfeve, e cila shërben vetëm për qëllimet e saja. Me të, në mënyrë të pavarur administron dhe dispozicionon Bashkësia Islame përmes organeve të veta pronësore-administrative dhe fetare.

Roli kryesor është ta rruaj dhe ta zhvilloj jetën fetare ndër pjesëtarët mysliman.

Organizimin e jetës fetare ta zhvilloj në bazë të normave fetare si dhe në të kuptuarit e islamit sipas të arriturave bashkëkohore, shkencore në frymën islame.

Bashkësia Islame nëpër mes institucioneve të saja e sidomos nëpër xhanitë si institucione themelore për zhvillimin e jetës fetare dhe fetare-arsimore, përveç faljen e namazeve do të organizoj, ligjërata

¹³¹ Kushtetuta e Bashkësisë Fetare Islame e Republikës së Maqedonisë, Shkup, 24 Korrik 2008, fq. 9-17.

dhe zhvilloj aktivitete të ndryshme që shërbejnë në përparimin e jetës fetare dhe fetare–arsimore.

Bashkësisë Islame, do të luaj rol të veçantë që nëpërmjet zyrtarëve të sajë mësimin fetarë si për të miturit ashtu edhe për të rritur që nëpërmjet të këtij mësimi të barten njohurit themelore të islamit dhe mësimet për ritualet fetare.

Pjesën më të madhe të organizimit të jetës fetare dhe realizimit të mësim–besimit fetarë zhvillojnë punonjësit e Bashkësisë Islame.

Njëra nga detyrat parësore të Bashkësisë Islame është që ti shkolloj pjesëtarët e sajë dhe t'i përgatit për kryerjen e detyrave obligimeve fetare të tyre. Kjo do të arrihet me angazhimin e mualimve nëpër mektepe.

Arsimimi fetarë është njëri nga obligimet parësore të Bashkësisë Islame, për të cilën ajo do të themeloj institucione fetaro–arsimore, medrese e fakultete.

Bashkësia Islame ka dhe qëllimet e saja të cilat edhe në kushtetutën e sajë janë evidente ne nenet në vijim:

Neni 6

Qëllimi i BFI–së është ngritja e vetëdijes fetare, organizimi i kryerjes së ibadeteve si dhe format e tjera me të cilat shprehen ndjenjat dhe jetësimi i Islamit te muslimanët.

Neni 7

BFI qëllimet e veta i realizon përmes:

- mësimin dhe kultivimit të vlerave islame;
- themelimit dhe mirëmbajtjes së xhamive, mesxhideve, qendrave islame, teqeve dhe mektebeve;

- themelimit dhe veprimt të institucioneve edukativo–arsimore;
- themelimit dhe veprimt të institucioneve shkencorë– kulturore;
- themelimit dhe mirëmbajtjes së bibliotekave, hanikaheve, arki–vave, muzeve; instituteve dhe institucioneve të ndryshme;
- themelimit dhe mirëmbajtjes së varrezave;
- themelimit dhe veprimt të institucioneve bamirëse;
- themelimit të vakëfeve, mirëmbajtjes dhe mbrojtjes së pronës së BFI–së;
- promovimit të së mirës dhe luftës kundër së keqes;
- organizimit të veprimtarisë botuese;
- kultivimit dhe bashkëpunimit tradicional me të gjitha bashkësitë islame; institucionet, asociacionet dhe organizatat e ndryshme në botë, të cilat kultivojnë vlera islame;
- bashkëpunimit me bashkësitë tjera fetare, organizatat joqeveritare dhe organet shtetërore në vend, dhe
- përmes çdo veprimtarie fetare, kulturore, shkencore, shëndetësore dhe socio–ekonomike për avansimin e popullatës muslimane.

Neni 8

BFI veprimtarinë e vet e mbështetë në parimet e:

- drejtësisë;
- transparencës;
- debateve para sjelljes së vendimeve në organet kolektive;
- konsultave në kryerjen e punëve;
- zgjedhjeve, emërtimeve, përgjegjësi dhe shkarkimeve të funksionarëve¹³².

¹³² Kushtetuta e Bashkësisë Fetare Islame e Republikës së Maqedonisë, Shkup, 24 Korrik 2008, fq. 4-5.

Përfundimi

Bashkësia Islame në këto anë do të përjetojë periudha të ndryshme të sistemeve dhe pushteteve, të cilat do të sundojnë në këto vende. Këto periudha do të lënë gjurmë të pashlyera në organizmin e institucioneve të Bashkësisë Islame, e në veçanti në uzurpimin e pronave dhe institucioneve të ndryshme të Bashkësisë Islame.

Periudhat dhe zhvillimin organizativ të Bashkësisë Islame, në bazë të analizave të zhvillimeve në periudhën midis Luftërave Ballkanike deri në Luftën e Parë Botërore në viset e Ballkanit, janë fazat në të cilat do të kalitej organizimi i Bashkësisë Islame. Atë mund ta ndajmë në:

- Periudha pas shpartallimit të Perandorisë Osmane;
- Periudha gjatë viteve 1918–1929;
- Periudha gjatë viteve 1930–1941;
- Periudha gjatë viteve 1945–1991 dhe
- Periudha gjatë viteve 1992–194;

Periudha gjatë shpartallimit të Perandorisë Osmani është faza e parë, e cila njihet si periudhë në të cilën fati i myslimanëve dhe Bashkësisë Islame do të përcaktohet nga marrëveshjet ndërkombëtare dhe konferencat e paqes.

Periudha gjatë viteve 1918–1929 është faza e dytë, e cila njihet me emrin Mbretëria Serbe–Kroate–Sllovene, një periudhë e cila për myslimanët do të jetë periudha më e vështirë e organizimit të Bashkësisë Fetare Islame.

Periudha 1930–1941 është faza e organizimit Kushtetues të Bashkësisë Islame e cila njihet me emrin Mbretëria Jugosllave, pe–

riudhë kjo kur do të riorganizohen organet e Bashkësisë Islame, duke u mbështetur në Kushtetutën e posa miratuar¹³³.

Me përfundimin e diktuarës së 6 janarit të regjimit në Mbretërinë Jugosllave u paralajmërua një situatë më e volitshme për Bashkësinë Fetare Islame. Me miratimin e Kushtetutës së Bashkësisë Islame më 25 mars të vitit 1936, do të bëhet edhe kthimi i selisë së Reisul Ulemasë prej Beogradi në Sarajevë¹³⁴.

Periodha gjatë viteve 1945–1992 është periodha e cila njihet me emrin RSF e Jugosllavisë, e cila për myslimanët do të jetë një ndër periodhat më të vështirë, sepse me sistemin e sajë komunist do të jetë në ndjekje dhe persekutime politike të shumë krerëve fetarë, e sidomos me uzurpimin dhe marrjen e pronave të mëdha vakëfeve.

Dhe, në fund, vjen periodha e cila njihet si periodhë postkomuniste, me pavarësimin e Republikës së Maqedonisë. Ajo është periudha tridhjetëvjeçare që e përjeton Bashkësia Islame e Republikës së Maqedonisë. Edhe pse edhe në këtë periudhë të organizimit të Bashkësinë Islame janë regjistruar përpjekje për destabilizim organizativ dhe përçarje të institucionit të Bashkësisë Islame, megjithatë Bashkësia Islame edhe ia ka dalë të qëndrojë e fortë dhe e paluhatur në aspektin organizativ dhe funksional.

Burimet dhe literatura:

Burimet:

1. Arkivi i Bashkësisë Islame të RM–Shkup.
2. Statuti i Meshihatit të Bashkësisë Islame të Republikës së Maqedonisë, Shkup, 1992.

¹³³ Muhamed, Salkić, *Ustavi islamičke zajednice*, Sarajevo, 1422/2001, f. 83,

¹³⁴ Muhamed, Salkić, *Ustavi islamičke zajednice*, Sarajevo, 1422/2001, f. 118,

3. Kushtetua e Bashkësisë Islame në Republikës së Maqedonisë, Shkup, 1994.
4. Kushtetuta e Bashkësisë Fetare Islame e Republikës së Maqedonisë, Shkup, 2003.
5. Kushtetuta e Bashkësisë Fetare Islame e Republikës së Maqedonisë, Shkup, 2008.

Literatura:

1. Radušić, Edin, *Stav Islamske zajednice prema raspadu Jugoslavije*, Prilozi, 36, Sarajevo, 2007.
2. Bećirbegović, Edah, *Organizacija Islamske zajednice u SFRJ*, Sarajevo, 1981.
3. Salkić, Muhamed, *Ustavi islamske zajednice*, Sarajevo, 1422/2001.
4. *80 Vjet Kushtetutshmërisë së BFI-së*, Shkup, 2017.

Revista:

1. Hëna e Re, viti IX, nr. 91–92, 1 Janar 1995, Shkup

Faqe interneti:

1. <https://pescanik.net/muslimani-i-raspad-sfrj/>

ISAMEDIN AZIZI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore
të Shqiptarëve – Shkup*

KONFLIKTE RRYMASH NË JETËN FETARE E POLITIKE TË SHQIPTARËVE TË MAQEDONISË

Shekulli XIX për shqiptarët shënon një epokë të re, njihet si shekulli i lëvizjeve dhe revolucioneve kombëtare, që çuan në konsolidimin e shqiptarëve si komb, në ngritjen e mëtejme të ndërgjegjes kombëtare dhe në zhvillimin e lëvizjes kombëtare. Rilindësit shqiptarë, të frymëzuar nga idetë përparimtare të iluminizmit dhe të revolucioneve evropiane, u munduan ta ngrenë në një shkallë më të lartë zhvillimin kombëtar shqiptar, që më vonë çoi në lindjen e nacionalizmit, një lëvizje karakteristike për historinë moderne të të gjithë popujve dhe për krijimin e shteteve kombëtare në atë periudhë.

Për dallim nga shqiptarët, popujt e tjerë të Ballkanit, që ishin pjesë e besimeve të krishtera, përfituan nga antagonizmi fetar me sundimtarët osmanë dhe e përdorën kishën si forcë ideologjike në luftën për krijimin e shteteve të tyre nacionale. Për shqiptarët, të cilët u përkisnin të tria besimeve, nuk mund të bëhej fjalë për këtë antagonizëm në rrafshin fetar. Në këto kushte bashkimi i shqiptarëve në luftën për çlirim do të arrihej jashtë fesë, mbi fenë dhe i mbështetur vetëm në parimin e kombësisë. Rilindësit në këtë drejtim bënë një punë të vështirë për t'i kapërcyer ndasitë fetare dhe politikat

përçarëse, qoftë të Perandorisë Osmane, qoftë të Patrikanës së Stambollit.¹³⁵

Ideologjia e Rilindjes Kombëtare, e cila në thelbin e saj, si çdo lëvizje tjetër nacionale, kishte formimin e shtetit kombëtar, në fillimet e para të saj nuk gjeti mbështetje nga të gjitha shtresat. Perandoria Osmane, e cila ishte ndërtuar mbi parimin fetar, kishte lënë pasojat e veta, sidomos te ajo shtresë e shqiptarëve, të cilët rrezikimin e elementit fetar nga ai kombëtar e shinin si rrezikim të ekzistencës së tyre. Ky sindrom, nëse mund ta quajmë “konflikt i heshtur” ndërmjet rrymës prokombëtare e asaj proturke, i mbështjellë nën petkun fetar, i ka përcjellë shqiptarët që nga organizimet e para politike të tyre.

Diskutimet dhe debatet rreth tezës së “konflikt të heshtur” fillojnë të datojnë që nga koha e Lidhjes së Prizrenit. Përpos rrymës atdhetare shqiptare, që përfaqësohej nga Komiteti i Stambollit e që nga vëzhguesit e huaj do të llogaritet si grupimi radikal, të cilët synonin themelimin e një lidhje shqiptare ose, po ta lejonin rrethanat ndërkombëtare, të një shteti shqiptar autonom, në Lidhjen e Prizrenit mori pjesë edhe rryma sulltaniste, siç u quajt në atë kohë, që përbëhej kryesisht nga nëpunës të administratës së vilajeteve dhe klerikëve myslimanë, të cilët anonin plotësisht nga vija politike e Portës së Lartë. Ata nuk ishin për një lidhje shqiptare, por për një lidhje islamike, ku do të merrnin pjesë të gjitha popullsitë myslimane të Ballkanit.¹³⁶ Si rezultat i këtij “konflikti të heshtur” ndërmjet rrymave të përmendura, sidomos nga ndikimi i fuqishëm i qarqeve konservatore fetare në punimet e kuvendit të mbështetur edhe nga

¹³⁵ “*Historia e Popullit Shqiptar*”, Rilindja Kombëtare, vitet 30 të shek. XIX-1912, vëll. II, Tiranë, 2002, 28.

¹³⁶ “*Historia e Popullit Shqiptar*”, Rilindja Kombëtare, vitet 30 të shek. XIX-1912, vëll. II, Tiranë, 2002, 151.

delegatët boshnjakë, kërkesa e grupimit radikal shqiptar për ruajtjen e tërësisë territoriale shqiptare në dy dokumentet e miratuara nga Lidhja me 17 qershor, si Kararnameja (Akti i vendimeve – Kanuni) dhe Talimati (Urdhëresa), nuk u përfshi.¹³⁷ Pikërisht kjo mospërfshirje e kërkesës së grupimit radikal shqiptar në dy dokumentet e miratuara nga Lidhja e Prizrenit, në të cilat vërehet fryma islamike, ka ngjallur shumë debate edhe në mesin e historianëve rreth devijimit të qëllimit të Lidhjes së Prizrenit.

Prof. Gazmend Shpuza, në shkrimin e tij me titull “Lidhja Islamike që u shndërrua në Lidhjen Shqiptare” e kritikon ashpër ndikimin që kanë pasur rrymat e huaja për të përhapur idenë se Lidhja e Prizrenit nisi si “mekanizëm islamik”.¹³⁸ Konkluzioni i tij është se Lidhja e Prizrenit u konceptua dhe lindi si një organizatë mbarëshqiptare që në ditët e para të themelimit të saj dhe asnjëherë nuk u shndërrua në një të tillë. Ai e mbështet këtë qëndrim kryesisht në programin e 15 qershorit, të miratuar nga Lidhja dhe të nënshkruar nga të dyja palët (rrymat), ndërsa ai kishte të bëjë me kërkesën e shqiptarëve për autonomi. Ai po ashtu mbështetet edhe në zhvillimet politike e ushtarake që pasuan menjëherë pas mbajtjes së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.¹³⁹ Prof. Shpuza e citon autorin turk, Sylejman Kulçe, për të cilin është plotësisht e qartë dhe e padiskutueshme që këta delegatë kishin ardhur aty jo për hir të interesave të ngushta, të veçanta, por, sikur nënvizon ai, “për mbrojtjen e të drejtave të Shqipërisë” mbarë. Më tutje ai shprehet se kuvendarët e sapombledhur në Prizren deklarorin me vendosmëri: “Qoftë i mallkuar kush ndjek interesat egoiste në

¹³⁷ “*Historia e Popullit Shqiptar*”, Rilindja Kombëtare, , vëll. II, Tiranë, 2002, 156-161.

¹³⁸ Gazmend Shpuza, “Lidhja Islamike që u shndërrua në Lidhjen Shqiptare”, *Gazeta Shqiptare*, 10 qershor 2018

¹³⁹ Po aty.

këtë kohë kur atdheu na thërret në shërbim në shërbim të tij. Ne, në Lidhjen tonë, vendosëm që para se gjithash të provojmë që, pa diskutuar për fenë, jemi shqiptarë”. Siç shihet, për ndarje krahinore as që bëhet fjalë. Shpalosja e bashkimit mbifetar të shqiptarëve u vlerësua që herët, siç shkruan Sylejman Kulçe, në mënyrë të natyrshme, “një vepër zgjimi e madhe”.¹⁴⁰

Ky “konflikt” rrymash i ka përcjellë shqiptarët pothuajse në të gjitha manifestimet e tyre politike. Edhe në Kongresin e Manastirit, ku çështja kryesore në punimet e Kongresit ishte çështja e një alfabeti të përbashkët, edhe pse të gjithë shfaqën mendimin se alfabeti për të cilin do të vendosej duhej të kishte si bazë alfabetin latin, prapëseprapë pikëpamjet e delegatëve u ndanë, sidomos për caktimin e shkronjave dyshe, që nevojiteshin për ata tinguj të shqipes që i mungonin latinishtes.

Se edhe në këtë kongres u paraqiten konflikte rrymash që në bazë kishin elementin fetar, më së miri na tregon letërkëmbimi ndërmjet Mit’hat Frashërit dhe Faik Konicës.¹⁴¹ Mbështetësit e alfabetit të

¹⁴⁰Po aty.

¹⁴¹Kristo Frashëri, *Përplasjet e Konicës me vëllezërit Frashëri për Gračinë e Xhonturqit*, Studime Albanologjike, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, 9, Shkup, 2014. “Konflikti ndërmjet Konicës dhe Frashëllinjve (Samiut dhe Naimit e më vonë edhe me Mit’hatin) kishte filluar shumë kohë më herët nga vitit 1897. Shkak për këtë u bë bashkëpunimi i Konicës me dy anëtarët e komitetit të Stambollit – me Nikolla Naçon, për të cilin armiku kryesor për Shqipërinë ishte Greqia dhe jo Turqia dhe me Dr. Ibrahim Themon, i cili kërkonte ta ngushtonte lëvizjen shqiptare vetëm kundër despotizmit sulltanor dhe jo kundër Perandorisë Osmane. Faiku nuk i kursente kritikën ndaj politikës së Perandorisë Osmane. Konflikti i tyre u transferua edhe në çështjen e alfabetit që duhej përdorur për shkrimin e gjuhës shqipe. Samiu ishte ithtar i palëkundur i alfabetit të Shoqërisë së Shkronjzëve Shqipe të Stambollit, e cila mbështetej në parimin fonetik; për çdo zë një gërmë, alfabet i cili huazonte për zërat e veçantë të shqipes germa nga alfabeti grek dhe sllav. Ndryshe nga ky alfabet, Faiku në revistën “Albania” mbështetej kryesisht mbi gërmat latine, kurse për zërat e tepërta të shqipes përdori kombinime brenda për brenda alfabetit latin”. Konflikti për çështjen e alfabetit nuk përfundoi vetëm me Samiun. Konflikti për çështjen e alfabetit tani ndërmjet Konica edhe Mit’hat Frashërit vazhdoi edhe në kohën

Stambollit ishin të mendimit se shkronjat që zgjodhi Shoqëria e Stambollit nuk kanë asnjë të metë. Në letërën e Mit'hat Frashërit dërguar Faik Konicës ndër të tjera thuhet: *“....Shkronjat që zgjodhi shoqëria e Stambollit s’kanë as sa një qime të metë: janë të lehta, të bukura, të thjeshta dhe të mbaruara [...] Abetarja jonë ka mirësinë që çdo letër të ketë një zë të veçantë, e ç’do zë ka një shkronjëze për të; s’ka m’e rëndë e m’e shëmtuar gjë se sa të bashkojmë dy a tri shkronjëza për të nxjerr një zë”*.¹⁴² Ndërkaq, nga ana tjetër, Konica që e mbështeste alfabetin latin, Kongresin e Manastirit e quante “Kongresi i shqiptarëve xhonturq dhe i pilafçinjve turq”.¹⁴³

Vendimi për të përdorur bashkërisht dy alfabetë, atë të Stambollit dhe abecenë latine, u mor për të mos shkaktuar përçarje në radhët e delegatëve dhe të shqiptarëve në përgjithësi.

Me largimit e Perandorisë Osmane nga Ballkani, nuk do të thotë se përfundoi edhe ndikimi i saj ndër shqiptarët. Ajo edhe më tutje do të jetë e pranishme, por tash nëpërmjet formave dhe mënyrave të tjera, kryesisht nëpërmjet religjionit dhe institucioneve dhe organeve fetare. Për ta ilustruar ndikimin e madh të institucioneve fetare dhe përfaqësuesve të tyre ndër shqiptarët e mbetur jashtë kufijve politikë të Shqipërisë, do ta përmendim vetëm një fakt – luftën Çanakalasë.¹⁴⁴ Në këtë luftë, për një kohë relativisht të

e mbajtjes së Kongresit të Alfabetit në Manastir në vitin 1908, duke e quajtur Kongresin e Alfabetit në Manastir si “Kongresi i shqiptarëve xhonturq”.

¹⁴²Zëri Islam, “Mbajtjen e Kongresit të Manastirit e finançoi Sulltani”, 19, shtator 2012.

¹⁴³Kristo Frashëri, *Përplasjet e Konicës me vëllezërit Frashëri për Greqinë e Xhonturqit*, Studime Albanologjike, Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve – Shkup, 9, Shkup, 2014.

¹⁴⁴Lufta e Çanakalasë ose beteja e Galipolit u zhvillua nga 25 prilli i vitit 1915 e zgjati deri më 9 janar të vitit 1916. Divizioni i 19 i Armatës së Turqisë në Betejën e Çanakalasë i komanduar nga Mustafa Kemali, sipas dëshmimeve të studiuesve dhe historianëve, përbëhej kryesisht nga shqiptarët.

shkurtër, do të mobilizohen dhe do të marrin pjesë me dhjetëra e dhjetëra mijëra shqiptarë, kjo edhe përkundër faktit se pas vitit 1912 shqiptarët do të ballafaqoheshin me rrezikun e shfarosjes së tyre kolektive nga dhuna e ushtrisë serbet. Me shpresë së mund të ndryshojë gjendja e tyre ose të kthehet prapë Perandoria Osmane në këto vise, thirrjes së sulltanit në cilësinë e kalifit për myslimanët e botës për luftë të shenjtë iu përgjigjën shumë shqiptarë. Parash-trohet pyetja: se si është e mundur që në kohë lufte dhe me komu-nikime të vështirësuar të bëhet ky mobilizim kaq i madh e i shpejtë ndër shqiptarët e mbetur jashtë Shqipërisë? Këtu ka vetëm një përgjigje ose vetëm shpjegim: nëpërmjet institucioneve fetare myslimane dhe imamëve të cilët nën moton “se në Turqi mbrohet islami” i bënë thirrje popullit që ta mbështeste luftën e Çanakalase. Se a ishte kjo thirrje e singertë e institucioneve fetare apo kishte ndonjë prapavijë të caktuar, kjo mbetet për t’u analizuar.

Për fat të keq histori e ngjashme si kjo, jo në përmasa të tilla, me aktorë të njëjtë po na përsëritet edhe sot e kësaj dite, me pjesëmarrjen e rinjve shqiptarëve në luftërat e huaja në Lindjen e Mesme.

Shqiptarët, në pamundësi për ta organizuar jetën e tyre politike në kuadër të shtetit të ri, pra Mbretërisë SKS, në bazë të elementit etnik, u detyruan që organizimin e tyre politik ta maskojnë nën ombrellën fetare. Si pasojë e kësaj politike jugosllave, shqiptarët në kuadër të Mbretërisë SKS jetën e tyre politike e fetare e organizuan nëpërmjet organizatës politike myslimane të njohur si Xhemijeti.¹⁴⁵

¹⁴⁵ Isamedin Azizi, *Shqiptarët e Shkupit pas vitit 1919 e deri në vitin 1991*, Shkupi 8000 vjet të jetës së organizuar, vëll. IV, Shkup, 2017, 980. Në një realitet të këtillë politik në kuadër të Mbretërisë së SKS-së, shqiptarëve iu mohuan të drejtat e tyre elementare, si e drejta e shkollimit në gjuhën amtare dhe përdorimi i kësaj gjuhe në raport me organet zyrtare, e drejta e organizimit politik në baza etnike e të tjera, me përjashtim të praktikimit të të drejtave fetare. Kjo situatë ndikoi që shqiptarët, në përgjithësi, e sidomos ata të Shkupit, duke mos pasur të drejtën për formimin e një

Ky maskim ishte i domosdoshëm, sepse Mbretëria e SKS-së nuk e njihnte kombësinë shqiptare, ndërsa e lejonte atë turke dhe e pranonte “identitetin islam”, të cilit i lejohej pasqyrimi në planin shoqëror, kulturor, por edhe politik. Këtë e dëshmon edhe botimi i gazetës “Hak” si organ i kësaj partie, i cili botohej vetëm në gjuhën turke e atë serbe.¹⁴⁶ Xhemijeti ose Shoqata Islamike për Mbrojtje dhe Drejtësi, edhe pse në emërtimin e saj nuk kishte elemente shqiptare, lirisht mund të themi se është partia e parë politike ku do të dominojë elementi shqiptar, sidomos te një pjesë e saj. Faktori-zimi i elementit shqiptar në këtë organizatë politike nëpërmjet krahut më të fuqishëm të saj, të udhëhequr nga vëllezërit dhe njëherazi dy kryetarët e parë të Xhemijetit, Nexhip dhe Ferhat Draga, Aqif Blytës, Nazim Gafurit e të tjerëve, filloi të bëhet pengesë e madhe për politikën jugosllave, sidomos pas denoncimeve dhe qëndrimeve të tyre në parlamentin jugosllav kundër politikës shtetërore ndaj popullatës shqiptare, para se gjithash kundër procesit të shpërnguljeve dhe të kolonizimit me elemente sllave të viseve shqiptare, si dhe për ndërprerjen e reformave agrare, hapjen e shkollave në gjuhën shqipe e turke etj. Duke marrë parasysh se ky organizim politik përbëhej nga një konglomerat interesash të cak-

organizimi politik me karakter etnik, të detyrohen që këtë organizim politik ta maskojnë nën petkun fetar, duke e paraqitur si organizatë politike të myslimaneve, e cila do të quhej Islam Muhafayaz-i Hukuk Cemiyeti, e më vonë edhe si Organizata e Myslimanëve të Jugut, e njohur si “Xhemijet” (në përkthim nga osmanishtja – klub ose shoqatë). Ky organizim politik, që kryesisht dominohej prej shqiptarëve, u themelua në Shkup në 17 dhjetor të vitit 1919 dhe kishte për qëllim t’i mbrojtë të drejtat fetare, kulturore dhe ato politike të myslimanëve të Maqedonisë, Kosovës dhe Sanxhakut.

¹⁴⁶Skender Asani, *Xhemijeti, veprimtaria e organizatës politike Xhemijeti në trevat lindore (1919-1925)*, Shkup, 2017, 58. Si organ partiak i saj botohet gazeta “Hak” (në arabisht Hak – drejtësi, e drejtë, e vërtetë), e cila botohet në gjuhën turke me shkronja arabe dhe në gjuhën serbe me shkronja cirilike e, pjesërisht, edhe në gjuhën frënge me shkronja latine. Ky organ shtypi botohet në Shkup. Numri i parë i saj del më 23 janar (e hënë) në vitin 1920. Deri më 17 janar 1921 botohet dy herë në javë, për t’u botuar më vonë tri herë në javë dhe për të përfunduar me botim të përditshëm. Numri i fundit i botimit të gazetës “Hak” në gjuhën serbe dhe turke doli më 10 dhjetor 1924.

tuara (bejlerë të ndryshëm që prioritet kishin ruajtjen e pronave të tyre, klerikë myslimanë që kënaqeshin vetëm me liritë fetare), etnisch (shqiptarë, turq, boshnjak etj.) dhe ideologjish të ndryshme (kombëtare dhe ato fetare), Xhemijeti ishte cak i lehtë i ndërhyrjeve të elementeve të caktuara të shtetit në përçarjen e kësaj partie, si-domos pas fuqizimit të saj dhe ndikimit të madh që kjo organizatë kishte në jetën politike e fetare të komunitetin mysliman.

Si rrjedhojë e këtyre presioneve, për një kohë të shkurtër, do të paraqiten dy-tri fraksione, që do të kërkojnë që partia t'i kthehet vetëm çështjes fetare dhe çështjes së pronave të vakëfeve e jo të humbet energji në mbrojtjen e interesave etnike. Beogradi nuk dëshironte kurrfarë organizimi politik të shqiptarëve, pos atij fetar, i cili në njërën anë ishte i domosdoshëm për çrrënjosjen e çfarëdo vetëdijeje kombëtare të tyre, ndërsa në anën tjetër kështu pretendonte të forcohej vetëdija fetare dhe e të qenit turq, sepse vetëm nëpërmjet saj shpërngulja do të ishte më e lehtë. Kjo politikë e Beogradit, e cila u manifestua edhe nëpërmjet privilegjeve të caktuara, do të gjejë mbështetje të fuqishme të elementet proturke e profetare të Xhemijetit, të udhëhequra nga Qenan Zija. Fërkimet dhe mosmarrëveshjet e ndryshme të rrymave brenda partisë do t'ia shkurtojnë edhe jetëgjatësinë kësaj organizate. Do të fillojë një fushatë e përgjithshme kundër Xhemijetit, sidomos kundër promotorëve të interesave shqiptare brenda kësaj partie, të cilët do të goditen keq nga institucionet shtetërore jugosllave. Ferhat Draga do të dënohet në fillim me 100 vjet burgim, për t'ju ulur më vonë në 20 vjet burg, prej të cilave do t'i mbajë vetëm tre vjet.¹⁴⁷

¹⁴⁷Qerim Lita, Ferhat bej Draga, prijës i lëvizjes kombëtare shqiptare në vitet e tridhjeta të shekullit të kaluar, *Scupi, (Organizata Xhemijeti dhe rezistenca e saj kundër kolonizimit) konferencë shkencore – 17.12.2017, Shkup, Shkup, 2018, 27.*

Edhe deri sa ishte në krye të Xhemijetit, por edhe pas shpërbërjes së saj, Ferhat Draga, së bashku me disa bashkëmendimtarë të tij, do të vazhdojë me aktivitetet politike për ndërgjegjësimin dhe ngritjen e vetëdijes kombëtare të popullatës shqiptare. Në rend të parë ky ndërgjegjësim do të duhej të bëhej brenda vet institucioneve fetare islame, sidomos të një pjesë e struktura më konservatore, e cila ishte pengesa kryesore në ndërgjegjësimin e saj. Duke e marrë parasysh ndikimin e madh që kishin në popull institucionet fetare dhe përfaqësuesit e tyre, Ferhat Draga tërë aktivitetin e tij do ta zhvillojë përmes Bashkësisë Fetare Islame, përkatësisht Mexhlisit të Ulemasë së Shkupit, kjo me të vetmin qëllim që ky institucion shpirtëror e shumë i rëndësishëm për gjithë popullatën myslimane të Maqedonisë të frymojë shqip.

Pikëpamje të ngjashme me Ferhat Dragën në këtë drejtim kishin edhe figurat e tjera patriotike shqiptare, që kishin për qëllim inkorporimin e tyre në kuadër të institucioneve fetare me synim vetëdijësimin kombëtar të tyre. Sipas një dokumenti të nxjerrë nga Arkivi i Jugosllavisë të datës 20 tetor 1924, thuhet se në Prishtinë ekziston një klub mysliman shqiptar, i cili kishte kontakte të ngushta me strukturat e Komitetit të Kosovës në Shqipëri dhe i njëjti bënte propagandë në favor të Shqipërisë.¹⁴⁸ Ky aktivitet, sipas dokumentit në fjalë bëhej me dijen dhe pëlqimin e Ferhat Dragës, kryetarit të Xhemijetit. Ndër të tjera në dokument përmendet edhe fakti se me propozim të Nazim Gafurit deputet i Xhemijetit në parlamentin jugosllav dhe në koordinim me Komitetin e Kosovës, si myfti i Prishtinës, në vend të Mehmet efendiut, duhej të emërohet Rexhep bej Mitrovica, ndërsa myftiu i deriatëhershëm i Prishtinës, Mehmet

¹⁴⁸ Arkivi i Jugosllavisë, Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ), fondi 334, fashikulli nr. 6, numri i njësies 21.

efendiu, i cili sipas dokumentit në fjalë, po ashtu kishte kontakte të afërta me anëtarët e Komitetit të Kosovës, duhej të kalonte në myftininë e Beogradit.¹⁴⁹ Nga ky dokument shihet qartë se figurat e rëndësishme politike të Komitetit të Kosovës, në bashkëpunim me rrymën shqiptare të Xhemijetit, kishin prirje që në institucionet fetare, qoftë në Maqedoni qoftë në Kosovë, të emërohen udhëheqës që para se gjithash të kenë taban kombëtar. Se synimi i patriotëve shqiptarë ishte i tillë, për këtë na flet edhe fakti se Rexhep Mitrovica, si njëri ndër nënshkruesit e Deklaratës së Pavarësisë së Shqipërisë, e më vonë edhe kryeministër i saj, gjatë kohës sa jetoi në Shkup, sipas biografisë së tij, na del se ndonëse nuk kishte të kryer ndonjë shkollë të lartë fetare (studimet e larta i kishte vazhduar në Paris), për shkak të autoritetit të lartë që gëzonte në popull, emërimi i tij në krye të myftinisë së Prishtinës do të kishte ndikim të madh në pengimin e shpërnguljeve të shqiptarëve që ndodhnin në këtë kohë.

Synimi i figurave politike shqiptare që në krye të institucioneve fetare të vendosen njerëz që, pos ndjenjave fetare të ushqejnë edhe ndjenja kombëtare shqiptare, do t'i shqetësojë tejmas qeveritarët e Beogradit. Përndjekja dhe burgosja e këtyre figurave në këtë nuk kohë ishte e rastësishme. Beogradi gjithmonë tentonte që ta pengonte inkuadrimin në krye të institucioneve fetare të personave të dëshmuar, pos në rrafshin fetar, ashtu edhe në atë kombëtar. Ai shumë më tepër preferonte që në krye të këtyre institucioneve të qëndrojnë njerëz që do ta ushqejnë popullatën myslimane me ndjenja fetare e turke.

Tendenca e ekzistimit të rrymave të ndryshme në kuadër të institucioneve fetare, sidomos në Maqedoni, do të vazhdojë edhe pas

¹⁴⁹Po aty.

përfundimit të Luftës II Botërore, por tash edhe me përkrahjen e segmenteve të caktuara shtetërore.

Demonstrimi i politikës diskriminuese ndaj shqiptarëve pas Luftës II në Maqedoni ishte i madh, sidomos në Shkup. Në konstituimin e Këshillit Ekzekutiv të qytetit të Shkupit, nga 17 anëtarët e propozuar nga Komiteti Qendror i PKM-së, 10 ishin maqedonas, 5 turq, 1 vllleh, 1 rom dhe asnjë shqiptar.¹⁵⁰ Në po të njëjtën kohë në Shkup ishin hapur 10 shkolla maqedonase, 2 turke dhe vetëm 1 shqipe.¹⁵¹ Kjo situatë e pavolitshme e popullatës shqiptare, e përcjellë me fërkime të pandërprera dhe me përplasje të haptë shqiptaro-turke, të ndihmuara nga pushteti për të krijuar para kushte për dominimin e elementit proturk, posaçërisht në Shkup, detyroi që edhe ata pak intelektual komunistë që ishin në pushtet të reagojnë ndaj këtyre padrejtësive. Ndër personalitetet e pushtetit komunist që gëzonte autoritet në mesin e popullatën shqiptare të Maqedonisë ishte Nexhat Agolli.

Me 16 shkurt të vitit 1948, me pjesëmarrjen e krerëve më të lartë fetarë myslimanë dhe personaliteteve të larta politike shtetërore komuniste, në Shkup mbahet mbledhja e këshillit të Organizatës Islame në Maqedoni. Figura kryesore në këtë organizim ishte ajo e Nexhat Agollit.¹⁵² Pas shumë debateve të ashpra të zhvilluara në mbledhje ndërnjet rrymës proshqiptare dhe asaj proturke, të përkrahur edhe nga pushteti, aty dominuan përfaqësuesit shqiptarë, si ata fetarë, ashtu edhe ata politikë. Në organet e organizatës islame u zgjodhën: Nexhat Agolli – kryetar i Këshillit të Përgjithshëm

¹⁵⁰ Државен Архив на Република Македонија (ДАРМ), фонд, 427.43/22-50.

¹⁵¹ QerimLita, Naçërtanie, K. Çervenkovski dhe identiteti shqiptar në Maqedoni, vëll. 1, Shkup, 2007, 29.

¹⁵² Mani Nesimi, *Nexhat Agolli, Atdhetar i harruar*, Tetovë, 2012, 90.

Mysliman, Osman Miftari dhe Esad Doko si sekretar.¹⁵³ Shikuar nga shumë aspekte, mund të thuhet se në këtë kohë ishte e qartë se qeverisja në këtë bashkësi fetare nga duart e imamëve, që në rend të parë betoheshin në përkatësinë fetare, ngadalë po kalonte në duart e shqiptarëve. Ndoshta, angazhimi i Agollit edhe në jetën fetare në Maqedoni ishte ndër faktorët që kanë ndikuar në përshpejtimin e eliminimit të tij fizik në vitin 1949.

Ndër dokumentet kryesore të miratuara në këtë mbledhje ishte edhe “Rezoluta për heqjen e ferexhesë”, përdorimi i së cilës më vonë do të ndalohet edhe me ligj.¹⁵⁴

¹⁵³Po aty.

¹⁵⁴Po aty.

ZEQIRIJA IBRAHIMI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore
të Shqiptarëve – Shkup*

SHTRESAT IDENTITARE TË SHQIPTARËVE MYSLIMANË NË MAQEDONI

Shqiptarët janë një komb që jeton në Gadishullin Ballkanit në disa shtete, por edhe në shumë vende europiane, në kontinentin amerikan dhe në Australinë e largët. Duke qenë një komb kaq i shpërndarë, detyrimisht që kushtet në të cilat jetojnë kanë ndikuar që, përveç gjërave të përbashkëta që i kanë si komb, siç janë gjuha, flamuri, folklori, traditat, ata kanë ndërtuar edhe ideale dhe tipare të tjera, që janë bërë tipike për komunitetin shqiptar në vendin përkatës. Një fragment të kësaj shqiptarie e kemi të vendosur edhe në Maqedoninë e Veriut, ku së paku 25% jetojnë shqiptarë. Dhe, kur shtrohet tema e përfshirjes së shqiptarëve të Maqedonisë ose e historisë së kësaj pjese shqiptare në trungun e përbashkët kombëtar, na dalin edhe probleme, të cilat do të mundohemi t'i elaborojmë në këtë kumtesë dhe për të cilat do të prodhojmë të krijojmë zgjidhje.

Përkufizime të përgjithshme nacionalizmin

Gjëja e parë që duhet përkufizuar në këtë pikë është se çfarë është kombi: a është përkatësi gjenetike, kulturore apo politike? Dhe, mendimi më i pranuar shkencor është se kombet nuk janë identitete gjenetike, porse janë identitete politike dhe kulturore. Sado që Benedict Anderson-i konsideron se kombi është *“një komunitet*

*politik i imagjinuar*¹⁵⁵, që krijohet, pra, për qëllime të ndryshme, si politike, ekonomike, religjioze, kulturore etj., nuk mund të mos e pranojmë faktin se kjo botë tashmë funksionon si e tillë dhe do të ishte tejet postmoderne që të kontestohet nevoja për ekzistimin e kombeve. Madje, sipas studiuesit të njohur të nacionalizmit, Ernest Gellner: *“Nacionalizmi nuk është shenjë e zgjimit të vetëdijes së kombeve: ai i shpik kombet aty ku nuk ekzistojnë”*¹⁵⁶. Kjo i bie se kombet nuk është se janë të krijuara, porse janë faktorë të tjerë që mundësojnë krijimin e tyre. Dhe, faktorët e tillë mund të jenë, mes tjerash, kultura, shteti ose gjuha.

Megjithatë, ajo që duhet të shpjegohet kur flasim për nacionalizmin si parim politik është se ai është i lidhur gjithnjë për modernitetin¹⁵⁷. Zaten, moderniteti e shpiku nacionalizmin, kjo falë lëvizjeve mendimore e filozofike në Europën Perëndimore, si iluminizmi e racionalizmi. E theksojmë këtë, sepse kombet që nuk e kanë përjetuar plotësisht modernitetin, e kanë vështirë ta ndërtojnë edhe nacionalizmin.

Sidoqoftë, në teorinë mbi nacionalizmin janë dhënë shumë mendime, por të gjitha ato mund të sintetizohen në përkufizimin se: *“Nacionalizmi në thelb është një parim, sipas të cilit njësi politike dhe njësi kombëtare duhet të përputhen.”*¹⁵⁸ Kështu gjykon edhe Gellner—i, i cili thotë se: *“... problemi i nacionalizmit shfaqet në një botë ku shtetet merren si të mirëqena ose kërkohen...”*¹⁵⁹

¹⁵⁵ Benedict Anderson, *Komunitete imagjinare, dy Lindje & dy Perëndime*, Tiranë, 2013, fq. 19.

¹⁵⁶ Po aty.

¹⁵⁷ Shih: Ernest Gellner, *Nacionalizmi*, botimet IDK, Tiranë, pa vit botimi, fq. 24.

¹⁵⁸ Erik Hobsbawm, *Kombet dhe nacionalizmi që nga 1780*, Toena, Tiranë, 2012, f. 21 dhe Ernest Gellner, *Nacionalizmi*, botimet IDK, Tiranë, pa vit botimi, fq. 61

¹⁵⁹ Ernest Gellner, *Nacionalizmi...*, fq. 17

Ajo që e ngjesh nacionalizmin është domosdo një element i përbashkët që e mban të lidhur komunitetin. Sipas Grenfeld-it, nacionalizmi i mbërthen tri lloje dukurish: 1) identitetin kombëtar dhe vetëdijen kombëtare; 2) ideologjinë artikuluar dhe 3) dukuritë ksenofobike të patriotizmit kombëtar.¹⁶⁰ Ky shpjegim bëhet i rëndësishëm edhe për interpretimin e nacionalizmit shqiptar si ideologji (shqiptaria ose shqiptarizma), në emrin e së cilës ndërtohen mite, krijohen figura dhe dënohen të tjerë si *renegatë të kombit*, duke pretenduar shpesh edhe në shenjtërinë e ideologjisë së tillë.

Duke shpjeguar më tej se si ndërtohet nacionalizmi do t'i referohemi përsëri Gellner-it, për të cilin ky element ngjizës është kultura: *“Nacionalizmi është një parim politik, sipas të cilit ngjashmëria kulturore përbën vjeggën themelore në shoqëri”*,¹⁶¹ që nënkupton se kultura e përbashkët është një ind lidhor i ndërtimit të identitetit të përbashkët, që pastaj rindërtohet në parim politik, siç është nacionalizmi.

Ndërkaq, sipas autores kroate Snježana Kordić, *“Në kuptimin modern kombi nuk mund të ekzistojë pa kuptimin e identitetit të përbashkët, ndërsa që njerëzit të ndajnë identitet të përbashkët patjetër duhet të garantohet një nivel minimal i komunikimit ndërnjetës”*.¹⁶² Ajo, pra, e rreh telin se komunikimi, në interpretimin tonë – gjuha, është ajo që i ndërton komunitetet me identitete të përbashkëta. Dhe, ky përkufizim është veçmas i rëndësishëm për interpretimin e nacionalizmit shqiptar, i cili elementin më të fuqishëm ndërlidhës e ka pikërisht gjuhën.

¹⁶⁰ Cituar sipas: Zagorka Golubović, *Unë dhe tjetri*, Logos-A, Shkup, 2019, fq. 141

¹⁶¹ Po aty, fq. 14

¹⁶² Snježana Kordić, *Jezik i nacionalizam*, Durieux, Zagreb, 2010, fq. 183.

Nëse do ta bënim një sintezë të këtyre shpjegimeve, do të thoshim se nacionalizmit i duhet një ideologji e përbashkët, një emocion (si patriotizmi), një kulturë e përbashkët ose një gjuhë e përbashkët. Megjithatë, këto janë njetet e ndërtimit të nacionalizmit, sepse synimi i tij është parimi politik i përputhjes së komunitetit të përbashkët etnik me njësinë e përbashkët politike. Pra, “të gjithë bashkëkombësit e mi në një shtet”.

Nacionalizmi shqiptar

Pasi që kemi bërë një përkufizim të përgjithshëm për nacionalizmin, kur këtë e vështrojmë në kontekstin shqiptar, para së gjithash duhet të themi se nacionalizmi shqiptar u shfaq në kushtet e bashkëjetesës së shqiptarëve me Perandorinë Osmane. Madje, etërit e nacionalizmit shqiptar, si Sami Frashëri e Pashko Vasa, ishin njëherazi ndihmues dhe kontribuues të mëdhenj edhe për shtetin osman, njëri si shkencëtar e tjetri si politikan. Kjo është e rëndësishme që të kuptohet se në çfarë kushtesh lindi nacionalizmi shqiptar.

Dhe, derisa Pashko Vasa (në veprën “*La verite sur l’Albanie*” / “*E vërteta mbi shqiptarët*”) mendon se shqiptarët duhet ta kenë një autonomi në kuadër të Perandorisë, ndërsa Sami Frashëri thotë se: “*Qëllim’ i vetëm i shqiptarëve është të ruajnë Shqipërinë të mos copëtohetë prej të huajve, të mbajnë gjuhën’ e kombërin’ e tyre, t’u rrinë kundreq entrigave t’arnukëvet të tyre e të ndalojnë të përhapurit’ e gjuhëvet e të mendimeve të greqet e te shqehet, të cilatë po i rëmojnë themeletë e po i nxjerinë rënjët Shqipërisë e shiptarërisë*”¹⁶³, ideja për shtet të pavarur vjen më vonë, kur më u

¹⁶³ Sami Frashëri, *Shqipëria ç’ka qenë, ç’është e ç’do të bëhetë*, Logos A, Shkup, 2004, f. 93.

pa se Perandoria nuk kthehej më në fuqinë e saj. Është kjo koha e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, që duke vepruar në kohën e romantizmit europian, e krijoi mitin e Skënderbeut si burim i lirisë shqiptare dhe luftëtarit kundër Perandorisë Osmane, pastaj në këtë kohë iu dha rëndësi gjuhës, folklorit, librit shqip dhe shkollës shqipe, duke mundurësuar kështu një vijë të nacionalizmit shqiptar, që do të kërkonte përputhjen e kufijve etnikë me ata gjeografikë (kjo ishte kërkesë që nga Lidhja e Prizrenit, sado që kërkesa fillestare ishte për autonomi). E duke kujtuar, pra, se nacionalizmi i projektuar shqiptar në filltet e tij synonte që ta ndërtojë nacionalizmin shqiptar “një komb – një shtet”, pas më shumë se një shekulli mund të konstatojmë se edhe Republika e Kosovës, edhe Republika e Shqipërisë janë projekte antinacionaliste,¹⁶⁴ sepse ato nuk janë ndërtuar mbi parimin e përfshirjes së gjithë kombit në një shtet të përbashkët. Kjo, në një mënyrë, ua pamundëson atyre të pretendojnë t’i vendosin standardet e nacionalizmit shqiptar.

Në këtë kuptim është shumë e rëndësishme të përkufizohet se çfarë është për shqiptarët *kërthiza e kombit* (Gellner), sepse kjo do të duhej ta përkufizonte edhe nacionalizmin shqiptar. (Këtu me termin *kërthizë* nënkuptohet se prej ku buron fryma e nacionalizmit përkatës, çfarë e ushqen atë. Për këtë Gellner-i thotë: “*Disa kombe kanë kërthizë disa e krijojnë kërthizën, disa ua kanë hedhur përsipër*”).¹⁶⁵ E kur e kërkojmë kërthizën e kombit shqiptar, na del se ajo mund të jetë kultura shqiptare dhe gjuha shqipe. Prandaj në jo pak raste shqiptarët llogariten si *komb gjuhësor*. Natyrisht edhe gjuha shqipe, në kuptim të të folmeve shqipe, nuk është homogjene, porse shfaq prirje që e bëjnë të dallueshme nga pika në pikë,

¹⁶⁴ Për këtë shih më gjerësisht: Milazim Krasniqi, *Nacionalizmi shqiptar*, Logos-A, Shkup, 2014

¹⁶⁵ Ernest Gellner, *Nacionalizmi...*, fq. 124

megjithatë, alfabeti i njëjtë dhe shkrimi i gjuhës së njëjtë standarde nga të gjithë shqiptarët, na e jep identitetin unik të kombit tonë.

Një problem tjetër i nacionalizmit shqiptar është se ai erdhi si model i parimit politik europian, por shqiptarët nuk është se e përjetuan modernitetin edhe si lëvizje europiane mendimore, filozofike, artistike etj. Arsyet i dimë tashmë, por mungesa e modernitetit bëri që edhe nacionalizmi tipik europian të mos mund të gjejë shtrat të mirë në mjedisin shqiptar. Këtë e konstaton edhe Gellner-i: “... edhe nacionalizmat e tjerë ballkanas mund të vështrohen si problematikë për teorinë tonë, po të kemi parasysh prapambetjen e Ballkanit ndaj standardeve të industrializimit dhe të modernitetit”¹⁶⁶. Sipas tij, një grup etnik që nuk e kalon industrializimin, rrjedhimisht modernitetin, vështirë e ka ta përkapë nacionalizmin.

Një kontribut për ndërtimin e nacionalizmit shqiptar s’do mend se dhanë grupet protestante ndër shqiptarët, ndërsa e dimë mirëfilli se protestantizmi ishte shtylla kryesore e prodhimit të nacionalizmit në Europë¹⁶⁷, sepse ishte beteja për afirmimin e gjuhëve etnike. Te shqiptarët protestantizmi u shfaq me familjen protestante Qiriazi në Manastir, e cila ishte ndër shtytëset kryesore edhe për alfabetin unik shqip dhe për botimet në gjuhën shqipe.

Prandaj, kur i shohim të gjitha kriteret e prodhimit të nacionalizmit europian dhe ato i përballim me nacionalizmin shqiptar, na rezulton se më shumë se parim politik “një komb – një shtet”, nacionalizmi shqiptar mbeti një ideologji për afirmimin e kulturës etnike e të historisë etnike shqiptare, të cilën pushtetet e ndryshme shpesh edhe e kanë uzurpuar për interesa të caktuara politike, duke e interpretuar sipas nevojave të qarqeve të caktuara politike. E, duke qenë një

¹⁶⁶ Ernest Gellner, *Nacionalizmi...*, fq. 57

¹⁶⁷ Po aty, fq. 96

komb i ndarë në disa shtete, edhe ideologjia e mbajtjes gjallë të nacionalizmit ka vepruar ndryshëm në areale të caktuara shqiptare. Kështu, derisa në Shqipërinë komuniste ideal i kombit shqiptar ishte marksizëm-leninizmi, ndërsa në Jugosllavi – enverizmi dhe titizmi, ndërsa në mërgatë mbeti gjallë një nacionalizëm rilindës, pas rënies së komunizmit idealet e Shqipërisë u bënë “integrimi europian”, idealet e Kosovës u bënë pavarësia dhe shteti i ri i Kosovës, ndërsa për shqiptarët e Maqedonisë ideal u bë barazia kombëtare.¹⁶⁸ Kjo e ka shtruar çështjen se a është nacionalizmi shqiptar homogjen dhe cilat janë standardet e nacionalizmit shqiptar.

Shikuar kështu, mund të konstatojmë se nacionalizmi shqiptar është tjetërsuar, ndërsa ka mbetur gjallë ideologjia e shqiptarisë, që më shumë priret për të mbrojtur figura e ngjarje të historisë shqiptare sesa që është ideologji nacionaliste “një komb – një shtet”. Kjo gjendje heterogjene ka bërë që shqiptarët të shikohen mes vete për nga dallimet dhe jo për nga ngjashmëritë. Në këtë mënyrë, për një shqiptar të Shqipërisë, shqiptari i Kosovës është *shumë nationalist* dhe mbase, *provincial*, ndërsa shqiptari i Maqedonisë *i paqytetëruar* *mjaftueshëm*, *konsevator* dhe *shumë religjioz*. Në anën tjetër, për shqiptarin e Kosovës, shqiptari i Shqipërisë është *gati i asimiluar* dhe *pa ndjenja kombëtare*, ndërsa shqiptari i Maqedonisë *i përvuajtur* dhe *religjioz*. E, shikuar nga këndi i shqiptarit të Maqedonisë, shqiptari i Shqipërisë është *një shqiptar që ka lëvizur shumë nga strumbullari shqiptar i Rilindjes Kombëtare Shqiptare*, ndërsa shqiptari i Kosovës është *pak si shumë enverist dhe herë–herë edhe titist*, por gjithsesi më afër identitetit të projektuar shqiptar sipas këtij këndvështrimi. Pavarësisht se cila është e vërteta e këtyre

¹⁶⁸ Një artikull në këtë temë, që pat zgjuar shumë debat është ai i Ben Blushit: <https://gruppostudentescoalbanesemilosao.wordpress.com/2012/12/04/tri-format-e-nacionalizmit-shqiptar/> (marrë më 02.09.2019)

konstatimeve dhe pavarësisht se ato mund të jenë fragmentare, ste-reotipa dhe jo përgjithësime, nuk mund të mohohet fakti se shqiptarët e Maqedonisë ndjehen inferiorë karshi shqiptarëve të tjerë, sepse e kanë vështirë që figurat dhe ngjarjet e historisë së tyre t'i integrojnë në historinë e përbashkët shqiptare.

Identiteti shqiptar në Maqedoni

Meqë shqiptarët e Maqedonisë deri vonë kanë pasur probleme elementare të ekzistencës, ndërsa shkollat shqipe, të mesme dhe universitare, kanë qenë përpjekje të stërmundimshme, ata gjithnjë janë vetëperceptuar si periferi shqiptare, qoftë e Kosovës ose e Shqipërisë. Ose, në saktë, shqiptarët e Strugës, Kërçovës dhe Dibres janë parë në pasqyrën e Shqipërisë, ndërsa ata të Gostivarit, Tetovës, Shkupit e Kumanovës janë shikuar në pasqyrën e Kosovës. Prandaj, sot kur duhet të vlerësohet shqiptaria e shqiptarëve në Maqedoni, synohet të prodhohen ngjarje e figura të historisë që do të pranohen edhe në Shqipëri e Kosovë dhe të përmenden në heshtje ose mos të përmenden fare ngjarje e figura që mund të mos jenë të pëlqyera a të përshtatshme nga Tirana ose Prishtina Një element i tillë është, fjala bie, organizata politike “Xhemijeti”, e cila në Tiranë gati se nuk njihet fare, ndërsa në Prishtinë shpesh trajtohet si organizatë fetare dhe turkofile, edhe pse faktet flasin se atë e kanë krijuar patriotët më të mirë të kohës (familja Draga) dhe ajo ka pasur për synim mbrojtjen e popullatës shqiptare (por, edhe myslimane) në Mbretërinë e Serbëve, Kroatëve dhe Sllovenëve. Ose, kur flitet për shkollat, shqiptarët e Maqedonisë mund të ndjehen keq që, në mungesë të shkollave publike, shkollat e vetme ishin mejtepet e hoxhallarëve nëpër xhami, ndërsa qarqet laike e shekullariste mund ta marrin këtë si hendikep.

Kjo gjendje na ka detyruar që të mundohemi të gjejmë një kornizë që e akomodon identitetin shqiptar të Maqedonisë në kuadër të identitetit të përgjithshëm shqiptar. Pasi që tashmë kemi konstatuar se nacionalizmi politik shqiptar gati se ka dështuar plotësisht, na bie të themi se – ashtu si në kohën e komunizmit, kur nacionalizmi vihej në shërbim të ideologjisë – edhe sot nacionalizmi shqiptar shihet me optikën e shekullarizmit europian dhe kjo bën që shqiptarët e Maqedonisë të duken mbase si *shqiptarë të paevoluar*. Përveçse përçmim, kjo është edhe një qasje e gabuar, sepse pikërisht kjo mënyrë e organizimit të shqiptarëve në Maqedoni e ka shpëtuar identitetin kombëtar të shqiptarëve këtu për ta nxjerrë në shekullin tonë. Duke qenë të izoluar dhe me identitet të theksuar fetar, shqiptarët në Maqedoni gati se 100% nuk kanë pranuar të martohen me maqedonas/e dhe kjo i ka mbrojtur nga asimilimi etnik. Tjetër: duke qenë të izoluar dhe konservatorë, i kanë ruajtur me xhelozi traditat shqiptare, folklorin shqiptar, këngët, vallet dhe veshjet shqiptare. Më tej: shqiptarët myslimanë në Maqedoni të sllavët maqedonas kanë parë *tjetrin*, me të cilin e kanë dalluar veten dhe e kanë vetëperceptuar si një qenie tjetër politike e kulturore¹⁶⁹. Hoxhallarët, po ashtu, ishin aktivë edhe në organizatën politike “Xhemijeti”, si dhe më vonë, në Luftën e Dytë Botërore, në Organizatën Nacional-Demokratike Shqiptare dhe një numër i madh i tyre e paguan me jetë ose me burg qëndrimin e tillë politik.

Kështu identiteti islam i shqiptarëve të Maqedonisë ka qenë mburoja e mbrojtjes së shqiptarisë këtu. (Kjo nuk do të thotë se Islami

¹⁶⁹ Derisa shqiptarët e Maqedonisë nuk shënojnë gati asnjë martesë të përzier shqiptaro-maqedonase për më shumë se 70 vjet, që mund ta hapte rrugën për asimilim, janë dhjetëra raste kur vajza shqiptare të Shqipërisë, madje jo vetëm të krishtera, por edhe me origjinë muslimane, martohen për maqedonas ose serbë, gjë që përbën “skandal” në perceptimin e një shqiptari të Maqedonisë.

është fe që e mbron identitetin kombëtar, sepse shqiptarët në Turqi janë asimiluar pikërisht për shkak të fesë së njëjtë, por në kontekst të Maqedonisë përkatësia islame e shpëtoi identitetin shqiptar). Po kujtojmë këtu se shqiptarët ortodoksë dhe ata katolikë në Maqedoni për gjysmë shekulli u tretën gati 100% pikërisht për shkak të përkatësisë fetare të krishterë. Andaj, kur e shohim kështu, në vend që shqiptarët e tjerë ta vlerësojnë elementin që i ka mbrojtur shqiptarët e Maqedonisë nga asimilimi, janë bajate vërejtjet me përcënim për identitetin e theksuar islam të shqiptarëve në Maqedoni. Kjo na shpie në konstatimin se perceptimi i nacionalizmit shqiptar në kushte të Maqedonisë nuk është i njëjtë siç ka qenë në Shqipëri. Nëse gjykojmë në kriterin gjuhësor ose në kriterin e Rilindjes Kombëtare Shqiptare, edhe plot figura të tjera shqiptare nuk janë kombëtare, por ato janë akomoduar brenda identitetin tonë kombëtar. Fjala bie, Nëna Terezë është murgeshë katolike dhe ajo u bë e famshme si misionare e Krishterimit dhe jo si shqiptare, por ajo sot pranohet gjerësisht nga shqiptarët dhe, madje, plot institucione arsimore, shëndetësore etj. e mbajnë emrin e saj dhe kjo nuk paraqet problem për shumicën myslimane shqiptare. Për këtë arsye, edhe veprimtarinë publike të ulemasë shqiptare duhet ta shohim në kontekst të përfitimeve që i ka pasur ose i ka sot populli shqiptar. Kështu në kohën e shpërnguljeve të dhunshme të shqiptarëve nga këto troje, një hoxhë shqiptar i Shkupit, Atallah ef, Kurtishi – me origjinë nga f. Studeniçan i Shkupit – lëshon një verdikt fetar (fetfa) se “*Kush shkon në Turqi, është qafir* (renegat).”. Në interpretimin fetar kjo është e padrejtë, sepse Islami askund nuk e përcakton se emigrimi në ndonjë vend të nxjerrë nga feja, por në kontekst të kushteve politike në të cilat jetonin shqiptarët në Maqedoni (atëbotë në Mbretërinë SKS) vetëm një “fetfa” e tillë ishte mundësi që të pengohet shpërngulja. Dhe, bindja e popullsisë ndaj kësaj fetfaje

ishte në përmasa të çuditshme. Njëherë një shqiptar mysliman e pyet një hoxhë në Shkup se *“meqë është haram të shkohet në Turqi, a bën të shkohet në haxhillëk me avion, sepse avioni kalon mbi Turqi?”*. Kjo e shpjegon më së miri ndikimin e madh që e kanë pasur hoxhallarët për ta mbrojtur gjeografinë tonë etnike. Madje, po të ishim krejt të sigurtë, do të duhej ta pranojmë se në kohën kur fetfatë e hoxhallarëve e bënë punën e tyre, shqiptarët nuk u shpërngulën nga këto troje, ndërsa sot kur autoritete nuk janë më hoxhallarët, gjeografia shqiptare gati se po zbrazet tmerërisht dhe tërësisht.

E shikuar në këtë drejtim, kur te shqiptarët e Maqedonisë nuk kishte shkolla ose ato ishin shumë të kufizuara, pikërisht medresetë, mejtepet dhe xhamitë kanë qenë mjedisi që e ka konservuar identitetin shqiptar dhe e ka mbrojtur nga asimilimi dhe nga shpërngulja. Madje, edhe kur dikush merr guximin të flasë se në xhami e në medrese është mësuar vetëm për fe, nuk duhet të harrojmë se ajo fe dhe ai moral u ka shërbyer pikërisht idealeve të mbrojtjes së identitetit shqiptar këtu. Ndoshta qarqet e majta dhe ato laike të sotme, për arsye subjektive, nuk duan t’ia njohin këtë meritë xhamisë dhe mejtepeve, por e vërteta e palëkundur është se pikërisht nëpër ato institucione u mbrojt identiteti jonë etnik dhe nuk u lejua të tjetërsohej. Ta mbash popullatën në këto treva, duke e mbrojtur gjeografinë shqiptare dhe ta pengosh asimilimin dhe ideologjizimin asimilues, kjo në kushte të imponimit agresiv të shpërnguljes dhe asimilimit të dhunshëm, ky është akti më i lartë patriotik në pjesën e dytë të shekullit XX në këtë vend.

Përfundim

Kur problemin e shohim në të gjitha këto dimensione, duhet të konstatojmë se në mungesë të një nacionalizmi shqiptar, kemi një ideologji shqiptare heterogjene, e cila nuk mund të flasë me vlera absolute për identitetin shqiptar.

E kur e kemi shpjeguar se si ka funksionuar dhe si funksionon sot shqiptaria në Maqedoni, kjo do të duhej të ishte leksion për qarqet e shqiptarizmit se si ta integrojnë edhe këtë identitet shqiptar në identitetin e përgjithshëm kombëtar: ku t'ia gjejnë vendin Ataulah ef. Kurtishit, medresesë “Medah”, Fetah Efendi Raufit, Shaban Efendiut, Xhemal Efendiut etj.? Sigurisht që ata nuk kanë qenë shqiptarë të tipit të Fishtës, të Nolit ose të Molla Vehbi Dibrës, por ata janë shqiptarë të tipit të shqiptarisë së zhvilluar në kushtet politike, ekonomike, arsimore e kulturore të shqiptarëve në Maqedoninë e sotme dhe detyra jonë nuk është që t'i gjykojmë ata sipas kriterëve të sotme të interpretimit të shqiptarisë, por duhet t'i vlerësojmë për atë kontribut që e kanë dhënë në kohën e tyre në të mirë të popullatës shqiptare në këto treva.

Nuk është fare hendikep të pranohet se identiteti jonë është heterogjen dhe se për arsye politike etj. ka shfaqur edhe prirje të këtilla, të cilat megjithatë kanë rezultuar në mbrojtje të gjeografisë etnike shqiptare dhe të popullatës shqiptare në këto troje. Dhe, nëse ne jemi gardianë të shqiptarisë si gjeografi, si kulturë dhe si gjuhë, këta njerëz ia kanë dalë, pavarësisht se me rrugë tjetër, ta realizojnë këtë mision dhe ne do të duhet të jemi falënderues për këtë.

Në fund do të duhet të konkludojmë se është shumë antishqiptare të pranohet se ne kemi krizë të identitetit, sepse ashtu do të pranojmë se kemi rrënim të harmonisë të elementeve formësuese të

strukturës së përbashkët, gjë që do ta cenonte vazhdimësinë e kup-timit dhe unitetin si baza të ndjesisë dhe përkatësisë në një tërësi. Ne të gjithë jemi shqiptarë, por secili në mënyrën e tij.

Burimet:

- Anderson Benedict, *Komunitete imagjinare*, dy Lindje & dy Perëndime, Tiranë, 2013
- Frashëri Sami, *Shqipëria ç'ka qenë, ç'është e ç'do të bëhetë*, Logos A, Shkup, 2004
- Gellner Ernest, *Nacionalizmi*, botimet IDK, Tiranë, pa vit botimi
- Golubović Zagorka, *Unë dhe tjetri*, Logos-A, Shkup, 2019
- Hobsmaum Erik, *Kombet dhe nacionalizmi që nga 1780*, Toena, Tiranë, 2012
- Kordić Snježana, *Jezik i nacionalizam*, Durieux, Zagreb, 2010,
- Krasniqi Milazim, *Nacionalizmi shqiptar*, Logos-A, Shkup, 2014
- <https://gruppostudentescoalbanesemilosao.wordpress.com/2012/12/04/tri-format-e-nacionalizmit-shqiptar/>

QENAN ISMAILI

*Bashkësia Fetare Islame në Republikën e Maqedonisë
së Veriut*

ROLI I XHAMISË NË MBROJTJEN E IDENTITETIT KOMBËTAR SHQIPTAR NË MAQEDONI

Hyrje

Zakonisht, kur përmendet xhamia, kjo Shtëpi e Zotit, na vjen ndërmend roli i saj parësor, vendi ku realizohet kushti dytë i Islamit, namazi. Megjithatë, historikisht dhe aktualisht, xhamia ka pasur dhe ka shtrirje më të gjerë të përdorimit, në drejtim të shfrytëzimit të saj për punë e aktivitete të ndryshme në dobi të fesë dhe shoqërisë. Ashtu ishte në kohën e të Dërguarit të fundit të Allahut, Muhamedit [SalAllahu Alejhi ve Selem], kështu është edhe sot, në vende të ndryshme të botës. Xhamia këtë rol ka pasur edhe në trevat tona, duke kontribuar në forma të ndryshme në mbrojtjen e identitetit tonë kombëtar dhe në ruajtjen e trungut të përkatësisë dhe traditave e vlerave tona pozitive shumëshekullore.

Roli i xhamisë në kohën e të Dërguarit [SalAllahu Alejhi ve Selem]

Në kuptimin më të ngushtë të fjalës, xhamia është vendi ku besimtarët muslimanë e adhurojnë Zotin dhe kryejnë ibadetin e namazit. Emri i saj vjen nga rrënja gjuhësore e fjalës “xhami”, e cila në gjuhën arabe quhet “mesxhid”, e që rrjedh nga fjala “sexhede” dhe e ka kuptimin e përkuljes ndaj Zotit, meqë sexhdeja, sipas hadithit

të Pejgamberit [SalAllahu Alejhi ve Selem], është veprimi në namaz ku njeriu është më afër Krijuesit të vet, Allahut të Lartësuar. Në këtë kuptim është edhe Fjala e Zotit Fuqiplotë në Kur'anin Fisnik: *“(ajo dritë) Është në shtëpitë (xhamitë) që Allahu lejoi të ngrihen, e që në to përmendet Emri i Tij, t'i bëhet lutje Atij mëngjes e mbrëmje.”*¹⁷⁰

Zaten, ky është edhe qëllimi kryesor i ndërtimit dhe ngritjes së xhamive mbi sipërfaqen e tokës, pra adhurimi dhe përmendja e Krijuesit Një e të Vetëm. Por, përveç kësaj, xhamitë, gjegjësisht mektebet e tyre, shkollat tradicionale të edukimit fetar, njihen zakonisht edhe si vende ku mësuesit e fesë, mualimët, e mbajnë procesin e mësim-besimit islam. Po ashtu, xhamitë njihen edhe si vende ku realizohen aktivitete të ndryshme me frymë fetare. Përgjithësisht, brenda kësaj kornize të lartpërmendur, funksionojnë sot numri më i madh i xhamive, si në vendin tonë, në rajon, por edhe më gjerë kudo nëpër botë.

Megjithatë, roli i vërtetë i xhamisë si institucion shkon përtej gjërave që i përmendëm më sipër dhe kjo dëshmohet edhe nga mënyra e përdorimit të saj në periudha të ndryshme historike, të largëta qofshin ato, si për shembull nga periudha e artë pejgamberike, ose më të afërta, sikur mund ta shohim këtë brenda trugut tonë kombëtar. Në kohën e Resulullahut [SalAlahu Alejhi ve Selem], xhamia kishte rol shumëdimensional e të shumëfishtë, duke e konsideruar atë edhe si një qendër e rrezatimit mendor, shkencor e kulturor¹⁷¹. Dhe, kjo, jo vetëm për arsyen e mungesës së objekteve të caktuara për aktivitete përkatëse, të cilat sigurisht mund të ndërtoheshin pa ndonjë problem të madh, por, në rend të parë, sepse ishte dëshira e

¹⁷⁰ (Kurani, Nur: 36)

¹⁷¹ Mursi, M. Arti i edukimit të fëmijëve. Shkup, 2009, fq. 190

të Dërguarit të Zotit për t'ia dhënë këtë karakteristikë xhamisë, Shtëpisë së Zotit – përdorimin dhe shfrytëzimin e saj për nevoja e aktivitete nga më të ndryshmet. Kështu, për shembull, në kohën e tij xhamia e luajti rolin e kuvendit popullor, ku u miratua Kushtetuta e Medinës; rolin e institucionit edukativo–arsimor, ku u ngritën intelektualisht shumë breza dhe dolën në pah dijetarë të fushave të ndryshme; rolin e komandës ushtarake, ku u planifikuan ekspeditat dhe prej aty u udhëhoqën betejat e shumta; rolin e qendrës sociale, ku gjetën strehim dhe përkujdesje jetimët dhe shtresat e ndryshme nevojtare të shoqërisë etj.¹⁷²

Xhamia dhe identiteti ynë kombëtar

Në trevat tona shqiptare, në kuptimin më të ngushtë dhe më të gjerë, gjatë historisë, xhamia, përveç rolit të saj parësor si vendfajle e adhurimi, ka luajtur rol të rëndësishëm e madhor edhe në ruajtjen e identitetit tonë fetar e kombëtar. Kjo veçanërisht vjen në shprehje në njëqindvjetëshin e fundit, kur lëvizje dhe ngjarje të caktuara politike e ushtarake bënë që identiteti ynë kombëtar e fetar të jetë në rrezik të vazhdueshëm prej pushtuesve të ndryshëm dhe rendeve të caktuara shtetërore. Ishte kjo periudha kur, në pjesën e parë të shekullit njëzet, synim i armiqve tanë ishte shfarosja dhe dëbimi ynë nga vatrat tona shekullore, ndërsa në pjesën e dytë të shekullit njëzet erdhi plani për asimilimin tonë dhe tjetërsimin identitar përmes formave perfide të një bashkëjetese të imponuar e të rrejshme, të veshur e të maskuar me petkun e vëllazërim–bashkimit.

Në këtë drejtim, në rrafsh mbarëkombëtar, qershori gjithmonë na e përkujton njërën nga ngjarjet më të rëndësishme historike të kom–

¹⁷² Halid, A. Gjurmëve të të Dashurit tonë. Shkup, 2018, fq. 235

bit tonë, Lidhjen Shqiptare të Prizrenit (1878), e cila e zgjoi dhe zhvilloi vetëdijen tonë kombëtare në të gjitha trojet shqiptare, në drejtim të mbrojtjes së qenësisë sonë nga zhdukja dhe organizimit për autonomi e pavarësi. Pavarësisht shtrembërimit dhe falsifikimit që i është bërë kësaj ngjarje nga historia komuniste, në rend të parë në lidhje me vendmbajtjen e saj, kinse në një godinë më të vogël se 50 metra katrorë, e vërteta është se Kuvendi i Lidhjes së Prizrenit u mbajt në xhaminë Gazi Mehmet Pasha, e njohur si xhamia “Bajrakli”, ndërsa në krye të saj ishte Myderriz Ymer Prizreni, i shoqëruar nga shumë hoxhallarë, intelektualë dhe patriotë të tjerë¹⁷³.

Sa i përket rolit të xhamisë në mbrojtjen e identitetit shqiptar në vendin tonë, atë shkurtimisht do ta përmbledhim në disa pika e lëmi vetëm brenda shekullit të fundit. Fillimisht xhamia mund të shihet si mburojë e hoxhallarëve në pengimin e shpërnguljeve masive të shqiptarëve nga trojet tona në gjysmën e parë të shekullit njëzet, që erdhi si pasojë e dhunës dhe gjenocidit të ushtruar serbosllav. Pasojat negative të një eksodi të tillë, në kuptimin e dëmtimit të identitetit tonë kombëtar e fetar përmes pastrimit të paramenduar etnik, i alarmuan dhe aktivizuan strukturat fetare islame, që nga mihrobi e minberi ta pengojnë largimin e njerëzve dhe braktisjen e vendlindjes, kjo përmes këshillave dhe ligjërimeve që si udhërrëfyes i kishin fjalët e të Dërguarit të Zotit, Muhamedit [Sallallahu Alejhi ve Selem]: *“Nuk ka migrim (hixhret) pas çlirimit të Mekës, por ka xhihad, mobilizim dhe vendosje”*¹⁷⁴.

Po ashtu, roli madh i xhamisë në ruajtjen e identitetit tonë kombëtar artikullohet edhe përmes hutbeve të rregullta javore dhe derseve

¹⁷³Gazeta IMPAKT. Historianët: “Kuvendi i Lidhjes së Prizrenit u mbajt në xhaminë “Bajrakli”, 2018.

¹⁷⁴Muslimi. *Sahihul Muslim*. Bejrut, 1488.

e ligjëratave tjera, që i kanë mbajtur hoxhallarët shqiptarë në gjuhën e tyre amtare, e që ka fituar në peshë posaçërisht në periudhën e egër të sistemit monist, kur nuk reshtën tendencat për ta bastarduar gjuhën shqipe përmes toponimeve të imponuara sllave nëpër libra e në media, si dhe përmes tendencës shoviniste të funksionimit të paraleleve të përziera në shkollat e mesme dhe pengimit të arsimit sipëror në gjuhën amtare të studentëve shqiptarë. Në këtë frymë, pra të ruajtjes së identitetit tonë, ka qenë edhe funksionimi dhe aktiviteti i mektebeve në këtë periudhë, ku përveç edukimit të fëmijëve në frymën e besimit dhe të vërtetave fetare e përfitimit të vlerave morale, po ashtu, përmes mësimit në gjuhën shqipe është kultivuar edhe fryma e atdhedashurisë të fëmijët, që i kanë vijuar këto shkolla tradicionale fetare islame nëpër xhami, gjë që ka rezultuar me ndjekjen dhe persekutimin e vazhdueshëm të hoxhallarëve e mualimëve nga pushteti i atëhershëm, pa përjashtuar edhe nxënësit, të cilët i kanë ndjekur këto mektebe dhe prindërit e tyre¹⁷⁵.

Në kohën më të re është për t'u përmendur e veçuar edhe roli dhe kontributi i hoxhallarëve dhe xhamive në strehimin dhe përkujdesjen e refugjatëve të luftërave të fundit në Ballkan, me theks të veçantë këtu të vëllezërve dhe motrave tona që ikën nga vendlindja e tyre në Kosovë, si dhe të atyre që ishin të detyruar t'i braktisin shtëpitë e tyre nga zonat e luftës gjatë konfliktit ushtarak të vitit 2001 në Maqedoni, kur xhamitë u shndërruan në qendra fillestare pranimi, organizimi dhe strehimi të këtyre njerëzve të sprovuar, e pastaj edhe në faktor të rëndësishëm motivimi e frymëzimi për të manifestuar bamirësi e për të dëshmuar treguar solidaritet në drejtim

¹⁷⁵ Aliu, B. Roli i xhamisë në mbrojtjen e identitetit fetar dhe kombëtar në Perëndim. Shkup, 2016, fq. 78

të hapjes së dyerve të shtëpive dhe strehimit të vëllezërve tanë e motrave tona.

Segment në vete në këtë drejtim është edhe fryma ndihmuese dhe altruiste që i ka karakterizuar gjithmonë xhamitë dhe institucionet fetare islame, në kuptim të tubimit të të hollave dhe mbështetjes së projekteve të ndryshme të karakterit kombëtar në vendin tonë, edhe atë në fusha të ndryshme, si: kulturore, edukative e arsimore, humanitare dhe sociale, si dhe në fusha e lëmi tjera ku e ka kërkuar nevoja në momente e periudha të caktuara.

Rrëfim i posaçëm në kuptimin e rolit të xhamisë në ruajtjen e identitetit tonë kombëtar është funksionimi dhe veprimi i xhamive dhe qendrave të ndryshme shqiptare islame në mërgim, gjithandej ku janë shpërndarë e vendosur tashmë me dekada bashkëkombësit e bashkëvendësit tanë të gjuhës e gjakut, në Evropë, Amerikë, Australi e gjetiu. Atje roli i xhamive dhe qendrave shqiptare islame, që nga fillimi i ndërtimit të tyre e deri më sot, e ka tejkaluar dimensionin fetar e shpirtëror, duke shërbyer edhe si vatra të grumbullimit të bashkatdhetarëve tanë, si institucione të ruajtjes dhe kultivimit të gjuhës e traditave, si pikënisje e realizimit të aksioneve dhe aktiviteteve të ndryshme me rastin e datave tona të rëndësishme kombëtare, ndërsa në shumë raste edhe si vatra arsimore në gjuhën shqipe, në mungesë të objekteve të veçanta për këtë qëllim. Këto dhe format e tjera të kontributit të xhamive dhe qendrave islame në Perëndim kanë pasur një ndikim të rëndësishëm në ruajtjen e identitetit kombëtar të bashkatdhetarëve tanë në shtetet e Perëndimit dhe e kanë penguar dukshëm tjetërsimin që e imponon vetvetiu qëndrimin për një kohë të gjatë larg atdheut, posaçërisht kur kihet

parasysh numri i madh i familjeve shqiptare nëpër shtetet e ndryshme perëndimore¹⁷⁶.

Dhe, krejt në fund, tentimi për ta dëmtuar tringun tonë identitar kombëtar e fetar, për fat të keq, vërehet edhe sot e kësaj dite nga individë, faktorë e subjekte të caktuara në Maqedoninë e Veriut, gjë kjo e cila bëhet edhe më qartë përmes obstrukcioneve të ndryshme që i bëhen Bashkësisë Fetare Islame në forma të lloj-llojshme, ndërsa në lidhje me temën që po trajtojmë, përmes pengimit dhe pamundësimit të funksionimit të xhamive në qytete të ndryshme, si për shembull xhamia e Hysamedin Pashës në Shtip, xhamia e Ali Pashës në Ohër, Jeni Xhamia në Manastir, Çarshi Xhamia e Prilepit, e djegur nga nacionalistët maqedonas gjatë konfliktit të vitit 2001 etj. Në lidhje me këto objekte fetare dhe rikt-hinin e tyre në pronësi të vërtetë të Bashkësisë Fetare Islame nuk kanë reshtur aktivitetet dhe angazhimet e kreut dhe strukturave të BFI-së, edhe për faktin se mbizotëron bindja jonë e përgjithshme si institucion fetar se këto xhami, përveç rolit të zakonshëm fetar që do ta kenë, në kuptim të realizimit të predikimeve dhe detyrimeve fetare, po ashtu do të luajnë rol të rëndësishëm edhe në ruajtjen dhe kultivimin e identitetit tonë kombëtar në qytetet dhe viset ku ato gjenden, duke pamundësuar asimilimin dhe tjetërsimin e popullatës shqiptare dhe muslimane të këtyre anëve.

Përfundim

Gjithsesi, roli i xhamisë në mbrojtjen e identitetit tonë kombëtar, në të gjitha trojet etnike shqiptare në përgjithësi, ndërsa në Maqedoninë e Veriut, në veçanti, është i padiskutueshëm dhe i shu-

¹⁷⁶ Po aty, fq. 84-96

manshëm. Megjithatë, për fat të keq, kjo është një fushë jo e hulumtuar sa duhet dhe e papërpunuar mirëfilli.

Prandaj, mendoj se ka nevojë për një shtjellim më të thellë e më të hollësishëm të këtij roli, përmes një bashkëpunimi të ngushtë mes Bashkësisë Fetare Islame dhe institucioneve tona shkencore, arsimore e akademike, për ta nxjerrë në pah kontributin e xhamive në veçanti dhe të institucioneve fetare islame në përgjithësi në drejtim të ruajtjes dhe afirmimit të identitetit tonë kombëtar. Le të shërbejë kjo konferencë si hapi parë nismëtar në këtë drejtim.

MURTEZAN IDRIZI

*Instituti i Trashëgimisë Shpirtërore e Kulturore
të Shqiptarëve – Shkup*

VEPRIMTARIA KOMBËTARE DHE FETARE E XHEMAL EFENDISË NË BURIMET ARKIVORE

Hyrje

Xhemail Xhemaili, i njohur si Molla Xhema ose Xhemal Efendiu, ishte fryma e shkollës së hoxhë Ataullah Kurtishit, përkatësisht me-dresesë “Medah”. Pas Ataullah Hoxhës, kësaj fryme i priu Fetah Efendiu, që ishte krah i djathtë i Hoxhës. Përveç predikimit të fesë, synimi i kësaj shkollë ishte pengimi i shpërnguljes së shqip-tarëve për në Turqi. Ky lloj ligjërimi ishte në kundërshtim me sis-temin jugosllav, sepse i prishte planet serbe për deportimin e shqip-tarëve nga tokat e tyre, andaj këta hoxhallarë do të përndiqeshin dhe do të burgoseshin.

Në gjeneratën e tretë të kësaj vije do të jetë edhe Xhemal efendiu, sikurse edhe bashkëveprimtarët e tij: Ferat Efendiu, Mehmet Efen-diu etj.. Xhemal Efendiu ishte hoxhë në plotkuptimin e fjalës, i përgatitur në aspektin akademik, i talentuar për detyrë e tij dhe shumë i shkathtë në veprimtarinë publike. Përveç gjuhës shqipe, si gjuhë amtare, ai e fliste mirë maqedonishten, turqishten dhe ara-bishten. Që në rini ishte dëshmuar me atdhedashuri dhe gatishmëri për t’u përballur me dukuritë negative të kohës. Gjatë gjithë jetës së tij mbeti një antikomunist i paepur. Në vijën kombëtare ka qenë personalitet shumë i vendosur, për çka dëshmon bashkimi i tij me

krerët e Lëvizjes Kombëtare për Çlirim dhe Bashkim (LKÇB), një organizatë nacionaliste e atdhetare shqiptare, e themeluar në Shkup, menjëherë pas kapitullimit të Mbretërisë Jugosllave (prill 1941), në krye të së cilës ishte veprimtari i shquar shqiptar nga Kumanova, Shaban Efendiu¹⁷⁷. Më vonë, përkatësisht pas kapitullimit të Bullgarisë (9 shtator 1944), ku – siç dihet – fushëgropa e Kumanovës iu bashkua administratës shqiptare, Xhemal Efendiu u përfshi në shtabin ushtarak të nënprefekturës së Mateçit, që në popull njihet shtabi i Sul Hotlës. Përveç kësaj, Xhemal Efendiu ka qenë edhe komandant i një njësie ushtarake, që kishte luftuar kundër ripushtimit të këtyre tokave nga forcat komuniste jugosllave/

Fëmijëria e Xhemalit

Në bazë të dokumentacionit, Xhemal Efendiu ka lindur më 16 maj 1914 në fshatin Nikushtak të Kumanovës¹⁷⁸. Megjithatë, të dhënat familjare flasin se Xhemal Efendiu është i lindur më 6 maj 1913¹⁷⁹. Ai i takonte një familje me standard të mesëm ekonomik. Babai i tij quhej Emin, e ëma e tij quhej Nazife, kurse bashkëshortja e tij quhej Shasine Ilazi. Ai rrjedh nga një familje me tradita fetare me plot devotshmëri.

Që në moshën pesëvjeçare e dërguan te hoxha i fshatit, Ramiz Efendiu, për ta mësuar leximin e Kuranit. Meqë Ramiz Efendiu e kishte vërejtur talentin e Xhemalit të njomë, u sugjeroi prindërve të tij që ta dërgojnë në medresenë e Kumanovës. Kështu ai regjistrohet në këtë shkollë dhe atë e përfundoi me sukses. Por, nuk u ndal as këtu. Shkollimin e vazhdoi në medresenë “Medah” në Shkup

¹⁷⁷ Qerim Lita, Shaban Efendia – atdhetar i devotshëm, Kumanovë 2010, fq. 89.

¹⁷⁸ ДАРМ, 1.885, Д. 1645, стр.1.

¹⁷⁹ Taxhedin Bislimi, “Medreseja Medah” e Ataullah Efendiut dhe nxënësit e saj, Shkup, 2011, fq.160.

pranë Ataullah Hoxhës¹⁸⁰. Derisa ishte nxënës në “Medah”, ai dëshmoi talent të përkryer dhe u aftësua për ligjërata. Gjatë muajit të Ramazanit shërbeu si hoxhë në disa fshatra, si në Sllupçan e Li-kovë, por edhe në fshatra të tjerë të Kumanovës. Madje, qysh duke qenë gjallë Ataullah Hoxha, me autorizimin e tij, Xhemali i ri u mbante ligjërata edhe gjeneratave të reja në medresenë e Hoxhës¹⁸¹. Burimet e proveniencës policore jugosllave vënë në dukje se Xhemal Efëndiu studioi plot 14 vjet në medresenë “Medah”, të cilën shteti e konsideronte si shkollë arabe¹⁸².

Organizimi i shqiptarëve jashtë kufijve të Shqipërisë

Para se të flitet për personalitetin e Xhemal Efëndiut, ia vlen të bëhet një kronologji për ngjarjet dhe organizimet e shqiptarëve për t’i mbrojtur trojet e tyre. Në vitin 1918 në Shkodër do të formohet Lëvizja e Kaçakëve e cila do të zgjerohet deri në Shkup dhe në viset e Kosovës. Qëllimi i kësaj lëvizje ishte që t’i mbrojë tokat shqiptare nga agresioni i shteteve fqinjë. Këta të fundit vazhdimisht ishin në ofensivë drejt kufijve shqiptarë. Serbët vazhduan me uzurpimin e tokave të shqiptarëve edhe atë pas pavarësimit të Shqipërisë. Sipas dokumenteve serbe, qendra e lëvizjeve kombëtare shqiptare ka qenë Shkupi¹⁸³.

Organizimet ishin të ndryshme, duke filluar me “Xhemijetin” e Ferhat Dragës, ndërsa më vonë vijon në këtë rrugë “Komiteti për Mbrojtjen e Kosovës”. Në këtë vijë do të vazhdojnë edhe organi-

¹⁸⁰ Taxhedin Bislimi, vepër e cit., fq.160.

¹⁸¹ Po aty, fq.160.

¹⁸² ДАРМ, 1.885, Д. 1645, стр.10.

¹⁸³ Qerim Lita, SHABAN EFENDIA atdhetar i devotshëm, botim privat, Kumanovë, 2010, fq. 35.

zata studentore “Besa” në Beograd¹⁸⁴. Komiteti për Mbrojtjen e Kosovës u zgjerua shumë në Karadakun e Kumanovës, ku më i zëshëm ishte Shaban Efendiu, i cili mendohej ta pengojë shpërnguljen e shqiptarëve për në Turqi. Rrjeti i Shaban Efendiut në Karadak të Kumanovës përkrahej nga nxënësit e tij¹⁸⁵.

Në vazhden e lëvizjeve, tashmë, aktivitetin e Komitetit do ta vazhdojë “Lëvizja Kombëtare për Çlirim e Bashkim”, që në opinion njihet si krahu opozitar shqiptar i “Bojali Hanit”¹⁸⁶. Në tokat që i mori ushtria bullgare, shqiptarët trajtoheshin njësoj si ushtria jugosllave. Okupatori i vjetër shkoi, erdhi një i ri, ai bullgar. Në lidhje me ngjarjet e reja “Lëvizja Kombëtare për Çlirim e Bashkim” më 19 prill 1941 mbajti një konferencë në vendin “Bojali Han”¹⁸⁷. Temë boshte në këtë konferencë mendohet të ishte rreziku që u kanosej tokave shqiptare, siç ishin Gjilani, Presheva, Kumanova dhe Shkupi. Angazhimi i “Lëvizjes Kombëtare për Çlirim e Bashkim” ishte që këto troje t’i bashkohen Shqipërisë Etnike¹⁸⁸. Nga kjo mbledhje do të themelohet edhe grupi delegates, i cili do të shkojë në shtetin amë për t’i njoftuar me ngjarjet dhe për të marrë këshilla. Delegacioni që doli nga LKÇB–ja, në krye me Shaban Efendiu, shkoi në Dibër e pastaj në Tiranë, ku u takuan me figura politike. Në Tiranë u takuan me Fuat Dibrën – këshilltar politik i qeverisë së Shëfqet Vërlacit. Nga ai morën garanci se Shqipëria do të bëjë çmos që vendet që gjenden nën okupimin bullgar dhe gjerman, t’i bashkohen Shqipërisë¹⁸⁹.

¹⁸⁴ Po aty, fq. 37.

¹⁸⁵ Po aty, fq. 77.

¹⁸⁶ Qerim Lita, SHABAN EFENDIA atdhetar i devotshëm, botim privat, Kumanovë, 2010, fq. 79.

¹⁸⁷ Po aty, fq. 91.

¹⁸⁸ Po aty, fq. 93.

¹⁸⁹ Po aty, fq. 96-97.

Kësaj lëvizjeje më vonë do t'i bashkëngjiten edhe shumë hoxhallarë të tjerë nga fshatrat e Kumanovës, ndër të cilët ishte edhe Xhemal Efendiu. Shkupi ishte qyteti që më së shumti e përkrahu Lëvizjen Kombëtare. Me bashkimin e dy krahëve fetar në Shkup, krahu i Ataullah hoxhës dhe ai i Said Hoxhës, qyteti i Shkupit u bë një qendër e Lëvizjes Kombëtare për Çlirim e Bashkim¹⁹⁰. Kjo jep të kuptohet se, në sajë të hoxhallarëve, lëvizja në fjalë do të përhapet në të gjitha trevat që ishin nën okupimin bullgar. Kjo lëvizje më vonë do të emërtohet “Lëvizja për Bashkimin e Tokave Shqiptare”, që pastaj të riemërtohet në “Lëvizja Nacional Demokratike Shqiptare”¹⁹¹. Nga trajtesa duket qartë se Ataullah hoxha dëshironte që t'i afrojë shqiptarët me turqit në qytetin e Shkupit kundër bullgarëve. Nga ana tjetër, krahu i Said hoxhës duket të ishte më shumë i dhënë në mbrojtje të kauzës shqiptare¹⁹².

Ta përmendim edhe atë se në Prizren më 16–21 shtator 1943 për së dyti themelohet Lidhja e Prizrenit¹⁹³. Asaj kohe nënprefektura e Mateçit të Kumanovës, ku vepronte Xhemal efendiu ishte nën koordinimin e Komitetit Qendror të Lidhjes II të Prizrenit. Në vitin 1944 kundër Lidhjes II të Prizrenit ishte edhe Partia Komuniste në Shqipëri dhe ajo në Beograd¹⁹⁴.

Beogradi e përcillte shumë me kujdes organizimin e shqiptarëve. Në momentin që do të largohej okupatori i lartpërmendur, ata ishin të gatshëm të fillojnë ofensivë në drejtim të Kumanovës. Më 24 shtator 1944 forcat partizane u nisën në drejtim të tokave shqiptare,

¹⁹⁰ Po aty, fq. 101.

¹⁹¹ Po aty, fq. 104.

¹⁹² Po aty, fq. 108.

¹⁹³ Qerim Lita, KQ. i NDSH-së dhe Azem Morana, Logos-A, Shkup 2011, fq.32.

¹⁹⁴ Qerim Lita, SHABAN EFENDIA atdhetar i devotshëm, botim privat, Kumanovë, 2010, fq. 149.

ata do të ndeshen me vullnetarët shqiptarë te vendi Guri i Zi. Ky vend është ndërmjet fshatrave Strinë dhe Brezë. Lufta ishte shumë e ashpër dhe viktima kishte në të dyja anët¹⁹⁵. Edhe muaji tetor 1944 kaloi në përleshje mes partizanëve dhe vullnetarëve shqiptarë nën koordinim të Lidhjes II të Prizrenit – njësia e Karadakut të Kumanovës¹⁹⁶. Më 17 nëntor pikërisht në fshatrat Miratoc, Llojan, Vaksincë, Rainicë dhe Zhunicë ndodhën luftëra të ashpra mes partizanëve dhe vullnetarëve shqiptarë¹⁹⁷. Fundi i vitit 1944 ishte me plot gjakderdhje. Aradhet e partizanëve, duke hyrë nëpër fshatrat e banuara me shqiptarë, bënë vrasje, arrestime, dëbime me dhunë dhe i uzurponin pronat e shqiptarëve. Rasti i fshatit Bllacë, që ndodhi më 18–19 nëntor 1944, është një dëshmi konkrete, sepse aty u pushkatuan të gjithë burrat e fshatit¹⁹⁸.

Shqiptarët e kishin të qartë qëllimin e shteteve fqinje, andaj edhe organizoheshin ashtu siç duhej. Për organizimin e shqiptarëve kontribut të veçantë luajtën hoxhallarët e këtyre trojeve, të cilët në kohë të duhur e informuan popullatën shqiptare për qëllimet e armiqve ndaj tokave shqiptare. Ashtu edhe ndodhi – më 9 shtator 1944 në Mateç u mbajt tubimi i shqiptarëve të kësaj ane. Ndër krerët më të njohur që morën pjesë në atë tubim ishin Sylë Hotla, molla Hajdari, Jetullah Seferi, Ali Staneci, Azem hoxha, Ferat efendi, Enver Destani, Hamzë Bellanoci, Iljaz efendi, Xhemal efendi, Murat Jusufi, Ramadan Qazimi, Shukri Osmani¹⁹⁹. Në këtë

¹⁹⁵ Po aty, fq. 161.

¹⁹⁶ Po aty, fq. 169.

¹⁹⁷ Po aty, fq. 174.

¹⁹⁸ Po aty, fq. 178.

¹⁹⁹ Po aty, fq. 149.

tubim foli Sulë Hotla, i cili, veç tjerash, tha: “Nëse dikush tradhton, do të pushkatohet”²⁰⁰.

Pas fjalimit të Sulë Hotlës në fshatin Mateç, u formuan dy shtabe: shtabi politik dhe shtabi ushtarak. Shtabin politik e udhëhiqte nënprefekti i Mateçit, Abdullah Ebibi i Hotlës, i njohur si molla Dulla, ndërsa anëtarë ishin molla Hajdari si komisar politik, Nijazi Osmani si sekretar, molla Iljazi nga fshati Mateç, molla Xhemali nga fshati Nikushtak²⁰¹, Refik Hasani nga fshati Sllupçan dhe Nezir Rahmani nga fshati Llojan. Ndërkaq shtabin ushtarak e udhëhiqte Sylë Hotla dhe Azem Hoxha²⁰².

Në lidhje me turbulencat që ndodheshin në hapësirat e Karadakut të Kumanovës, shërbimet shtetërore – me bashkëpunëtorët e tyre – e përcillnin situatën me shumë kujdes. Sidomos e ndiqnin grupin e Sulë Hotlës, kush i printe kësaj lëvizje, kush inkadrohej në të etj. Një ndër figurat e kësaj lëvizjeje që përndiqej nga shërbimet ishte edhe Xhemal Efendiu. Nga burimet arkivore mësojmë se Xhemal Efendiu mbante lidhje të ngushta me dy figurat e shquara të Dervenit të Epërm: hafiz Abdulla Abdullahun nga Zhelina dhe mulla Garip Beadinin nga Grupçini. Lidhje të ngushta politike, fetare, kombëtare e shoqërore mbante edhe me bashkëfshatarin e tij, Ferhat Ibrahim, i njohur në popull si Ferhat Hoxha, ndërsa pati lidhje të drejtpërdrejta edhe me ushtarakun e njohur të kësaj ane, Sulë Hotlën²⁰³. Xhemal Efendiu mund të llogaritet si një urë që e lidhte grupin e hoxhallarëve të dalë nga medreseja e Ataullah hoxhës dhe grupin e lëvizjes së Sulë Hotlës.

²⁰⁰ Taxhedin Bislimi, vepër e cit., fq.163.

²⁰¹ Po aty, fq.162.

²⁰² Qerim Lita, SHABAN EFENDIA atdhetar i devotshëm, botim privat, Kumanovë, 2010, fq. 150.

²⁰³ ДАМ, 1.885, Д. 1645, стр.2.

Veprimtaria kombëtare e Xhemal Efendiut

Veprimtaria e Xhemal Efendiut është shumëdimensionale. Ajo ka karakter kombëtar dhe fetar. Si një njeri me formim teologjik islam, ai ishte një hoxhë i pjekur, ndërsa si një shqiptar që kujdesej për popullatën e tij, ishte një veprimtar i dalluar i çështjes shqiptare. Kështu në shtëpinë e Xhemal Efendiut në fshatin Nikushtak mba-heshin mbledhje, ku merrnin pjesë Ataulloh Hoxha nga Shkupi dhe Sulë Hotla dhe në ato takime rëndom diskutohej për Shqipërinë Etnike. Në disa raste në ato mbledhje prezantonte edhe Fetah Efendi Raufi nga Shkupi. Synimi i Xhemal Efendiut ishte krijimi i Shqipërisë Etnike²⁰⁴. Madje, edhe para se të bëhet anëtar i Ballit Kombëtar, Xhemal Efendiu e ndihmonte vazhdimisht Sulë Hotlën, duke u dërguar ushqim dhe gjëra të nevojshme për mbijetesë²⁰⁵.

Pasi u anëtarësua në lëvizjen e Sulës, Xhemal Efendiu edhe më shumë fitoi besim në syrin e tij. Burimet sekrete jugosllave nxjerrin në pah se nga hoxhallarët e fushëgropës së Kumanovës, të cilët iu bashkëngjiten shtabit të Sul Hotlës, Xhemal Efendiu ishte i vetmi që mbante pushkë automatike.

Për ta kuptuar ma mirë veprimtarinë kombëtare dhe fetare të Hoxhës, do ta sjellim dëshminë e tij para organeve të hetuesisë, të cilën e dha më datë 6 qershor 1947. Nga procesverbali i përpunuar nga shërbimi mësojmë²⁰⁶ se organet e hetuesisë ia parashtruan disa pyetje. Në përgjigjet e Xhemal Efendiut shihet edhe burrëria edhe vendosmëria e tij në kauzën që ai e mbronte. Këtë po e ilustrojmë me dialogun e tij me hetuesin.

²⁰⁴ ДАМ, 1.885, Д. 1645, стр.9.

²⁰⁵ ДАМ, 1.885, Д. 1645, стр.9.

²⁰⁶ ДАМ, 1.885, Д. 1645, стр.32.

Hetuesi: Ku ishte nga viti 1941 deri në kapitullimin e Bullgarisë? (po theksojmë se bullgarët qëndruan si okupatorë në këto vise të Maqedonisë së sotme katër vjet: nga viti 1941 e deri më 1944 – M.I.)²⁰⁷.

Xhemal Efendiu: Gjatë kësaj kohe isha në Shkup në medresenë e Ataulah Hoxhës. Kjo zgjati deri në vitin 1944. Atëherë e përfundova shkollimin dhe u ktheva në fshatin Nikushtak. Në fshat qëndrova deri para muajit të Ramazanit. Në muajin gusht të po të njëjtit vit shkova në fshatin Ramanli si hoxhë për Ramazan. Gjatë kësaj kohe ndodhi edhe kapitullimi i bullgarëve.

Hetuesi: A e kishte themeluar Sulë Hotla gjatë kësaj kohe shtabin dhe si u anëtarësive ti?

Xhemal Efendiu: Shtabi ishte i formuar. Sula kërkoi nga unë që të anëtarësohem dhe të organizohemi kundër partizanëve, derisa të vijë një fuqi e madhe.

Hetuesi: Si mund të mendoni në fuqi të madhe kur këtu ishin gjermanët?

Xhemal Efendiu: Ne nuk trembeshim nga gjermanët, por frika ishte se po që se largoheshin ata, në vendin e tyre do të vinin partizanët...²⁰⁸.

Hetuesi: Kush ishit anëtarët e shtabit?

Xhemal Efendiu: Përveç meje, ishte edhe Molla Xhaferi nga fshati Mateç, Molla Iliazi nga fshati Mateç, Molla Hajdari nga fshati Orizare, Molla Dulla nga fshati Hotël dhe Ferat Hamiti, i cili ishte këshilltari suprem.

Hetuesi: Pse në shtabin e Sulës të gjithë ishit hoxhallarë?

²⁰⁷ Qerim Lita, SHABAN EFENDIA atdhetar i devotshëm, botim privat, Kumanovë, 2010, fq. 143.

²⁰⁸ ДАРМ, 1.885, Д. 1645, стр.32.

Xhemal Efendiu: Ne hoxhallarët në shtabin e Sulë Hotlës gëzonim shumë autoritet dhe kishim mundësi ta afrojmë popullin me këtë shtab.

Hetuesi: Çfarë obligimi kryenit ju?

Xhemal Efendiu: Detyra jonë ishte për t'i përfutur njerëzit në anën tonë. Ne hoxhallarët shkonim në çdo fshat dhe e ftonim popullin kundër partizanëve, sepse partizanët dëshirojnë të na robërojnë, të na i shkatërrojnë xhamitë, të na e prishin fenë, të na i zbulojnë gratë. Këto gjëra i kamë thënë edhe para xhematit në fshatin tim Nikushtak. Me këtë arritëm që ta afrojmë popullin me lëvizjen e Ballit Kombëtar.

Hetuesi: Çfarë roli kishe ti?

Xhemal Efendiu: Unë, si anëtar i shtabit, përveç që e ftoja popullin kundër partizanëve, isha edhe komandant i sektorit operativ në vendin "Vllain Grob". Në afërsi prej një e gjysmë apo dy kilometra larg nga vija e luftës kemi zhvilluar operacione direkte me partizanët dhe kemi pasur një të lënduar²⁰⁹.

(Në një burim tjetër arkivor mësohet se molla Xhema ka qenë figurë kyçe në shtabin e Sulës – M.I.)

"Hetuesi: Sa partizanë janë vrarë me urdhër të shtabit?

Xhemal Efendiu: Nuk e kam të njohur se është vrarë ndonjë partizan.

Hetuesi: A ka ardhur dikush nga Shkupi tek shtabi i juaj?

Xhemal Efendiu: Njëherë kishte ardhur Memed Sadiku, por unë nuk kam qenë aty dhe nuk e di çfarë kanë biseduar me Sulën. Në prezencën time kanë ardhur Abdulla dhe Gani Selimi nga Shkupi, me qëllim që të na afrojnë ose të na pajtojnë me partizanët. Gjith-

²⁰⁹ ДАРМ, 1.885, Д. 1645, стр.33.

hashtu ka ardhur edhe Feta Beli Hani i, cili qëndroj afër dy orë në biseda me Sulën, por unë nuk e di çka kanë biseduar.

Hetuesi: A ka pasur Sulë Hotla takime me ndonjë figurë fetare nga Shkupi?

Xhemal Efendiu: Në shkurt të vitit 1944, kur hoxha Feta Raufi u evakuua nga Shkupi për shkak bombardimit të qytetit, ai erdhi tek unë në fshatin Nikushtak. Ndërkohë erdhi edhe Sula, por nuk u bisedua diçka e rëndësishme. Ndërkaq në tetor 1944 Feta Efendi Raufi erdhi përsëri po në të njëjtin vend tek unë dhe atëherë erdhi edhe Sula, por edhe Memed ef. Sadiku nga Grushina. Në këtë ta-kin u mor vendimi që të mbahet fronti kundër partizanëve derisa të vijë një fuqi e madhe (mendohet për anglo-amerikanët – M.I.)...

Hetuesi: Si e shihni Feta Raufin?

Xhemal Efendiu: Feta efendi Raufi është njëri i besueshëm, i arsimuar dhe i vjetër në moshë.

Hetuesi: Çka bëtë pas çlirimit?

Xhemal Efendiu: Në kohën ndërmjet viteve 1944 dhe 1945 qëndruam në Shkup. Dymbëdhjetë ditë u fsheha te Feta Efendi Raufi. Pastaj u kthyem në fshatin Nikushtak, ku qëndrova i fshehur deri në paraqitjen time para pushtetit²¹⁰.

Hetuesi: Pas çlirimit bullgar çfarë armiqësie ke pasur ndaj Federatës Nacionale Popullore Jugosllave?

Xhemal Efendiu: Në vitin 1945 u takova me Sulë Hotlën në vendin “Arabishte”, në afërsi të fshatit Nikushtak. Për këtë takim më ftoi Zijadin Rexhepi, ndërsa aty ishte prezent djali i Sulës, Destani, Aliu nga fshati Brezë dhe Eshtrefi nga Likova. Në këtë takim u vendos që të qëndrojmë stoik ndaj pushtetit jugosllav dhe të orga-

²¹⁰ ДАРМ, 1.885, Д. 1645, стр.34.

nizohemi në çdo fshat për një Shqipëri etnike nën lëvizjen e Mit'hat Frashërit.

Hetuesi: Pas kësaj mbledhjeje çfarë biseduat?

Xhemal Efendiu: Unë u takova me shokun e vjetër, tek i cili kisha besim – Nijazi Osmani.

Hetuesi: Çka ke bërë diçka tjetër kundër Republikës Popullore Federative Jugosllave?

Xhemal Efendiu: Edhe nga dy tri herë kemi zhvilluar biseda politike kundër RPFJ-së me shokun tim Nijazi Osmani. Kam thënë se “kështu më nuk shkon; në asnjë konferencë ndërkombëtare nuk sillet paqja; kështu që do të plasë sherri mes koalicionit Angli–Amerikë kundër Rusisë, me ç’rast do të fitojë koalicioni Angli–Amerikë”. Këtë e kam thënë²¹¹.

Në të vërtetë, gjatë kësaj kohe shërbini sekret kishte depërtuar thellë në privatësinë e Hoxhës. Në çdo hap që ai e bënte, atë e ndiqnin nga afër nëpërmjet bashkëpunëtorëve të tyre (shqiptarë). Kështu nuk kaloi as një muaj që kur ishte marrë në pyetje, Sigurimi Shtetëror i Brendshëm (UDB) përsëri më 10 korrik 1947 e mori në pyetje Hoxhën. Por, edhe në këtë seancë Xhemal Efendiu pa fije frike nga organet e hetuesisë përgjigjet njësoj si në herën e parë. Meqë pyetjet ishin gati të njëjta me ata të seancës së parë, ne do t'i japim vetëm hollësitë që nuk janë në seancën e parë:

Hetuesi: Çfarë qëndrimi kishe ndaj Luftës Nacionale Çlirimtare?

Xhemal Efendiu: Qëndrimi im ishte kundër Luftës Nacionale Çlirimtare.

Hetuesi: Cilat ishin arsyet e tua që të jesh kundër LNÇ-së?

Xhemal Efendiu: Derisa isha pranë hoxhës, Fetah Efendisë, ai ishte shumë kundër partizanëve. Unë u ndikova nga ai.

²¹¹ ДАРМ, 1.885, Д. 1645, стр.35.

Hetuesi: Çfarë vendime sillte shtabi?

Xhemal Efendiu: Vendimet ishin që luftën kundër partizanëve ta vazhdojmë deri në fund, kur ta bëjmë Shqipërinë etnike... ne do të vazhdonim të luftojmë derisa të vinin anglo-amerikanët.

Hetuesi: Kush tjetër vinte në shtab?

Xhemal Efendiu: Njëherë kishte ardhur Mehmet Efendi Sadiku nga Shkupi dhe kishin biseduar në lidhje me përleshjet në teren. Në fund të takimit Mehmet Efendiu e kishte përgëzuar Sulën për Shqipërinë etnike...Në muajin shkurt të vitit 1944 tek unë në fshatin Nikushtak erdhi edhe Fetah Efendi Raufi. Atëherë aty erdhi edhe Sulë Hotla dhe ky ishte takimi i tyre i parë. Në këtë takim nuk u diskutua diçka shumë e rëndësishme. Më 10 tetor 1944 përsëri erdhi Fetah Efendiu dhe njëkohësisht erdhi edhe Mehmet Efendiu nga Grushina. Ata qëndruan tek unë në Nikushtak dy-tre ditë, por qëllimi i tyre ishte të shkojnë në fshatin Mateçë te Sula. Nuk i kam të njohura vendimet e këtij takimi, por e di se të njëjtën ditë u kthyen tek unë në fshatin Nikushtak. Të nesërmen unë dhe Mehmet Efendiu përsëri shkuam te shtabi i Sulës në Mateç, sepse kishim mbledhje. Në mbledhje isha unë, Mehmet Efendiu, Sula, Mulla Xhaferi dhe Refik Sllupçani. Në këtë mbledhje vendosëm për një armëpushim me partizanët, kuptohet nëse ata pranonin.

Hetuesi: A ndërmorët ndonjë hap konkret për ta ndërprerë përleshjen me partizanët?

Xhemal Efendiu: Me Sulë Hotlën kemi shkruar një letër drejtuar partizanëve për një armëpushim. Sula më angazhoi mua që unë t'ua përcjell letrën. Unë e mora letrën dhe ia dorëzova personit me emrin Nevzat Demiri nga fshati Nikushtak. Ai e përcolli deri te partizanët. Nuk e di se a kishin njohuri Fetah Efendiu dhe Mehmet Efendiu për përmbajtjen e letrës. Në letër shkruam se nuk do t'i

sulmojmë partizanët dhe se ata mundë të kalojnë lirshëm në rrugën që e lidh Karadakun me fshatrat Mojançë dhe Haraçinë.

Hetuesi: Pasi dërguat letërgaranci se nuk do t'i sulmoni partizanët, a keni luftuar me ta?

Xhemal Efendiu: Edhe pse në letër u garantuam se nuk do të luftojmë kundër partizanëve, ne kemi vazhduar me sulme ndaj tyre në vendin "Vllain Grob"

Hetuesi: Me çfarë qëllimi premtuat armëpushim dhe përsëri luftuat ndaj tyre?

Xhemal Efendiu: Ne u premtuam se nuk do t'i sulmojmë derisa nuk i shkelin kufijtë që ne i kontrollonim, por ata dëshironin të hyjnë në territoret ku ishim ne.....

Hetuesi: A ke vepruar diçka kundër pushtetit popullor?

Xhemal Efendiu: Edhe pasi u dorëzova, kemi biseduar me Nijazi Osmanin se patjetër të ndryshohet ky pushtet dhe se do të ndodhë lufta mes anglo-amerikanëve dhe Rusisë, ku fitues do të dalin amerikanët”²¹².

Pa kaluar edhe një ditë nga dëgjimi në hetuesi, Prokurori Publik i Shkupit më 11 korrik 1947, në pajtim me kërkesën nr: 5400 të datës 10.07.1947, që e dërgoi Sigurimi Shtetëror i Brendshëm (UDB) për Maqedoni, kërkoi hetim me paraburgim për vepr penale ndaj Xhemal Emin Xhemailit dhe Ferat Ibrahimit, që të dy nga fshati Nikushtak. Prokuroria e miratoi këtë kërkesë dhe për këta dy persona ngriti akuzë për vepr penale kundër popullit dhe shtetit, për strehimin e njerëzve të Ballit Kombëtar, përkatësisht të Lëvizjes Nacional Demokratike Shqiptare. Motivi i burgosjes ishte se menjëherë pas kapitullimit të Bullgarisë, këta dy siç thuhet në aktakuzë: “u bënë anëtarë të Ballit Kombëtarë në krye me Sulë Hotlën,

²¹² ДАМ, 1.885, Д. 1645, стр.35-36, 43-44.

me seli në fshatin Mateç”. Gjithashtu motiv tjetër ishte edhe se ata e “ndihmuan Ballin Kombëtar”, duke i strehuar dhe duke u krijuar hapësirë atyre për të qëndruar në ilegalitet²¹³. Nga dosja personale e sigurimit shtetëror del se Xhemal Efendiu ishte “armiku kryesor për shtetin” dhe përfaqësues i “Ballit Kombëtar”²¹⁴. Motiv tjetër për burgosje përmendet edhe gjoja “lidhja e Xhemal Efendiut me okupatorët bullgar”,²¹⁵ diçka që nuk përputhet me realitetin.

Xhemal Efendiu qëndroi në burg stoik, pa u luhatur aspak nga qëndrimet që i kishte. Edhe pse ishte dobësuar shumë fizikisht, kishte humbur shumë kilogramë, ai aspak nuk devijoi nga kauza për një Shqipëri etnike, demokratike pro anglo-amerikane. Dënimin e vuajti në burgun e Idrizovës në Shkup²¹⁶. Pas përfundimit të dënimit, më 1953 lirohet nga burgu²¹⁷.

Xhemal efendiu pasi doli nga burgu

Personi i shërbimeve me nofkën “Besa” tregon se më 14 korrik 1953 e ka vizituar Xhemal Efendiun dhe e ka dëgjuar me vëmendje rrëfimin e tij, siç vijon:

“Burgu ishte i mbushur me plot njerëz. Vërtet ishte një tmerr burgu. atë nuk do ta harroj kurrë... Në burg kishte edhe serbë edhe bullgarë, por ne shqiptarët e kemi paguar më shtrenjtë se gjithë të tjerët. Këta maqedonasit po e shurdhojnë popullin me fjalë të kota. Ka nga shqiptarët që e ndihmojnë palën maqedonase. Kanë kaluar shumë fuqi të ndryshme nëpër këto treva, por një ditë u shkatërruan edhe ato. Ne kemi qenë kundër frymës komuniste dhe këtë e

²¹³ ДАПМ, 1.885, Д. 1645, стр.36-37.

²¹⁴ ДАПМ, 1.885, Д. 1645, стр.1.

²¹⁵ ДАПМ, 1.885, Д. 1645, стр.9.

²¹⁶ ДАПМ, 1.885, Д. 1645, стр.10.

²¹⁷ ДАПМ, 1.885, Д. 1645, стр.9.

kemi paguar me gjak (me viktima). Nuk ka rëndësi pse kam fjetur 6 vjet në burg, sepse komunistët na luajtën në fjalë dhe na punuan pas shpine. Erdhën shumë njerëz nga Shqipëria për të ndihmuar, sepse e dinin se ku flitej shqip do të jetë Shqipëri. Pas gjithë kësaj që ndodhi tek ne, duhej që në çdo vend ku shqiptarët ishin shumicë, të jenë dy shqiptarë e një maqedonas. Jugosllavia po thirrej në parullën e vëllazërim–bashkimit, që nuk ka qenë kurrë”.

Në fund të bisedës Xhemal Efendiu, i drejtohet “Besës” me fjalët:

“Çfarë të drejta kemi ne? A kemi shkolla ku mësohet Kurani? Pse na hiqet ferexheja? Vëllazërim–bashkimi nuk është diçka tjetër, pos një parullë boshe”²¹⁸.

Veprimtaria fetare Xhemal Efendiut njihet nëpërmjet akuzave që ia bëri shteti

Akuzat ndaj Hoxhës ishin të ndryshme, ndonëse ishin të pabaza. Sa më shumë që akuzohej, aq më shumë autoriteti i rritej. Ai i thoshte drejtpërdrejt pushtetit se ju do të largoheni nga këto troje dhe se këtu do të vijnë anglo–amerikanët. Po ashtu përmendet armiqësia që kishte ndaj pushtetit jugosllav dhe, gjoja, “bashkëpunimi i tij me bullgarët”²¹⁹. Me një fjalë, akuzat ndaj hoxhës ishin nga më të ndryshmet.

Bashkëpunëtorët e shtetit u munduan që personalitetin e Hoxhës ta njollosin me lloj–lloj akuzash. Në një raport tjetër të sigurimit shtetërorë, ku ishte i ftuar bashkëpunëtori me nofkën “Karadaçki”, ai thotë se me datë 25 janar 1965 Xhemal Efendiu në fshatin Ni–kushtak kishte mbajtur ligjëratë, në të cilën – veç tjerash – është

²¹⁸ ДАРМ, 1.885, Д. 1645, стр.11.

²¹⁹ ДАРМ, 1.885, Д. 1645, стр.10.

shprehur se “..Feja islame nuk shkatërrohet kurrë. Derisa nuk shkatërrohet bota, nuk shkatërrohet edhe Islami”. Në vazhdim, bashkëpunëtori thekson se Xhemali “ua tërhoqi vëmendjen xhematit, duke u thënë atyre se për çfarë arsye nuk e morën hoxhë për muajin e Ramazanit, si një i diplomuar dhe më i thirrur në këtë profesion²²⁰. Nga një shënim zyrtar bëhet e ditur se i punësuar shqiptar në polici si lëndë hulumtimi e ka pasur Xhemal Efendium. Polici në fjalë mundohet ta paraqesë molla Xhemën si person repressiv. Me datë 28 shtator 1977 personi që punonte në polici (Sali Ajdini) e takon hafëz Mustafën (i lindur 1954 në Kumanovë), njëkohësisht shok me molla Xhemën, për bisedë më të gjatë dhe ulen në ëmbëltoaren “Pehlivan” në Kumanovë. Nga kjo bisedë polici i lartcekur mësoi se molla Xhema nuk kishte armë dhe veturë, por ishte njeri shumë insistues në përhapjen e fesë dhe në themelimin e shkollave fetare. Molla Xhema e kishte dërguar të birin në tokat arabe për të mësuar për hoxhë. Kontrolli mbi të do të vazhdojë, ashtu që për çdo paraqitje të tij shërbimet do të ngrenë hetime²²¹.

Molla Xhema akuzohej për shumëçka vetëm sepse mendonte se shteti nuk duhet të ketë dorë në Bashkësinë Islame dhe në këshillat e xhamisë. Vetëm sepse mendonte se në fshatrat e Kumanovës duhet të rinovohen xhamitë dhe të hapej një medrese në Kumanovë. Ai llogaritej si iniciator për gjitha këto aktivitete fetare dhe trajtohej si person antishtetërorë.

Në një raport të personit me nofkën “Isak”, i cili referon para organeve për mbledhjen e cila u mbajt në hapësirat e Bashkësisë Islame të Kumanovës (më 6 mars 1984 në orën 10–11, ai rrëfen për rrjedhën e mbledhjes, ku është folur për kandidatët e mundshëm

²²⁰ ДАРМ, 1.885, Д. 1645, стр.21.

²²¹ ДАРМ, 1.885, Д. 1645, стр.23.

për kryetarë të këshillave të xhamive. Në gjitha xhamitë kishte një qetësi në përzgjedhje, pos në xhaminë qendrore të Kumanovës, për çka kishte mospajtime në lidhje me këshillin që do ta udhëhiqte xhaminë. Kështu informon ai²²².

Bashkëpunëtori policor me nofkën “Isak” tregon se një ditë prej ditëve në kohën e lutjes në xhami kishte shumë pjesëmarrës. Ky rast u shfrytëzua “për ti propozuar kandidatët e mundshëm për këshilla të xhamive, të cilët do të jenë të afërt me pushtetin”. Një person që ishte nën hetime me emrin Abedin Aqifi me nofkën “Penzioner”, i revoltuar nga kjo gjendje, çohet dhe e refuzon një përzgjedhje të këtillë. Duke iu drejtuar xhematit, Aqifi – ndër të tjera – theksoi se përzgjedhjet nuk përputhen me statutin e BFI-së. Për këtë arsye “kandidatët e përzgjedhur i konsideroj me presion të jashtëm”. Unë – vazhdon Aqifi – i njohë të drejtat tona në këtë fe dhe nuk pajtohem me këta kandidatë të propozuar. Ne vendosim se cilët kandidatë do të propozohen si kandidatë të mundshëm për këshill të xhamisë”. Sipas bashkëpunëtorit në fjalë, në xhami kishte qenë prezent edhe molla Xhema si imam i xhamisë, i cili ishte pajtuar plotësisht me Abdefin Aqifin²²³. Këtu shihet qartë se edhe molla Xhema ishte që pushteti mos të ketë qasje në këshillat e xhamisë. Nga ana tjetër, bashkëpunëtori me nofkën “Isak” çohet dhe thotë se “ne kemi dilema për kryetarin e këshillit të xhamisë, Demo Aqifin, i cili qëndrimet tona si këshill i xhamisë i shpërfaq në mesin e xhematit. Për këtë shkak kemi vendosur ta shkarkojmë nga detyra”. Në vazhdim shihet qartë se hetuesia do ta ndjekë personin me

²²² ДАРМ, 1.885, Д. 1645, стр.24.

²²³ ДАРМ, 1.885, Д. 1645, стр.25.

nofkën “Penzioner”, duke trajnuar persona të tjerë të përshtatshëm për ta përcjellë atë²²⁴.

Nga dokumentet arkivore vërehet se institucionet e hetuesisë e përcillnin punën e Bashkësisë Islame, në veçanti hoxhallarët me ndjenja të larta fetare e kombëtare. Është me rëndësi të vihet në dukje fakti se sipas burimeve policore një pjesë e ulemave bashkëpunonin ngushtë me organet e atëhershme të UDB-së. Kështu kryeimami i Myftinisë së Kumanovës, Iljaz Efendiu, nga f. Mateç, më 17 prill 1963 ishte ftuar nga po i njëjti shërbim për disa zhvillime në fshatrat e fushëgropës së Kumanovës. Qëllimi i thirrjes ishte vërtetimi i disa të dhënave në lidhje me fjalët dhe aktivitetet e disa prijësve fetarë nëpër fshatrat e Kumanovës, të cilët dëshironin rinovimin e xhamive. Fshatrat e përmendur në këtë rast ishin: Orizarja, Nikushtaku, Opaja, Likova, Llojani, Mateçi, Hotla dhe qyteti i Kumanovës. UDB-ja dëshironte të mësojë se nga buronte ideja për rinovim ose ndërtim të xhamisë dhe kush është iniciuesi i kësaj nisme. Në pyetjen se kush qëndron pas këtyre iniciativave, kryeimami nga Kumanova shprehet si më poshtë: “Në rajonin e Kumanovës, brenda Bashkësisë Islame, ka dy grupe hoxhallarësh. Grupi i parë i prin vijës së Ataulla Hoxhës. Në krye të këtij grupi është Ferat Ibrahimini nga fshati Nikushtak, me detyrë në fshatin Ramanli dhe Xhemal Xhemaili nga fshati Nikushtak, me detyrë në fshatin Grushinë. Shokët më të afërt dhe më besnikë të këtyre dyve janë: Ibrahim Bajrami, Ejup Jashari, Selim Ajvazi, Memet Azizi dhe Ejup Abdullahi... Hoxhallarët që rrjedhin nga shkolla e Ataulla Hoxhës gjatë ligjëratave të tyre potencojnë se ata shqiptarë që nuk kanë mjekra të gjata, që nuk mbajnë plis dhe që nuk i mbulojnë gratë e

²²⁴ ДАРМ, 1.885, Д. 1645, стр.26.

tyre me shami, nuk janë myslimanë. Të njëjtit janë kundër arsimit – mit të femrës dhe në këtë drejtim janë shumë radikalë...”²²⁵.

Kryeimami vazhdon të japë informata për të gjithë hoxhallarët e krahut të Ataullah Hoxhës, ku si shembull e merr hoxhën Ejup Jashari nga fshati Sllupçan, i cili – siç do të shprehet ai – në mektebin e tij “i mëson 5 apo 6 fëmijë”. “Në oborrin e shtëpisë së Hoxhës – vazhdon Iliazi – këta fëmijë vijnë të luajnë me fëmijët e Hoxhës, ndërsa më vonë i merr brenda dhe ua mëson leximin e Kur’anit. Kështu ndodhi edhe në disa fshatra tjerë të Kumanovës...”²²⁶. Nga kjo del se qëllimi kryesor i UDB-së ka qenë që, nëpërmjet kryeimamit, të vërtetohen disa të dhëna për iniciativën e disa hoxhallarëve për rinovimin e xhamive, si dhe a mësojnë fëmijë apo jo. Grupi i dytë i hoxhallarëve ishin të gjithë të tjerët.

Pas luftës së Dytë Botërore Xhemal Efendiut e ushtroi detyrën e imamit dhe mualimit në fshatin Ramanli të Kumanovës dhe një vit më pas kaloi si imam në fshatin Grushinë të Shkupit. Pasi doli nga burgu, e vazhdoi detyrën e imamit deri në vitin 1963 në fshatin Grushinë²²⁷. Pastaj shpërngulet në Kumanovë. Aty shtëpia e tij ishte shndërruar në mejtep dhe nga ky vend dolën diku 300 nxënës. Meqë përcillej nga pushteti, ai kishte vendosur që fëmijët t’i mësojë në shtëpi, që mos të bie në sy të njerëzve²²⁸.

Aktiviteti i Xhemal Efendiut në jetën fetare nuk kishte të ndalur. Në një raport tjetër nga personi që punonte për shtetin, të hartuar më 28 prill 1964, tregohet një bisedë mes dy personave, ku njëri ishte imam në fshatin Mateç e tjetri nga Kumanova. Ata, mes tje-

²²⁵ ДАРМ, 1.885, Д. 1645, стр.14.

²²⁶ ДАРМ, 1.885, Д. 1645, стр.14.

²²⁷ Taxhedin Bislimi, vepër e cit., fq.161.

²²⁸ Po aty, fq.161.

rash, bisedojnë se Xhemal Efendiu dhe Azem Hoxhan nga Kumanova marrin pjesë në një ceremoni fetare dhe para të pranishmëve flasin për kryetarin e Bashkësisë Fetare Islame, Bedri Hamidi, për të cilin – siç thuhet në deklaratën e bashkëpunëtorit të UDB-së – “nuk angazhohet shumë për të hapur një medrese në Kumanovë, siç që është ajo në Prishtinë”. “Nxënësit tanë – vazhdon deklarata – nuk kanë të holla për të shkuar të mësojnë në Prishtinë”. Azem Efendiu dhe Xhemal Efendiu para masës flasin, pra, për hapjen e një medreseje në Kumanovë, duke e alarmuar këtë çështje. Në anën tjetër Azem hoxha dëshiron ta sjellë Xhemal Efendium në Kumanovë si hoxhë..²²⁹

Në një raport tjetër të sigurimit shtetëror thuhet se për t’u vërtetuar të dhënat e mësipërme, ishte i ftuar bashkëpunëtori i tyre me nofkën “Eni Usta”, nga i cili kërkuan të dhëna në lidhje me të përfolurin Xhemal Efendiu. Gjithnjë sipas deklaratës së bashkëpunëtorit, Xhemal Efendiu “i nxiste njerëzit për të hapur një medrese në Kumanovë” dhe, madje, përgjegjësi i kësaj medreseje do të ishte pikërisht vet Xhemal ef. Xhemaili. Në vazhdim bashkëpunëtori flet për nismëtarin tjetër, përkatësisht për Azem Hoxhën²³⁰.

Pasi doli nga burgu, Xhemal Efendiu një kohë jetoi në fshatin e lindjes, e pastaj kaloi edhe në qytetin e Kumanovës. Në vitin 1986, bashkë me familjen, vendoset në Shkup. Vdiq më 1 mars të vitit 1997 dhe u varros në fshatin e lindjes në Nikushtak të Kumanovës²³¹.

²²⁹ ДАРМ, 1.885, Д. 1645, стр.18.

²³⁰ ДАРМ, 1.885, Д. 1645, стр.19-20.

²³¹ Taxhedin Bislimi, vepër e cit., fq.165.

Përfundimi

Nga sa u tha më sipër, mund të konkludojmë se Xhemal Efendiu ishte hoxhë i përkryer dhe i devotshëm. Në çdo fshat ku e ushtroi detyrën e hoxhës, ai e bëri atë e bëri me zell dhe me dëshirë. Nga ana tjetër edhe xhemati i çdo xhamie e donte një hoxhë ashtu siç ishte molla Xhema.

Në këtë tekst, me anë të burimeve arkivore, u vërtetua atdheas-huria e Xhemal Efendiu, si para organeve të hetuesisë, ashtu edhe para shokëve të idealit. Shokët nuk i tradhtoi asnjëherë dhe me asnjë çmim.

Në këtë punim vërtetohet se Xhemal Efendiu ishte njeri i paepur. Ai asnjëherë nuk iu nënshtrua pushtetit dhe ishte i gatshëm që edhe jetën ta flijojë për liri. Këtë e pagoi me heqje lirie (me burg), por ai nuk u lëkundë nga qëndrimet e idealit për një Shqipëri Etnike.

Edhe pasi doli nga burgu, ai vazhdoi punën si hoxhë. Atë që e mendohte, e thoshte pa kurrfarë hezitimi. I ftonte njerëzit në atë që ai besonte se është më e mirë për shoqërinë. Në këtë mënyrë nxori një numër të konsiderueshëm të nxënësve, që e mësuan leximin e Kuranit dhe mësim-besimin. Xhemal Efendiu si, në vijën kombëtare, edhe në atë fetare, mbetet një shembull për teologët mysli-manë, por edhe për të tjerët. Ai i tregoi kësaj shoqërie se si duhet ta duam fenë dhe atdheun.

MUZEMIL OSMANI

Bashkësia Fetare Islame e Republikës së Maqedonisë së Veriut

NJË PERSONALITET I TRADITËS DHE I FESË NË SHËRBIM TË KOMBIT DHE TË MIRËQENIES SHOQËRORE

Në letrat shqipe të karakterit islam, për shumë arsye, kryesisht të natyrës politike, keni një shkëputje të gjatë kohore të mendimit intelektual islam. Kjo dukuri vërehet sidomos tek popullata shqiptare në trevat e Maqedonisë, ku, edhe pse dikur pati traditë mendimi përkatës, megjithatë, për gati 70 vjet u ndërpre të menduarit dhe të gjykuarit publikisht sipas pikëpamjeve islame. Hoxhë Voka mund të konsiderohet si mendimtari i fundit mysliman para se mbi nënqiellin tonë të pllakos analfabetizmi dhe, pastaj, edhe ateizmi i cytur nga komunizmi ortodoks sllav.

Koha e mendimit intelektual islam

Kuadri teologjik asnjëherë nuk mungoi në trevat tona. Ai ishte i pranishëm gjithnjë. Popullata jonë, nga gjiri i vet, nxori mjaft dijetarë të devotshëm të proveniencës islame, mirëpo veprimtaria e tyre ishte ngushtuar dhe rrudhur gjithnjë në kuadër të predikimeve elementare islame. Më tej nuk lejohej. Opinioni islam dhe pikëpamjet nga këndvështrimi islam ishin të pamundshme. Çdo gjë që predikohej jashtë kornizave komuniste në gjuhën shqipe dhe për shqiptarët, sulmohej, përndiqej dhe burgosej. Në horizont ishte tendenca për krijimin e “kombit komunist”, që duhej t’i vishej ekskluzivisht popullit shqiptar. Këtu diku duhet kërkuar arsyet e ndërprerjes së atij mendimi angazhues dhe të atyre përpjekjeve publike për ta

kultivuar Islamin autokton dhe për ta avancuar mendimin islam e për ta shprehur atë në gjuhën shqipe. Censura dhe autocensura tashmë ishin ngritur “si policë kujdestarë” dhe ishte “institucionalizuar” në trurin e intelektualit shqiptar. Përpjekjet për ta neglizhuar këtë “polic kujdestar” do të vërehen me grupin e parë të teologëve tanë, që do të shkollohen në disa qendra islame të botës arabe. Por, edhe më tej do të pengohet mendimi islam origjinal në gjuhën shqipe. Nëpër ca broshura e ilmhale të kohës do të publikohen në gjuhën shqipe shkrime kryesisht të përkthyer nga gjuha boshnjake, nga gjuha arabe dhe turke. Pra, assesi të profilizohej mendimi intelektual shqip i veshur me petkun islam.

Vitet e nëntëdhjeta, kur do të përfundojë periudha komuniste, shqiptarët e Maqedonisë do t'i gjejë relativisht të kompletuar mirë në rrafshin e botës teologjike islame. Numri i studentëve të kthyer nga universitetet islame ishte mjaft i madh. Intelektualët e proveniencës islame kishin zënë vend në medresenë “Isa Beu”, nëpër organet e Bashkësisë Islame, si dhe nëpër xhamitë e ndryshme të vendit. Proceset e reja politike të vendit gjithsesi që e mobilizuan edhe kuadrin tonë teologjik. Opinionet dhe pikëpamjet islame nisën të qarkullonin publikisht. Pa dyshim, kishte nevojë për një profilizim të mendimit intelektual shqiptar, i cili do të ndikonte në përpjekjet e para publike për ta rifuqizuar identitetin autokton islam të shqiptarëve të vendit. Këtij procesi, pa dyshim, do t'i prijë Kryetari i Bashkësisë Islame të RM (sot: RMV), H. Sulejman ef. Rexhepi.

Rikthimi i traditës: feja në shërbim të kombit dhe të mirëqenies

Në këtë periudhë jo vetëm që duhej guxim, por edhe strategji, si dhe afinitete për ta orientuar zhvillimin e jetës fetare islame në dy

kahe: për ta riorganizuar dhe për ta fuqizuar institucionalizimin e jetës fetare islame, si dhe për ta profilizuar dhe për ta bërë me iden-titet burimor shqiptar tërë atë qasje islame, e cila ishte në rrezik që të ngjyrosej me elemente joautoktone.

Paraqitjet publike, të shpeshta, si dhe tepër të guximshme, të H. Sulejman ef. Rexhepit, e detyruan edhe politikën zyrtare shtetërore që të ketë më shumë kujdes ndaj Islamit dhe myslimanëve të vendit. Ky guxim prej intelektualit të lartë islam ua hapi shtegun edhe bashkëpunëtorëve të tjerë të tij, të cilët, duke publikuar herë pas here vështrime islame, dhanë kontributin e tyre drejt të menduarit më shkencërisht, si dhe drejt ballafaqimit me problemet e shumta shkencore islame. Jeta fetare islame, bashkë me mendimin islam autokton, po zhvillohej gjithnjë e më shumë.

Pra, me H. Sulejman ef. Rexhepin u ngrit ajo urë lidhëse e mendimit tradicional islam me mendimin bashkëkohor e intelektual, i cili pa dyshim që ishte në funksion të zgjidhjeve edhe të shumë problemeve kombëtare në vend. Tradita e teologëve shqiptarë, për të dhënë kontribut drejt zgjidhjeve të problemeve kombëtare, mori hov edhe më të madh sidomos me daljen në skenë të efendi Rexhepit si lider fetar i myslimanëve të Maqedonisë.

Opinionet e tij, pikëpamjet e tij, qasjet e tij në zgjidhjen e problemeve fetare e kombëtare, pa dyshim që kanë lënë gjurmë të pashlyeshme gjatë kësaj kohe dhe gjatë tërë historisë kombëtare. I cituar dhe i respektuar jo vetëm në botën shqiptare, por edhe më gjerë, H. Sulejman ef. Rexhepi do të bëhet model i mendimtarit origjinal dhe vizionar.

Filozofia fetare e efendi Rexhepit është “ta ruajmë dhe ta kultivojmë Islamin burimor shqiptar”, ndërsa filozofia politike e tij është

që “pa fe nuk ka atdhe”, dy filozofi këto që pa dyshim përbëjnë shkollën që bart emrin e Sulejman Rexhepit.

Këto dy filozofi tashmë i kanë kornizat e veta, i kanë kopertinat e veta, që do të thotë se janë përmbledhur dhe përfshirë në disa tituj librash.

Sulejman efendi Rexhepi, si Kryetar i Bashkësisë Islame të Maqedonisë së Veriut, është një lidërsip i gjallë, një model lideri që inspiron udhëheqje të përkryer drejt zgjidhjes së shumë problemeve, qofshin ato fetare ose kombëtare.

Koha e “anonimatit absolut”

Debati, mendimi ndryshe, shprehja e mendimit alternativ, kundërshtimi i pikëpamjeve, ofertat avancuese, gjithnjë garantojnë perspektivë të suksesshme dhe sigurojnë kapjen e majave të suksesit. Kur ky “konfliktualitet pozitiv” zhvillohet brenda komunitetit, atëherë pa dyshim se ngrihet një shoqëri e shëndoshë. Fundja, ky do të duhej të ishte synim i çdo elite, i çdo lideri, i çdo udhëheqësi.

Në shoqëritë që lëngojnë nga “fatkeqësia multietnike”, e shkaktuar nga zhvillimi i koncepteve megalomane, kemi pastaj tjerren e teorive të konspiracionit, sepse perspektiva shikohet pikërisht nga aparatit me dioptri konspirative. Për t’u zhvilluar ky sistem që rrënon çdo vlerë të multinacionalitetit dhe të multikulturalizmit, duke e imponuar “më të madhin”, kjo më së lehti arrihet përmes prodhimit dhe instalimit të lojtarëve që do të gëzojnë jo vetëm përkrahje absolute institucionale, por, nëse e do nevoja, edhe “anonimatin absolut” (kur të njeh pushteti me emër e mbiemër, lëvozhga e anonimitetit ngjan në cipën e qepës). Kjo metodologji diversante e pushtetit në kohë paqeje aplikohet me qëllim të zvetënimit të

peshës së liderit të një komuniteti intelektual, politik e fetar, por edhe të vënies nën kontroll të veprimtarive të subjekteve gjegjëse. Synimi nuk ngel vetëm në këto suaza të ngushta, por qëllimi final është konfliktualiteti negativ, përplasjet fizike, shkaktimi i sjelljeve ekstremiste, e deri te lëkundja e themeleve të një subjekti të caktuar, me qëllim të intervenimit të pushtetit për ta zgjidhur situatën. Pra, duke tentuar pushteti që të marrë fytyrën e “shpëtimtarit”, në fakt e maskon fytyrën e vet të vërtetë prej armiku të përbetuar kundër të gjithë atyre që nuk i nënshtrohen ideologjisë së pushtetit.

Sukseset e Ef. Rexhepit

Sukseset e tij konsistojnë:

- në sigurimit e qindra bursave për shkollimin e lartë të kuadrit tonë nëpër universitete e qendra të ndryshme islame;
- në përpjekjet permanente drejt zhvillimit dhe të kultivimit të Islamit tradicional dhe autokton, të atij Islami që na e lan trashëgim të parët tanë;
- në apelin gjithnjë e më të fuqishëm për shkollimin e femrës muslimane deri në instancat më të larta arsimore;
- në koordinimin e punëve me të gjitha subjektet politike të bllokut musliman, të cilat në programet e tyre partiake nënvizojnë ruajtjen e trashëgimisë shpirtërore islame, si dhe avancimin e jetës fetare islame;
- në përkrahjen e gjithanshme për themelimin e universitetit të parë në gjuhën shqipe në Maqedoninë e Veriut, të Universitetit të Tetovës;

- në dhënien e kontributit vetëmohues në ngritjen e Medresesë “Isa Beu”;
- në themelimin dhe në ngritjen e objektit të Fakultetit të Shkencave Islame në RMV;
- në disperzimin e paraleleve për femra e për djem të kësaj medrese në disa qendra të Maqedonisë së Veriut;
- në hedhjen e gurit themeltar për mbi 100 xhami anekënd territorit;
- në menaxhimin e krizave humanitare për mbi 20 mijë myslimanë nga Bosnja dhe për mbi 300 mijë shqiptarë nga Kosova;
- në menaxhimin e krizës humanitare gjatë konfliktit në Maqedoninë e Veriut në vitin 2001; dhe, mbi të gjitha,
- në kultivimin dhe përhapjen e mendimit intelektual e akademik mbi çështjet islame te popullata jonë, mbi ruajtjen dhe forcimin e unitetit tonë fetar e kombëtar dhe, si rrjedhojë e këtij angazhimi, në devalvimin e lojërave të dyshimta, në zbërthimin e tyre, si dhe në neutralizimin e të gjithë lojtarëve të shërbimeve të ndryshme të vendit dhe të infiltruar nga jashtë.

Inicimi dhe kontributi i H. Sulejman ef. Rexhepit për organizimin dhe mbajtjen e një konferencë në hapësirat e Medresesë “Isa Beu” me titull “Shqiptarët e Maqedonisë”, do të jetë halë e përrjetshme në sytë e çdo pushtetari antishqiptar.

BOTUES:
INSTITUTI I TRASHËGIMISË SHPIRTËRORE
E KULTURORE TË SHQIPTARËVE – SHKUP
FAKULTETI I SHKENCAVE ISLAME – SHKUP

SCUPI, vëllimi 27 – 2019

Kryeredaktor: Dr. Zeqirija Ibrahim
Përgjegjës i botimit: Dr. Sevdail Demiri
Redaktor teknik: Naser Fera

Shtypi: Focus Print – Shkup
Tirazhi: 500 copë

Ky vëllim i 'Scupi-t' botohet me vendimin e Këshillit
të ITSHKSH–Shkup nr. 0201–09/2 të datës 14.01.2019

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

323.1(=18):28(497.7)(082)

ROLI i islamit në mbrojtjen e identitetit shqiptar në Maqedoni :
(konferenca mbajtur më 13 qershor 2019) / [kryeredaktor Zeqirija
Ibrahimi]. - Shkup : Instituti i trashëgimisë shpirtërore e kulturore të
shqiptarëve, 2019. - 202 стр. : илустр. ; 21 см. - (Biblioteka Scupi ; v 27)

Фусноти кон текстот

ISBN 978-608-4653-98-1

а) Албански идентитет - Заштита - Улогата на исламот - Македонија -
Зборници

COBISS.MK-ID 111015946